



DALAN SHAPLLO



**VEPRA
DHE
PROBLEME
TË
REALIZMIT
SOCIALIST**

Artikuj kritikë



ANALIZË MARKSISTE-LENINISTE DHE FRYMËZIM PËR ZHVILLIMIN E GJITHANSHËM TË ARTIT

— Vëllimi «Raporte e fjalime»; 1974-1975 të shokut
Enver Hoxha —

Fjala e shokut Enver Hoxha, mbajtur në 20 dhjetor 1974 në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH, që përfshihet në vëllimin «Raporte e fjalime», 1974-1975, është një përgjithësim i gjendjes, i detyrave dhe i perspektivave të krijimtarisë sonë artistike në periudhën e zhvillimit të saj pas Plenumit të 4-t të KQ të PPSH të qershorit 1973. Shoku Enver Hoxha ngriti një varg problemesh me rëndësi teorike e praktike, të cilat kanë vlerë aktuale për formimin filozofik dhe estetik të krijuesve dhe për lëvrimin e harmonishëm të gjinive dhe llojeve të ndryshme të artit.

Idetë dhe orientimet që dha shoku Enver në fjalën e tij, kanë të bëjnë me luftën midis pikëpamjeve marksiste-leniniste dhe pikëpamjeve idealiste e regresive, midis botëkuptimit materialist e revolucionar, që bart me vete ndjenjën realiste e optimiste mbi ngjarjet dhe njerëzit, dhe botëkuptimit idealist, mistik, me ndjenjën pesimiste, me vështrimin e shtrembër, irreal të sendeve. Mësimet e tij mbështeten thellësisht në filozofinë marksiste-leniniste, në

gjendjen reale të letërsisë e të arteve dhe ndihmojnë për të çelur udhë të reja.

Problemet që ngriti shoku Enver Hoxha në fjalën e 20 dhjetorit lidhen me detyrat e krijimtarisë pas Plenumit të 4-t të KQ të PPSH dhe me aspektet e reja që dalin në kushtet e arritjeve të dukshme në shumë fusha të artit, sidomos në disa gjini e lloje të veçanta, që përfaqësojnë denjësisht kohën tonë. Në këtë fjalim u trajtuan problemet teorike e praktike që lidhen me rolin e shkrimtarëve, artistëve dhe gjithë punonjësve të artit për formimin botëkuptimor të njeriut tonë, për të rrënjosur tek ai dhe në shoqëri, siç thekson shoku Enver Hoxha, «atë botëkuptim, ato zakone, ato ndjenja, ato shije, atë etikë, atë filozofi revolucionare që të mos lejojë pikërisht as ringjalljen e as përhapjen e botëkuptimeve mikroborgjeze e borgjeze. Ky vlerësim i lartë që u bëri shoku Enver Hoxha rolit të artit dhe shkrimtarëve e artistëve si «ndihmës të Partisë për edukimin komunist të njerëzve tanë», është një nxitje dhe inkurajim për ta shpурë më tej krijimtarinë dhe për t'i dhënë asaj një përmbajtje gjithnjë më të thellë filozofike dhe artistike. Për këtë kërkohet njohja e thellë e shoqërisë, e tipave, e veprimtarisë së njeriut në të gjitha punët e mëdha të vendit tonë, kërkohet vëzhgimi i realitetit përmes luftës së të kundërtave, duke hyrë në ndërgjegjen e njeriut, duke luftuar «skutat e errëta» dhe duke lartësuar moralin dhe virtytet komuniste. Kryerja e këtij misioni nga artisti kërkon një art të vërtetë, të cilin ne e kemi e duam ta zhvillojmë edhe më tej; kërkon thellësi mendimi dhe njohje të jetës; mospajtim me shfaqjet e botëkuptimeve të huaja, si dhe me cektësinë dhe kalimin shkarazi të problemeve që nxjerr jeta.

Arti ynë, si pjesë përbërëse e ndërgjegjes së shoqërisë socialiste, i kundërvihet gjallërisht artit borgjez e revizionist, gjithë rrymave dhe mënyrave irrealë, të çoroditura, ose pesimiste dhe të përshkuara nga ankthi që sundojnë në këto lloje artesh. Praktika jonë

dëshmon për këtë kundërvënie dhe për zhvillimin e mbarë të letërsisë, arteve figurative, muzikës, kinemasë dhe arteve të tjera tek ne. Uniteti i pikëpamjeve filozofike, qëllimi i përbashkët për t'i shërbyer popullit, përparimit shoqëror, komunizmit; pasioni për të luftuar të keqen, padrejtësinë, tradhtinë revizioniste dhe çdo kalbëzim, krijojnë mundësinë për një art të vërtetë me vlera të vërteta shoqërore dhe artistike. Orientimet e Partisë dhe të shokut Enver Hoxha kurdoherë kanë qënë një frymëzim i madh për një art të tillë, të cilin e ndjek dhe e do populli, që gëzon simpati edhe jashtë kufijve të atdheut.

Probleme si ai i edukimit të poetëve dhe përgjithësisht i krijuesve të rinj, i zhvillimit të mëtejshëm të dramës e të gjinisë skenike, i kritikës letrare dhe artistike, i raportit midis krijimtarisë së kultivuar dhe folklorit, si dhe të tjera, janë trajtuar në mënyrë të veçantë në fjalën e 20 dhjetorit 1974. Të gjitha këto, në lidhje të ngushtë me atë problem themelor të forcimit të botëkuptimit revolucionar për të cilin folëm, janë studiuar dhe studiohen mirë nga punonjësit e kulturës e të artit dhe ka pasur arritje të mëtejshme. Këto porosi të shokut Enver Hoxha kanë hapur horizonte dhe janë zbatuar në praktikë.

Pa dashur të bëjmë bilancin e punëve, po duke nxjerrë disa konkluzione për të mirat e dobësitë, do të vërenim se gjatë kësaj periudhe, pas fjalës së shokut Enver Hoxha dhe orientimeve që u dhanë në Kongresin e 7 të Partisë, është forcuar roli edukues i artit, roli i madh i tij për forcimin botëkuptimor materialist dhe revolucionar të njerëzve tanë. Romani, poema (në disa nga veprat më të mira), filmi, piktura e skulptura, disa nga gjinitë e mëdha muzikore dhe kënga, balleti, si dhe lëvizja amatore përgjithësisht, kanë shënuar suksese të ndieshme. Si në filma ashtu edhe në romane, duke u nisur nga skenarët, si dhe nga veprat që janë në shtyp, mendojmë se do të ketë përsëri ngjitje në këto gjini. Skulptura monumentale, si një art

i denjë për epokën tonë madhështore dhe heroike. larg pompozitetit dhe gjigantomanisë, ka pasur vepra të bukura, të cilat do të vijnë duke u shtuar po të zgjidhen më mirë disa probleme konkrete e praktike, si dhe po të ketë një konceptim ideestetik më të qartë për kërkesat e këtij lloji arti. Mjaft probleme dalin për demokratizimin dhe larminë e mëtejshme të këngës, për një harmoni më të madhe midis tekstit poetik dhe muzikës, me gjithë përparimet e bëra. Po kështu edhe për gjinitë e mëdha muzikore, për muzikën koncertale, simfonike etj., dalin probleme të një përparimi të mëtejshëm, sepse këto gjini, krahas të tjerave, japin mundësi për trajtimin e mendimeve e të ndjenjave më komplekse e më të plota, për të shprehur kështu më mirë botën e njeriut të sotëm.

Një punë e madhe dhe e vazhdueshme bëhet me talentet e reja. Poetët e rinj, si dhe prozatorët (ndonëse këta janë relativisht më të paktë), janë bashkëpunëtorë të rregullt të shtypit dhe botojnë vëllime të shumta poetike. Në vijat kryesore poezia e tyre është e shëndetshme, sjell freskinë e moshës e viseve ku ka buruar; sinqeriteti dhe optimizmi janë tipare të poezisë së të rinjve që shkruajnë për atdheun, Partinë, për bukurinë e tokës, aksionet dhe dashurinë e pastër. Kjo poezi e tyre, për fat të keq, nuk është analizuar e vlerësuar sa duhet edhe nga kritika jonë. Vihet re një afrim më i madh ndaj jetës; më shumë realitet dhe më pak fantazi e trilluar duket në krijimet e tyre më të mira, ku ndihet edhe një formë kombëtare, varg e gjuhë më të punuara dhe më afër traditës sonë. Por ka edhe dobësi. Ata mund të mësojnë më shumë nga poetët tanë më të mirë dhe nga folklori. Ka vëllime poetike ose poezi të botuara në shtyp që nuk lënë gjurmë, janë prozaike, të rëndomta dhe më mirë do të ishte të mos botoheshin. Me gjithë qartësinë më të madhe të mendimit dhe të gjuhës që ka fituar kjo poezi, ka ende raste figurash të papërcaktuara e të pakapshme, ka raste që nuk është gjetur çasti i frymëzimit, sepse

fantazia nuk ushqehet sa duhet nga vrotimet reale, jetësore.

Dramaturgjia dhe teatri janë një art shumë i kërkuar dhe i domosdoshëm për shoqërinë tonë, ku komunikimi me mijëra spektatorë është i drejtpërdrejtë. Kënaqësia që zgjon një shfaqje e bukur teatrale është e madhe, sepse arti i fjalës gërshetohet me lojën e aktorit, me pikturën etj. Pas Plenumit të 4-t të KQ të PPSH edhe dramaturgjia e teatri janë zhvilluar. Janë shkruar e vënë në skenë vepra të arritura, të cilat teatri, në shumicën e rasteve, i ka paraqitur drejt dhe u ka nxjerrë në pah vlerat si, «Lulet e shëgës» dhe «Përmbytja e madhe» të K. Jakovës, «Zonja nga qyteti» e R. Pulahës, «Gjëmimi i atij dimri» e T. Laços, «Shënomëni dhe mua» e H. Minarollit, «Djem të mbarë» e F. Krajës etj. Jeta teatrale është gjallëruar në njëfarë shkalle, po ky gjallërim ka qenë me hope, nuk ka qenë i vazhdueshëm. Kërkesat e publikut janë të mëdha, është vetë karakteri i theksuar demokratik i këtij arti, që njerëzit e kërkojnë kaq shumë dhe presin prej tij më tepër. «Është e domosdoshme, — thekson shoku Enver Hoxha, — që dramaturgjia jonë të ngrihet në një nivel sa më të përsosur, t'u largohet banaliteteve dhe jo vetëm t'i përgjigjet shkallës së sotme të kulturës së masave që frekuentojnë këtë teatër, por ky të jetë njëkohësisht frymëzuesi i një përparimi të mëtejshëm të shijeve dhe të hovit revolucionar për një jetë më të kulturuar».

Teatri ynë, siç thotë shoku Enver Hoxha, është popullor, socialist, ai nuk ndjell atmosferë të errët dhe gjendje ankthi, nuk është pjellë e mendjeve të çoroditura e hipnotizuese. Fryma e tij është e shëndoshë dhe edukuese. Por ne flasim për një përparim më të madh, për një kulturë më të dukshme të tij, për një dramaturgjia që t'i përgjigjet kohës, të pasqyrojë bukur, përmes kontradiktash dhe me zgjidhje të drejtë, realitetin e sotëm ose të kaluar. A ia kemi arritur një nivel të tillë? Nuk mund të themi se po, me gjithë sukseset e

arritura. Shkaku kryesor është mungesa e repertorit e, në raste të veçanta, e zgjedhjes së tij të pasuksesshme. Por kryesore është se ka pak drama të mira dhe duhet një mobilizim më i madh nga krijuesit për t'i pasuruar repertorët. Bien në sy ende krijime të parrealizuara, shfaqje të rëndomta e skematike, dialog i varfër, dramatizime bajate, që nuk ia nxjerrin në pah vlerat veprës, por ia zbehin. Pamjet dhe ndeshjet e mëdha të kohës gjejnë ende pak vend në skenat e teatrove tona. Ky art duhet të zërë më mirë vendin që i takon për të udhëhequr shijet dhe jo për të kultivuar shijet e prapambetura.

Me gjithë përpjekjet e disa estradave, si të Durrësit, Tiranës, Shkodrës, Fierit etj., përsëri ky teatër mbetet prapa dhe nuk i kënaq shijet dhe kërkesat e publikut të sotëm. Humor i rëndomtë, i sforcuar, pa mençuri, rendja pas një suksesi të sipërfaqshëm e banal vihen re shpesh në shfaqjet e estradave, ku problemat kryesor e përbëjnë gjithashtu repertorët, skeçet, kultura e interpretimit dhe e fjalës shqipe. Humori popullor ka hyrë më shumë kohët e fundit, po më tepër përpjekje mund të bëhen për t'i pasuruar estradat tona me këtë frymë.

Një problem tjetër që ngre shoku Enver Hoxha, është ai i kritikës, i dobësive të saj. Gjatë kësaj periudhe mund të themi se janë hedhur disa hapa përpara, janë luftuar mënyrat e pakapshme, toni didaskalik e analiza e përgjithshme dhe globale e saj. Janë rrahur gjerësisht disa probleme, si mbi karakterin kombëtar, mbi romanin, mbi artet figurative etj. Po ende kritika mbetet prapa në krahasim me krijimtarinë dhe nuk ndjek si duhet procesin e krijimit, nuk kap problemet më të mprehta, t'i analizojë ato konkretisht dhe të ndihmojë për rrugët e zgjidhjes. Kritika duhet të luftojë frazat e përgjithshme, si dhe ngadalësinë e saj në prononcimin ndaj fenomeneve e veprave të reja.

Fjala e 20 dhjetorit e shokut Enver Hoxha është një dokument i rëndësishëm partie, që i frymëzon krijuesit

dhe nxit për diskutimin dhe rrahjen e problemeve aktuale të artit. Duke u mbështetur në mësimet e Partisë dhe të shokut Enver Hoxha, me punë, me analizën e saktë të çështjeve dhe me një njohje të thelluar të jetës, shkrimtarët dhe artistët tanë, kritikët e studiuesit do të aktivizohen edhe më tepër për ta shpурë më përpara artin tonë në të gjitha llojet e gjinitë, dhe sidomos atje ku ka nevojë për ecje më të dukshme përpara.

1977

KUPTIMI I DREJTË I REALIZMIT SOCIALIST DHE LUFTA PËR MBROJTJEN E TIJ

Një ndër problemet e rëndësishme teorike dhe praktike që lidhet me artin tonë socialist dhe, përgjithësisht, me mendimin estetik revolucionar është problemi i metodës krijuese të këtij arti, i thelbit të saj dhe i luftës që është bërë e po bëhet për ta mbrojtur nga sulmet borgjeze dhe revizioniste.

Shoku Enver ka folur shpeshherë për parimet e realizmit socialist, për kuptimin e drejtë të këtyre parimeve, të shikuara në tërësinë e vet, si metodë artistike. Ai e ka parë metodën me një sy historik, në etapa të zhvillimit të shoqërisë sonë dhe të vetë artit, në prizmin e luftës ideologjike, kundër çdo devijimi si edhe, në plan botëror, kundër pikëpamjeve të mbështetura në estetikën idealiste, dekadente e formaliste. Orientimet e Partisë dhe të shokut Enver për kuptimin e drejtë dhe mbrojtjen e realizmit socialist kanë udhëhequr ideologjikisht shkrimtarët, artistët, studiuesit e kritikët tanë në punën e tyre krijuese.

Mësimet e Partisë mbi realizmin socialist mbështeten në mendimin e klasikëve të marksizëm-leninizmit, Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit për artin revolucionar, në përvojën e artit të proletariatit botëror dhe në

përvojën e historisë së vendit tonë e të kulturës e artit socialist tek ne.

Siç dihet, koncepti i realizmit socialist nuk lindi menjëherë. Marksii dhe Engelsii bënë fjalë për një lëtrësi të klasës punëtore, të revolucionit, për një realizëm të tipit të ri që ta shikonte kohën dhe shoqërinë në prizmin e materializmit historik dhe dialektik, përmes specifikës së artit. Ata flisnin për artin që do t'i takonte epokës së komunizmit. Lenini përcaktoi parimin themelor të realizmit socialist, partishmërinë proletare, një parim i ri revolucionar në mendimin estetik të deriatëhershëm. Kritikët e teoricienët marksistë i quajtën veprat e para, që shprehnin botëkuptimin e klasës punëtore, vepra të tipit socialist. Me zhvillimin e artit të ri, pas Revolucionit Socialist të Tetorit, doli më qartë dhe në mënyrë të natyrshme nevoja e përcaktimit të metodës krijuese, realizmit socialist, ashtu siç ka dalë edhe në epoka të tjera nevoja për të formuluar parimet e metodave të klasicizmit, romantizmit, realizmit kritik etj. Një art që thotë të vërtetën e jetës, që e shikon zhvillimin si pasojë e luftës së klasave dhe që ndriçon me idealin revolucionar, e thërret shoqërinë përpara drejt revolucionit, për përparimin dhe lumturinë e njeriut punonjës — ky do të ishte synimi kryesor i kësaj metode krijuese.

Shoku Enver na ka porositur gjithmonë që të studiojmë në thellësi klasikët, estetikën revolucionare marksiste-leniniste dhe të mbrojmë partishmërinë proletare, karakterin kombëtar, të kuptojmë drejt problemin e heroit pozitiv si dhe parimet e aspektet e tjera që lidhen me metodën e realizmit socialist.

Duke folur për mësimet e Partisë dhe të shokut Enver mbi realizmin socialist, është me rëndësi, si problem i parë, ai i vendosjes së drejtë të këtij nocioni në kuptimin e përgjithshëm filozofik e estetik, konsekuenca dhe evoluimi i mendimit të Partisë sonë krahas zhvillimit të shoqërisë dhe të artit.

Realizmi socialist nuk është parë kurrë tek ne si një formulë skolastike, si një sistem estetik i marrë hua,

po si drejtim i ri letrar-artistik, historikisht i domosdoshëm dhe i lindur përmes përvojës botërore, po në kushtet konkrete të vendit tonë. Prandaj ai është shikuar me premissat, gjenezën, kristalizimin dhe konsolidimin e tij, sipas ideologjisë marksiste-leniniste, në realitetin shqiptar.

Në fjalimet, përshëndetjet, letrat, shoku Enver ka përmendur shumë herë edhe përfaqësues të mëdhenj kombëtarë ose të huaj të letërsisë dhe artit që u takojnë drejtimeve dhe metodave të tjera krijuese përparimtare si romantizmit, realizmit etj. Ai ka përmendur me dashuri të madhe Naimin, ka çmuar autorë të tjerë shqiptarë të së kaluarës si edhe të realizmit socialist. Krahas Gorkit e Majakovskit, si shkrimtarë të realizmit socialist, krahas shkrimtarëve të tjerë me prirje demokratike e revolucionare si Romen Rolani etj., shoku Enver ka folur shpesh me simpati për Molierin, Balzakun, Hygonë e mjaft të tjerë, duke tërhequr vëmendjen që të kuptohet thelbi i klasor e social i veprës së tyre dhe të mos shihen në sipërfaqe.

Drejtimet dhe metodat (si tërësi parimesh e sistemesh estetike) lindin në kushte të caktuara social-historike dhe arti përparimtar ka kaluar nëpër një proces të gjatë historik, me anët pozitive, po edhe me kufizimet e veta. Edhe arti i epokës së revolucionit proletar dhe i socializmit do të ketë drejtimin e vet, se përgjithësimet teorike burojnë nga praktika dhe kanë si bazë filozofike marksizëm-leninizmin. Për këtë botëkuptim, për vështrimin materialist të jetës, kundër vështrimeve idealiste, mistike, iluzore flet shoku Enver, sidomos në fjalën e tij të 20 dhjetorit 1974, duke hapur horizont të gjerë para krijuesve të realizmit socialist, si ndihmës të Partisë në edukimin komunist të masave.

Tiparet e letërsisë së realizmit socialist, që u formua duke u mbështetur në realitetin e Luftës e udhëhequr nga Partia dhe shoku Enver, u dukën që në krijimet e para. Ndër shembujt tipikë të asaj kohe, «Epopeja e Ballit Kombëtar» e Sh. Musarajt, që lindi gjatë Luftës, shpreh karakterin popullor dhe partishmërinë në

forma shumë të afërta për popullin dhe partizanët. Po kështu poema «Prishtina» e Ll. Siliqit, që e mori frymëzimin në Luftë po u krijua pas Luftës, e konkretizon frymën e Partisë shumë qartë dhe përshkohet nga një palos i dukshëm revolucionar, tipare që do ta shoqëronin gjithmonë poezinë tonë.

Në etapa të ndryshme, duke parë nga afër letërsinë dhe artin, forcimin dhe përhapjen e tij përmes luftës së klasave, shoku Enver gjithmonë ka inkurajuar dhe ka vënë në dukje kristalizimin e metodës së realizmit socialist, ka orientuar që të ecet në këtë rrugë. Kështu, më 1948 duke pasur parasysh Konferencën II të Lidhjes së Shkrimtarëve, të vitit 1946, shoku Enver ka thënë: «Që prej kësaj kohe gjithnjë më shumë bëhet i theksuar drejtimi i ri në letërsi, lufta për ideologjinë socialiste, për realizmin socialist».1) Ndërsa më 1949, duke iu drejtuar shkrimtarëve të rinj, shoku Enver ka orientuar: «Realizmi socialist duhet të bëhet metodë drejtuese në detyrën e madhe që kanë shkrimtarët tanë të rinj popullorë».2) Me lulëzimin e mëtejshëm të artit, me daljen e problemeve më të ndërlikuara, me ashpërsimin e luftës ideologjike, edhe mësimet e Partisë e të shokut Enver janë më komplekse dhe ndihmojnë në zgjidhjen e problemeve themelore të realizmit socialist, për ta parë atë në zhvillimin dialektik, në raportin midis objektit e subjektit, në luftën filozofike midis materializmit e idealizmit dhe në transformim të vazhdueshëm.

Problemi i dytë, në mësimet e Partisë dhe të shokut Enver për këtë aspekt teorik, lidhet me të kuptuarit e thelbit të realizmit socialist, me novatorizmin, me ndryshimin nga metodat e tjera dhe me synimin kryesor të tij.

Që nga fundi i viteve '40 shoku Enver, në këshillat që u jepte shkrimtarëve të rinj, tregonte se ku duhet ta përqendronin vëmendjen dhe si ta kuptonin qartë e

1) E. Hoxha, «Mbi letërsinë dhe artin», f. 22

2) Po aty, f. 34

thjeshtë këtë metodë që po përvetësonin. Duke iu drejtuar shkrimtarit të ri, ai thoshte: «*Jetën dhe procesin e zhvillimit ta shohë në të gjitha pamjet, në mënyrë realiste dhe në dinamizmin e progresivitetin e saj*».1) Në orientimin e dhënë shkrimtarëve të rinj, dalin disa anë në të kuptuarit e realizmit socialist, si uniteti i traditës me novatorizmin, përvetësimi i trashëgimisë realiste, pasqyrimi kompleks i jetës (pra luftë kundër skematizimit dhe shikimit të njëanshëm) si dhe trajtimi novator i realitetit në prizmin e zhvillimit dinamik e të progresit. Kjo do të thotë t'i kesh këmbët në tokë, të nisesh nga jeta, nga populli yt dhe të shohësh gjithmonë përpara. Duke zbatuar këtë porosi të Partisë dhe të shokut Enver, të mbështetur në realitetin e transformuar, shkrimtarët dhe artistët tanë dhanë në vitet '50 e më vonë vepra që mishërojnë në vetvete këto kërkesa. U lëvruan gjinitë e mëdha që pasqyrojnë më gjerë jetën dhe u zbatuan më mirë në të gjitha llojet e gjinitë parimet e realizmit socialist.

Shoku Enver gjithmonë ka theksuar se arti i realizmit ecën përpara përmes luftës klasore, ideologjike-estetike, se përsëritja mekanike e metodave të vjetra nuk pajtohet me partishmërinë, me novatorizmin dhe se duhen luftuar si ndikimet moderniste, ashtu edhe mbeturinat e rrymave të kaluara në brendi dhe në formë. Kështu, përsëri në «Këshilla për shkrimtarët e rinj», ai orientonte për të mos mbetur te kufijtë e realizmit të tipit të vjetër, që mjaftohej vetëm me kritikën e ndonjë aspekti të shoqërisë së dikurshme, siç ndihej në ndonjë krijim të kohës, por duhej shkuar drejt realizmit të ri socialist, që përveç kritikës më të thelluar e më tendencioze të së vjetrës, do të pasqyronte në radhë të parë «*realitetin e ri, jetën e re, forcën e re*».2) Ky këhim i fuqishëm drejt realitetit, për të cilin këshillonte shoku Enver, është dukur që në vitet e Luf-

1) E. Hoxha. «Mbi letërsinë dhe artin», f. 34

2) Po aty, f. 33


tës e do të merrte pas Çlirimit një hov edhe më të madh që vjen gjer në ditët tona.

Lufta me romantizmin e sëmurë, me melodramatizmin e, në një plan politik e ideologjik, lufta kundër oportunitizmit e liberalizmit, kundër modernizmit e konservatorizmit, për të cilat ka folur vazhdimisht shoku Enver në etapa të ndryshme të zhvillimit, tregon se realizmi socialist nuk është një metodë e kristalizuar që në fillim dhe jashtë ndikimeve e shfaqjeve të huaja. Ajo ecën përpara në luftë të vazhdueshme me armiqtë e saj, me presionin borgjezo-revizionist, me të kuptuarit e cekët, me njohjen e paktë të jetës dhe të filozofisë marksiste-leniniste, me konceptimin formalist e eklektik të metodës, me skematizmin dhe pikëpamjet e ngurta. Mësimet e shokut Enver na vlejné për të kuptuar rrugën historike të artit tonë dhe të artit botëror, të sotmen dhe të ardhmen e tij.

Thelbi i realizmit socialist lidhet me konceptimin e drejtë të parimit të tij bazë, partishmërisë proletare, i cili, siç theksohet nga Partia, mbetet gjithmonë problem themelor dhe aktual për artin socialist. Largimi nga ky parim si edhe nga karakteri kombëtar, nga realizmi në brendi dhe në formë, shpuri sidomos para Plenumit të 4-t 1973, në disa shtrembërime të metodës që u goditën ashpër nga Partia. Lufta kundër tyre ka forcuar edhe më tepër pozitën e realizmit socialist dhe ka bërë të mundur një përparim të mëtejshëm të letërsisë dhe arteve në të gjitha gjinitë dhe llojet.

Besnikëria ndaj parimeve nuk ka pasur dhe nuk ka të bëjë me të qëndruarit në vend, me amullinë, përkundrazi: ajo siguron, ecjen përpara me hap revolucionar, siguron dinamizmin dhe progresivitetin e vazhdueshëm. Mendimet e shokut Enver mbi realizmin socialist të shprehura në Konferencën e 17 të Partisë për Tiranën, më 1968, ngrenë disa probleme teorike e praktike për të kuptuar drejt këtë metodë dhe përbëjnë një formulim të plotë dhe të shumanshëm të saj. «Kur flitet për realizmin socialist, — thotë ai, — kjo çështje nuk duhet kuptuar si një formulë e thatë që përsëritet tej e tëhu,

57/12



mbi të cilën thuren teorira dhe shumë herë nxirren formula akademike. Realizmi socialist është pasqyrim me besnikëri i jetës socialiste që po ndërtojmë në të gjitha aspektet e saj, i transformimeve kolosale materiale dhe me temp revolucionar që pëson vendi ynë, shoqëria jonë, njerëzit tanë në bazë të teorisë marksiste-leniniste dhe në bazë të masave e vendimeve të përpunuara nga Partia jonë. Por ky realizëm socialist nuk paraqitet aspak në forma statike, të ngurta; ai zien, është në zhvillim të përhershëm e të vazhdueshëm, nëpërmjet një lufte të kundërtave, nëpërmjet një lufte klase, nëpërmjet luftës të së resë kundër së vjetrës. Ky realizëm socialist i paraqitur dhe i kuptuar kështu është i lidhur me të tani-shmen dhe me perspektivën...»¹⁾

Siç kuptohet, shoku Enver drejtohet këtu kundër teorizimeve skolastike që kanë pasur vend edhe tek ne. Pasqyrimi i drejtë dhe i kuptueshëm i realizmit socialist drejtohet si kundër shtrembërimeve borgjeze-revizioniste dhe luftës që i bëjnë ata kësaj metode, kundër ndikimeve të tyre tek ne, ashtu edhe kundër konceptimit dogmatik e të njëanshëm të saj. Ne e shohim këtë metodë si revolucionarë dhe prandaj arti ecën përpara me vepra të shumta dhe mjaft prej tyre të një cilësie të lartë, ai pasqyron brendinë në dinamikën e saj, bëhet më i larmishëm dhe evoluon në format e veta artistike, duke krijuar tipa të veçantë subjektësh, kompozicionesh e konfliktësh, një mishërim origjinal të masës e individit brenda veprës letrare, përvetësim krijues të krijimtarisë popullore, zhvillim të ndjeshëm të gjuhës, të dialogut.

Lloje dhe gjini të ndryshme kanë mundur të shprehin lëvizjet e shoqërisë sonë, të mendimit dhe ndjenjës, raporte të ndërlikuara njerëzore.

Realizmi socialist vjen e thellohet me kalimin e viteve dhe veprat shprehin në mënyrë më të plotë e më artistikisht të vërtetën e jetës, dinamikën dhe zhvillimin e saj. Kështu, përveç temave aktuale edhe në temat

1) E. Hoxha, «Mbi letërsinë dhe artin», f. 292-293

mbi të kaluarën realizmi socialist spikat në zbulimin objektiv të forcave shoqërore, në nënvizimin e interesave të klasave progresive dhe të perspektivës historike.

Veçoritë e tiparet për të cilat flet shoku Enver, duke iu referuar problemit të realizmit socialist, i gjejmë në tërë letërsinë e artet tona. Ato dalin edhe më qartë në veprat më të mira. «Lumi i vdekur» i J. Xoxes p.sh e merr historinë e popullit në një plan të gjerë me lëvizjet dhe ballafaqimet e klasave, në prizmin e interesave popullore dhe «të një shprese të re» që do të sjellë «dita e re». Në një periudhë të mëvonshme, në fushën e poezisë, poema «Nënë Shqipëri» e D. Agollit, me një dinamikë që i përshtatet poezisë sonë, jep të sotmen, lidhur me të kaluarën, realitetin që kalon nëpër botën e poetit. Politika e Partisë, vepra e popullit dhe idealet e komunizmit dalin të gërshetuara në këtë poemë të realizmit socialist.

Një ndër veprat e viteve të fundit, me ngjarjet epike të jetës sonë, të luftës kundër revizionizmit, në një gërshetim planesh e tipash të shumëllojshëm është romani «Dimri i madh» i I. Kadaresë. Në këtë roman duket qartë se si përvetësimi i metodës së realizmit socialist mund të japë vepra me një frymëmarrje të gjerë historike, ku masa dhe figura e udhëheqësit revolucionar, si ajo e shokut Enver, paraqiten të lidhura ngushtë në një plan monumental dhe epik. Këta ishin vetëm disa shembuj.

Por, kuptohet, para letërsisë e arteve, mbetet shumë për të bërë që të zhvillohet edhe më tej realizmi socialist, që të pasqyrohen transformimet e shoqërisë dhe heroit pozitiv me ideale të mëdha, po me këmbët në tokë, në jetën tonë, siç mëson shoku Enver.

Problemi i tretë që do të prek shkurtimisht është lufta e Partisë sonë me pikëpamjet e huaja borgjezo-revizioniste në fushën e teorisë dhe të praktikës estetike mbi metodën e realizmit socialist. Shoku Enver ka theksuar se baza filozofike e shumë shkollave e «shkollëzave», që mbijnë si kërpudhat në vendet borgjeze, është ide-

alizmi, me gjithë format dhe stërholimet që marrin teoritë filozofike dhe estetike. Mohimi që i bëhet realizmit socialist nga estetët borgjezë ka rrënjë politike dhe ideologjike; ai lidhet me mohimin e revolucionit proletar dhe të luftës së klasave. Duke luftuar realizmin socialist, duke e quajtur këtë si «të ngushtë», «dogmatik» estetët borgjezë dhe revizionistë mbrojnë artin «e paan-gazhuar», larg problemeve më të mprehta shoqërore. Individualizmin dhe «lirinë» për t'i shërbyer kapitalit, siç e përcaktonte Lenini në fillim të këtij shekulli. Përveç rrymave dhe shembujve të njohur nga ekzistencializmi etj., do të ishte me interes të përmendim një prirje të sotme estetike p.sh. tek disa autorë perëndimorë, për t'u kthyer përsëri te romantizmi, të lodhur nga shkollat e tjera, sepse gjoja «shekulli ynë është romantik» dhe romantizmi vjen në letërsi si «nata kur zërat e ditës janë zbehur». Ky mendim mbrohet nga disa shkrimtarë e studiues sepse, sipas tyre: «Vlera e romantizmit është se shuan kategoritë, heq kufijtë, zhduk përcaktimet», pra, heq çdo kuptim shoqëror dhe synim të qartë e të përcaktuar të artit dhe vendos kaosin. Është karakteristike prirja për t'u kthyer në rryma të kaluara si në antikitet, klasicizëm apo romantizëm. Kjo ndjenjë, që shpreh një deziluzion dhe largim nga realiteti, nuk mund të jetë veçse iluzore, sepse rrymat e dikurshme nuk mund të kthehen më dhe në artin e sotëm borgjez do të shprehet doemos çoroditja shpirtërore dhe pasiguria për të ardhmen.

Nga lufta e sotme kundër pikëpamjeve revizioniste mbi realizmin socialist, një temë kjo e gjerë dhe e rëndësishme, do të kapim vetëm ndonjë moment tipik për qëndrimet e tanishme. Dihet mohimi që i kanë bërë revizionistët sovjetikë dhe revizionistët e tjerë realizmit socialist, duke e quajtur të vjetëruar apo «dogmatik» dhe kanë bërë thirrje për të «zgjeruar kufijtë», për bashkëjetesën e rrymave të ndryshme në një vend socialist, për dyert që duhet t'i hapen (siç i janë hapur atje) modernizmit etj. Revizionistët sovjetikë në teorinë estetike, duke iu përmbajtur një demagogjie zyrtare, në dukje e pranojnë realizmin socialist, po ky realizëm so-

cialist i tyre është krejt i transformuar, i është hequr përmbajtja klasore dhe revolucionare.

Qëndrimin e revizionistëve kinezë ndaj traditës përparimtare botërore na i qartëson shoku Enver në veptrat e tij «Imperializmi dhe revolucioni» dhe «Shënime për Kinën». Revizionistët kinezë kanë qenë e janë kundër realizmit socialist, si një metodë e lindur nga revolucioni. Ata nuk e kanë pranuar as përvojën e Revolucionit Socialist të Tetorit. Në vend të saj kanë nxjerrë teorinë eklektike dhe metafizike të «romantizmit revolucionar», të cilat nuk kanë pasur asgjë të përbashkët me revolucionin, kanë mbrojtur në fakt bazat idealiste aprioartistike të artit. Teoria e «njëqind luleve» në kulturë e art nuk është tjetër veç një teori eklektike dhe një hapje dyersh rrymave të huaja qofshin këto të vjetra apo të reja. Në të vërtetë arti për ta shterroi, u quajt i panevojshëm dhe u mohua çdo traditë. Prandaj sot nuk janë të papritura kapërcimet nga njëri ekstrem në tjetrin, hapja e dyerve artit modernist. Politika e paprincipitë në kulturë e art, si në gjithçka, ka sjellë atje një përzierje metodash që, në thelb, ka shpurë në përmbajtjen borgjezo-revizioniste.

Pëstjellim pikëpamjesh, mungesë e plotë argumentesh dhe një art që i përgjigjet politikës revizioniste — këto janë tipike për teorinë dhe praktikën e këtyre vendeve.

Orientimet e Partisë dhe të shokut Enver Hoxha mbi realizmin socialist, metodën krijuese të artit tonë, kanë një forcë të madhe bindëse sepse mbështeten në parime të qarta marksiste-leniniste dhe në praktikën e një arti që lulëzon. Ato kanë një rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare në luftën për mbrojtjen dhe zhvillimin e artit të realizmit socialist.

FRYMË SOCIALISTE DHE ORIGINALITET KOMBËTAR

Rrethi i problemeve dhe i detyrave që shtroi Kongresi i 8 i Partisë për shkrimtarët e artistët, për kritikët e studiuesit është i gjerë dhe kërkon një punë të madhe e të vazhdueshme për t'i përvetësuar në thellësi. Ndër to u shtrua me forcë edhe problemi i forcimit të frymës socialiste dhe të karakterit kombëtar. Lidhur me këtë dhe me anët e tjera të rëndësishme del edhe raporti midis traditës e novatorizmit, i një lidhjeje të ngushtë midis tyre dhe i një pune më të madhe për ta çuar më tej novatorizmin, sepse arti i realizmit socialist është një art i madh novator. Duke folur për meritat dhe për rezultatet e krijuesve gjatë kësaj periudhe, shoku Enver nënvizon se ato janë arritur «duke u mbështetur fort në traditat tona më të shëndosha letrare e artistike, duke i pasuruar ato me kërkime e gjetje të reja novatorë...».

Në veprat tona të pesë vjetëve të fundit, në gjini të ndryshme, është pasuruar karakteri kombëtar, i cili është kuptuar më mirë si problem i brendisë dhe i formës. Krijuesit tanë, duke vënë në bazë parimet e realizmit socialist, aspektin kombëtar e kanë parë kurdoherë në lidhje të ngushtë me partishmërinë proletare, që është

parimi themelor. Theksimi i tipareve kombëtare bëhet për arsye të parimeve estetike të artit socialist, i cili, në periudhën e lulëzimit të kombeve, nuk mund të realizohet veçse përmes origjinalitetit kombëtar. Kështu, karakteri universal i ideve të revolucionit merr një konkretizim dhe ngjyrë të papërsëritshme. Koha e sotme, synimet agresive të superfuqive, erërat kozmopolite e shkombëtarizuese, që synojnë shkatërrimin e kulturave kombëtare, këto rrethana, si edhe vetë parimet e artit tonë revolucionar e patriotik, shtrojnë gjithmonë në mënyrë të mpreshtë nevojën e forcimit të mëtejshëm të origjinalitetit kombëtar. Problemi shihet në lidhjen dialektike të vet dhe prandaj Partia na mëson që, duke forcuar frymën socialiste, pasqyrimin e jetës dhe të problemeve me të cilat jeton kombi ynë socialist, do të dalin edhe më qartë tiparet kombëtare të letërsisë e arteve.

Gjatë kësaj periudhe fryma socialiste dhe karakteri kombëtar kanë përshkuar më mirë veprat tona letrare, kanë tingëlluar nëpër koncerte e festivale apo janë dukur në ekspozitat e arteve figurative. Shkrimtarët dhe artistët kanë dhënë tablo të gjera të jetës; në veprat më të mira janë skalitur tipa të gjallë e janë dhënë pamje të vërteta nga realiteti ynë. Krijimtaria është një fushë e gjallë veprimtarie, ku arrihen rezultate, ku kërkohet, ku gjenden anë të reja të jetës e formë adekuate për brendinë e re, po ku ka edhe dobësi, vepra të zbehta e një konceptim i cili nuk është kurdoherë i thelluar. Prandaj Partia shton para krijuesve që të kapin më mirë problemet e kohës, të pasqyrojnë heroizmin masiv dhe heronjtë që udhëheqin njerëzit në punën e përditshme, duke i nxjerrë ata me tipare njerëzore, me këmbët në tokë, pa bujë dhe pompozitet.

Thellimi i frymës socialiste do të thotë të njihen e të kapen më mirë, sipas parimit historik — konkret, marrëdhëniet e njerëzve sot si edhe në Luftën Nacionalçlirimtare dhe në të kaluarën. Analiza klasore, shoqërore e tipave dhe dukurive, interpretimi në një sfond të qartë dhe të saktë historik, ndriçimi i fakteve me një ideal,

me një mendim që shpie përpara, që ndihmon për të kuptuar dukuritë, si edhe perspektivën e tyre, do të bëjnë që të forcohet fryma socialiste dhe të dalin më mirë në pah edhe veçoritë kombëtare. Rastet që janë kritikuar, p.sh., në fushën e romanit, ku ka arritje të dukshme në tërësi, siç e tregoi edhe konkursi i 40-vjetorit, po iku vihen re edhe mungesa e dobësi, lidhen me njohjen e pamjaftueshme të jetës, po edhe me një konceptim të cekët të materialit, me mungesën e një problemi qendror, me varfëri filozofike dhe kulturore. Prandaj do forcuar edhe kërkesa ndaj vetvetes, nga autorët, po edhe nga botuesit për të mos lejuar vepra me nivel të dobët, nën nivelin e mundësive dhe të kërkesave të sotme të shoqërisë sonë. Kur organizohet materiali rreth një problemi qendror, njihen faktet mirë, njihen njerëzit dhe, kur nuk mungon mjeshtëria artistike, dalin vepra të mira që fitojnë simpatinë e lexuesit dhe të spektatorit. Kështu p.sh., në javën e teatrove profesioniste u pëlqye shfaqja e Tiranës «Komunistët», (dramë e R. Pulahës, regjia P. Mani) dhe e Fierit «Dy krisma në Paris»: (dramë e P. Kulla, Sh. Mita, regjia P. Kulla.). Edhe në to mund të vihen re të meta, në të parën, për një mishërim më artistik e jo negativ të figurave qendrore e, në të dytën, për një thurje më të mirë të materialit (skena e gjyqit të Avni Rustemit në Paris është ajo që mban spektatorin dhe krijon emocion), por këto shfaqje si edhe ndonjë tjetër, sillnin një realitet, mbronin diçka me pasion, kishin pika kulminante, të cilat tërhiqnin veçanërisht vëmendjen e njerëzve. Shembull i mirë i kësaj pjesë së një problemi, të shikuar estetikisht është edhe «Kur po xhirohej një film (Skenari i Sh. Vreto, Xh. Keko, regjia Xh. Keko), ku merret një pjesë e jetës, dhe zgjidhet natyrshëm me ndjenjë artistike. Kështu, duke vizatuar ekspozitën e arteve figurative kushtuar 40-vjetorit të Partisë. të bëjnë përshtypje mjaft vepra ku e sotmja pasqyrohet me mjeshtëri, ku ka frymëzim dhe një pikënisje estetike.

Arti ynë i realizmit socialist mbështetet në traditën më të vjetër e më të re. Tradita e letërsisë dhe arteve

të kohës sonë duhet të njihet e të çmohet më shumë edhe nga të rinjtë për ta çuar atë më tej. Po të marrim poezinë, do të vemë re zhvillimin e saj, pasurimin e zërave të rinj, të cilat shpesh sjellin motive të freskëta: larg deklaratave, por, krahas kësaj, ndihet edhe uniformitet, monotoni, përsëritje mekanike e folklorit ose, në ndonjë rast të veçantë, duket një mënyrë amorfe që e heq kufirin midis prozës e poezisë. Ndonjë gjini, si poema, me tradita të pasura klasike dhe të reja ndër ne, tani lëvrohet pak dhe prandaj nuk bëhen sa duhet përgjithësimet për jetën socialiste dhe vetvetiu krijohet një zbrastësi. Poemat e krijuara nga D. Agolli, Ll. Siliqi, I. Kadare, F. Arapi, L. Qafëzezi, A. Gjakova apo nga poetë më të rinj si K. Petriti e Xh. Spahiu janë një mbështetje e mirë për ta çuar më tej këtë zhanër me mundësi të mëdha sintetizuese dhe emocionale.

Novatorizmi në fushën e poezisë kërkon një njohje të mirë të traditës poetike të kultivuar dhe popullore, si edhe një interpretim krijues, aktiv të ngjarjeve me të cilat jeton shoqëria jonë. Kështu edhe në fusha të tjera të artit. Po të hidheshim, p.sh., në një lloj tjetër arti, në atë të koreografisë, ku është bërë mjaft për të zbuluar e përpunuar vallen popullore e ku janë krijuar edhe baletet të bukura, si «Cuca e maleve» (muzikë e N. Zorajit, koreografi e A. Alisë) etj., do të vërejmë se ende bëhet pak për të dhënë në brendi dhe në formë frymën e re socialiste, për të shprehur me gjuhën plastike atë botë të pasur bashkëkohore të njeriut tonë. Traditë nuk do të thotë përsëritje motivesh dhe arkaizëm, ashtu sikundër novatorizëm nuk do të thotë shuarje e traditës apo ekstravagancë.

E reja në art, siç dihet, kërkon zbulimin e së resë në jetë, të këndeve të reja të marrëdhënieve pak të zbuluara ose të para në thellësi. Kur përsëritet po ai tip konflikti, po ato mbyllje me fjalë të mëdha lexuesi ose spektatori mërzitet dhe nuk ta vë më veshin. Sado formë të re t'i vëshesh një subjekti të konsumuar, me një shikim të cekët, nuk do të tingëllojë si një gjë e re. Veç

asaj nuk duhet harruar se autorë të ndryshëm e sjellin të renë në forma dhe mënyra të ndryshme.

Krijimi tek ne është në jetën e përditshme, në punën e çdo njeriu, në ndërgjegjen e tij. Prandaj edhe në art ai do të shprehet edhe më mirë e më bukur përmes punës serioze dhe fantazisë krijuese, të mbështetur në realitet nga ana e shkrimtarëve dhe artistëve tanë të partishëm e militantë.

1981

1314

NJOHJE E THELLË E JETËS, FORMIM MË I PLOTË BOTËKUPTIMOR

Vitet e fundit, si edhe më parë, letërsia jonë ka njohur arritje të reja. Disa nga drejtimet kryesore në të cilat vërehet përparimi i përgjithshëm i letërsisë, nga pikëpamja ideore, kanë të bëjnë me pozitën e shëndosha materialiste në shikimin dhe analizën e shoqërisë, gjë që duket në gjini të mëdha, si romani etj., në zbulimin dhe pasqyrimin e drejtë të disa konflikteve të mëdha antagoniste të kohës sonë, në një prirje më të theksuar realiste që ndihet në poezitë, si dhe në përpjekjet (ndonëse ende të pakta) për të ngritur disa probleme shoqërore e morale. Edhe temat e problemet e historisë sonë, si p.sh. të periudhës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, kanë tërhequr vëmendjen. Autorët e veprave me këtë temë kanë studiuar historinë, janë munduar të thellohen në ngjarjet, duke gjetur fillin që lidh epokat dhe kuptimin aktual të luftës, të kryengritjeve, të heroizmit e dramacitetit të së kaluarës.

Vazhdon procesi i përpjekjeve për të dhënë tablo të përgjithësuara nga e sotmja dhe e kaluara, për të hetuar një dinamikë edhe më të madhe se më parë në ngjarjet, në botën e brendshme ose në veprimet e nje-

riut, si dhe për të dhënë, nga një kënd shikimi filozofik më të thelluar patosin e shoqërisë dhe të idealeve tona.

Janë bërë gjerësisht të njohura për masat e lexuesve vepra si «Nënë Shqipëri» e D. Agollit, e cila u këndon forcës, vitalitetit dhe bukurive të Atdheut, luftës dhe përpjekjeve për ta lulëzuar dhe mbrojtur atë. Romani i I. Kadaresë «Dimri i madh» është një vepër shumëplanëshe, që pasqyron qëndrimin e Partisë dhe të popullit tonë në një moment kyç të historisë. Vepra si këto e të tjera kanë vlerë aktuale dhe u bëjnë jehonë ngjarjeve e problemeve që ngre Partia në situatën e sotme. Në dramaturgji janë trajtuar drejt aspekte të historisë sonë me një tingëllim të ndieshëm aktual në vepra si «Besa e madhe» e M. Markajt, ose «Besëlidhja shqiptare» e S. Krasniqit, të cilat tregojnë burimet e heroizmit të popullit tonë në luftë kundër fuqive të mëdha dhe shovinistëve fqinjë. Dramë me vlera për pasqyrimin e transformimeve shoqërore dhe epërsisë morale të së resë ka qenë «Përmbytja e madhe», e K. Jakovës që u prit me interes nga spektatorët. Një vend të shquar në komedinë e sotme zë «Zonja nga qyteti» e R. Pulahës, e cila ka fituar simpatinë e spektatorëve dhe është ndjekur gjithmonë me interes. Po kështu, ka lënë një përshtypje shumë të mirë (përmes një filmi të arritur) skenari i V. Koreshit «Gjeneral gramafoni», i cili në një mënyrë origjinale, me forcë ideore, me kontraste e sinteza, tregon shpirtin e lartë patriotik të popullit, bukurinë shpirtërore të njeriut të thjeshtë dhe të krijimit të tij artistik. Autorë tashmë të njohur kanë shkruar vepra me vlerë për aktualitetin ose të kaluarën, siç janë romani «Vëllezërit» i A. Oërgës, «Ja vdekje, ja liri» i S. Spasses, «Midis dy kohëve» i S. Drinit, «Ura me tri harqe» i I. Kadaresë, «Mërgata e qyqeve» i N. Jorgaqit, drama të T. Laços, F. Krajës etj., vëllimet me tregime «Pëllumbat e janarit» i Z. Çelës e «Mirazhi» i A. Abdihozhës etj. Kanë ngritur probleme aktuale dhe kanë traj-

tuar motive qytetare e shoqërore, ose, edhe tema nga historia, poetë si Ll. Siliqi, F. Arapi, N. Gjetja, A. Istrefi, Xh. Spahiu, H. Aliaj etj.

*
* * *

Arritjet e viteve të fundit janë të rëndësishme në procesin e krijimtarisë, por njëkohësisht dalin edhe disa probleme ideoartistike.

Në shumë raste Partia ka theksuar dy probleme themelore: atë të njohjes së thelluar të realitetit dhe të forcimit të pozitave botëkuptimore. Të dyja këto momente, pa i marrë asnjëherë të shkëputura nga njëri-tjetri, sigurojnë zhvillimin e realizmit dhe, kur botëkuptimi është materialist e dialektik, përcaktojnë metodën krijuese të realizmit socialist.

Në veprat tona më të mira, në ato më të arriturat e kohëve të fundit, i gjejmë të lidhura këto dy momente dhe prandaj ato kanë dalë serioze e pëlqehen nga lexuesi. Në qoftë se njohja do të kuptohet si diçka empirike e metafizike, do të kemi një pasqyrim të çkët ose edhe të shtrembëruar, sepse artisti duhet të shkojë në jetë me një botëkuptim dhe kënd shikimi të caktuar e atje të pasurohet me përshtypje, mbresa e fakte dhe pastaj, në «laboratorin» e vet të krijimit, ua nënshtron këto fakte analizës, qëllimit që ka dhe idealeve që do të mbrojë. Natyrisht, stilet janë të ndryshme dhe ashtu duhet të jenë, por pa njohje dhe pa një pikëvështrim filozofik-estetik të thelluar nuk mund të ketë vepra të vërteta.

Mungesa e njohjes së thelluar, e të jetuarit intensiv me jetën e përditshme, nga njëra anë, dhe disa mungesa që vihen re edhe në formim, në horizontin kulturor, nga ana tjetër, janë shkaqet kryesore që sjellin do bësitë e vërejtura kohët e fundit.

Letërsia jonë, si dhe artet e tjera, gjatë procesit të

tyre të zhvillimit e kanë pasur në qendër të vëmendjes temën aktuale, njeriun e kohës sonë. Krahas temës së ndërtimit të socializmit, edhe ajo e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare ka qenë e mbetet aktuale, sepse pasqyron epokën e Partisë, burimet e jetës së re. Edhe veprat me temë historike kanë lindur si një nevojë për të treguar heroizmin e popullit në të kaluarën dhe për të afirmuar vazhdimësinë e këtij heroizmi. Por, siç dihet, çdo art përparimtar, e aq më tepër i realizmit socialist, afirmohet në radhë të parë përmes motiveve e problemeve të realitetit të drejtpërdrejtë. Nga praktika e këtyre dy vjetëve të fundit del se një vëmendje më e madhe duhet treguar për temat e aktualitetit, të para këto në tërë pasurinë dhe thellësinë e tyre politike, shoqërore e morale. Njohja e vazhdueshme dhe sistematike, thellimi në dokumentet e Partisë e në problemet e mjeshhtërisë së artit do të përcaktojnë edhe pasurimin e letërsisë me vepra nga periudha e ndërtimit të socializmit, ku të spikatë më shumë njeriu i sotëm, që punon e krijon, që bën historinë. Në disa nga veprat tona në prozë vihet re një njohje e cekët, ose përmbajtja e varfër ideore; në disa drama ka përsëritje në motive, tipa ose konflikte që janë zbuluar edhe më parë. Ose, kur kapen temat shoqërore, ka raste që kalohet në moralizime dhe nuk ndihet jeta e gjallë. Ndodh që herë mungojnë të dhënat konkrete nga realiteti, ka pak atmosferë, pak flitet për mjedisin, tepruhet me anët e jashtme dhe harrohet njeriu, herë dialogu është i rëndomtë, pa një bukuri dhe një mendim filozofik në kuptimin jetësor dhe jo të sentencave moralizuese.

Njohja më e thelluar e jetës është detyrë e shkrimtarit dhe artistit, një kërkesë e brendshme e realizimit të planeve dhe synimeve të artistike. Në forma të ndryshme krijuesit shikojnë në bazë, në qendra pune e kooperativa. Kjo kërkon një organizim më të madh nga Lidhja e Shkrimtarëve dhe e Artistëve me degët e saj në rrethe, kërkon vazhdimësi dhe ndjekje sistematike të problemit.

Orientimet e Partisë na mësojnë që të jemi kur-

doherë vigjilentë dhe të mos e harrojmë asnjë çast luftën e madhe ideologjike që bëhet sot, presionin bor-gjezo-revizionist. Ndonëse është bërë një luftë e madhe dhe janë çrrënjosur mjaft elemente të huaja, që dukeshin në vepra të veçanta, prapë lufta vazhdon dhe ndodh që në shkrime të pabotuara, ose edhe në ndonjë të botuar, vërehen probleme ideore që kanë të bëjnë me një tipizim të njëanshëm, me shikimin dhe zbulimin e cekët të kontradiktave, me një raport të papërcaktuar mirë të individit me shoqërinë (në disa vjersha të veçanta), ose, gjë që ndodh më shpesh, me disa figura të errëta e të pakuptueshme, që janë recidive e huazime formaliste. Detyra jonë është që t'i zbulojmë e t'i luftojmë këto shfaqje në kohën e duhur dhe të punojmë me krijuesit për t'i edukuar e formuar më mirë me frymën e partishmërisë proletare. Është e nevojshme që, duke forcuar luftën kundër shfaqjeve të huaja me origjinë moderniste, të mos harrojmë edhe luftën kundër skematizmit dhe qëndrimeve «për të qenë brenda». Arti i realizmit socialist është novator, është në natyrën e tij, të çajë përpara ai nuk pajtohet as me liberalizmin, as me konservatorizmin. Po të marrim, p.sh., poezinë, ajo jashtë figurshmërisë nuk mund të kuptohet; vetë populli ka figura të shkëlqyera në artin e tij të madh. Kështu që na bie të ndjekim një rrugë të drejtë ku të mos kenë vend kërkimet formaliste dhe mbingankesat me figura, gjë që shpie edhe në probleme ideore; por edhe të mos na duket si i papranueshëm një kërkim i ri i këtij ose i atij autori, kur poezia është e mirë dhe militante. Pozitat e shëndosha ideologjike dhe estetike nxisin edhe kërkime të guximshme, forma të reja në harmoni me përmbajtjen e re e të shëndoshë. Në të kundërt, monotonia e formës flet edhe për varfëri të përmbatjes, të kulturës dhe të konceptimit ideestetik.

Krahas temave të mëdha politike të sotme, duhet të zënë një vend edhe temat shoqërore e morale. Aspekti moral i njeriut hyn pak në veprat tona. Ka shumë probleme të rinisë, të jetës së tyre, të moralit, të dashurisë që mbeten jashtë vëmendjes së krijuesve, qof-

shin këta edhe të rinj. Në poezi këto motive trajtohen më shumë, por janë të domosdoshme edhe në gjini epike e në drama, që të ngrihen problemet më thellë. Theksimi i përvojës më të mirë dhe rrahja e mendimeve për problemet që dalin sot, do të ndikojnë për një zhvillim edhe më të mbarë, për një pasqyrim më të gjerë e të thelluar të realitetit socialist, në radhë të parë, si dhe të momenteve kyçe të historisë sonë.

VEPRA MË TË SHUMTA DHE MË TË MIRA KUSHTUAR REALITETIT TONË SOCIALIST

Letërsia jonë e realizmit socialist ka lindur si një domosdoshmëri për të pasqyruar dhe shprehur realitetin e ri shqiptar, duke u mbështetur në mësimet e Partisë dhe të shokut Enver, në parimet estetike marksiste-leniniste, të cilat u kristalizuan dhe u formuluan më qartë e më plotësisht me kalimin e viteve. Botëkuptimi i ri dhe realiteti konkret që kanë nxjerrë në jetë këtë letërsi dhe këto arte, duke trashëguar traditat më të mira të së kaluarës, përcaktojnë dhe ndihmojnë jo vetëm që të pasqyrohet drejt realiteti aktual, por edhe që temat e problemet e së kaluarës të shihen më mirë sipas parimit njohës, konkret-historik, për të thënë të vërtetën për çdo epokë e ngjarje dhe sipas parimit të vlerës ideestetike aktuale — në ç'mënyrë i flasin së sotmes marrëdhënie të caktuara njerëzore, zgjidhje të caktuara. Meqenëse përmbajtja e artit lidhet me idetë që e përshkojnë veprën, me objektin e pasqyrimin dhe, zakonisht, me problematikën (kjo varet dhe nga llojet e gjinitë), atëhere kuptohet vetiu, se zgjedhja e temës, e objektit ka një rëndësi të dorës së parë, sado që është e qartë se realizimi i drejtë dhe i thelluar ideo-artistik përcakton vlerat kryesore. Ky orientim tema-

tik-problemor ka rëndësi të madhe për të kuptuar se sa përcaktues është objekti i pasqyrimin, kthimi më i madh dhe më depërtues i shikimit nga e sotmja e jetës sonë, nga problemet me të cilat jeton njeriu i socializmit, nga virtytet e tij morale dhe lufta kundër së keqes, nga konfliktet e sotme, të cilat kapërcehen për të ecur më përpara. Ne kemi mjaft vepra kushtuar realitetit socialist. Po të marrim shembuj nga fusha e romanit, do të përmendim që nga «Kënetat» e F. Gjatës, «Përsëri në këmbë» e Dh. Xhuvanit, «Juga e bardhë» e J. Xoxes, «Përballimi» i T. Laços, «Dimri i madh» i I. Kadaresë, «Zbulimi i A. Kondos e gjer te romanet e kohëve të fundit si «Buka e një stine me borë» i K. Kostës, «Trëndafili në gotë» i D. Agollit, «Vëllezërit» i A. Cergës, «Jetë e dashuri» i M. Qillerit, «Një verë pa lamtumirë» i Z. Çelës, «Luginat» i H. Petrelës e mjaft të tjerë. Kështu ka edhe në gjini e arte të tjera, si p.sh. në ekspozitat e shumta të arteve figurative, në këngë që i kushtohen optimizmit të njeriut të sotëm etj.

Nga pikëpamja sasore, në shumë gjini dhe lloje tema aktuale zë vendin kryesor dhe raporti tematik është i drejtë. Ngritja e nivelit ideoartistik do ta bëjë atë më të efektshme dhe do të ndihmojë më shumë në edukimin estetik të njeriut të sotëm.

E gjithë letërsia dhe artet tona, edhe kohët e fundit, kanë pasur arritje të dukshme në punën e tyre për pasqyrimin e jetës me partishmëri proletare, me frymë kombëtare. Nga vetë gjendja e letërsisë dhe e arteve, nga stadi i sotëm i zhvillimit të tyre dhe dëshirat e lexuesve e spektatorëve të shumtë, dalin detyra për t'u hyrë më thellë proceseve të realitetit socialist, për të shtuar, përgjithësisht, kërkesat ideoartistike që në zgjedhjen për botim, për shfaqje, për propagandim etj.

Në unitetin e përmbajtjes dhe formës duhet parë më mirë objekti i pasqyrimin, proceset që kalojnë sot dhe që kërkojnë një shprehje e pasqyrim më të mirë. Është e nevojshme që shkrimtarët dhe artistët tanë ta përqendrojnë më shumë vëmendjen te njeriu i ditëve tona, te heronjtë që ndërtojnë socializmin, duke i parë

ata me realizëm, me virtytet e tyre të mëdha dhe me problemet e preokupimet e tyre në jetën e përditshme. Ky njeri jeton në një mjedis të caktuar, punon, has vështirësi, ka shokë rreth e rrotull, ka familje, dashuron, urren, jeton me problemet kombëtare dhe ndërkombëtare. Ai jeton me detyrat që shtron Partia çdo ditë në realizimin e planeve dhe në marrëdhëniet me njerëzit. Botëkuptimi i Partisë, filozofia marksiste-leniniste, njohja konkrete e jetës japin mundësi të hyhet në dialektikën e sendeve dhe fenomeneve, të njihen më mirë proceset shoqërore dhe psikologjike të njeriut, duke i parë ata me realizëm dhe në dritën e zhvillimit, të perspektivës së tyre revolucionare. Në veprat e viteve të fundit kushtuar temës së sotme, në romane, filma, drama apo tregime — të pakta janë ato personazhe që shquhen për një konceptim të plotë plastik, që të mbeten në mend dhe që do të dëshiroje të ndiqje në jetë shembullin e tyre. Ka mjaft raste që karakteret mbeten të zbehta, të paplotësuara, nuk kanë jetën e tyre, ëndrrat dhe momentet e zgjidhjes së dramave, të shkëlqimit të mendimeve të tyre. Kjo ndodh nga njohja e pamjaftueshme dhe nga konceptimi i cekët ideoestetik i personazheve. Ka raste kur kjo ndodh edhe nga mungesa e mjeshtrisë, nga përvoja e paktë artistike në zbulimin e konfliktit, në gjetjen e subjektit, ku do të shtjellohet ngjarja dhe në përdorimin e mjeteve stilistike. Po kryesore është brendia, njohja, konceptimi i materialit jetësor dhe gjetja e këndvështrimit ideoestetik. Problemet e rëndësishme që kanë tërhequr e duhet të tërheqin edhe më shumë vëmendjen lidhen me transformimet e mëdha socialiste në jetën tonë. Anë të rëndësishme të periudhës së rindërtimit të vendit, të shtetëzimit të industrisë, të Reformës Agrare, të kolektivizimit, të luftës politike kundër revizionizmit, probleme morale e zakonore që gërshetohen me ato më themeloret, janë trajtuar e po trajtohen. Kështu mund të merrnim shumë shembuj; ndër to dramat «Toka jonë» apo «Përmbytja e madhe» të K. Jakovës, «Baca i Gjetajve» i F. Krajës, «Zonja nga qyteti» apo «Furrnalta» të R.

Pulahës dhe poema e vjersha poetësh më të njohur e më të rinj si D. Agolli, Ll. Siliqi, I. Kadare, F. Arapi, K. Petriti, L. Qafëzezi, V. Bala, Xh. Spahiu, A. Gjakova, N. Pappleka, A. Istrefi, N. Gjetja, B. Londo, N. Lako, Ll. Ruci, R. Marku, S. Mato, M. Zeqo e mjaft poetë të tjerë e prozatorë të rinj që shkruajnë në organet tona dhe kanë botuar vëllimet e tyre. Poezia, me gjithë dobësitë e saj, e ka pasqyruar e shprehur mirë të sotmen edhe për vetë veçoritë e gjinisë më të shpejtë e më të shkathët në gërshetimin e momenteve historike duke i dhënë epërsi realitetit të sotëm. Poezia ka mundur të shprehë entuziazmin e së sotmes, ndjenjat e njeriut që lidhen me patriotizmin dhe me idetë e mëdha të socializmit; në të i këndohet bukurisë së fshatit, arave, aksioneve; i këndohet jetës dhe punës së rinisë, të arsimitarëve, të jetës shkollore; ka poezi të mira edhe për punëtorët, për gjeologët e minatorët, megjithëse më të pakta janë ato që u kushtohen problemeve dhe botës së brendshme me të cilën jetojnë punëtorët kudo që ndodhen në punë, në familje, në shoqëri. Shkruhen poezi, tregime e ndonjë roman për jetën në ushtri, për problemin e mbrojtjes, i cili nuk mund të merret i shkëputur, po si një pjesë e jetës së gjithë popullit. Pak romane apo drama kemi nga e sotmja, ku të ndihet një motiv kryesor tematik-problemor, ku heronjtë të ndodhen në një tërësi jetësore, sepse në çdo qelizë të shoqërisë sonë vijnë të gërshetuara si në një fokus puna, shkolla, ushtria dhe familja. Është e kuptueshme se tematikë qendrore ka pasur dhe do të ketë (ndryshe subjekti hëllakatet e copëzohet), po ndarja tematike nuk mund të jetë mekanike e skematike sepse problemet janë të lidhura me njëri-tjetrin; kështu edhe realiteti do të dalë më i plotë dhe efekti artistik do të jetë më i madh.

Nga një shikim sado i shpejtë i disa veprave kryesore për realitetin socialist (disa prej të cilave i përmendëm) do të vëmë re se nuk janë ndjekur me po atë interes e thellësi të gjitha etapat e zhvillimit të tij. Është treguar vëmendje më e madhe për periudhën

menjëherë pas Çlirimit (kuptohet se edhe ajo duhet pasqyruar — këtu është fjala për raporte më të drejta midis periudhave) dhe më pak shkruhet për të sotmen, për ditët tona, jo në kuptimin e përshtypjeve të shpejta, po të veprave aktuale me vlera artistike. Prirja nga e kaluara, qoftë kjo edhe nga faza të hershme të epokës së socializmit, kur teprohet, ka në vetvete diçka romantizuese, ocet në rrugë të çelura ku sukcesi duket më i sigurt, sepse janë dhënë prova artistike dhe modele që ndjekin njëri-tjetrin. Duke shfaqur këto mendime, ne jemi të ndërgjegjshëm se, që fenomenet më imediate të jetës sonë të paraqiten mirë në letërsi dhe arte, kjo nuk është një punë aq e lehtë; kërkohet njohje e thelluar, aftësi depërtuese botëkuptimore, zbulim i kontradiktave dhe zgjidhje e natyrshme dhe jo skematike e tyre; kërkohet një aftësi përgjithësuese novatore më e shpejtë se për fenomene të kaluara. Të gjitha këto flasin për seriozitetin e problemit, po edhe për domosdoshmërinë e rezultateve më të shumta e më të mëdha në këtë fushë. Le të kujtojmë autorë të mëdhenj realistë francezë, rusë, anglezë etj., të shek. të 19 e të fillimit të shek. të 20 se si u janë përgjigjur ngjarjeve aktuale me vepra që pasqyronin frymën e kohës, natyrisht sipas parimeve të metodës së tyre krijuese, pa mundur të dalin nga kontradiktat e shoqërisë ose duke kërkuar zgjidhje utopike dhe irrealë, po problemet dhe karakteret ishin të kohës.

Është e nevojshme që lexuesi dhe spektatori të gjejnë më shumë kohën dhe veten e tyre në vepra, luftën për novatorizëm, për progresin dhe zëvendësimin e metodave të vjetra — gjë që shoqërohet edhe me luftë morale dhe psikologjike kundër zakoneve dhe veseve të shoqërisë së vjetër; luftën për zhvillimin e shkencës, të arsimit, për marrëdhëniet socialiste në familje etj. Një-rëzit jetojnë me këto probleme, me këto biseda, kanë mendimet e tyre, filozofojnë, polemizojnë me njëri-tjetrin dhe, mbi të gjitha, veprojnë, po këto pak dalin nëpër veprat letrare, në teatër etj., ose ndonjëherë jepen edhe në forma skematike e vulgare. Lexuesi ynë gëzo-

het, natyrisht, për çdo vepër të mirë që del e çdo teme qoftë, po cilësia më e mirë do të bëjë që të tërhiqet më shumë vëmendja nga temat e sotme, sepse ato janë të kohës, zgjojnë emocione të drejtpërdrejta dhe ndihmojnë më direkt në luftën për ndërtimin e socializmit, për formimin e mëtejshëm të njeriut të ri. Le të kujtojmë p.sh. një roman si «Buka e një stine me borë» apo novelën «Zemër e pastër» e K. Kostës. Këto vepra pëlqehen për njohjen e problemit, të jetës së fshatit, për karakteret që formohen dhe kontradiktat që zbulohen me ashpërsinë e tyre dhe u jepet një zgjidhje joskematike. Të metat e kompozimit apo të zgjatjes vende-vende në roman mbeten në plan të dytë dhe më shumë spikatin vlerat. Po kështu edhe novela, e cila ngrihet mbi një kontrast të gjetur – në njërën anë zemërmirësia, dashuria për njerëzit dhe një lloj naiviteti, në anën tjetër (tek një njeri i veçuar) hipokrizia dhe ligësia e botës së vjetër, dëmtimi i pronës socialiste, vjedhja që zbulohet nga fshatarët. Mprehtësia e kontradiktës e bën novelën realiste dhe tërheqëse.

Në fushën e tregimit e të novelës ka mjaft autorë që i kanë kushtuar vëmendje temës së sotme. Kështu kanë krijuar në këtë fushë autorë si A. Abdihoxha, Dh. S. Shuteriqi, N. Prifti, E. Kadare, V. Koreshi, T. Laço, N. Lera, Sh. Tigani H. Jaçellari, F. Balliu, B. Kukeli, B. Myftari etj. Por kërkohet që edhe në këtë gjini më tepër të kapen tema të mprehta, të dalin më shumë karaktere dhe konflikte të kohës, të shkruara me thellësi ndjenje e mendimi, me gjetje origjinale e të përshkuara më shumë nga novatorizmi.

Tema e familjes, e dashurisë, e marrëdhënieve morale-etike në shoqërinë tonë kanë tërhequr, po duhet të tërheqin edhe më shumë vëmendjen e autorëve tanë. Edhe kur kapen këto subjekte, shpesh mbeten fragmentare, nuk arrihet në vlera përgjithësuese dhe nuk ka një sintezë mendimi rreth ngjarjes që zhvillohet. Mjaft vepra tonat vuajnë edhe nga një prirje përshkruuese, ku personazhet pak mendojnë, pak hidhet dritë në

kthesat e tyre shpirtërore dhe të pakta janë vizionet mbi shoqërinë dhe mbi njeriun.

Kur në skenat tona ose në ekran trajtohen tema të ditës, zgjohet një interes i veçantë. Krahas filmave të mirë nga Lufta apo e kaluara, janë pëlqyer filma me temë aktuale si «**Rrugë të bardha**» (skenari V. Koreshi, regjia V. Gjika), «**Beni ecën vetë**» (skenari K. Blushi, regjia Xh. Keko), «**Ballë për ballë**» (skenari I. Kadare, regjia K. Çashku, P. Milkani) etj. Po filma me temë aktuale kërkohen më shumë dhe me cilësi, sepse ndihen mungesa dhe kjo është bërë nevojë e spektatorit. Do të përmendim një dramatizim që ndofta, pak është përmendur në kritikën tonë: atë të teatrit të Vlorës, sipas romanit të R. Pulahës «**Rruga Budi**». Kjo shfaqje pëlqehet, sidomos nga rinia, sepse ka një sinqeritet në parashtrimin e problemit, përshkohet nga humori dhe goditen të meta reale, pa rënë në gjuhë skematike. Kështu u prit mirë edhe «**Shoku Niqifor**» i P. Kullës etj. Satira dhe humori, edhe në gjinitë skenike, do të kërkojnë mënyra të ndryshme pasqyrimi dhe problemet do të kenë doemos, nuancat e tyre. Trajtohen në to kontradikta antagonistë dhe joantagonistë. Në trajtimin e kontradiktave joantagonistë nuk do të thotë që gjërat të kalohen lehtë dhe përciptazi, po duhet t'u shkohet problemeve deri në fund dhe çasti i zgjidhjes të jetë i fortë dhe i besueshëm. Po kështu edhe dramat, që e kanë të vetin problemin e konfliktit, i cili duhet të gjendet realisht në jetë, të shtjellohet me fantazinë e artistit dhe të vihet në pah duke emocionuar njerëzit dhe jo duke i lënë të ftohtë. Kjo kërkon që të shkruhet më shumë për të sotmen dhe kërkesat e teatrove, të redaksive botuese etj. (si edhe për veprat e gjinive të tjera) të jenë më të mëdha.

Që të mund të zbulohen dhe të trajtohen më mirë temat aktuale të realitetit tonë, është e nevojshme të kuptohen dhe të njihen më thellë proceset e zhvillimit të së resë, në luftë kundër së vjetrës, procesi i novatorizmit të jetës. Në themel të artit tonë të realizmit socialist qëndron konceptimi novator, i lidhur me traditën

ashtu siç kanë orientuar kurdoherë Partia dhe shoku Enver. Ky është një tipar dallues i tërë letërsisë dhe arteve, pavarësisht nga temat që kapen. Kështu, veç autorëve të shumtë që kanë kapur temën aktuale, sidomos kohët e fundit, në historinë e letërsisë sonë zenë vendin e tyre të nderuar për novatorizëm dhe cilësi të tjera autorë që kanë trajtuar tema nga e kaluara, Lufta Nacionalçlirimtare, si edhe realiteti i pasqirimit, si; Sh. Musaraj, S. Spasse, A. Varfi, A. Çaçi; krijues të tjerë të njohur si S. Godo, N. Jorgaqi, S. Drini etj.

Kontribut në trajtimin e temës aktuale në kohën e vet kanë dhënë autorë që nuk janë më midis nesh si: S. Çomora, N. Bulka, Z. Sako, M. Gurakuqi, D. Siliqi, F. Ballanca etj.

Novatorizmi i letërsisë sonë, si edhe i arteve të tjera, ka të bëjë, në radhë të parë, me konceptimin materialist dialektik, sipas të cilit masat punonjëse janë ato që bëjnë historinë dhe heronjtë, që e kuptojnë zhvillimin dhe prirjen e shoqërisë, lozin rol përparimtar. Ai lidhet ngushtë edhe me mendimin se, ne jo vetëm e sotitim dhe e zbulojmë shoqërinë, po përiqemi ta transformojmë atë, ta shpiem më tej. Nga ky shikim buron edhe vendi i heroit pozitiv në letërsinë tonë, edhe interpretimi dialektik i kontradiktave si edhe i së ardhmes së shoqërisë. Shoku Enver ka folur për kuptimin krijues, novator të realizmit socialist, i cili nuk duhet marrë në forma të ngurta dhe statike, po në dinamike, në zhvillim të vazhdueshëm. Në vijat e veta kryesore kështu ecën letërsia dhe artet tek ne, po koha shtron përpara disa kërkesa për të mos mbetur në vend, për të qenë më konsekuente në kërkimet novatore në kuptimin dhe interpretimin e thelluar të marrëdhënieve socialiste dhe të karakterit kombëtar-popullor. Pra, novatorizmi kërkohet, në radhë të parë, në jetë, në përmbajtje, pastaj, natyrisht, edhe në formë. Format kanë qenë dhe mund të jenë të shumëllojta, mjafton që japin një brendi të re, ose ta interpretojnë atë në mënyrë të re, marksiste-leniniste. Edhe forma evoluon, sikundër ka evoluar, po këtu ka rëndësi të kuptohet pro-

blemi dialektikisht: as rutinë, forma të amullta, pra kundër një konceptimi stanjant, të ngurtë e skematik në punë të formës, — as avangardizëm, largim nga tradita dhe një shtytje përpara kuturu pa kuptuar se ku vetë dhe ç'kërkon. Po të marrim p.sh. e të shohim shkurtimisht poezinë, nga kjo pikënisje, do të vemë re se këtu përdoren forma, vargje, metra, figura të larmishme dhe pëlqehen autorë me stile të ndryshme. Kuptohet se gjithmonë e rëndësishme është se ç'thua, a ke shkëndija, a ke mendime emocionuese për t'ua komunikuar të tjerëve. Megjithatë edhe mënyra se si e thua ka rëndësinë e saj dhe këtu dalim te uniteti i përmbajtjes me formën. Pasurimi i poezisë do të kërkuar më parë në pasurimin e motiveve, të mendimit, të pershtypjeve të freskëta nga jeta, po mishërimi artistik i tyre, në një moment, bëhet përcaktues. Kështu, në praktikë vemë re se ndihet varfëri idesh e përvoja, po, në anën tjetër, edhe kërkime të pakta në mënyrat e të shprehurit, përsëritje të po atyre figurave, apo edhe figura të errëta ndonjëherë që nuk kanë të bëjnë me novatorizmin, po me formalizmin. Sidoqoftë poezia, ndofta, është fusha ku bëhen më shumë kërkime, ndërsa ka fusha të tjera si p.sh. drama, teatri, ku mund të bëhet më tepër. Edhe në skenat tona ka kërkime novatore, po ky është një art shumë i ndjeshëm, komunikues, që sjell jetën në forma konkrete, prandaj kërkon më shumë hapësirë, dinamikë, gërshetim të harmonishëm të mendimit me veprimin. Bukuria qëndron te larmia e formave dhe jo te monotonia e tyre. Të marrim p.sh. dramën e vëna në skenë «Baca i Gjetajve», (regjia S. Fanku) dhe «Furnalta» (regjia P. Mani). E para, duke u nisur nga vetë brendia, ka një formë më tradicionale, po konceptimi i përgjithshëm është novator; krijimi i pushtetit të ri në Luftë, vendosja e së resë. E dyta si formë ka një konceptim, në njerën anë, heroik-monumental dhe, në anën tjetër, satirik-humoristik, ku momenti i pamfletit, i patetikës lozin rol në ecurinë e shfaqjes. Një unitet të tillë të përmbajtjes dhe të formës, si në këto dy shfaqje, duhet ta kërkojmë edhe në të tjera, në mënyrë që jeta jonë, di-

namika e saj, e reja revolucionare, me emocionet e fuqishme që sjell, të vijnë më shumë në skenë, ku në qendër do të jetë kurdoherë njeriu me botën, me luftën, me psikologjinë e tij.

Është koha që të punohet më shumë e më mirë me temën aktuale (pa mënjanuar temat e tjera, po me çpërsinë e temës së realitetit socialist), të njihet jeta më thellë në kuptimin konkret dhe filozofik, të jetohet më shumë me problemet që shtron Partia dhe të ngrihen kërkesat për botime e vënie në skenë, të mos pajtohemi me mediokritetin. Koha që jetojmë, kultura që kanë përvetësuar masat, botëkuptimi ynë i përparuar dhe gjithçka e mirë që është krijuar gjer tani kërkojnë një art të madh, të denjë për epokën, për popullin dhe Partinë tonë, të cilët mbajnë të pashuar zjarrin e mendimit novator, revolucionar, idealet e socializmit dhe të komunizmit.

1981

ASPËKTE TË SOTME TË REVIZIONIZMIT SOVJETIK NË TEORINË DHE PRAKTIKËN ARTISTIKE

Në letërsinë e artin dhe në teorinë e sotme letrare sovjetike shprehet politika revizioniste e socialimperializmit sovjetik, gjen pasqyrim ajo mënyrë jetese dhe gjendje shpirtërore që zotëron atje si pasojë e borgjezimit të jetës, e kontradiktave shoqërore dhe morale që sundojnë.

Procesi i largimit nga parimet e metodës së realizmit socialist në Bashkimin Sovjetik ka filluar me kohë, që me ardhjen në fuqi të revizionizmit hrushovian. Në fushën e teorisë e të kritikës zyrtare mbahet gjithmonë maska dhe ruhet, hera-herës, në dukje një terminologji marksiste. Synimet e demagogjisë janë të njohura.

Kjo maskë vihet re shpesh nëpër artikuj të shtypit letrar e artistik, në referate e simpoziume. Duan të krijojnë përshtypjen e rreme se asgjë s'ka ndryshuar që nga koha e Gorkit, Majakovskit, Fadejevit etj., dhe se luftohen shkarjet që mund të vërehen aty-këtu. Po e vërteta është krejt ndryshe.

Gjendja reale në fushën e letërsisë e arteve dhe pikëpamjet revizioniste në ideologji, ashtu si edhe në politikë, nuk mund të fshihen krejt; ato dalin edhe she-shit, duke dashur të përlligjin praktikën e sotme krijuese, zgjerimin «pa cak» të kufijve estetikë dhe një çorodi-

tje eklektike në lëmin e mendimit artistik, që vihet në garë me avangardizmin dhe formalizmin perëndimor.

Prapa pohimeve, rasteve kur bëhen be e rrufe për realizmin socialist, për frymën popullore dhe partishmërinë komuniste, fshihen largimet e hapura nga parimet e realizmit socialist, një revizionim i vazhdueshëm i pozitave të dikurshme. Ky revizionim lidhet me mohimin e thelbit të realizmit socialist, me zëvendësimin e tij me teori mikroborgjeze e të nënshtrimit ndaj borgjezisë, lidhet gjithashtu me shpërftyrimin dhe mohimin e mësimëve leniniste mbi letërsinë dhe trashëgiminë, me teorinë e njohur të «rrjedhës së vetme e të përbashkët në kulturën e një kombi», me heqjen e çdo kufiri klasor, ideologjik në vlerësimin e autorëve të së kaluarës.

Këto pikëpamje dhe të tjera dalin nëpër organet letrare dhe në botime të veçanta, inkurajohen dhe nxiten, pastaj, kuptohet, meqë ka rrezik të hiqet krejt maska, frenohen disi; shkruhet ndonjë artikull, i cili u heq nga pak vërejtjen autorëve të shumtë që i shprehin, duke mos munguar të pohojë se këto pikëpamje janë të pjeshme dhe hasen rrallë. Një lojë e tillë — lësho shumë e mblidh pak, sa për dukje, — sjell një pështjellim të madh teorik, përlligj devijimet dhe shkollat artistike formaliste, nxit e gjallëron një intelektualizëm borgjez e mikroborgjez dhe ndihmon për të ruajtur sundimin revizionist në Bashkimin Sovjetik.

Le t'i shohim shkurtimisht disa nga këto pikëpamje që përmendëm.

Parimi i partishmërisë proletare, i formuluar nga Lenini më 1905, pranohet nganjëherë sa për formë, po ka edhe mjaft raste kur e zëvendësojnë atë me «humanizmin», duke i dhënë këtij termi një brendi krejt revizioniste. Në kritikë p.sh. pohohet mendimi se humanizmi është parimi themelor i metodës së realizmit socialist. «Parimi themelor i metodës së artit tonë është humanizmi» — thotë kritikuri në zë D. Markov (Voprosi literaturi, 1977, Nr. 1.). Bëhen gjithashtu pohime se partishmëria proletare nuk i kundërvihet një fryme universale popullore dhe njerëzore. Me termat «liri», «humanizëm i

vërtetë», «frymë universale», «njerëzore» kritikët dhe estetët revizionistë mundohen të fshehin gjendjen reale dhe të përlligjin qëndrimet e tyre «pan njerëzore» jashtë konceptimit klasor, larg atij humanizmi proletar për të cilin fliste Gorki, që thoshte se ky humanizëm nisët nga dashuria e madhe për njeriun punonjës dhe nga urrejtja për borgjezinë. Në emër të humanizmit, theksonte Gorki, duhet luftuar, duhet shkatërruar ajo që pengon zhvillimin e shoqërisë.

Shtrembërimet janë kudo, por gjithmonë e më shumë ato dalin haptazi, sa ndonjëherë kritikët revizionistë detyrohen me gojën e tyre të bëjnë disa konstatime të thata: «Megjithatë, thotë një kritik, nuk janë zhdukur krejt rastet e vështrimeve nga pozitë jashtëhistorike, jashtëklasore të dukurive, figurave dhe koncepteve të së kaluarës» (Voprosi literaturi Nr. 4, 1980).

Këto e të tjera qëndrime, e aq më shumë vetë krijimtaria, tregojnë qartë se, në të vërtetë, në Bashkimin Sovjetik është hedhur poshtë me kohë parimi i partishmërisë proletare; se pasi i quajtnë dogmatikë dhe të vjetëruar Stalinit e Zhdanovit, estetët revizionistë mundohen ta interpretojnë siç u vjen për mbarë qëndrimin leninist, në përshtatje me pikëpamjet e tyre të sotme.

Interpretime të tilla subjektiviste si ai mbi lirinë e artit në shoqërinë socialiste janë identike me ato që kritikon shoku Enver Hoxha, kur flet për kuadrot e Partisë Komuniste Franceze: «Këta njerëz, — thotë ai, — i interpretonin në rrugë revizioniste e borgjeze thëniet e Leninit, të Stalinit e të Zhdanovit se shkrimtarët dhe artistët në shoqërinë socialiste duhet të jenë të lirë në krijimet e tyre, duhet të kenë iniciativë personale, por të jenë gjithmonë realistë dhe të krijojnë vepra që t'i shërbejnë me të vërtetë revolucionit dhe socializmit.»¹⁾

Zëvendësimi i partishmërisë proletare me humanizmin, qoftë ky edhe i emërtuar «socialist», do të

1) E. Hoxha. Eurokomunizmi është antikomunizëm, f. 217

thotë se mohohet parimi i luftës së klasave. Dihet që veprat artistike të realizmit socialist luftojnë për një humanizëm revolucionar, po këtu është fjala për një humanizëm borgjez, për një frymë pajtuase, për heronj të deziluzionuar, për përligjje të artit mistik e fetar, gjoja në emër të humanizmit, i cili, kështu siç paraqitet në të vërtetë, e turbullon shpirtin e njeriut, e ligështron atë dhe e mënjanon krejt nga problemet reale të shoqërisë së sotme. Një humanizmi të tillë duhet t'i nënshtrohet, sipas tyre, edhe vetë partishmëria, parimi i luftës së klasave. Në emër të një pseudohumanizmi të tillë krijohen në letërsi, arte figurative, muzikë e balet, vazhdimisht vepra ku heronjtë e dikurshëm të luftës patriotike janë të lodhur e të sflitur, ku revolucioni ka humbur çdo qëllim dhe njerëzit zhyten në mjerimin e tyre individual. Në emër të këtij pseudohumanizmi, ushtari sovjetik, në një qoshe të Stalingradit, i shtrin dorën një gjermani të plagosur, ose një fshatare ruse bie në dashuri dhe martohet me një rob gjerman etj.

Duke luftuar pikëpamjet e Leninit mbi dy kulturat në kombin borgjez, estetët revizionistë pohojnë se gjoja është keqkuptuar teoria e tij mbi dy rrjedhat kryesore në kulturën e së kaluarës dhe se ka vetëm një kulturë, vetëm një rrjedhë. Kështu, pikëpamjet e ndryshme, lufta ideologjike dhe estetike, lufta në fushën e mendimit dhe rrymat e ndryshme në art nuk paskan rëndësi: tradita është e përbashkët dhe, me tërësinë e saj, formon kulturën e një kombi. Në emër të këtij qëndrimi, në Bashkimin Sovjetik, ndonëse thuhet me fjalë dhe bëhet diçka sa për formë, tradita e demokratëve revolucionarë, e Bjelinskut, Çernishevskit ose e periudhës së realizmit socialist, e Gorkit, Majakovskit etj., mbetet në hije, mënjanohet, quhet e vjetëruar. Ja se si detyrohen përsëri të pranojnë me gojën e tyre estetët revizionistë: «Vitet e fundit, mjerisht është dobësuar pak vëmendja ndaj përpunimit të trashëgimisë estetike të demokratëve revolucionarë. Njëfarë roli kanë luajtur këtu edhe disa botime të pa-

pjekura që nuk e çmojnë trashëgiminë e demokratëve revolucionarë...» (J. Llukin, Voprosi, literaturi, Nr. 4, 1980. f. 129). Edhe nga pohime të tilla kuptojmë kaosin që ekziston në botime dhe në pikëpamjet e shprehura.

Kur paraqitet kultura e së kaluarës si një rrjedhë e vetme dhe mohohet lufta e ideve dhe e pikëpamjeve, vetvetiu i bëhet jehonë politikës së sotme të hapjes së dyercë, dhe të justifikimit të çdo lloj rryme moderniste.

Mohimi i traditës përparimtare dhe revolucionare sjell me vete pohimin e traditës reaksionare fetare rehabilitimin e një varg autorësh formalistë dhe dekadentë, apo të kritikëve, që kanë qenë në shërbim të carit e të reaksionit. Emra të tillë si Bullgarin. Illovajskij, Hlebnikov, Cvetajeva etj., përmenden tani ndër vlerat e traditës kombëtare ruse. Kërkoht botimi i autorëve monarkistë fetarë — dhe kjo realizohet në zbatim të frymës hegjemoniste e të shovinizmit rusomadh. Gjallërimi i traditave të lashta fetare sllavjane, i madhështisë së hershme në shërbim të madhështisë së sotme, temat pompoze në letërsi apo grandomania në artet figurative, i shërbejnë politikës së sotme agresive të socialimperializmit sovjetik, përligjjes së krimeve të shëmtuara në Afganistan e gjetkë dhe, përgjithësisht, politikës ekspansioniste. Kjo bashkë me tendencën që shpie drejt shkatërrimit moral të njeriut, jetërsimit dhe mëdyshjeve të tij shpirtërore, zbrazësisë morale përbëjnë dy drejtimet e sotme kryesore në pikëpamjet estetike për traditën, të cilat shprehen sidomos në gjini të veçanta, si në vepra të arteve figurative, poezi etj. Edhe në muzikë, me gjithë demagogjinë, kjo estetikë largohet nga tradita nacionale, u heq brendinë revolucionare veprave klasike ruse e sovjetike, fut ritmin modernist dhe sjell kështu një eklektizëm të plotë.

Përveç shprehjeve moderniste, vihet re se edhe format e njohura tradicionale përdoren për të përçarur tek masat e ndryshme të lexuesve e spektatorëve idetë sunduese revizioniste. Dhe ndodh që, nën tingujt e këngëve të përmallshme, me plot fjalë mbi patriotiz-

min, ushtarët sovjetikë venë e shkelin brutalisht lirinë e popujve të tjerë.

Përsa i takon formës, gjithmonë e më shumë përligjen praktikat e rrymave moderniste dhe bashkëvëprimi i metodave të ndryshme. Problemi i realizmit socialist, thotë kritika e sotme sovjetike, duhet parë si: «problemi i një sistemi artistik historikisht të hapur» (Z. Kedrina, Voprosi literaturi, 1977, Nr. 8). Dhe më poshtë e quan të mundshëm përvetësimin nga realizmi socialist të arritjeve të sistemeve të tjera, duke pasur parasysh çdo lloj rryme dhe sistemi estetik. Ky qëndrim del mjaft i qartë pasi studiuesja thotë, për teknikën letrare të quajtur «përroi i ndërgegjes» se «nuk ka asgjë të keqe në vetvete dhe mund të përdoret» (po aty). Kuptohet qartë se nga këto pohime dalin dy përfundime: së pari, pikëpamja e Rozhe Garodisë mbi realizmin pa cak, e cila ka hyrë gjerësisht në praktikën artistike të Bashkimit Sovjetik, pranohet pothuajse edhe teorikisht dhe, e dyta, duke përligjur «përroin e ndërgegjes», një mënyrë artistike e përdorur nga autorë modernistë më të hershëm, si Prust, Xhojs e nga të tjerë bashkëkohorë, pranohet njëkohësisht edhe vetë thelbi i artit modernist, kaosi shpirtëror dhe përkrahet mohimi i plotë i realizmit.

Në artet figurative dhe në muzikë kanë zënë vend të gjitha praktikat artistike borgjeze-moderniste si impresionizmi, abstraksionizmi, kubizmi ose ekspresionizmi. Në poezi ka shprehje të një intimiteti individualist apo të figurave hermetike. Kështu edhe në gjini të tjera.

Shtrembërimet teorike dhe kritike, baza estetike e filozofike që u vihet rrymave të sotme, përbëjnë një problem më vete dhe flasin për degjenerimin e mendimit, për borgjezimin e ideologjisë së jetës në Bashkimin Sovjetik, për pikat e përbashkëta me revizionizmin pa maskë edhe në fushën e letërsisë e të arteve.

Një aspekt tjetër shumë i rëndësishëm është ai i kontradiktës së madhe midis demagogjisë zyrtare teorike dhe praktikës krijuese artistike. Flitet për realizmin socialist, për heroin e punës, bëhen mbledhje ku

trumbetohen parimet revolucionare por më pas vërehet një hendek i thellë midis fjalëve të thëna dhe veprave që krijohen. Kështu, nuk i ka mbetur shenjë realizmit socialist. Në të vërtetë, të shkruash atje për klasën punëtore duket diçka e vjetëruar, anakronike. Shkruhen p.sh., romane se si biri, një nxënës shkolle, vret babanë pijanec dhe asnjë rrugëdalje nuk mund të gjendet për të shpëtuar njeriun. Më shumë bëhet fjalë për intelektualë krijues të shkëputur nga populli që gëzojnë të gjitha të mirat dhe bëjnë ligjin në mjediset e artit; edhe kur kritikohen disa anë të shoqërisë, si p.sh., shfaqje të burokratizmit, kjo luftë kufizohet në provincë, në vende të shkreta, kurse qendra del e kulluar. Kur kapet tema e luftës, tregohet p.sh. ndonjë skuadër e izoluar që merr fund në mizerje dhe uri, e braktisur nga shokët. Filozofia e jetërsimit, individualizmit, e futjes në botën e ëndrrave, e kthimit në kishat dhe sçktet e harruara, shkëputja e njeriut nga shoqëria etj., janë tipike për veprat që krijohen sot në Bashkimin Sovjetik. Edhe kur mundohen të paraqesin tipa pozitivë, si në pikturë, skulpturë, romane etj., këta janë të krekosur, vanitozë, me lustër, me shprehjen e njeriut që kënohet për gjoja superpotencën dhe madhësinë e tij.

Në kundërshtim me artin e sotëm revizionist dhe me demagogjinë e pikëpamjet e hapura teorike revizioniste ngrihet tradita revolucionare e përparimtare ruse dhe ajo botërore. Kundër tyre ngrihen letërsia dhe arti ynë i realizmit socialist me të vërtetë të lirë për t'i shërbyer popullit dhe socializmit, njeriut punonjës dhe lumturisë së tij në rrugën e teorisë e praktikës revolucionare.

1980

PËRPARIMI I KULTURËS SONË DHE ZHVILLIMI I SHIJEVE ESTETIKE

Zhvillimi i kulturës sonë socialiste, në të gjitha fushat e saj, ka sjellë me vete edhe ngritjen e shijeve estetike. Kjo flet për një rritje shpirtërore dhe kulturore të shoqërisë tek ne.

Ecjen përpara të shijeve të shëndosha revolucionare dhe të kërkesave artistike e përcakton, në një masë të rëndësishme, formimi i përgjithshëm kulturor i njeriut jo vetëm në fushën e artit, të kulturës artistike, por edhe në fushat e tjera të ideologjisë, politikës, shkencës, në mënyrën e jetesës, në atë të prodhimit etj.

Lidhja e artit me publikun është reciproke dhe dialektike. Arti vepron te lexuesi apo spektatori dhe këta, nga ana e tyre, ushtrojnë ndikim të drejtpërdrejtë tek ai. Lidhje të tilla shërbejnë si një rregullator i vazhdueshëm. Varet nga gjendja e shoqërisë dhe prej këtej, nga brendia e artit se ç'raporte do të krijohen midis tij dhe vlerësuesve, sa do t'i plotësojë arti kërkesat e shoqërisë dhe sa është në gjendje shoqëria të nxitë dhe të frymëzojë zhvillimin e artit në gjinitë dhe llojet e tij më të ndryshme. Këto raporte dialektike i ka dalluar Marksi kur ka thënë se arti krijon edhe publikun që e kupton dhe se ai nuk është vetëm objekt për subjektin, por edhe subjekt për subjektin. Po ta themi me fjalë të tje-

ra, shprehja e Marksit zbulon raportin reciprok të artit me publikun, pra, tregon se arti i kushtohet njeriut që do të gjejë në të jetën, veten e tij, shoqërinë; i kushtohet njeriut që do të gjejë artin objekt gjykimi, por, në të njëjtën kohë, arti bëhet një forcë më vete që krijon artdashësit, i edukon njerëzit dhe i drejton shijet e tyre.

Partia dhe shoku Enver, duke folur për problemet e letërsisë dhe të artit, i janë drejtuar edhe shijes së shëndoshë revolucionare, nevojës së edukimit të saj. Në Plenumin e 4-t të KQ të Partisë, ky problem u ngrit në mënyrë të veçantë, krahas luftës kundër ndikimeve liberale dhe ruajtjes së pozitave të realizmit socialist. Në këtë Plenum shija estetike u trajtua në kuptimin e saj themelor — një çështje shoqërore dhe jo individuale. Elementet individuale ekzistojnë, por nuk përcaktojnë vlerësimin objektiv shkencor të një vepre arti. «...shijet kanë gjithmonë karakter shoqëror, — ka thënë shoku Enver Hoxha në Plenumin e 4-t — formohen nën ndikimin e drejtpërdrejtë të marrëdhënieve ekonomiko-shoqërore, të ideologjisë e të kulturës, të psikologjisë shoqërore. Këtej del i qartë edhe karakteri klasor që kanë ato.»¹⁾ Nga ky përcaktim kuptohet fare mirë se cila është ajo sferë e gjerë ku duhet kërkuar burimi i shijeve dhe se forcimi i njeriut dhe stadi kulturor zënë vendin e tyre të dukshëm në evoluimin e shijeve estetike.

Partia ka theksuar rëndësinë e luftës që duhet bërë kundër shijeve të ulëta e banale borgjezo-revizioniste, shijeve të vjetëruara e anakronike, të cilat vijnë si pasojë e ndikimeve të huaja artistike dhe e mënyrës së jetesës dhe koncepteve të papajtueshme me jetën tonë.

Në kushtet e zhvillimit të vrullshëm të socializmit tek ne, Partia na mëson të bëhemi përkrahës të evoluimit të shijes, duke u mbështetur në marksizëm-leninizmin dhe në traditën tonë kombëtare. Ne jemi si kundër qëndrimeve liberale ashtu edhe kundër qëndrimeve kon-

1) E. Hoxha, «Mbi letërsinë dhe artin», f. 403

servatore, që do të bëheshin pengesë për një evoluim të mëtejshëm. Në të njëjtën kohë ky përparim nuk mund të arrihet pa një zhvillim të gjithanshëm kulturor të njeriut dhe kjo gjithmonë e më shumë po bëhet realitet në shoqërinë tonë.

Duke u nisur nga mësimet e Partisë dhe të shokut Enver Hoxha për këto çështje, do të dëshironim të kapnim disa ndër problemet e shumta dhe të gjera të shijes estetike, që dalin nga praktika e zhvillimit të përgjithshëm të kulturës, të letërsisë dhe arteve.

Kështu, një problem i rëndësishëm, që ecën krahas evoluimit të shijes estetike, është forcimi i përmbajtjes së saj. Publiku i gjerë artdashës është edukuar tek ne me shije të shëndoshë, që ka në vetvete një qëndrim klasor të qartë. Kjo shije nuk është thjesht një pohim apo mohim vulgar, por lidhet me brendinë dhe me të kuptuarit gjithmonë e më shumë të veçorive të artit. Ajo ka ardhur me kohë e me një përgatitje arsimore-kulturore të rinisë dhe të masave. Tani kuptohen e ndiqen më mirë edhe gjini që duan një kulturë më të madhe profesionale, si muzika instrumentale apo opera, baleti etj., megjithëse përhapja dhe depërtimi i tyre më i madh në masa mbeten problem edhe për të ardhmen. Po të shohim romanet që lexohen apo filmat që ndiqen, do të vemë re se shija është e mirë; tërheqin vëmendjen vepra me vlera të vërteta, me përmbajtje të shëndoshë dhe formë të arritur; krijime me veprim të qartë dhe thurje të bukur, ku e dobishmja me interesanten janë në harmoni me njëra-tjetrën. Është e natyrshme se shija ka të bëjë edhe me moshat dhe me psikologjinë e tyre. Veprat letrare dhe filmat me subjekte të zhdërvjellëta, me të papritura, si tanët ashtu edhe filma të huaj me ide përparimtare, tërheqin mjaft vëmendjen e rinisë dhe kjo është e natyrshme. Po shtypi, kritika jonë organizata e rinisë dhe shkolla mund të bëjnë një punë më të madhe që të mos ketë prirje të tepruara drejt një mënyre të caktuar, po të zgjerohet sfera e interesave të rinisë dhe të luftohet kuptimi i sipërfaqshëm i veprës artistike apo i së bukurës në jetë. Një

vëmendje më e madhe drejt idesë, peshës kryesore të një veprë, do të bëjë që ajo të kuptohet më mirë dhe të nxirren prej saj më shumë përfitime edukuese.

Veprat më të mira të artit formojnë simpatizuesit e tyre dhe lozin rol në formimin e shijeve. Po shpesh duhet edhe një ndihmë nga mendimi kritik, nga opinioni shoqëror për t'i shpjeguar më mirë vlerat e veprave dhe për t'u ndalur atje ku ato i pasurojnë shijet. Këtë e kërkon karakteri novator i veprave si edhe nevoja e zbulimit dhe përhapjes së tipareve të reja estetike që përftohen.

Një punë të dukshme ideoestetike për edukimin e rinisë dhe të fëmijëve bën dhe ajo krijimtari që u kushtohet e u përshtatet atyre në fusha të ndryshme. Edukimi estetik i fëmijëve është një detyrë shumë e madhe e shoqërisë sonë, sepse që në këtë moshë fillojnë e vihen bazat e një kulture të vërtetë. Prandaj kërkohet kujdes edhe më i madh që as të mos u krijojmë atyre zbrazëti në shije, as mos kalojmë në një njohje thjesht racionale, të thatë e me moralizime që shpien në shije vulgare. Zgjerimi tematik, gjuha e përshtatshme për moshat, vendi më i madh i fantazisë do të nxitin drejt shijeve më të plotë. Edhe gjinia e përrallës, ndër të tjera, freskia dhe pasurimi i saj me përshtypje sa më të shumta nga jeta jonë, do të zgjerojnë këndin e perceptimit estetik të fëmijët.

Përmbajtja e shijeve dhe evoluimi i tyre lidhen me formimin e një botëkuptimi më të plotë ideoestetik të publikut të sotëm artdashës, i cili ndihmon për të kapur anët më thelbësore të letërsisë e artit, për të reaguar menjëherë ndaj shfaqjeve të huaja, për të gjetur çfarë është reale dhe e besueshme dhe çfarë është artificiale dhe e sajuar. Në anën tjetër, publiku i sotshëm kërkon më shumë nivel artistik dhe nuk e pranon skematizmin, moralizimet e thata, mungesën e karaktereve dhe të mendimit, dialogun e zhveshur dhe të cekët. Me pjekuri reagon ai edhe ndaj veprave të huaja që përkthehen apo filmave që shfaqen, duke çmuar ç'është e mirë dhe serioze, e vendosur në periudhën

historike kur ka lindur, dhe ç'është e cekët, aventuroze apo me një përmbajtje të kufizuar.

Zhvillimi i gjithanshëm i shijes ndihet në interesin e masave për artet e ndryshme, si dhe në një qëndrim të drejtë krahas artit të kultivuar edhe në atë amator e folklorik. Folklori i popullit tonë ka gjetur një përhapje të gjerë dhe pëlqehet nga të gjithë, duke përfshirë edhe të rinjtë, të cilët rriten me tradita të shëndosha kombëtare.

Po të shohim etapat e ndryshme të zhvillimit të jetës sonë, të kulturës dhe të artit, do të vëmë re se shija ka evoluar nga koha në kohë, duke u bërë më e thellë, me më shumë përmbajtje dhe me kërkesa më të mëdha. Krijimet më të mira, të çdo periudhe qofshin, lenë gjurmë dhe mbeten në historinë e kulturës së një vendi, por edhe koha vë njëkohësisht vulën e vet në këto krijime. Në qoftë se dikur, në hapat e parë, një pohim i përgjithshëm entuziast do të na kënaqte, tani kërkojmë më tepër se kaq: depërtimin në prozgjdhjen e drejtë të kontradiktave, natyrisht, sipas rasteve dhe gjinive. Nëse në fillimet e veta arti ynë i rikishte edhe momente naive, personazhe të njëtrajtshëm, tani kërkohet një pasqyrim më kompleks dhe forcë më e madhe në zbulimin e karaktereve. Po kështu, edhe larmia e stileve dhe individualiteteve është shtuar dhe publiku që lexon, që ndjek teatrin, estradat etj., tani kërkon e gjykon më shumë për to.

Evoluimi i shijeve duket edhe më i theksuar në vështrimin ideologjik. Sa më tepër forcohet ndjenja e kolektivitetit dhe luftohet psikologjia e pronës private, aq më shumë njeriu ynë punonjës formon botëkuptimin e vet materialist dhe, si pasojë, sfera e shijeve liberale, apo anakronike dhe sentimentale ngushtohet dhe zhduket. Kështu ndodh që edhe krijuesit i luftojnë këto recidive; edhe publiku nuk i qas, sepse i quan të huaja, apo të vjetra dhe larg tipareve të sotme të jetës. Rrallekush mund të preket sot nga një melodi sentimentale, gjë që nuk do të thotë se njeriu largohet nga sentimen-

tet, nga ndjenjat, po, përkundrazi, priret drejt ndjenjës së vërtetë. Kjo ndodh sepse jeta jonë është e vrullshme. ndjenja realiste është forcuar dhe formimi ideoestetik i njeriut është më i plotë. Por asnjëherë nuk duhet nënvleftësuar rreziku i depërtimit të shijeve moderniste, liberale, sepse këto, ndonëse i takojnë gjithashtu një botë që po vjetërohet dhe do të shkojë drejt fundit, përsëri mund të ndikojnë, sepse na ofrohen si të reja, novatore, kurse në të vërtetë nuk kanë të bëjnë fare me novatorizmin.

Prandaj rëndësi të madhe merr lufta për të forcuar edhe më tej shijet revolucionare, kundër shijeve borgjezo-revizioniste dhe atyre që mbajnë erë vjetërsi. Që të dyja këto i takojnë një botëkuptimi të huaj dhe pugen me njëra-tjetrën në pengesat që i sjellin konceptimit të ri estetik. Ky problem duhet parë si në shijet e një pjese sado të kufizuar lexuesish e spektatorësh, ashtu edhe në elemente të veçanta të vetë artit, me gjithë trungun e shëndoshë të tij dhe luftën e vazhdueshme që u është bërë shfaqjeve të huaja. Kuptohet se, në të dy drejtimet, në shijet dhe në dukuritë artistike, kjo luftë vazhdon si pasojë e zhvillimit të luftës së klasave dhe e presionit të ideologjisë borgjezo-revizioniste, si edhe për faktin se mbeturinat nuk zhduken lehtë nga ndërgjegjja. Edhe ato shfaqje të huaja që dalin në vepra të veçanta të publikuara ose të papublikuara kanë, pa dyshim, edhe një pikë mbështetje sado të pakët, gjejnë diku një truall që favorizon.

Shfaqje të shijeve të huaja vërehen në të kuptuarit e cekët të novatorizmit, kur ky ngatërrohet me elemente formaliste. Kështu, po të marrim letërsinë, ndonjë vjershë e errët apo formaliste quhet si gjë e re e kohës, nga ndonjëri, që nuk e kuptoka dot kushdo. Ose në ndonjë rast, quhet si e vjetëruar ajo prozë që i përmbahet traditës dhe nuk ka në sipërfaqe ndonjë gjë që «të të çudisë». Këto janë shprehje të një snobizmi apo vështrimi të cekët, që rrjedh nga koncepte dhe nga një formim i pamjaftueshëm. Kërkimet janë të domosdoshme në art e, për pasojë, edhe shijet që nisen nga e re-

ja, që presin diçka bashkëkohore, në kuptimin më të shëndoshë, janë pozitive, por këto nuk duhet të ngatërrohen me kërkesat formaliste. Po të shohim, p.sh. poezinë ka raste kur figura, — mjet i domosdoshëm poetik,

— keqpërdoret, imazhi largohet nga përfytyrimi real dhe ndodh që kemi të bëjmë me jetërsimin e figurës njerëzore ose me mbingarkesë figurash, që, dashur pa dashur, shpie në formalizëm. Problemi i një prirjeje të tepruar për disa tema dhe subjekte uniforme, i një trajtimi romantizant dhe subjektivist të temave të lash-tësisë apo edhe të së sotmes, është gjithashtu një dobësi e natyrës artistike dhe ideore, e cila duhet luftuar për ta vënë theksin më shumë te aktualiteti.

Ndonëse në të rrallë, por nuk përjashtohen ende në letërsi shije të tilla të apasionimit pas ndonjë romani të vjetëruar, të përkthyer dikur, plot dashuri sentimentale e rënkime. Shije të vjetëruara arkaike, melodramatike, ndeshen në ndonjë krijim letrar të sotëm, në konceptimin e jashtëm të fenomeneve dhe në mungesën e interpretimit të duhur social të temave që trajtohen.

Në fushën e muzikës vihen re, nëpër mjedise intime, ku ka hyrë, por jo sa duhet, kënga e sotme e re, shfaqje të një shijeje të vjetëruar e të huaj. Zhdukja e këtyre fenomeneve, sado të rralla, do të arrihet si me edukimin e bartësve, ashtu edhe me krijimin dhe futjen më të gjerë në masa të këngës së re të kapshme, depërtuese e të larmishme. Për forcimin e shijeve duhet bërë një punë më e madhe edhe me orkestrenat e lokaleve e të lulishteve, ku shpesh repertori është i rëndomtë dhe ekzekutimi i dobët. Po kështu ndodh edhe në disa estrada, ku, krahas këngëve të mira, kultivohet edhe një shije vulgare dhe ndihet mungesa e kulturës (megjithëse tani për këtë flitet shpesh e ka edhe përparime) si në meloditë, në skeçet, interpretimin etj.

Po kështu, lindin probleme të kësaj natyre edhe për artet figurative, ku bien në sy, herë pas here, shfaqje të shijeve të huaja dhe të prapambetura. Këto ndo-

dhin nga mënyra e konceptimit artistik apo nga një estetikë e vjetër, si dhe nga puna e pamjaftueshme në përhapjen e veprave të arteve figurative, në shpjegimin dhe propagandimin më të mirë e më me kulturë të tyre, që njerëzit ta ndiejnë më shumë nevojën për t'i futur e zgjedhur më mirë veprat apo riprodhimet nëpër institucione, lokale, shtëpi e vatra kulture e sidomos në mjedise familjare. Përhapja ende e një shijeje idilike e vulgare me jastëqet e zbukuruara me peizazhe, ku duket një kasolle e vetmuar apo një çift i «përmalluar» etj., apo rasti tjetër kur muret mbeten bosh, duke ndjellë një zbrastri shpirtërore, përbëjnë një problem shoqëror që nuk zgjidhet me masa administrative, po me rrënjosjen e kulturës së re artistike, të shijeve të sotme, me punën për njohjen dhe përhapjen e artit të ri.

Është e kuptueshme se këto arrihen kur vetë arti, duke përfshirë edhe artet e aplikuara e prodhimet artistike, forcon më tepër përmbajtjen e vet, thellohet në jetë dhe kur autorët nisen edhe më shumë nga shije të formuara, janë edhe më vigjilentë ndaj çdo ndikimi të huaj dhe i përgjigjen më mirë shijeve të përparuara të kohës. Arti ynë i krijon dhe i ka krijuar admiruesit e vet të shumtë; puna është për ta përmirësuar gjendjen dhe për ta shpurë përparimin më tej.

Për përhapjen dhe edukimin e shijeve të shëndosha një rol të madh, siç u përmend, lozin kritika artistike, takimet e krijuesve me publikun, të gjitha mjetet e propagandës, shtypi dhe radiotelevizori. Këtu bëhet një punë e madhe, por kjo do forcuar e përmirësuar që të kultivohen edhe më tepër shijet estetike të drejta. Kjo arrihet, kur nxirren në pah krijimet më të mira, kur i shmangemi monotonisë dhe uniformitetit në mjetet e propagandimit të artit, kur i zgjedhim më mirë poezitë që recitohen dhe kur recitimi bëhet më i bukur, kur transmetohet më shumë dhe me nivel më të lartë muzika e kompozitorëve tanë etj. Dhe kuptohet se sa rëndësí ka kultura e propagandimit, kompetenca e nxjerrjes në pah të vlerave dhe veçorive të artit. Kjo plotëso-

het me një mobilizim më të madh të inteligjencies krijuese, të arsimtarëve, studentëve etj., të amatorëve të apasionuar që japin mendimet e tyre mbi veprat dhe dukuritë e artit.

Zhvillimi i mëtejshëm i shijeve estetike të masave është një problem i rëndësishëm i kulturës sonë, që ndikon në formimin shpirtëror dhe moral të njeriut, që i zgjeron atij horizontin e kulturën dhe i shton aftësitë krijuese.

1979

DRAMA
PROZA
POEZIA

1907
AND
ALSO

VËSHTRIM MBI DRAMËN TONË – BRENDIA DHE ARTI I SAJ

(1974-1978)

Këto 4-5 vitet e fundit dramaturgjia jonë ka ecur përpara, ashtu si gjithë llojet dhe gjinitë e tjera të artit tonë të realizmit socialist. Dramat e shkruara dhe të vëna në skenë kanë zgjuar interesin e spektatorëve dhe lexuesve. Drama, si një gjini letrare, e cila jetën e saj të vërtetë e gjen në skenë, ka tërhequr vëmendjen duke na dhënë pamje realiste të jetës, konflikte dhe karaktere si edhe duke ngritur dhe shtjelluar probleme shoqërore e morale që ndihmojnë për edukimin e njeriut të sotëm. Duke vazhduar traditën e re të realizmit socialist, dramaturgjia, pas Plenumit të 4-t të KQ të PPSH të qershorit 1973, ka ecur në një rrugë të drejtë, ka zbatuar parimin e partishmërisë proletare, ashtu si gjithë letërsia dhe artet e tjera tek ne, është munduar të pasurojë përmbajtjen e saj dhe të ngrejë nivelin ideoartistik. Radhët e dramaturgëve janë shtuar në mënyrë të konsiderueshme me autorë që vijnë nga gjini të tjera letrare ose me të rinj që po debutojnë. Prej të gjithëve janë bërë përpjekje për të ecur me proceset revolucionare të jetës, për të pasqyruar në drama dhe pastaj në skenë, pamje, tipa, du-

kuri apo episode të marra nga etapa të ndryshme të realitetit të sotëm dhe të kaluar.

Në dokumente të ndryshme të Partisë, në fjalime, biseda dhe përshëndetje të shokut Enver, kurdoherë është treguar një kujdes i madh për dramaturgjinë, për teatrin tonë të realizmit socialist; është folur për forcën e tij edukative, për karakterin militant dhe revolucionar, që e ka burimin qysh me teatrin partizan, i cili, ndonëse në hapat e parë, sillte me vete frymën popullore e të partishme dhe zgjonte emocione tek njerëzit.

Pas kritikave të rrepta që u bënë në Plenumin e 4-t ndaj disa shfaqjeve negative në art, pas goditjes së pikëpamjeve armiqësore dhe punës antiparti e antikombëtare të Fadil Paçramit dhe Todi Lubonjës, si u kritikua largimi nga partishmëria dhe fryma kombëtare në drama të veçanta, Partia, duke vënë në dukje përparimin e mëtejshëm në gjini dhe lloje të ndryshme të artit, disa herë të tjera e ka ngritur edhe problemin e dramaturgjisë, të skenës e të ekranit. Fjala e shokut Enver në 20 dhjetor 1974 i kushton një vëmendje të veçantë këtyre problemeve; ajo është frymëzim për zhvillimin e mëtejshëm të dramaturgjisë dhe teatrit. Nga këto orientime del se është e nevojshme të bëhet një punë më e madhe dhe të mobilizohen të gjitha forcat krijuese për t'iu përgjigjur kërkesave të kohës, duke shpурë në vend më mirë porosinë e Partisë për këtë art kaq të dashur, me karakter të theksuar demokratik dhe masiv.

Detyrat që ngrihen në Kongresin e 7 të Partisë, problemet e rëndësishme politike, ekonomike dhe shoqërore, analiza e gjendjes së brendshme dhe të jashtme në atë Kongres, të shikuarit e proceseve të zhvillimit me syrin e luftës klasore, këto si edhe orientimet për forcimin e partishmërisë e të karakterit kombëtar, për njohjen më të thelluar të jetës dhe ngritjen e nivelit ideoartistik, për dramaturgjinë tonë, si për gjithë artin, janë drejtimi kryesor ideologjik si edhe burim temash e subjektsh, që do të zbulojnë edhe më mirë proceset e ritmet e zhvillimit të realitetit tonë.

Dramaturgjia ka forcuar përmbajtjen e saj dhe janë luftuar e shmangur gabimet si edhe mjaft dobësi e të meta të natyrës ideologjike që viheshin re në vepra të veçanta para Plenumit të 4-t. Sipas mësimëve të Partisë, duke u thelluar në estetikën marksiste-leniniste, përmes diskutimesh krijuese dhe analizash, në faqet e shtypit dhe sidomos në krijimtari konkrete, u goditën pikëpamjet e huja, të konkretizuara edhe në drama të veçanta, si të F. Paçramit e të ndonjë tjetri, që mbronin pozitën e deheroizimit, të heroit të lëkundur, të ndarjes metafizike midis idesë dhe realitetit, midis të ashtuquajturit teatër racional dhe teatër emocional. Këto si edhe të tjera pikëpamje e shfaqje të huaja u luftuan dhe dramaturgjia doli më e pastër dhe më e shëndoshë. Përparimi është i ndjeshëm dhe shfaqjet e huaja tani janë më të rralla, po lufta klasore midis pikëpamjeve ideologjike është e vazhdueshme, prandaj vigjilenca duhet të jetë e mprehtë dhe të tregojmë kurdoherë kujdes për pastërtinë ideologjike të krijimtarisë sonë. Mos harrojmë gjithashtu se edhe cektësia, zgjidhja formaliste e kontradiktave, niveli i ulët artistik, nuk janë vetëm probleme të mjeshtërisë e të formës, po edhe probleme të përmbajtjes ideologjike, që lidhen me zbatimin në praktikë të parimeve të realizmit socialist.

Fjala e Partisë dhe e shokut Enver ka qenë dhe është kurdoherë frymëzuese për zhvillimin e mbarë të letërsisë dhe arteve tona. Fryma optimiste mobilizuese dhe problemet shumë të rëndësishme që ngre Partia na ndihmojnë për të parë më mirë gjendjen e dramaturjisë dhe për të arritur rezultate të reja, duke konfirmuar atë çka është më e mirë, me cilësi ideoartistike dhe për të kapërcyer të metat që vihen re.

Forcimi i mëtejshëm i përmbajtjes jetësore dhe ideologjike të dramaturgjisë sonë

Dramaturgjia e këtyre viteve ka ecur në gjurmët e dramave dhe komedive tona më të mira të mëparshme, të atyre që kanë hyrë në radhën e veprave të shquara dhe ndiqen me interes si «Toka jonë», «Familja e peshkatarit», «Cuca e maleve», «Prefekti», «Karnavalet e Korçës», «Fytyra e dytë». Këto drama, si edhe të tjera, kanë luajtur rol në zhvillimin e dramaturgjisë sonë, sepse nisen nga një njohje e thellë e jetës, nga zbulimi realist i konflikteve që kanë vënë në qendër, por edhe nga thurja e përshtatshme për dramën, me veprim, dialog, parashtrim të logjikshëm të problemit dhe me përgatitje të ndeshjeve, të cilat bartin në vetvete kulmet e dramave, momentin konkret të subjektit dhe, njëkohësisht, peshën e mendimit që arrin në përgjithësime emocionuese. Këto anë pozitive janë të dukshme në dramat më të mira të periudhës që analizojmë. Si në sasi, ashtu edhe në cilësi (po t'i shohim nga niveli i përgjithshëm mesatar) dramaturgjia e viteve të fundit ka shënuar përparime në krahasim me dekadat e mëparshme; teatri ynë i realizmit socialist, teatri kombëtar, është forcuar. Ne flasim tani për një përparim të mëtejshëm, për t'iu përgjigjur kërkesave gjithmonë në rritje të lexuesve dhe spektatorëve.

Kur themi se është forcuar përmbajtja ideore dhe jetësore e dramave, kemi parasysh përmbajtjen në kuptimin më të saktë estetik të kësaj fjale, kur në vepër gjejmë një pozicion ideologjik të përcaktuar dhe të shëndoshë; gjejmë jetë, episode reale, si edhe tipa që bartin një mendim dhe veprojnë me bindje. Në një kuptim më të gjerë, pothua të gjitha dramat tona kanë pikësynime të drejta, nisen nga një qëllim i mirë, po ka mjaft raste kur ky pikësynim nuk shndërrohet në përmbajtje ideoartistike, mbetet skemë dhe idetë abstrakte e të thata, ose zotëron një veprim i jashtëm, i pangjeshur me mendimin. Për forcimin e përmbajtjes jetësore, filozofi-

ke dhe estetike duhet të luftojë gjithë letërsia dhe artet e tjera për t'iu përgjigjur më mirë realitetit tonë heroik dhe lartësisë së mëndimit revolucionar të Partisë sonë.

Në dramën më të mira kemi të bëjmë me një forcim të përmbajtjes në kuptimin që folëm. Tendenca pozitive e luftës dhe mënjanimi të çdo pikëpamjeje të huaj është e përgjithshme në tërë dramaturgjinë tonë.

Pasqyrimi me realizëm i momenteve të rëndësishme nga historia e revolucionit në vendin tonë është tipik për disa nga dramën e krijuara dhe të vëna në skenë gjatë kësaj kohe. Kontribut të veçantë në krijimtarinë dramaturgjike kanë dhënë autorët si K. Jakova, T. Laço, R. Pulaha, F. Kraja etj. Prirja që u përmend si edhe prirje të tjera ideo-tematike kanë dalë qartë në veprat dramaturgjike të këtyre autorëve si edhe mjaft autorëve të tjerë.

Pasqyrimi i jetës së re të fshatit, i transformimeve në shoqëri dhe në ndërgjegjen e njerëzve, i rolit edukues të heroit pozitiv është bërë në disa nga dramën dhe komeditë më të mira. «Zonja nga qyteti» e R. Pulahës është një vepër që i ka trajtuar me mprehtësi dhe bukuri artistike këto probleme. Vlerat e veprës dhe mishërimi artistik i saj në skenë dhe në ekran, përmes lojës së paharrueshme të aktorëve, e kanë vënë atë në një vend të shquar. Spektatorët e shikojnë me ëndje, mësojnë prej saj dhe ndiejnë kënaqësi të vërtetë që vjen nga gërshetimi i brendisë, fjalës së gjetur, lojës dhe humorit të natyrshëm.

Te komedia «Zonja nga qyteti» goditet qëndrimi mikroborgjez dhe meskiniteti i një bote të ngushtë që shembet në kontakt me jetën e gjallë dhe të shëndetshme të fshatit tonë të ri. Kjo komedi, e vënë në skenë në fillim nga teatri i Korçës dhe pastaj nga i Tiranës, ka figura të gjalla dhe të besueshme. Problemi i vajtjes në fshat të rinjve për t'i shërbyer atdheut dhe socializmit shtrohet në mënyrë të natyrshme e të drejtë. Një meritë e dukshme e kësaj komedie është krijimi i heroit pozitiv të thjeshtë, të besueshëm dhe pa idealizime

të tepëruara, i rolit të sekretarit të partisë, një punonjësi të afruar me njerëzit, që di t'i edukojë dhe t'i bindë ata. Figura e tij bëhet simpatike; ai nuk moralizon dhe nuk del jashtë stilit të komedisë. Kjo komedi është e bukur, sepse, përveç atyre që u përmendën, ajo lthyen shabllonet e disa dramave dhe komedive, ku gjithçka dihet që në fillim dhe subjekti ndërtohet sipas një skeme të paracaktuar.

Një fenomen i dukshëm pozitiv është interesimi për problemet e transformimeve ekonomike, të cilat shpiten edhe në ndryshime shoqërore psikologjike në ndërgjegjen e njeriut të thjeshtë. Kështu, ky aspekt është parë përmes antagonizmit botëkuptimor e klasor, midis nesh dhe armiqve, si dhe në gjirin e popullit. Të tri dramat e K. Jakovës «Lulet e shegës», «Përmbytja e madhe» dhe «Lugajanët», të luajtura edhe në skenat e teatrove tona, në vështrime të ndryshme, merren me këto anë të jetës dhe rrahin probleme të kësaj natyre. Po kështu edhe drama «Djem të mbarë» e F. Krajës tregon ndryshimet shpirtërore të njeriut nën ndikimin e marrëdhënive socialiste të punës në minierë; apo drama «Shënomëni dhe mua» e H. Minarollit flet mbi luftën që bëri Partia për kolektivizimin e fshatit, ndeshjen e botëkuptimit revolucionar me atë reaksionar si edhe me psikologjinë e pronës private. Është gjë pozitive, që flet për forcimin e realizmit, interpretimi i jetës përmes proceseve politike dhe ekonomike. Këto momente kanë qenë gjithmonë në bazë të veprave realiste më të shquara të letërsisë sonë dhe të letërsisë së përparuar botërore. Pa njohje dhe pasqyrim të thelluar të këtyre anëve, ku trajtohen probleme të tilla, jeta del e zbehtë, vepra mund të mbetet e montuar dhe aprioristike, vlerat e saj njohëse dhe ideore do të jenë të pakta.

Një meritë e veçantë e dramaturgut Kolë Jakova është pikërisht njohja e saktë e ambienteve që trajton dhe gërshetimi i problemeve që kanë për bazë një realitet konkret, me tipa të veçantë me ngjyrë të caktuar dhe me gjuhë të natyrshme e shprehëse. Pa dashur të bëjmë analizën e veprave të veçanta të tij, do të thek-

sonim se në dramën që përmendëm, del qartë prirja sociale e dramaturgjisë sonë dhe forcimi i përmbajtjes realiste të saj. Kështu, te «Lulet e shëgës» trajtohet periudha e pasqirimit me luftën klasore, përmes një antagonizmi të ashpër dhe të papajtueshëm. Në njërin anë qëndrojnë ambiente progresive të shoqërisë, njerëz me vendosmëri dhe bindjet e tyre, me forcën që u dhanë idetë e revolucionit dhe pushteti i ri dhe, në anën tjetër, përfaqësues klasash shfrytëzuese dhe shërbëtorë të tyre, të cilët ende nuk pajtohen dot me faktin se u iku pushteti nga dora dhe përdorin intrigën, dinakëritë për të ruajtur vetveten dhe privilegjet që gëzonin dikur. Midis qëndron një përfaqësues i fshatarësisë, i lëkundur, me lakminë e përjetshme për pasuri e para, të cilin armiq të duan ta përdorin si vegël. Ngjarjet, njerëzit veprojnë mbi të dhe e vërteta del përpara sysh. Revolucionin, në udhën e tij të pandalur, rrëzon, spraps, po edhe bind, bën me vete njerëz të popullit që, përkohësisht, gabohen.

Një ndërthurje të kontradiktave joantagoniste me kontradiktat antagoniste gjejmë në dramën «Përmbytja e madhe» të K. Jakovës, e cila, ndofta, ka qenë drama më e goditur e tij në këto vite dhe një ndër dramën tona të mira. Kjo ka ardhur për vlerat e dramës, po edhe për meritë të trupës së Teatrit Popullor, që ka ditur ta vejë në skenë me sukses. Cili është problemi i kësaj vepre? Ajo e merr frymëzimin nga një ngjarje tipike e ditëve tona, nga transformimet e Atdheut dhe arrin të japë tipa dhe fate njerëzish, me luftën dhe dramën e tyre të brendshme. Ndërtimi i hidrocentralit dhe i digës së tij kërkon krijimin e liqenit artificial, i cili do të përmbytë toka, fshatra dhe, midis tyre, një kullë që simbolikisht dhe realisht vendoset në skenë. Edhe përmbytja është reale dhe simbolike njëherej; të rinjtë janë optimistë; ata ndërtojnë jetën e re, dashurohen duke shkelur zakonet e vjetra të hakmarrjes dhe paragjykimet: po një gjyshe s'ndahet dot nga kulla dhe nga ato vise ku ka kujtime të shumta dhe varret e të afërmeve. Këtu gërshetohet edhe puna e armiqve të pushtetit, që përfitojnë nga dobësitë e plakës dhe kjo e

bën atë të kuptojë të vërtetën. Pavarësisht nga vërejtjet që mund të bëhen, drama është mbështetur mbi një ide të rëndësishme dhe konceptimi i saj arrin në përgjithësi, të shpë në një përfytyrim poetik që do të dëshironim të zhvillohej edhe më tej.

Ndonëse me një temë e problematikë të rrahur edhe më parë nga ky autor e nga të tjerë, por me një koherencë të brendshme dhe me realizëm, është trajtuar edhe drama «Lugajanët», e interpretuar nga teatri i Durrësit, e cila nuk ka pasur gjer tani ndonjë jehonë në shtyp. Por, mendojmë, se ajo ka vlera shoqërore dhe tregon se shpërbërja e familjes patriarkale dhe largimi i normave konservatore të jetesës, u bë një domosdoshmëri historike në kushtet e formimit të kooperativave bujqësore. Prona private dhe normat morale të vjetëruara pengojnë lumturinë dhe përparimin ekonomik të jetës. Në anë tjetër, familja socialiste, duke mos u pajtuar me familjen patriarkale, forcon unitetin moral, sepse lidhja midis njerëzve bëhet e lirë, pa vartësinë ekonomike dhe nënshkrimin e gruas. Rrahja dhe zgjidhja e drejtë e këtyre dukurive të jetës dhe problemeve sociale kërkojnë një zgjerim të tematikës së dramaturgjisë.

Një prirje tjetër, më tepër e fushës së moralit, e edukimit të njeriut nëpërmjet punës, në luftë kundër paragjykimeve e qëndrimeve mikroborgjeze, ndihet gjithashtu në disa drama e komedi, si «Doktori pacient» e R. Pulahës, «Lezja» e K. Blushit, «Diell mbi Kastër» e F. Krajës, «Çifti i lumtur» e B. Pepës, «Njerëz të afërm» e R. Hysës, «20 vjeç» e B. Hoxhës etj. Problemi i vajtjes në fshat sidomos nga brezi i ri, siç e theksoi përsëri shoku Enver në fjalimet e tij gjatë vizitave në Gjirokastrë e Sarandë, lufta për emancipimin e gruas, ndërtimi i marrëdhënieve socialiste midis njerëzve, kundër mbeturinave feudale e patriarkale, janë objekt i pasqyrimit në mjaft drama. Por, siç do të shohim, jo gjithmonë këto probleme janë rrahur me thellësinë e duhur dhe nuk lenë kurdoherë gjurmë.

Ndër problemet e mëdha të sotme, ndonëse më pak, nga disa autorë janë trajtuar edhe ato të revolucionit

tekniko-shkencor, apo të luftës kundër burokracisë dhe mendimit të prapambetur në drama, si «Tymra që spastrohen» e Z. Cikulit, e cila ka vlera edukative, apo «Rruga drejt lartësive» e N. Dokles, një dramë me disa vlera edhe artistike e me një lloj poezie; të cilat nuk janë zbuluar apo janë mënjanuar në shfaqjet e saj në teatër.

Karakteristikë në këtë periudhë është edhe përpjekja për të kapur tema të luftës kundër revizionizmit, për të lëvruar dramën e mirëfilltë politike, e cila duhet të marrë një zhvillim më të dukshëm, me përpjesëtime më të gjera. Drama të tilla kanë qenë «Flamur në dallgë» e M. Stefës «Dështimi i një kryqëzate» e K. Pirros etj.

Kështu, në dramaturgjinë tonë janë pasqyruar pamje, fakte, tipa nga aktualiteti ynë. Pozitive është që dramaturgët tanë më me përvojë apo më të rinj e kanë ndier nevojën e rrokjes së temave të aktualitetit dhe kanë dhënë zgjidhje të drejta të konflikteve.

Në trajtimin e temës dhe problematikës së Luftës Nacionalçlirimtare ka pasur një prirje të dukshme pozitive, për të krijuar vepra dramatike me realizëm, herë-herës, përmes një poezie të brendshme, përmes aspekteve shoqërore e klasore, në mpleksjen e botëkuptimeve, të zakoneve, të konflikteve antagonistë dhe jo-antagonistë.

Duke iu drejtuar periudhës së Luftës, dramaturgët kanë zgjedhur episode dhe probleme që zbulojnë realitetin e asaj kohe e i bëjnë jehonë edhe së sotmes. Lufta Nacionalçlirimtare, me gjithë disa vepra të denja që janë krijuar, mund të pasqyrohej edhe më mirë në dramaturgjinë tonë, me aspekte më pak të njohura, me tipa të gdhendur dhe me poezinë e saj heroike. Kjo mbetet një detyrë për të ardhmen ashtu siç mbetet edhe ngritja e cilësisë së dramave me temë nga aktualiteti. Në dramat që janë shkruar e vënë në skenë dalin në dukje ato anë për të cilat folëm; spikat qëndresa heroike e popullit, udhëheqja e komunistëve; skenat masive janë përdorur më gjerësisht dhe ka pasur

kërkime për të ndërtuar subjekte dhe konflikte më pak të rrahura, që burojnë nga realiteti dhe pikëvështrimi i metodës krijuese të realizmit socialist. Kështu, ka pasur sukses si në teatrin e Fierit, ashtu edhe në të Tiranës drama «Gjëmimi i atij dimri» e T. Laços, e cila shquhet për tiparet që u përmendën. Ky autor shkroi edhe dramën «Duke gdhirë viti 1945», që dha gjithashtu një kontribut në pasurimin e repertorit, por me «Gjëmimin e atij dimri» T. Laço krijoi një vepër me subjekt më prekës, tipa më të plotë, përgjithësisht, një ndërtim original dramatik dhe gjuhë të bukur e poetike, gjë që shpesh mungon në dramat tona.

Prirja tjetër e trajtimit të realitetit të Luftës përmes marrëdhënieve morale, zakonore, sociale, duke treguar epërsinë e moralit partizan, ndjenjën e unitetit të popullit kundër klerit dhe bajraktarit, punën e komunistëve, të partizanëve për të arritur këtë unitet — e shohim qartë te drama «Shpartallimi» e F. Krajës, e cila është luajtur me vërtetësi dhe kolorit nga trupa e teatrit të Shkodrës. Ky autor ka kontribuar mjaft në këtë periudhë dhe anët pozitive të krijimtarisë së tij janë zgjedhja e materialit konkret jetësor, dialogu i shkathët dhe një aftësi e thurjes së subjektit dhe të fabulës së përshtatshme për dramën.

Për një pasqyrim të shumanshëm të luftës, për zgjerimin e tematikës nga ajo kohë, kanë dhënë një kontribut dramat e botuara «Mësim nga historia» e L. Qafëzezit dhe «Duke mposhtur vdekjen» e E. Mandisë. Drama «Mësim nga historia» trajton një problematikë pak të rrahur në dramaturgji: organizimin e lëvizjes ilegale të qyteteve në një sfond masiv dhe edukimin e një figure, në thelb pozitive, që gabon përkohësisht, si pasojë e një sedre të sëmurë, e një egoje të theksuar, të një qëndrimi mikroborgjez dhe sentimental. Ky është një problem real i luftës dhe nuk është stisur, pavarësisht nga vërejtja që kemi se autori duhej të thellohej më shumë në ndërgjegjen e këtij personazhi dhe të tregoheshin, me një analizë sociale e psikologjike, shkaqet e një sentimentalizmi dhe qëndrimi mikroborgjez.

Edhe në punë të kompozicionit, të sfondit të shtrirë mbi të cilin vendoset ngjarja, ka për të diskutuar rreth kësaj drame, por mendojmë se ajo ka vlerat e saj njo-hëse dhe prandaj mund të vihet në skenë.

Drama «Duke mposhtur vdekjen», që bën fjalë për qëndresën në një kamp përqendrini, është shkruar me kulturë dhe në të, fund e krye, zotëron një ndjenjë heroike e përshkuar edhe nga çaste poetike, pavarësisht nga ndonjë dobësi artistike që ka ajo, si një notë libreske, apo e kompozicionit.

Teatri ynë është marrë pak me dramat historike dhe kjo mungesë është ndier. Në prag të 100 vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit u krijuan drama historike dhe njëra u vu në skenë. Vepra të botuara dhe të denja me temë historike kanë qenë trilogjia «Gjergj Kastrioti» e M. Markajt, një pasqyrë besnike e historisë, dramë e poetizuar si edhe drama e tij e fundit «Besa e madhe». Kjo dramë historike është një vepër serioze, e shkruar me vërtetësi, me patos patriotik dhe e gjen konfliktin në ngjarjet reale të asaj kohe. Është pozitiv dhe flet për një zhvillim të dramës historike, fakti se autori nisat nga e vërteta historike, nga problemi themelor i kohës dhe imagjinatën e vë në funksion të këtyre ngjarjeve. Veç kësaj, në këtë vepër është theksuar problemi i unitetit moral dhe shpirtëror të popullit në luftë kundër armikut dhe tradhtisë. Kështu gjendet një urë e sigurt e lidhjes midis kohëve dhe ngjarjeve të kaluara e të sotme.

Vepër me temë historike është edhe «Plumbat e shkronjave» e N. Priftit, e cila trajton luftën në periudhën pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, për hapjen e shkollave shqipe. Ndonjë dramë që ka meritat e saj si «Gurët e Kreshanës» e L. Papës (nota heroike dhe një lloj poezie e përshkon këtë vepër) vështirë se mund të quhen historike, sepse mbeten të përgjithshme dhe pak të konkretizuara.

Të gjitha temat dhe problematika e rrahur në këtë periudhë krijimtarie kanë ndihmuar, përmes veprave më të arrira dhe të vëna në skenë me sukses, për

forcimin e përmbajtjes jetësore dhe ideologjike të dramës sonë. Është forcuar partishmëria e saj, karakteri kombëtar dhe popullor, si në zgjidhjen e problemeve tipike për rrugën historike të kombit tonë, ashtu edhe në ngjyrat, gjuhën dhe pasqyrimin e veçorive psikike.

Arritje ka pasur edhe në punë të mjeshtërisë, të mënyrave të thurjes së subjektit, të përdorimit të dialogut, të detajeve. Ka qenë pozitive se nga radhët e prozatorëve dhe poetëve kanë hyrë në dramaturgjë dhe numri i tyre, si edhe i dramaturgëve të rinj, do të vijë duke u shtuar.

Krahas këtyre anëve pozitive, vihen re dobësi e mungesa si në përmbajtje, ashtu edhe në punë të mjeshtërisë e dalin probleme të veçanta që lidhen me to.

Nevoja e pasqyrimit më të thellë dhe më të larmishëm të jetës, të heroit pozitiv dhe të konflikteve

Ritmet e jetës sonë të sotme, formimi i njeriut të ri, zhvillimi i shoqërisë përmes luftës së klasave, prej nga burojnë edhe konfliktet e antagonizmat e brendshme dhe të jashtme, kërkojnë një pasqyrim më të thelluar e më të plotë në dramaturgjë dhe në teatër, në këtë art që gëzon tek ne popullaritet të madh dhe është një mjet edukimi i drejtpërdrejtë i mijëra spektatorëve. Këtë përparim të mëtejshëm e kërkon edhe niveli kulturor i masave punonjëse si edhe vetë zhvillimi i artit tonë socialist me arritjet më të mira, të cilat janë të dukshme në gjini dhe lloje të ndryshme.

Siç u tha, disa anë thellësore të realitetit kanë gjetur shprehje në dramën tona dhe këto vepra janë pritur mirë nga spektatorët. Por ende realiteti nuk del sa duhet në dinamikën e tij, me problemet e mëdha që e karakterizojnë, me heronj luftarakë për fitoren e së resë, me drama të thella politike, shoqërore dhe morale, drama të cilave shoqëria jonë është në gjendje t'u japë zgjidhje dhe kështu të hidhet dritë në të ardhmen. Në raportin që shoku Enver mbajti në Kongresin

e 7 thuhet: «Pasqyrimi më i mirë i disa temave të mëdha në krijimtarinë artistike, si ajo e rolit hegjemon të klasës punëtore në shoqëri, e shndërrimeve revolucionare të fshatit tonë socialist, e forcës revolucionarizuese të komunistëve, trajtimi i temave kardinale dhe i momenteve kyç të historisë së popullit tonë, dhe sidomos të Luftës Nacionalçlirimtare e të revolucionit socialist, janë një kërkesë e domosdoshme për t'i bërë letërsinë e artet tona edhe më revolucionare».1)

Këto kërkesa dalin në mënyrë të veçantë para gjinive të mëdha, si romani e drama. Siç është shpjeguar edhe herë tjetër, këto porosi të Partisë duhen kuptuar në thelb e jo përciptazi, në specifikën e artit dhe, në këtë rast, të dramës. Temat e mëdha dhe kardinale dalin edhe në subjekte me përpjesëtime të gjera historike, për të cilat gjithashtu kemi nevojë, por edhe në episode më të thjeshta e në ngjarje të jetës së përditshme, që e pasqyrojnë shpirtin e njeriut tonë me heroizmin e përditshëm, me mendimet, gëzimet dhe hallët, me jetën shoqërore dhe familjare. Për ne janë të huaja temat e ngushta, kur heronjtë mbyllen në vetvete dhe kur marrëdhëniet intime merren të veçuara nga jeta dhe shoqëria. Trajtime të tilla janë tipike sot për dramaturgjinë revizioniste ku sundon kulti i individualizmit dhe i një rrethi vicioz pa rrugëdalje.

Dramaturgjia jonë do të forcojë edhe më tepër brendinë e saj, pikënisjen filozofike dhe do të pasurohet me material jetësor, kur dramaturgët të njohin më mirë proceset e jetës, faktet historike, kur të jenë të pajisur edhe më mirë me teorinë marksiste-leniniste, me mësimet e Partisë. Dramaturgjia jonë ka nevojë për një qëndrim më novator ndaj ngjarjeve aktuale dhe tipave. Ndihet nevoja të njihen më mirë tipat dhe konfliktet jetësore, që të mos mbetemi në po ato lloje subjektesh dhe konfliktesh, të cilat ndodh që kalojnë nga njëra dramë në tjetrën. Roli i punës, i klasës punëtore gjer tani ka dalë zbehtë në dramaturgji, ndonëse janë

1) E. Hoxha, «Mbi letërsinë dhe artin», f. 537.

shkruar dhe vënë në skenë dhe drama me këtë temë. Por mendimi i sipërfaqshëm, karakteret e zbehta dhe skematizmi i konceptimit bëjnë që këto të lenë pak gjurmë ose aspak dhe të ndihet boshllëku. Jeta e fshatit, me problemet aktuale, me luftën kundër mentaliteteve mikroborgjeze, për të mos shkruar në fshat etj. janë rrahur më mirë, por edhe në këto vepra ka filluar të ndihet një monoton e theksuar dhe nuk zbulohen anë të reja të realitetit. Lufta kundër revizionizmit, që është një temë e madhe dhe tronditëse, është trajtuar ende cekët, megjithëse nga pozita të drejta të mbrojtjes së marksizëm-leninizmit dhe të internacionalizmit proletar. Po kjo ndeshje historike kërkon mendim të thellë, njohje të fakteve dramatike, patos politik dhe dramaticitet. Të mos pajtohemi me zgjidhjet pllakateske e të cakta. Fjala e partishme duhet të tingëllojë në skenat tona me forcë bindëse dhe të emocionojë spektatorët. Edhe probleme të forcimit të familjes sonë, të emancipimit të gruas, të luftës kundër egoizmit dhe qëndrimeve mikroborgjeze, kundër mbeturinave të vjetra në ndërgjegje mund të bëhen objekt i rëndësishëm i dramave tona.

Problemet themelore që lidhen me përmirësimin e mëtejshëm të dramës kanë të bëjnë me kuptimin e drejtë të heroit pozitiv, ashtu siç e shpjegon Partia dhe shoku Enver, si edhe të konflikteve dramatike. Mishërimi i idealit të shoqërisë sonë në tipa pozitivë, që vlej në si shembull edukimi, nuk ka të bëjë me idealizimet dhe me paraqitjen skematike të heroit. Shoku Enver na mëson që heroi t'i ketë këmbët në tokë, të jetë një luftëtar për të formuar më mirë vetveten dhe njerëzit që ka përreth. Në disa nga veprat dramatike, në komedi e skeçe, disa herë heroi pozitiv nuk është jetësor, vjen menjëherë i formuar dhe lëshon fraza të gatshme. Si trajtimi idilik, ashtu edhe ai eklektik (kur të mirat dhe të metat maten me përqindje) janë të gabuara dhe e zbehin figurën. Vendosja e heroit në rrethana më të besueshme jetësore dhe në konflikte të thella, zbulimi i tij shpirtëror më i thelluar do ta ngrënë më lart fi-

gurën e tij, e cila do të zëjë një vend edhe më të sigurt e më të madh në krijimtari.

Heroi dhe konflikti janë probleme që lidhen me njëri-tjetrin, sidomos në gjininë e dramës.

Njohja e paktë e jetës dhe e problemeve të saj si edhe mungesa e mjeshtërisë kanë bërë që, në disa raste, konfliktet dhe subjektet të mbeten brenda caqeve të një skeme të caktuar. Dikush, një magazinier, llogaritar apo, ndonjëherë, edhe brigadier saboton fshehurazi dhe kjo jepet fare përciptazi, pa treguar fare ç'është ky njeri, ku mbështetet dhe ç'botëkuptim ka, botëkuptim që duhet të luftohet në rrënjë dhe në mënyrë bindëse. Mbeturinat në ndërgjegje të një brigadieri apo përgjegjësi nxiten nga një njeri i dyshimtë; planet novatore i lufton si rregull ndonjë inxhinier apo kryeinxhinier. Në vend të ndeshjes së pikëpamjeve, ndodh që personazhet zihen, grinden, thuajse me një nxitje artificiale; disa japin këshilla. Për të mpleksur më mirë kontradiktat, në disa raste, hyn konflikti i hakmarrjes dhe zgjidhje të tjera të përsëritura e uniforme.

Siç u përmend edhe më parë, kapja e konflikteve antagonistë është gjë pozitive dhe një realitet tipik që kërkon pasqyrim. Po gjithçka duhet të jetë në vendin e vet, e logjikshme dhe e natyrshme, në unitet me ngjarjen dhe mendimin themelor të dramës. Në qoftë se në drama si «Lulet e shegës», «Gjëmimi i atij dimri» apo «Shpartallimi» antagonizmi klasor është i përligjur dhe koherent me përmbajtjen, kjo nuk mund të thuhet doemos për një drama të tjera si «Buka e duarve tona», «Rrënjë të hekurta» etj. Ne kemi nevojë të thellojmë në veprat tona konfliktin antagonist, debatin dhe ndeshjen e ashpër me armikun dhe kjo bëhet, siç dihet, me anë të veprimit dhe të mbrojtjes së hapur të ideve, të mbrojtjes me zjarr të tyre dhe jo të hedhjes së parullave; kjo arrihet duke bashkuar, siç thoshte Engelsi, aspektin ideal me atë realist. Por, që të realizohet kjo duhet të jenë faktet e forta dhe mendimi të vijë i natyrshëm, përmes veprimit. Ndodh që drama mbetet në dy skaje të shpëputura: ose veprimi është i si-

përfaqshëm dhe mungon mendimi i vërtetë, ose rrihen mendime jashtë ngjarjes e karaktereve dhe atëherë doemos do të biem në moralizim dhe do të shuajmë interesin e spektatorit. Shtrimi i problemit dhe i konfliktit real nuk mund të bëhet me fjalë, me moralizime, siç ndodh në disa drama, por duke u mbështetur në fakte tipike, të ndriçuara nga mendimi, nga karaktere të vërtetë që kanë botën e tyre. Kështu edhe ndeshja e të kundërtave do të ketë një tingëllim më konkret dhe ideologjik dhe nuk do të jepet shkas që spektatori apo lexuesi nganjëherë të verë buzën në gaz dhe të thotë me vete: «Ç'kanë, përse hahen këta njerëz? Kjo gjë mund të zgjidhej fare thjesht...»

Meqenëse drama si gjini do të mbetet doemos në konfliktet shoqërore, në dramën e jetës, është e nevojshme të kuptohet më mirë natyra antagoniste dhe jo-antagoniste e konfliktit. Kjo duhet të burojë nga logjika e ngjarjeve. Ka raste kur nuk thellohen konfliktet jo-antagoniste, nuk zbulohen shkaqet e një qëndrimi mikroborgjez apo patriarkal dhe kalohet në një kthesë të papritur të konfliktit drejt antagonizmit. Është e vërtetë se shpesh kontradiktat gërshetohen, armiku përdor dobësitë e njerëzve të veçantë për qëllimet e tij. Ne kemi pasur edhe drama të mira të kësaj natyre. Por është e nevojshme të luftohet kundër zgjidhjeve artificiale dhe skematike e kjo bëhet duke hyrë më mirë në proceset e jetës, duke përvetësuar kërkesat e dramës si gjini, e cila, pa dyshim, evoluon po ruan veçoritë dhe natyrën e saj gjinore. Në Kongresin e 7 të Partisë u tha për krijuesit, midis të tjerash: «Nga ata kërkohet të pasqyrojnë drejt në veprat e tyre proceset dhe prirjet themelore të zhvillimit të revolucionit tonë, kontradiktat e jetës dhe të luftojnë çdo shfaqje të formalizmit e të skematizmit në trajtimin e tyre...». Pra Partia kërkon thellim në proceset e jetës dhe zgjidhje reale e të thelluar të kontradiktave.

Në përfundim të rrahjes së përgjithshme të problemit të konflikteve do të thoshnim se prirja e dramaturgisë sonë për të zbuluar konfliktet antagoniste është e

drejtë e duhet të bëhet më mirë e më thellë, por kjo nuk do të thotë që të mënjanohej dhe të zgjidhen çekët konfliktet joantagoniste. Lufta kundër skematizmit dhe zgjidhjeve artificiale është e lidhur ngushtë me pasurimin dhe forcimin e mëtejshëm të përmbajtjes jetësore dhe ideologjike të veprave.

Tani le të shohim më konkretisht disa probleme që dalin nga krijimtaria dramaturgjike e kësaj periudhe.

Folëm për monotoninë dhe panatyrshmërinë e disa lloj konflikteve. Ky problem ka të bëjë si me përmbajtjen, ashtu edhe me formën po më tepër është problem i përmbajtjes. Në drama të mira, me thellësi realiste si «Përmbytja e madhe» dhe «Lugajanët» të K. Jakovës, që sjellin atmosferën e punës dhe tipa të realitetit të sotëm, nuk na duket i domosdoshëm momenti i hakmarrjes, jo vetëm sepse krijohet një uniformitet, kur një motiv përdoret shumë herë, po edhe sepse ngjarjet mund të zhvilloheshin më mirë në logjikën e tyre të nisur. Kështu pa u zgjatur, do të thoshnim se konflikti kryesor të «Përmbytja e madhe» është forca e së resë dhe lufta në ndërgjegje ndaj një lloj nostalgjie të tepëruar, patriarkale që shohim të plaka Gjelë. Psikologjia e re, që përfaqësohet nga më të rinjtë, mund të ishte trajtuar më mirë e më gjerë në dramë dhe motivi i hakmarrjes, në këtë rast, nuk do të ishte i domosdoshëm, sado që me këtë s'duam të themi se ky problem nuk ka të drejtën e vet të qytetarisë. Po kështu, më e dukshme na del kjo gjë, sa që kalon edhe në njëfarë melodramatizmi, në dramën «Djem të mbarë» e F. Krajës, ku konflikti kryesor është futja e gruas në një punë të vështirë, lufta kundër mosbesimit ndaj saj dhe dashuria e të rinjve. Sa nis kjo dashuri, papritur endet filli i fatkeqësisë: familjet e të rinjve dikur kanë qenë në hasmëri. Koha jonë, natyrisht, e kapërcen këtë konflikt dhe dashuria triumfon. Po a nuk do të ishte më mirë të thellohej problemi i parë, pak i trajtuar dhe të mos thureshin dy drama brenda një vepre?

Është e nevojshme që të kapen konfliktet më tipike dhe të mos përqendrohet vëmendja më tepër se ç'duhet në anë morale e zakonore, përgjithësisht të kapërcyera në shoqërinë tonë. Motivet sociale qytetare thuhet se kanë mbetur jashtë vëmendjes së dramaturgëve tanë, po edhe në gjini të tjera nuk i gjejmë të rrahura. Nevoja që ndihet për trajtimin e temës shoqërore familjare nga jeta e qytetit u duk edhe në interesimin që u tregua për shfaqjen e teatrit të Vlorës «Rruga Budi», sipas romanit të R. Pulahës, me dramatizim të F. Hysit. Shfaqja solli një notë të freskët dhe, përmes një ndjenje optimiste e, vende-vende, mjaft gazmore, u mundua të zgjidhë drejt probleme morale që preokupojnë rininë dhe familjen e sotme. Një trajtim më novator i konflikteve dhe i tërë materialit jetësor, do të shpjerë në forcimin e dramaturgjisë, në përsëritjen e saj dhe do të krijojë më shumë mundësi për të skalitur heronj pozitivë, me një botë të pasur shpirtërore. Këta komponentë të përmbajtjes dhe të formës. njëkohësisht, si tipat dhe konfliktet, janë shumë të lidhur me njëri-tjetrin. Një konflikt artificial, i paqenë, me gjithë mjetet shprehëse që mund të zotërojë autori, nuk shpie dot në krijimin e tipave të besueshëm. Karaktere të goditura pozitive e negative, apo me një luftë të brendshme që vijnë, më në fund, në pozita të drejta kanë dhënë në dramën e tyre K. Jakova, T. Laço, F. Kraja, R. Pulaha, N. Prifti, M. Markaj, Z. Cikuli, H. Minarolli, V. Ziko etj. Personazhe të veshura me një ngjyrë poetike gjejmë edhe në dramën «Rruga drejt lartësive» të N. Dokles, në dramën «Duke mposhtur vdekjen» të E. Mandisë etj.

Rrahja e problematikës dhe konfliktet që ngrihen në një dramë nuk arrijnë në rezultatin e dëshiruar ideo-artistik, në qoftë se nuk shkohet gjer në fund dhe, aq më keq, kur lihet në mes të udhës një problem dhe kalohet në një tjetër. Është e njohur dhe e pranueshme se në një vepër mund të gërshetohen problemet, po njeri do të mbetet kryesor. Ndodh që nuk mbahet dot vëmendja e gjallë gjer në fund në një anë të jetës dhe

atëherë kalohet në anë të tjera. Kështu p.sh. disa drama që kapin problemin e revolucionit tekniko-shkencor, ose qëndresën, iniciativën dhe guximin në punë, pa qenë e domosdoshme kalojnë në probleme të tjera. Kështu ka ndodhur me dramën «Tymra që pastrohen», e cila ka vlerat e saj, ku konflikti familjar dhe i emancipimit të gruas nuk zgjidhet dot në një dramë që ka për qëllim të afirmojë, në radhë të parë, shpirtin novator të një inxhinieri të ri dhe të luftojë prapambetjen, sedrën e sëmurë të një tjetri. Në dramën me temë nga puna, nga revolucioni tekniko-shkencor, del edhe një problem tjetër i rëndësishëm, për të cilin është folur edhe në shtyp. Edhe këtu, si në gjini të tjera, kemi të bëjmë me dy aspekte të këtij problemi: ose nuk njihet mirë procesi teknik dhe flitet në përgjithësi për një vegël, për një detaj dhe inxhinierët nuk dalin si njerëz të mësuar e me përvojë, ose kalohet në një natyralizëm teknikist apo praktikizëm, kur vetëm flitet për një shpikje, po prapa kësaj nuk shohim njerëzit me mendimet, vuajtjet e brendshme për të gjetur të vërtetën, pasionet që u zgjon puna dhe krijimi, pengesat reale që u dalin përpara. Sfera e temave nuk ka pse të jetë e kufizuar; subjekte të harmonishme të jetës hyj-në gjithmonë e më shumë në letërsi. Puna është që, brenda tyre të dalin karakteret, mbrojtja e ideve dhe ndjenjave të çaktuara, të rrihen probleme me rëndësi ideore. Këtu lind edhe problemi i dramës që bart në vetvete heroi pozitiv, i cili i përjeton të gjitha dhe kapërcen jo vetëm vështirësitë që i dalin përpara, po edhe ato që bluan në ndërgjegje.

Për një lloj shmangie nga problemi kryesor mund të flasim edhe për dramën, përgjithësisht të realizuar dhe të saktë historike të N. Priftit, «Plumbat e shkronjave». Në këtë vepër, që u shfaq në Korçë e Fier, e cila ka për konflikt kryesor luftën për hapjen e shkollave shqipe (që autori e zbulon drejt), në variantin e botuar del edhe problemi i edukimit të një hajduti, kaçak, i cili, pa e ditur, përdoret si vegël nga armiqët. Nuk mund të thuhet se këto vija janë fare të pali-

dhura, por, sidoqoftë, drama do të fitonte po të thellohej subjekti në drejtimin e nisur.

Forcimi i realizmit, i së vërtetës jetësore dhe i tipave të besueshëm lidhet edhe me përpjekjet që duhen bërë për t'iu shmangur moralizimeve, sentencave dhe për të zbuluar konfliktet e vërteta. Drama «Rruga e madhe» e V. Zikos, që ka një temë interesante (luftën kundër mentaliteteve mikroborgjeze, meskitetit, kundër ambienteve me thashetheme të qyteteve), është disi moralizuese dhe skematike: të mirat duken sikur janë mbledhur me dorë tek disa njerëz, që i kanë të gjitha meritat; veprimi është i paktë dhe nuk ka argumente për të filozofuar shumë.

Do të ishte me interes, për temën e formimit moral të njeriut, drama «Një copë rrugë» e L. Papës, por me gjithë disa skena dhe ndonjë personazh të goditur, drama na duket artificiale. Ideja e autorit mbi besimin që duhet pasur ndaj mjekimeve popullore dhe forcës morale për t'u shëruar është e drejtë (Bujari, një punëtor, është djegur në punë, vuan nga shtylla kurrizore dhe është paralizuar), po prapëseprapë është nënvleftësuar momenti konkret, aftësia shkencore dhe këmbëngulja për ta shëruar këtë njeri. Kështu që cinizmi i mjekut kryesor nuk është i kuptueshëm dhe lidhja e Elës, shoqes së Bujarit, që bën stazhin në spital si mjeke, vetëm me të na duket si një zgjidhje intime sentimentale. Kështu pra, është mirë të shkruhen drama me subjekte të reja, nga jeta qytetare, apo të një lloji tjetër ku të dalin edhe më qartë probleme të përparimeve shkencore tek ne, po këto duhet të jenë më realiste dhe më të natyrshme.

Një problem tjetër i natyrës ideore, lidhur me raportin e forcave shoqërore që veprojnë, ka dalë, ndonëse më rrallë, edhe në ndonjë dramë si «Thellësitë» e F. Gjatës, botuar në «Nëntori», ku flitet për punën dhe entuziazmin e naftëtarëve që duan të hapin një pus të ri. Në të nuk nxirret si duhet puna dhe shpirti novator i intelektualëve teknikë, të cilët në realitet japin

ndihmën e tyre krahas punëtorëve. Po drama ka merita dhe mendojmë se do të ishte e ndreqshme.

Në dramën tona ndodh që heronjtë nuk janë jetësorë, veprimet dhe gjuha e tyre nuk janë bindëse, por në lidhje të ngushtë me këtë shikim të sipërfaqshëm, ndodh gjithashtu, që edhe vetitë pozitive të personazheve, virtytet e tyre nuk shkojnë më tej moralizimeve të thata, nuk merren gjithmonë brenda realitetit, karaktereve, brenda veprimit dhe mendimit. Shoku Enver na mëson që virtytet të mos kuptohen në mënyrë idealiste dhe metafizike, po të trashëguara nga e kaluara e mirë e popullit dhe të lindura e të formuara në shoqërinë tonë socialiste. Letërsia realiste dhe, aq më shumë ajo e realizmit socialist nuk mund të kthehet prapa te kuptimi abstrakt i virtyteve, siç ishte në drejtime tashmë të kapërcyera artistike.

Ndër gjinitë, për të cilat ndihet një nevojë më e madhe, dhe ku duhet të gjejnë një mishërim më të plotë këto ide është komedia, si edhe pjesët satirike-humoristike për estradën. Ne kemi komedi të bukura, siç është «Zonja nga qyteti». Edhe ndër të tjera, që u përmendën, gjenden elemente komike, situata të goditura. Por në teatrot tona vihen në skenë pak komedi, sepse krijimtaria në këto gjini është e paktë. Kjo gjini mund të nxitet e të përkrahet më shumë se deri tani, sepse kushtet objektive e kërkojnë. E vjetra, ndahet nga shoqëria duke shkaktuar të qeshura, thoshte Marksi. Kjo është një e vërtetë shumë e dukshme për shoqërinë tonë në zhvillim, që nuk pajtohet me të keqen, që zbulon kontradiktat, i zgjidh ato dhe shkon përpara. Shkaqet e mungesave që ndihen në komedi dhe në pjesët satirike lidhen me kuptimin e cekët të mundësive që ka kjo gjini, me përpjekjet ende të pakta për të gjetur një raport të drejtë midis situatave komike që zbulohen dhe vendosjes së heroit apo të personazhit pozitiv në veprë. E vërteta është se përmirësimi ka në këtë fushë; kjo ndihet edhe në estradat tona, të cilat, me gjithë të metat, kanë bërë ndryshime. Tani ka më shumë përpjekje që heroi pozitiv të shkrihet në të tërën dhe të

mos mbajë fjalime. Po përsëri mbetet shumë për të bërë (e kjo jo vetëm në gjinitë satirike) që ky hero të dalë më i lidhur me jetën e ambientin dhe më i përfshirë në stilin dhe komizmin e veprës. Shkaku tjetër i mungesave duhet kërkuar edhe në një lloj konformizmi që, në fakt, pengon inkurajimin e kësaj gjinie dhe të zbulimit të drejtë të kontradiktës në të. Pasurimi i repertorëve me komedi, si edhe me dramën, përgjithësisht, do të arrihet me përpjekje të përbashkëta të krijuesve, në radhë të parë, po edhe të teatrove e estradave që e drejtojnë këtë punë.

Të gjitha dukuritë që u vunë re, në një plan më të përgjithshëm, burojnë nga njohja e pamjaftueshme e jetës, e proceseve aktuale si edhe nga formimi i pamjaftueshëm ideologjik e profesional. Këto dobësi apo probleme të rritjes, probleme që dalin në rrugën e zhvillimit të mëtejshëm të dramaturgjisë sonë, lidhen me mungesat ideore, me shfaqje të skematizmit, po edhe me mungesë përvoja dhe kulturore. Është e nevojshme të bëhet një punë edhe më e madhe nga autorët si edhe të ngrihen kërkesat nga teatrot, botuesit apo televizioni. Me gjithë synimet pozitive për të cilat folëm, drama si «Duell mbi Kastër», «Njerëz të afërm», «Duar të fuqishme», «Vëllezërit» etj., si edhe disa dramatizime vuajnë nga skematizmi, ato sa e cekin argumentin ose ecin në rrugë krejt të rrahura.

Paqartësi ideologjike hasen ndonjëherë edhe në drama që shfaqen apo botohen. Shfaqjet e veçanta negative lidhen me konceptimin e gabuar të luftës kundër burokratizmit, me paraqitjen si tipike aktuale të fenomeneve jotipike, me dobësi në paraqitjen e forcave pozitive. Nuk po flasim për mangësitë e shumta artistike të këtyre veprave. Me gjithë sukseset e arritura në forcimin e përmbajtjes, vigjilenca duhet mbajtur gjithmonë e mprehtë dhe të mos lihen të kalojnë vepra të gabuara ideologjike dhe as të zbehta e pa vlerë artistike, sepse një krijim skematik dhe artificial e ul idenë.

Forcimi i mëtejshëm i përmbajtjes, raporti më i

drejtë i temave, theksimi i problematikës aktuale dhe të Luftës Nacionalçlirimtare, pa lënë mënjanë edhe temat historike për të cilat gjithashtu ndihet shumë nevoja, — këto do t'i gjallërojnë dhe do t'i bëjnë më militante dramaturgjinë dhe teatrin. Puna heroike e punëtorëve, e fshatarëve, e inteligjencies popullore, lufta kundër bllokadës, kundër rrethimit imperialisto-revizionist, për formimin shpirtëror të njeriut të ri, kërkojnë vepra të denja dhe me një nivel më të lartë ideoartistik. Këto anë kryesore të jetës lidhen me marrëdhëniet morale familjare, marrëdhëniet midis të rinjve. Kapja e jetës në thellësinë dhe pasurinë e vet do të luftojë dhe skematizmin, uniformitetin dhe do t'i japë një impuls të ri dramaturgjisë dhe teatrit.

Këto aspekte të dramës, të elementeve të përmbajtjes së saj, do të delnin më të qarta po t'i merrnim të lidhura me mjeshtërinë e ndërtimit, me punën për një formë më të lartë, që t'i përshtatet më mirë përmbajtjes së re.

Disa probleme të mjeshtërisë

Duke folur për probleme të përmbajtjes, të pasqyrimt të konfliktit dhe tipave, vetvetiu dolën edhe anë të ndryshme të mjeshtërisë, sepse në një vepër të gjitha komponentët lidhen me njëra-tjetrën.

Është e njohur aftësia e disa dramaturgëve tanë me përvojë si K. Jakova e F. Kraja. Veprat e tyre mund të jenë herë me më shumë e herë me më pak sukses, por kurdoherë ndihet në to arti dramatik. Ndër shkrimtarët që merren më tepër me gjini të tjera, ka nga ata që kanë dhënë prova se e njohin mirë dramën si D. Agolli, F. Gjata, Dh. Xhuvani, N. Prifti. Të tjerë shkrimtarë e kanë të theksuar elementin dramatik apo dialogun në veprat e tyre të prozës si p.sh. I. Kadare, Sh. Musaraj, J. Xoxa etj. dhe do të ishte me interes

kontributi i tyre në dramaturgji. Gjatë kësaj kohe janë dalluar dy autorë, që vijnë nga gjini e prozës, R. Pulaha dhe T. Laço, të cilët kanë hyrë tani në radhët e dramaturgëve. Këta, si edhe të tjerë, sjellin diçka të vetën, origjinale.

Evoluimi i dramës, brenda kërkesave gjinore, është një domosdoshmëri objektive, që rrjedh nga zhvillimi i jetës sonë, nga konceptimi novator yni ndaj përmbajtjes dhe formës. Prandaj është folur në shtyp e në diskutimet tona që të mos kërkojmë vetëm një tip të ndërtimit të dramës, p.sh. dramën klasike të një njeriu me dilemën e tij shpirtërore. Edhe kjo ka vendin e vet, po në artin e realizmit socialist nuk përsëritet në mënyrë mekanike e shkuara: drama e njeriut shihet e lidhur me shoqërinë, me kolektivin që e ndihmon dhe e shpie në rrugë të drejtë, kur personazhi priret nga e mira. Historia, zhvillimi i ngjarjeve kanë nxjerrë në skenë kolizione të mëdha klasore, ndeshje frontale, të cilat mund të trajtohen duke e pasuruar subjektin me tablo epike, me skena masive. Është e kuptueshme se ky novacion nuk ka pse të shpjerë në tablo amorfë. Figura njerëzore ka qenë dhe mbetet në qendër të dramës realiste. Simbolet janë të nevojshme kur dalin nga jeta dhe lidhen me materialin konkret. Zgjidhjet konvencionale dhe simboliste, që zunë të duken para Plenumit të 4-t të 1973, ne i luftuam si të huaja. Por, në anën tjetër, mendimi ynë duhet të jetë dialektik dhe të pranojë e të përkrahë çdo gjë të re edhe në mjetet shprehëse, gjithçka që është e nevojshme për të dhënë dinamikën dhe pasurinë e jetës së sotme. Po të vemë re dramën tona, po edhe spektaklet, me përjashtime të pakta, janë uniforme, ka pak fantazi në ndërtimin dramaturgjik e kjo reflektohet edhe në skenë. Nuk ka pasur forma të atilla të larmishme ku të dalë mendimi, poezia që të emocionojë spektatorin edhe më drejtpërdrejt dhe të ndihmojë në interpretimin e ngjarjeve. Të gjitha mënyrat, kur janë të gjetura e të përshtatshme, zenë vendin e tyre dhe duhen çmuar. P.sh. si dramën e K. Jakovës me kompozicion të përqendruar, me një ndër-

tim thua jse klasik, ashtu edhe ato të T. Laços me një shtrirje drejt skenave masive, me gërshetimin e konfliktit si në shoqëri ashtu edhe në familje etj., janë të nevojshme dhe plotësojnë njëra-tjetrën. Por prirja drejt novatorizmit do të bëhet edhe më e dukshme në dramaturgjinë tonë sa më tepër të kapen anë të reja të realitetit, njerëz të rinj dhe sa më mirë të përvetësohet metoda e realizmit socialist.

Jeta të shpie drejt kërkimeve dhe përtërin artin, por edhe kultura duhet njohur. Mungesat në mjeshtërinë e dramës, në përgatitjen profesionale, siç është pohuar me të drejtë, janë një nga shkaqet e rëndësishme të prapambetjes së saj relative. Pas problemit të njohjes së jetës dhe të formimit më të plotë ideologjik vjen, pa dyshim, ai i përvetësimit më të mirë të mjeshtërisë.

Është e nevojshme të sqarohet dhe të kuptohet mirë problemi i zhvillimit të gjinisë në vështrimin dialektik: as ngurrim dhe konceptim metafizik i disa rregullave të dhëna, as anarshizëm dhe subjektivizëm në të kuptuarit e zhvillimit të formave. Drama, si gjini, ka lindur për të plotësuar një nevojë shpirtërore në shoqëri, për të dhënë konfliktet, dramën e jetës, natyrisht, në kohë të ndryshme, me ideale dhe patos të ndryshëm. Por gjetja e momentit dramatik nuk mund të mënjanohet dhe të japim në skenë konflikte fiktive, mikrodrama, ku më tepër merr rëndësi procesi i jashtëm, se sa njeriu, se sa lufta e tij për të zgjidhur konfliktet dhe për të çarë përpara. Mësimet e Partisë, që mbështeten në marksizëm-leninizmin, mbi luftën e klasave si forcë lëvizëse e shoqërisë, na tregojnë se jeta duhet marrë në luftë dhe në zhvillimin e saj; pra, mundësitë objektive për një përparim të mëtejshëm të dramës janë të plota. Puna është që të zbulohen fenomenet e jetës më thellë. Drama e kohës sonë, e realizmit socialist, nuk bie në fatalizëm dhe nuk gërmon në subkoshiençë për të gjetur anët e sëmura të njeriut, siç bëjnë dramaturgët dekadentë revizionistë. Ajo karakterizohet nga heroizmi, nga besimi në të ardh-

men; nga optimizmi që buron prej forcës shpirtërore të masave popullore, të udhëhequra nga Partia.

Pasqyrimi i realitetit në mënyrë revolucionare nënkupton edhe njohjen e përvojës më të mirë kombëtare dhe botërore. Dhe, të gjithë e dimë, se që nga tragjedianët klasikë grekë, Eskili, Sofokliu, Euripidi, te Shekspiri, Ibseni, Shou, Gorki, Brehti etj., veprat dramatike kanë në qendër një moment të përcaktuar dramatik, një konflikt të rëndësishëm jetësor dhe filozofik. Dialogu kurdoherë është i bukur e plot ngjyra dhe karakteret kanë jetën e tyre. Tipare të tilla ne shohim edhe në dramën e autorëve tanë më të mirë që u përmendën, si edhe në komeditë me kolorit të theksuar popullor, të Çajupit. Drama, duke qenë poezi e karaktereve, sipas shprehjes së Gorkit, nuk mund të jetë një gjini aq e lehtë; ajo kërkon përqendrim, atmosferë, fabulën e saj dhe momentet tronditëse ku shpërthen konflikti dhe drama hyn në rrugën e zgjidhjes.

Meqenëse objekti kryesor i pasqyrimin tek ne është veprimi, epika e jetës, është e natyrshme që çastet dramatike do të kenë epizmin e tyre, i cili buron nga madhështia e kohës sonë. Por prania e ngjarjes dhe e veprimit të qartë nuk duan të thonë se drama, sipas temës dhe problemit nuk ka nevojë edhe për lirizëm, për detaje poetike, për një atmosferë që të riprodhojë tërësinë shpirtërore dhe marrëdhëniet e ngrohta psikologjike midis njerëzve tanë. Këtë element duhet ta ketë drama e ta japë edhe teatri. Por, për fat të keq, midis të mirave hasen edhe drama e spektakle të tharta, që nuk kanë atmosferë, lirizëm, ku nuk ndihet kultura e fjalës, e mendimit apo edhe e lojës e vënies në skenë dhe kështu ndodh që shfaqjet nuk e krijojnë dot atë ndjenjë vërtetësie dhe bukuri që teatri duhet të shpërndajë që nga skena te spektatorët dhe që lidhen me gërshetimin e fjalës e të mendimit, me lojën e aktorit, me pikturën dhe me muzikën.

Si në të gjitha sferat e veprimtarisë, ashtu edhe në fushën e letërsisë dhe të arteve, Partia ka shtruar problemin e ngritjes së cilësisë dhe të kulturës. Niveli

i sotëm i jetës sonë kërkon përgatitje shkencore dhe kulturë. Për këtë foli në mënyrë të veçantë shoku Enver në vizitat e tij në Gjirokastrë dhe Sarandë. Rëndësia që u dha ai këtyre problemeve, vlerësimi i madh i shkencës, artit e kulturës, folklorit, respekti ndaj diturisë, ndaj dijetarëve tanë të kaluar dhe punonjësve shkencorë e njerëzve të tanishëm të penës — këto na bëjnë të mendojmë për të ngritur edhe më lart cilësinë dhe për të njohur më thellë traditën, kulturën tonë të lashtë dhe të re.

Një problem tjetër i përmirësimit të formës artistike është edhe përdorimi i gjuhës, i frazës dhe i shprehjeve, i humorit popullor. Për këtë porositi shoku Enver, kur thotë: *«Jeta e popullit, fjala e mprehtë e tij, psikologjia dhe humori popullor të zenë më shumë vend në veprat letrare e artistike, sidomos në gjinitë e skenës»*. Dramaturgjia jonë ka ecur përpara, nga kjo anë; në disa drama të mira dialogu ka ngjyra të dukshme popullore. Ne kemi dramaturgë që përdorin një gjuhë shumë të mirë dhe të përshtatshme për skenën, si K. Jakova, R. Pulaha, M. Markaj etj. Por kjo është një fushë e gjerë dhe do punuar me kujdes e vazhdimisht. Krahas anëve të mira, ndeshet shpesh edhe dialog i rëndomtë. P.sh. drama *«Me gjuhën e pushkës»* e H. Minarollit ka një konflikt të fortë, por gjuha e personazheve është agjitative dhe nga kjo drama humbet mjaft. Ndryshe është gjuha në dramën tjetër të këtij autori *«Shënomëni dhe mua»*, ku personazhet flasin në mënyrë të individualizuar. Karakteri libresk i shumë dialogëve bie në sy, krahas deklarativizmit që vjen nga mungesa e veprimit, apo nga paaftësia e krijimit të personazheve të vërtetë. Njohja e pamjaftueshme e tipave, pasqyrimi i njëanshëm i raportit midis tipikes dhe individuale bëjnë që, në disa drama, heronjtë pozitivë t'i ngjajnë njëri-tjetrit, të flasin njëllëj. Po kështu ndodh edhe me disa personazhe negative, të cilët kanë frazeologji të njëllëjtë dhe zbulohen në të njëjtën mënyrë. Kështu ndeshemi me figura priftërinjsh, diversantësh, sabotatorësh që kanë një ngjashmëri të ma-

dhe me njëri-tjetrin si në dramë, ashtu edhe në spektakël. Edhe thelbi tipik ka nuancat e veta që përcaktohen nga rrethanat dhe koha, le pastaj që individualitetet nuk mund të jenë të njëjlojta.

Repertori i teatrove është pasuruar edhe me dramatizime të veprave të njohura të prozës sonë. Këto kanë plotësuar një boshllëk. Dramatizime si të romaneve «Lumi i vdekur», «Para agimit», «Komisari Memo», «Njeriu me top», «Zbulimi», «Shembja e idhujve», «Rruga Budi» etj. janë vënë në skenë. Por edhe dramatizimi, siç dihet, kërkon një mjeshtëri të veçantë, që të zgjedhësh momentet kryesore të veprës dhe çastet më dramatike të saj t'i lidhësh me një bosht. Qoftë për shkak të dramatizimit të dobët, qoftë të vënies në skenë, këto nuk kanë pasur gjithmonë sukses. Më mirë janë pritur «Stuhi në mal» (sipas romanit «Zbulimi»), vënë në teatrin e Gjirokastrës dhe «Rruga Budi» në teatrin e Vlorës.

Këto ishin shkurt disa nga problemet e mjeshtërisë, natyrisht, ka edhe mjaft të tjera. Përgatitja më e mirë profesionale, fitimi i përvojës dhe i kulturës së të shkruarit do të ndihmojnë për kristalizimin gjinor të dramës sonë, do të bëjnë më të dukshme prirjet e evoluimit të saj edhe në formë, e cila do të pasurohet krahas përmbajtjes dhe mendimit.

1978

HISTORIA DHE E SOTMJA NË ROMANIN SHQIPTAR

Historia e kombit tonë dhe e sotmja e tij kanë qenë kurdoherë në qendër të vëmendjes së njerëzve të penës që kanë shprehur dhe mbrojtur interesat e këtij kombi, interesat e popullit shqiptar. Që nga lashtësitë e kulturës sonë e gjer sot, gjithmonë me një zë më të qartë dhe më të fuqishëm, këta njerëz kanë dalë në mbrojtje të interesave kombëtare, kanë studiuar apo pasqyruar historinë, zakonet, psikologjinë, luftërat për liri, vetitë morale të popullit dhe kanë treguar me emocion, me dhembshuri e me kurajë se pa liri, pa të drejta kombëtare, pa kulturë e përparim, nuk mund të ketë zhvillim dhe mbarësi të vërtetë.

Përfaqësues të shquar të kulturës shqiptare nuk e kanë parë asnjëherë problemin kombëtar të shkëputur nga problemet e shoqërisë në përgjithësi, të ideve demokratike dhe lirisdashëse, sot të problemeve të revolucionit dhe të socializmit. Me një kuptim të qartë kombëtar dhe universal i formuluan apo i shprehën pikëpamjet e tyre patriotike, të përpunuara, Pashko Vasa, Samiu, Naimi, i cili kërkonte liri për popullin e vet, mbronte shqipen «e ëmbël dhe të bukur», urrente tradhtarët dhe donte të rronte në fqinjësi të mirë me popujt e tjerë. Ai e donte njerëzimin me një dashuri prej iluministi, po gjithmonë me ndjenja të zjarra, të pa-

sionuara, si një vazhdim i natyrshëm i mallit dhe dashurisë për vendlindjen, për Shqipërinë e tij.

Duke u mbështetur në këto tradita, romani ynë ka bërë një hap cilësisht të ri dhe është tani një ndër gjinitë më të zhvilluara.

Romani, si një gjini komplekse, që ka mundësi ta përfshijë jetën e shoqërisë dhe të kombit në disa plane dhe me karaktere të shumta, ka dhënë edhe ndër ne rezultate të ndjeshme në aspekte të ndryshme e sidomos në pasqyrimin e historisë dhe të sotmes së kombit.

Romani shqiptar që krijohet në RPSSH, si edhe në Kosovë e Maqedoni, me gjithë ndryshimin hera-herës në pikëpamjet ideestetike ka një truall të përbashkët — kombin, historinë, fizionominë e tij, psikologjinë dhe temperamentin, luftën për të ruajtur trojet e veta, lirinë, nderin dhe dinjitetin kombëtar. Këto momente kanë të bëjnë me tipare të rëndësishme të brendisë dhe të formës dhe me qëndrimin ideomocional të autorëve ndaj asaj që përshkruajnë.

Duke e shtruar problemin e karakterit kombëtar si përmbajtje dhe formë, ne nuk mund ta kuptojmë këtë të mbyllur në guaskën e nacionalizmit, po në një vështrim marksist-leninist, të lidhur ngushtë me pikëpamjet ideologjike, me qëndrimin filozofik botëkuptimor. Nga kjo pikëpamje, letërsia dhe romani kanë pikat konverguese jo vetëm brenda letërsive dhe romaneve të shkrimtarëve me kombësi të njëjtë, po në plan më të gjerë, botëror. Kështu, prirja përparimtare dhe demokratike i afron veprat e kombeve të ndryshme. Mbrojtja e njeriut të thjeshtë, pasqyrimi me vërtetësi i luftës së klasave, patosi i lirisë dhe i barazisë shoqërore e shumë momente të tjera të rëndësishme — krijojnë boshtin e shumë veprave me frymëmarrje të përafërme, që i shërbejnë kulturës përparimtare të njerëzimit.

Kurdoherë, po sidomos në dekadat e fundit, është rrahur në mënyrë të mprehtë problemi i karakterit ko-

mbëtar të letërsisë e artit në teori dhe në praktikë. Lufta e mendimit në këtë fushë është shtuar, si pasojë e synimeve të fuqive të mëdha për t'u imponuar vendeve më të vogla kulturat e tyre dhe kështu është kthyer në një problem të mpreshtë politik. E ashtuquajtura teori e ndërkombëtarizimit të kulturave, e gjoja e vjetërsimit të fytyrës kombëtare të artit dhe e modernizimit të tij universal, nuk është tjetër veçse një teori e rrëme, që mundohet të fshehë të vërtetën dhe të shuajë kulturat e popujve dhe kombësive më të vogla.

Në kuptimin për të cilin folëm, duke e parë karakterin kombëtar në lidhje me pikëpamjet socialiste ose, në kushte të tjera, demokratike përparimtare, është në dobi të kulturës shqiptare ta shtrojmë, ta mbrojmë dhe ta interpretojmë në thellësi këtë problem që ka të bëjë drejtpërdrejt me zhvillimin e romanit dhe të gjithë artit e kulturës.

Duke e marrë problemin në brendi dhe në formë, kjo do të ftohtë të shohim te karakteri dhe fytyra kombëtare shpirtin e kombit, historinë e tij, mënyrën e të konceptuarit filozofik të jetës e të vdekjes, psikologjinë e formuar në kushtet e veçanta të zhvillimit historik si edhe gjuhën — këtë moment kaq të rëndësishëm në hartimin e një vepre, zakonet, çdo hollësi që hyn në konstitucionin shpirtëror të popullit.

E gjithë kjo, që estetëve formalistë dhe kozmopolitë do t'u dukej anakronike, i jep konkretësinë veprës dhe nuk e ndan atë nga kultura e vërtetë botërore, po, përkundrazi, e bashkon edhe më tepër me të.

Janë të njohura në letërsinë dhe artin e popujve të ndryshëm, sidomos në periudha të caktuara historike, rastet kur momenti kombëtar, kurdoherë i rëndësishëm, merr një kuptim edhe më të madh dhe shndërrohet në një përmbajtje themelore, duke mishëruar në karaktere idealet pozitive dhe duke dhënë ngjyrimë të papërsëritshme që përbëjnë anën konkrete, komunikuese dhe emocionale të veprës artistike. Por ky element kombëtar është kurdoherë i pranishëm dhe pa të nuk mund

të ketë të vërtetë, nuk mund të ketë figura konkrete dhe idetë do të mbeteshin abstrakte dhe pa një destinacion të qartë.

Historia e popullit tonë, me periudhat e saj të ndryshme, ka tërhequr romancierë, të cilët kanë dhënë vepra si «Kështjella» e I. Kadaresë, «Skënderbeu» e S. Godos, trilogjinë për Rilindjen e S. Spasses, «Vraje tradhtinë» e S. Drinit, «Mic Sokoli» e S. Krasniqit etj. Temën historike, me një ngarkesë të problemeve shoqërore dhe aktuale e trajtojnë shkrimtarët shqiptarë në Kosovë e Maqedoni, si në veprat «Tokë e përgjakur» e N. Rahmanit, «Plagët» e M. Isakut, «Sheshi i unazës» e Z. Rahmanit etj. Në vepra të tilla ngrihet problemi i historisë, i luftës për të ruajtur tokën amtare, i dashurisë e mallit për vendin. Ky motiv themelor, në disa vepra, merret në lidhje të ngushtë me motivet shoqërore, me luftën kundër bejlerëve dhe pushtuesve që ushtronin ndaj popullit një shtypje të dyfishtë — kombëtare dhe shoqërore. Kjo është një temë e problematikë që ka pasur e do të ketë të ardhme, krahas asaj aktuale që zë gjithmonë e më shumë vendin kryesor. Trajtimi i saj nuk bëhet me ftohtësi, po me ndjenjë e temperament, duke u nisur nga një domosdoshmëri dhe kërkesë aktuale për të lartësuar traditat, për të mbrojtur identitetin kombëtar dhe për t'u treguar brezave të sotëm e të ardhshëm se kanë për se të krenohen me të parët e tyre, me historinë e shkëlqyer të kombit dhe qëndresën e tij të paepur. Momenti social në këto lloj veprash, ndonëse nuk del zakonisht në plan të parë, gërshetohet në ngjarje dhe u jep domethënie më të madhe karaktereve.

Trajtimi i mëtejshëm i kësaj teme kërkon sinteza më të mëdha, aspekte të reja të njohura të historisë sonë, gjithmonë patos patriotik dhe larmi formash artistike, sikundër janë vënë re në praktikë. Po kurdoherë konkretësia e motiveve dhe pasqyrimi i njeriut, i karaktereve — përmes stileve individuale — mbeten të rëndësishëm dhe thelbësorë për të dhënë me vërtetësi kohën, kolizionet e mëdha historike dhe botën e brendshme të njeriut të popullit, krahas njerëzve të shqu-

ar luftëtarë e mendimtarë, që nxjerr ai nga gjiri i tij.

Në trajtimin e temës historike kanë vendin e tyre, natyrisht, edhe mënyrat dhe stilet e ndryshme, kur brendia është e qartë dhe popullore. Pavarësisht nga forma e ndërtimit, ato i shërbejnë trajtimit të problemit kombëtar, të luftës për pavarësi shpirtërore dhe kulturore, luftës së ashpër kundër shkombëtarizimit dhe qëndresës epike të popullit, të njerëzve të lidhur me njëri-tjetrin.

Realitetit të paraluftës, gjendjes shoqërore të masave fshatare i kanë kushtuar vëmendje disa romancierë në veprat e tyre si J. Xoxe të «Lumi i vdekur», S. Spasse të «Ata nuk ishin vetëm», N. Rrahmani të «Tokë e përgjakur». Këto dhe vepra të tjera të kësaj natyre lozin rol në paraqitjen e karaktereve kombëtare, të dramës së fshatarësisë shqiptare. Kanë kaluar vite që kur u shkrua, p.sh. «Lumi i vdekur» po kjo vepër dhe vlera e saj është kristalizuar në gjykimin e lexuesve dhe të kritikës. Përmes pamjeve dhe problemeve të mëdha shoqërore, psikologjike që trajton ky roman spikatën karakteret me tipare të qarta kombëtare, me zakonet, temperamentin, me romantikën e dashurisë rinore dhe dramën e fshatarësisë së asaj kohe. Duke treguar dashurinë e pastër midis Vitës dhe Adilit dhe miqësinë midis familjeve, lidhjen e tyre të sinqertë, autori ngre një problem më të rëndësishëm se ndjenja e dashurisë intime, ai flet për dashurinë dhe unitetin e vëllezërve e motrave të një gjaku, që kanë një histori, një gjuhë, një traditë.

Jetën e fshatarëve, sidomos para lufte ose me mbarimin e saj, përshkruan Nazmi Rrahmani në romanet e tij. Ndërsa në dy të parët, «Malësorja» dhe «Tymi i votrës së fikun», ngre probleme të fatit të gruas në shoqëri, të zakoneve kanunore që shkaktojnë viktimë apo tregon ngjarje të tilla që flasin për protestën e të rinjve fshatarë kundër zakoneve patriarkale, në dy të mëvonshmit — «Tokë e përgjakur» dhe «Rruga e shtëpisë sime», — problemet bëhen më komplekse dhe marrin një kuptim më të gjërë. Toka, puna e

fshatarit, dashuria për vendlindjen, kthimi tek ajo me një patos të thellë, tragjedia fshatare dhe qëndresa janë motive themelore në këto vepra.

Me qëndrimin në luftën kundër fashizmit janë marrë në romanet e tyre autorë të njohur si Sh. Musaraj me «Para agimit». Dh. S. Shuteriqi me «Qlirimtarët», D. Agolli me «Komisarin Memo». A. Abdihoxha me «Një vjeshtë me stuhi», F. Gjata me «Këshilltarët», L. Qafëzezi me «Yje dhe helmeta», H. Petrela me «Kronikë e viteve të paharruar», M. Kallamata me «Shtigjeve të zëna» etj.

Me këtë temë është edhe romani «Njerëzit» i H. Sulejmanit. Si në këtë roman, ashtu edhe në «Fëmijët e lumit tim» dhe në tregime autori niset kurdoherë nga kritere të një morali të drejtë; heronjtë e tij arsyetojnë për problemin e luftës kundër fashizmit, për të drejtat kombëtare në luftë kundër fashizmit. Ndjenjën e formimit të njeriut në luftë, e pastërtisë morale të tij, emancipimit të shoqërisë përmes luftës e trajtojnë edhe autorët e tjerë që u përmendën.

Rruga e emancipimit të gruas në historinë shqiptare ka veçoritë e veta. Kjo temë është trajtuar në romane si këtu, ashtu edhe në Kosovë. Janë trajtuar disa tema në një plan historik dhe politik-shoqëror si te «Njeriu me top» i D. Agollit e, po të hidhemi në një gjini tjetër, në drama si «Përmbytja e madhe» e K. Jakovës etj. Letërsia ngre ato probleme që shqetësojnë shoqërinë; kur këto janë kapërcyer, përsëri mund t'u kthehesh pa e tepruar, nga kënde të tjera shikimi dhe duke zbuluar anë të reja. Edhe gjetjet origjinale, struktura ku vendosen ngjarjet shtojnë drejt një kuptimi dhe domethënieje të re. Problemi i kapërcimit të hasmërisë, i lirisë së vajzës apo djalit për të zgjedhur bashkëshortin e vet ka tërhequr vëmendjen e disa romancierëve e krijuesve të tjerë shqiptarë të Kosovës si R. Kelmendi me «Heshtjen e armëve», N. Rrahmani me «Tymin e votrës së fikun» etj.

Në romanin «Heshtja e armëve» (në kuptimin e gjaqeve) R. Kelmendi, me një stil të rrjedhshëm dhe

me dialog plot kolorit lokal, flet për dashurinë e dy të rinjve, Sokolit dhe Zojës, dhe kapërcimin e vështirësive nga ana e tyre për të gjetur rrugën e bashkimit. Të afërmit, njerëzit përreth nuk e flakën këtë dashuri ndonëse dikush mbetet me ndjenjën e hakmarrjes në zemër. Shkrimtari lufton për emancipimin, përshtetur an me poezi ndjenjën e të rinjve dhe tregon kështu se kjo duhet të jetë rruga në jetë.

Koha kalon dhe jeta shtron për zgjidhje të tjera probleme, më të komplikuar, që kërkojnë një gërshe-tim më të madh të tipave, të marrëdhënieve të tyre dhe të mendimit mbi shoqërinë. Këto janë probleme që nuk mund të merren kurrë të ndara nga fizionomia e kombit, nga tiparet kombëtare, nga rruga e veçantë si arrihet drejt një qëllimi të caktuar.

Duke folur për tiparet kombëtare të romanit të sotëm shqiptar, nuk mund të mos prekim një nga momentet themelore të nocionit të kombëtares, karakterin evolutiv, dinamik të psikologjisë dhe problemeve që i dalin përpara një kombi. Konceptimi i drejtë i nocionit të kombëtares përfshin doemos të kaluarën dhe të sotmen, zhvillimin dhe perspektivën. Njeriu i socializmit, në romanet e krijuara në RPSSH, del me tiparet e njeriut aktiv të sotëm, njeri që ka mënjeluar paragjykimet dhe lufton kundër ndikimeve të huaja dhe mbeturinave të botës së vjetër.

Në kushtet tona, romani, ashtu si edhe gjinitë e tjera letrare-artistike, është mbështetur dhe mbështetet në metodën e realizmit socialist. Të udhëhequr nga mësimet e Partisë, shkrimtarët tanë kanë përvetësuar një botëkuptim të shëndoshë revolucionar dhe pasqyrojnë jetën në shumanshmërinë e saj. Zbatimi i parimeve krijuese të realizmit socialist e ka çuar romanin tonë drejt thellimit në proceset e jetës, në zbulimin dhe zgjidhjen e kontradiktave, drejt pasqyrit të njeriut, i cili vihet kurdoherë në qendër të vëmendjes.

Problemet e mëdha politike dhe shoqërore e morale të aktualitetit, përmes periudhave të ndryshme të historisë sonë të re, dalin qartë dhe me konflikte të

mprehta në vepra si «Dimri i madh» e I. Kadaresë, «Përsëri në këmbë» e Dh. Xhuvanit, «Përballimi» e T. Laços, «Zbulimi» e A. Kondos, «Një lindje e vështirë» e E. Kadaresë, «Buka e një stine me borë» e K. Kostës, «Mërgata e qyqeve» e N. Jorgaqit, «Vëllezërit» e A. Cergës, «Mars» e V. Koreshit, «Rruga Budi» e R. Pulahës etj.

Me veçoritë e tyre, romancierët shqiptarë në Kosovë paraqesin momente dhe pamje të jetës së sotme, të emancipimit të gruas, të përpjekjeve për të përhapur gjuhën kombëtare e kulturën dhe për të luftuar çdo gjë që pengon progresin shoqëror. Në disa prej veprave që u përmendën si dhe të R. Kelmendit, A. Shkrelit kapen aspekte të realitetit të sotëm në planin shoqëror e moral dhe tregohet evoluimi i karaktereve, psikologjia e tyre e sotme.

Karakterit evolutiv i romanit duket, në radhë të parë, në brendi, po ai ndihet edhe në strukturë e në elemente të tjera të formës.

Në bazë të mjaft romaneve shqiptare ose në mënyrën e ndërtimit të tyre ka elemente të rrëfimit popullor, të konceptimit poetik në fillimin e kapitujve apo në parantezat lirike, gjë që të kujton nganjëherë rapsoditë apo baladat tona folklorike. Natyrisht, këto çaste si edhe të tjera, futen organikisht në vepër dhe shpesh duhet syri depërtues i studiuesit për t'i përcaktuar saktë. Në prozën tonë narracioni popullor, dialogu plot kolorit zë një vend të madh dhe kjo ka të bëjë me karakterin popullor, komunikues të veprave, me shpirtin demokratik të tyre.

Një tipar i zhvillimit të romanit, si pasojë e rritjes shpirtërore të kombit dhe e pasurimit të kulturës, është edhe thellimi i konceptimit filozofik, i një lidhjeje më të ngushtë, në veprat më të mira, të mendimit me veprimin, të përshkrimit me reflektimet e autorit mbi ngjarjet që tregojnë. Kjo prirje pozitive që ndihet, ku më shumë e ku më pak, sipas stileve dhe mënyrave të secilit autor, do të ketë të ardhme dhe do të luftojë edhe më tepër deskriptivizmin që ndeshet herë

pas here në vepra të veçanta, kur nuk arrihet në përgjithësimet e çuhura dhe figurat artistike mbeten të zbehta.

Një veçori tjetër e romanit shqiptar, që vjen duke u zhvilluar, është edhe poezia që e përshkon, një lloj poetizimi që shpreh një moment përtëritjeje kombëtare, patosi të brendshëm e, njëkohësisht, e afron më shumë me mendimin emocional dhe ndikon në strukturën e veprës. Kjo afron, në disa raste, narracionin e gjallë me ndërtimin e poemave në frymëmarrjen e përgjithshme të veprës. Kërkimet në fushën e formës janë të lidhura me përmbajtjen dhe nuk mund të bëhen qëllim me vete, sepse kështu e humbasin funksionin e tyre dhe shpien në formalizëm. P.sh. kur rrëfimi bëhet nga disa figura, në vetë të ndryshme, kjo përliqjet në rast se me monologun e brendshëm zbulohet më mirë karakteri, ruhet lirizmi dhe singeriteti i tregimit, kur njeriu flet për veten e tij. Po, në praktikën e romanit tonë, mënyra klasike e të treguarit, kur brendia është novatore, ka dhënë mjaft rezultate. Kjo do të thotë se format e larmishme janë të domosdoshme dhe shprehin përmbajtjen e re kur mbeten funksionale dhe nuk shkojnë në rrugë arbitrare dhe subjektiviste. Po kërkimet janë të domosdoshme, në radhë të parë, në jetë, në shoqëri, në studimin e tipave dhe të mjediseve e pastaj, natyrisht, edhe në kërkimet e formës adekuate për një përmbajtje të caktuar.

Karakterin e fizionomisë kombëtare, përveç anëve të brendisë e të formës për të cilat folëm, problemeve thelbësore që përbëjnë historinë dhe të tanishmen e kombit, ia jep romanit, pa dyshim, edhe tërë koloriti, gjuha, nuancat psikologjike, mënyra si e shprehin njerëzit miqësinë e dashurinë, dhembjen e gëzimin, si i respektojnë zakonet e mira. Dhe kur lexon romane të sotme të autorëve të ndryshëm shqiptarë e ndien detajin, ngjyrën kombëtare dhe ato elemente që përbëjnë konstitucionin shpirtëror të një kombi.

Zhvillimi dhe formimi i mëtejshëm i romanit shqiptar, kristalizimi i problematikës dhe i tipareve kombëta-

re është një fenomen i dukshëm që do të ketë të ardhme. Sa më tepër të thellohen romancierët në proceset historike dhe aktuale të jetës, sa më shumë të hyjnë në problemet e psikologjinë e njerëzve, duke përvetësuar detyrat e mëdha të mjeshtërisë, aq më shumë do të përparojë romani i sotëm shqiptar dhe do të rritet pesha e tij në jetën shpirtërore të popullit.

(mbajtur në konsultën për romanin në Tiranë, ku morën pjesë edhe shkrimtarë e kritikë nga Kosova)

1980

PASQYRIMI I KOHËS SONË DHE HISTORISË NË ROMANIN E VITEVE TË FUNDIT

Në zhvillimin e gjinive të ndryshme letrare romani tek ne po zë një vend gjithmonë e më të rëndësishëm. Me tradita të pakta në të kaluarën, me një përvojë të re, romani i periudhës së letërsisë së realizmit socialist ka disa dhjetëvjeçarë që po lëvrohet me sukses, duke plotësuar nevojat dhe dëshirat e lexuesve, niveli kulturor dhe kërkesat estetike të të cilëve vijjnë duke u shtuar.

Romani, si një gjini letrare me prirje kryesore epike, me mundësi për ta përfshirë jetën në gjerësinë dhe kompleksin e saj, ka bërë dhe do të bëjë rrugën e tij të zhvillimit. Në letërsinë përparimtare botërore dhe në letërsinë tonë, që ecën në traditat më të mira kombëtare e ndërkombëtare, romani ka dhënë dhe po jep tablo të gjera, të ndërlikuara të jetës, të luftës klasore. Rruga e tij si gjini nis që nga shtegtimet dhe peripecitë e njeriut gjer te kontradiktat e thella midis kapitalit e punonjësve, te përshkrimi i rrugës së njeriut në jetë, te kritika e ashpër e shoqërisë borgjeze dhe zhgënjimi i njeriut në këtë shoqëri.

Romani i realizmit socialist ka pasqyruar ndërkaq ngjyrat e reja të botës proletare që do të hynte në një lëvizje të madhe revolucionare nën udhëheqjen e komunistëve; ka nxjerrë në shesh humanizmin proletar dhe luftën e klasave duke u futur në dialektikën e ndërgjegjes dhe duke dhënë shpresat e së ardhmes. Ro-

mani shqiptar i realizmit socialist ka ecur në këtë rrugë i mbështetur fort në truallin amtar, në temat e problemet e shoqërisë sonë, nëpër fazat e ndryshme të zhvillimit të saj, në epokën e luftës e të socializmit dhe të historisë së vendit tonë.

Romani shqiptar i sotëm ka problemet dhe vështrësitë e veta të zhvillimit, po, në tërësinë e vet, ai ecën në një rrugë rritjeje dhe tani, në 40-vjetorin e themelimit të PPSH, duke i hedhur një sy kësaj rrugë, do të bindeshim për arritjet e dukshme, për shtimin e numrit të romaneve të botuara, për pasurimin e problematikës së tij, rritjen e nivelit artistik në krahasim me të kaluarën, për shtimin e radhëve të romancierëve dhe formimin e individualiteteve më të shumta krijuese në këtë fushë.

Në letërsinë përparimtare të vendeve të ndryshme, romani kultivohet në traditën realiste me ngjyrë të theksuar kombëtare e përmes evoluimit të dukshëm të formave, dhe me një thelb të shëndoshë. Krahas kësaj prirje, siç dihet, është edhe ajo që përshkruan degjenerimin e njeriut, shturjen e shoqërisë, romani që largohet nga çdo traditë realiste e përparimtare. Kështu bëhen eksperimente të shumta duke shpallur krizën e romanit, që nuk është gjë tjetër veç *kriza e heroit*, paaftësia për të kapur, në përmasa të gjera dhe komplekse, pamjen e ngatërruar të jetës në shoqërinë borgjeze dhe për të shpjeguar shkaqet e krizës shoqërore. Po teoritë e antiromanit, të romanit të ri, të valës së re të tij dhe shumë teori, që e quajnë tashmë si të kapërcyer subjektin, karakteret, madje edhe idenë në një vepër romaneske, si edhe të tjera teori të shumta, bien njëra pas tjetrës. Romani vazhdon rrugën e vet si një gjini shumë demokratike nga forma, duke pranuar trajta nga më të ndryshmet; prirjen filozofike, poetike, shtratin epik apo lirizmin dhe dramën, përshkrimin dhe arsytimin, rrëfimin e drejtpërdrejtë apo përmes imazheve poetike të gërshetuara me legjendën etj.. veçse kurdoherë në rrugën e çarë nëpër shekuj. ashtu siç është quajtur, si një epos i kohëve moderne. Në këtë zhvi-

Ilim jep kontributin e vet edhe romani ynë, gjini e një letërsie që është në rritje, në përtëritjen e vet, besnike e së vërtetës dhe e mendimit revolucionar.

Romani ynë ecën përpara në kundërshtim me rrymat e sotme borgjezo-revizioniste, të tjetërsimit të njeriut në shoqëri, të çarmatosjes së tij para vështirësive dhe kontradiktave, të shtrebbërimit të historisë, të deheroizimit dhe të krizave të thella morale, nga të cilat nuk gjendet rrugëdalje. Shembujt më të mirë të romanit tonë tregojnë se si çohen më tej traditat realiste dhe të realizmit socialist, se si mund të krijohen vepra me vlerë ideoestetike kur nisësh nga e vërteta e jetës, nga njeriu dhe bota e tij, nga mësimi i artistit për ta vënë talentin në shërbim të popullit. Në këtë rrugë romancierët tanë i ka çuar vetë realiteti ynë, njeriu punonjës. Ata janë drejtuar e drejtohen nga mësimet e Partisë dhe të shokut Enver për letërsi dhe art të partishëm, të thellë, me cilësi të larta artistike.

Periudha që nga Plenumi i 4-t e këtej, sidomos këto katër-pesë vjetët e fundit, karakterizohet nga një zhvillim i mëtejshëm i romanit tonë në rrugën e arritjeve të dhjetëvjeçarëve të mëparshëm. U forcua përmbajtja ideore e veprave të kësaj gjinie; iu kushtua vëmendje më e madhe temës aktuale, megjithëse këtu ndihen mungesa, sidomos në cilësi; u dhanë disa tablo të plota historike, më pak nga aktualiteti e më shumë nga luftërat dhe përpjekjet e popullit në të kaluarën; u pasqyrua Lufta Nacionalçlirimtare me heroikën e saj gjithmonë aktuale dhe me disa probleme shoqërore-morale të formimit të njeriut. Romani ka zënë një vend të dukshëm midis gjinive të tjera dhe kjo tregon vitalitetin e letërsisë sonë, aftësinë e saj për të dhënë me realizëm tablo të gjera të jetës dhe për të hyrë më thellë në karakteret. Shkrimtarët tanë kanë punuar për të vënë në jetë orientimet e Kongresit të 7 të Partisë dhe mësimet e shokut Enver. Kapja e disa temave të mëdha, pasqyrimi i proceseve të revolucionit, i heroit pozitiv

që zhvillohet në luftë e sipër, pasqyrimi i dnëjtë i shoqërisë përmes luftës klasore nga pozitrat e partishmërisë proletare dhe të karakterit kombëtar dhe të tjera detyra që u shtruan në Kongresin e 7 kanë qenë në qendër të vëmendjes së krijuesve dhe kanë gjetur zbatim në mjaft vepra të arrira.

Në këtë periudhë janë luftuar me ashpërsi ndikimet e huaja si dhe skematizmi. Kanë dalë autorë të rinj që e lëvrojnë këtë gjini dhe numri i tyre do të vijë duke u shtuar, sepse i tillë është procesi i jetës sonë dhe ritmi i nivelit kulturor që vjen në rritje. Janë botuar vepra të shquara, të cilat e kanë fituar ose po e fitojnë vendin e tyre midis lexuesve si, ndër veprat që pasqyrojnë periudhën e ndërtimit socialist «**Dimri i madh**» e I. Kadaresë, «**Përballimi**» e T. Laços. «**Buka e një stine me borë**» e K. Kostës, për kohën e Luftës ose në prag të saj «**Njeriu me top**» e D. Agollit, «**Belxhiku që këndon vënce**», e Sh. Musarajt, «**Lulja e Kripës**» e J. Xoxes. «**Këshilltarët**» e F. Gjatës, apo romani historik nga e kaluara si «**Skënderbeu**» i S. Godos, trilogjia e S. Spases për rilindësit, «**Shembja e idhujve**» i S. Drinit etj. Si këto romane ashtu edhe mjaft të tjera, si dhe gjithë krijimtaria e kësaj periudhe, shpjen më tej traditën e romanit të ri të *llojit social*, në bazë të të cilit janë *karakteret jetësore* me prirjet e veta psikologjike e lirike, po gjithmonë brenda natyrës epike të pasqyrimin objektiv të realitetit, duke forcuar në të, te veprat më të mira, gjykimin mbi faktet dhe ngjarjet, prirjen filozofike dhe analizën e konflikteve shoqërore dhe politike. Një dukuri tjetër, lidhur me llojin social të romanit, është romani historik, ku jepen tablo dhe ngrihet probleme me përmasa të mëdha kombëtare, ku njeriu vihet përballë kohës, ku dalin, në radhë të parë, ngjyrat politike, të gërshtuara dhe me ato shoqërore, po ku problemi kombëtar, patriotik zë një vend të dukshëm. Prirjet dhe dukuritë lindin nga koha. Dhe e tillë ka qenë koha jonë plot dinamizëm, luftë kundër bllokadës imperialisto-revizioniste, riafirmim i rrugës historike të popullit tonë, përpjekja e vazhdueshme për formimin moral të njeriut të ri.

Në romanet më të shquara është vënë re si prirja e një depërtimi më të thelluar në ndërgjegje dhe në procesin e formimit të karaktereve, vërtetësia dhe poetizimi i jetës, ashtu edhe ajo e shtrirjes në gjerësi, duke na dhënë, nga pikëpamja e strukturës, një lloj polifonizmi, gërshetimi të planeve dhe linjave të shumta të subjektit, të cilat, në rastet më të mira, kanë çuar në rezultate të dukshme për ta kapur jetën në një etapë të rëndësishme të historisë sonë dhe në shumanshmërinë e saj.

Stilet janë pasuruar dhe është përdorur një gjuhë e larmishme e mbështetur në gjuhën popullore. Kështu shkrimtarët kanë dhënë një ndihmë më të madhe se në të kaluarën për zhvillimin e gjuhës sonë letrare. Në mjaft romane ka gjuhë të gjallë, të punuar, ndihet më shumë kultura e të shkruarit. Është çuar edhe më tej, me gjithë dobësitë që vihen re, individualizimi, gjuha e gjallë dhe tipike për çdo personazh, duke gërmuar në thesarin e pashtershëm të frazeologjisë popullore, të ngjyrave dhe nuancave të fjalës së popullit me vlera të shumta individualizuese dhe emocionuese.

Gjatë kësaj periudhe janë të dukshme arritjet në fushën e romanit, ku vërehet një përparim i natyrshëm në krahasim me të kaluarën duke parë sidomos nivelin e përgjithshëm mesatar. Por, bashkë me zhvillimin, dalin edhe disa probleme të mprehta veçanërisht lidhur edhe me një pasqyrim më të thellë e më të gjerë të realitetit socialist, për të rritur cilësinë në trajtimin e çdo teme dhe të përvetësimit të një mjeshtërie më të madhe sidomos nga më të rinjtë.

Nevoja e pasqyrimin të shumanshëm të thellimit të mëtejshëm në temat e realitetit socialist

Në këtë periudhë, e veçanërisht brenda këtyre 4-5 vjetve, është trajtuar më gjerësisht tema aktuale duke tërhequr një numër më të madh autorësh. Siç është thënë edhe në diskutime e në shtyp, raporti midis temave të sotme e të kaluara është i drejtë, ka më shumë romane nga e sotmja. Disa vepra me këtë problematikë ja-

në ndër më të mirat, nga autorë të njohur apo më të rinj të talentuar, kurse një sasi e konsiderueshme e romaneve të botuara me këtë temë kanë nivel të ulët artistik, u kalohet fenomeneve në sipërfaqe, janë të paktë personazhet që mbahen mend dhe shtjellimi i subjektivit nuk arrin të lejë gjurmë të lexuesi. Të meta e do bësi që lidhen me zgjatjen, me mungesën e skalitjes së karaktereve apo me një përshkrim të sipërfaqshëm të ngjarjeve, hasen edhe në romane me temë nga e kaluara apo nga Lufta, po për këto tema janë bërë përpjekje më të shumta që të kapen tablo të gjera të jetës, të luftërave, të trajtohen disa pamje e probleme themelore të historisë. Këtu janë plotësuar boshllëqe dhe janë arritur rezultate (e kjo është një anë e mirë), po ka dalë detyra e pasqyrimit më të shumtë e më të mirë të aktualitetit në letërsi e arte, veçanërisht edhe në roman, në këtë gjini me mundësi të mëdha për të dhënë jetën e sotme në dimensione të shumta dhe në larminë e saj.

Le ta shohim këtë problem duke analizuar arritjet, domethënien dhe vlerat e disa veprave të veçanta dhe pastaj të mundohemi të zbulojmë edhe dobësitë dhe problemet që dalin.

Romani që i kushtohet temave të periudhës së ndërtimit të socializmit, problemeve të kohës, etapave dhe aspektëve të ndryshme të kësaj periudhe, është lëvruar më tej në këto vite, duke u mbështetur në traditën më të mirë të deritanishme në fushën e romanit mbi aktualitetin si, «**Kënetat**» i F. Gjatës, «**Përsëri në këmbë**» i Dh. Xhuvanit, «**Juga e Bardhë**» i J. Xoxes, «**Duel i madh**» i A. Abdihoxhës etj. Vepra më të afërme në kohë, që e kanë zënë tashmë vendin në letërsinë tonë dhe për të cilat është folur, janë romanet, «**Dimri i madh**» i I. Kadarësë, «**Përballimi**» i T. Laços. «**Dimri i madh**» (1977) ka shënuar një arritje të dukshme në fushën e romanit politik, ngritur mbi një bazë historike të kohës sonë, të luftës kundër revizionizmit sovjetik dhe të qëndresës së masave, të shtresave të ndryshme të shoqërisë sonë, të udhëhequra nga Partia. Siç është

pohuar në kritikën tonë, autori ka ditur të gërshetojë, përmes planeve të ndryshme, figura të shquara si ajo e shokut Enver, e cila jepet, në mënyrë lapidare e koncize, në momente të caktuara kulmore, me figura nga radhët e intelektualëve e të njerëzve të thjeshtë. Konflikti me revizionistët është shtjelluar në mënyrë të atillë që krijohet një tension dramatik dhe zgjohet interesi te lexuesi.

Lëvrimi i romanit politiko-historik, ku pasqyrohen ngjarje dhe antagonizma të rëndësishme të kohës, është një prirje pozitive në letërsinë tonë e vihet re edhe në vepra të tjera si në gjininë e romanit ashtu edhe në poema, drama etj. Meritë e romanit «Dimri i madh» është se në të ngrihen me nivel artistik momentet politike dhe ndërtimi polifonik i pamjeve dhe tipave nga jeta, çon në arritje idëoartistike që japin tablonë e kohës dhe dramaticitetin e saj, duke treguar se e drejta dhe vitaliteti shpirtëror janë në anën tonë.

Do të tërhiqim vëmendjen edhe te stili i autorit, lakonik dhe përmes imazheve të qarta nga ana vizuale si edhe te një afrim më i madh me prozën e karaktereve (sipas traditës realiste), të gërshetuara hera-herës me përfytyrime poetike e të figurshme.

Romani i T. Laços, shkruar për një periudhë tjetër (vitet e para pas Çlirimit, për marrëdhëniet midis qytetit dhe fshatit) me një stil të dallueshëm realist, ka tërhequr vëmendjen e lexuesve dhe të kritikës për vërtetësinë e ngjarjeve, për figurat e komunistëve që janë krijuar në të dhe situata reale dramatike që përftohën nga rrjedha e ngjarjeve të jetës së përditshme. Këto, dhe vepra të tjera me temë aktuale, botuar pas Plenumit të 4-t, kanë dhënë ndihmën e tyre edhe te autorë të tjerë, si në trajtimin e temës së luftës kundër revizionizmit, ashtu edhe të luftës klasore brenda vendit, me harmonizimin e problemeve ekonomike, morale e shoqërore.

Lufta e masave punonjëse për ndërtimin e socializmit, për sigurimin e bukës në vend, për formimin

moral të njeriut, lidhja e intelektualit me popullin, me tokën, poezinë e punës, vështirësitë ekonomike, konfliktet antagoniste dhe joantagoniste, heroizmi i punonjësve në çdo front që të ndodhen dhe të tjera tema e probleme kanë tërhequr vëmendjen e prozatorëve tanë. Po t'u hidhim një sy romanëve të krijuara brenda kësaj periudhe, ndonëse motivet gërshetohen, do të vinim re një pamje pak a shumë të tillë të raportit të njeriut me shoqërinë, me realitetin: njeriu ynë dhe koha e ngjarjet politike; njeriu dhe morali, kriteri moral-estetik i gjykimit; njeriu ynë përballë antagonizmave klasore në etapa të caktuara të kohës pas Çlirimit etj.

Një ndër veprat që trajton temën e punës e të luftës për të prodhuar bukën në vend, në kushte të vështira natyrore e të një lufte klasore të ashpër, është romani «Buka e një stine me borë» i K. Kostës, një ndër veprat më realiste të shkruara vjetët e fundit. Vlera e kësaj vepre qëndron në pasqyrimin me vërtetësi të ngjarjeve të përditshme, në skalitjen e disa karaktereve si Pelik Baduni, Puravel Duka etj., në krijimin e konflikteve, të cilat burojnë nga faktet dhe nuk mbajnë erën e trillimit artificial. Sado të komplikuarra duken ndeshjet dhe disa tipa, autori arrin në përfundime të drejta dhe niset nga qëllimi për të flakur të keqen dhe afirmuar të renë. Personazhet pozitive shpesh vishen me një lirizëm të përmbajtur që ka në vetvete ndjenjë dhe ngrohtësi për njerëzit e mirë. Mënyra e ndërtimit të kësaj vepre ka të bëjë më shumë se me një fabul interesante, me procedimin e karaktereve, të cilët, natyrisht hyjnë në marrëdhënie të caktuara dhe krijohet kështu një subjekt, ndofta, jo në kuptimin më klasik.

Edukimit të njeriut në punë, në ndërtimin e hidrocentralit të Fierzës, miqësisë së njerëzve, luftës midis psikologjisë që sjell puna e përbashkët socialiste kundër asaj të pronës private, çasteve të heroizmit, i është kushtuar edhe romani i A. Cergës «Vëllezërit», i cili shquhet për lirizmin e përshkrimeve dhe për rikrij-

min e marrëdhënieve të përzemërta, shoqërore midis njerëzve me profesione të ndryshme që punojnë në një front.

Duke ruajtur stilin e tij, po në një mënyrë tjetër nga romanet e mëparshme, D. Agolli shkroi në këtë periudhë «**Trëndafili në gotë**», një vepër kushtuar lidhjes së intelektualit krijues me jetën në një krahinë veriore, midis sharrëxhinjve. Ky është një roman i llojit liriko-psikologjik, ku ngrihen probleme morale. Roli aktiv i intelektualit në luftën për transformimin e shoqërisë; marrëdhëniet intime të dhëna përmes një dialektike shpirtërore; ndeshja realiste e shikimit të jetës dhe të ngjarjeve që ndodhin; lufta kundër meskinitetit dhe thashethemeve — këto anë të përmbajtjes, të dhëna në një kompozicion të qartë dhe të ngjeshur, me pak personazhe po përgjithësisht të skalitura me gjuhë të punuar, e bëjnë veprën me vlerë ideo-artistike. Nga varianti i botuar në «**Nëntori**» autori ka bërë ndryshime sidomos në paraqitjen e figurës së shkrimtarit të ri, Minait, të përpunuar e të plotësuar. Vepra si, **Trëndafili në gotë**» e të tjera botuar më parë si, «**Rruga Budi**» e R. Pulahës, apo ndonjë tregim e novelë me temë shoqërore-morale, ku kriteri kryesor i vlerësimit të njeriut është ai moralo-etik, tërheqin vëmendjen e lexuesit dhe ndihmojnë në formimin e tij. Një moment i ri për t'u theksuar është rrahja e mendimit estetik, kuptimi i së bukurës, në luftë kundër skemës, — ide që zhvillohen drejt-përdrejt në këtë roman përmes bisedave.

Një zbulim moral të njeriut të sotëm, duke e vënë përballë jetës dhe punonjësve, shokëve të punës, fshatarëve, fqinjve e miqve gjejmë në romanin e Z. Çelës «**Një verë pa lamtumirë**», shkruar me gjuhë të punuar dhe me ndjenjë poetike. Po të kërkonim një fabul tipike dhe shtjellim të një konflikti qëndror, që do të përqendronte veprimin, vështirë se do ta ndeshnim në këtë vepër, por në të mendojmë se, përgjithësisht, i arrihet qëllimit për të zbuluar një karakter qëndror, veteriner Visarin, i cili transferohet në Tiranë dhe për këtë është i gëzuar po nuk nxiton të largohet nga puna, nga shokët dhe, së bashku me të shoqen, bart me

vete atë jetë, ato kujtime të dhëna shpesh me detaje të goditura.

Marrëdhëniet morale dhe etike, lufta për emancipimin e femrës, formimi i ndërgjegjes së gruas të vajzës shqiptare në luftë dhe në punë kanë tërhequr vëmendjen e autorëve të tjerë dhe të shoqeve letrare. Në fushën e romaneve kryesisht mbi këto tema emrit të E. Kadaresë i janë shtuar në këtë periudhë edhe emra të tjera si. Dh. Bozdo, N. Lako, E. Mandia. Ato sjellin kontributin e tyre në lëvrimin e romanit tonë dhe e pasurojnë atë në aspekte njohëse dhe psikologjike.

Problemi i punës, i rolit krijues të saj dhe i luftës kundër revizionizmit, i jetës qytetare, i gjallërisë së të rinjve është dhënë në disa romane si «**Jetë dhe dashuri**» i M. Qillerit, «**Pajtoni i fundit**» i K. Blushit etj.

Romani «**Jetë dhe dashuri**» ka tërhequr vëmendjen veçanërisht për gjerësinë e trajtimit të problemit, për gërshetimin e anëve të ndryshme të jetës dhe të dashurisë, për një shkathtësi që përdor autori në krijimin e personazheve, të cilët veprojnë dhe kanë jetën e tyre intime, botën e brendshme.

Pas romanit të A. Kondos «**Zbulimi**», për punën e gjeologëve dhe ndeshjen me revizionistët, ky roman i M. Qillerit, që afron nga tema me të parin, ndihmon për kapjen e këtyre problemeve dhe të kësaj jete me vështirësitë, bukurinë dhe romantikën e saj. Kështu, heroi kryesor i romanit, Viktor Kama, si edhe Tomi Bregu, Kristina etj., krijohen përpara nesh si karaktere që veprojnë dhe kanë marrëdhënie midis tyre. Pasioni i gjeologut dhe i shkrimtarit, i cili shkruan një roman për herë të parë, njohja e mjedisëve dhe stili i rrjedhshëm kanë dhënë frytet e veta dhe vepra është edukuese dhe me vlera artistike.

Është e kuptueshme se antagonizmi klasor dhe ideologjik, lufta kundër meskinitetit dhe paragjykimëve të botës së vjetër, dalin pothuaj në të gjitha veprat, po lka të atilla ku ky problem është qendror dhe subjekti zhvillohet përmes tij. Të tilla janë psh., «**Do të jetojmë ndryshe**» i Dh. Xhuvanit mbi periudhën e parë menjëherë

pas Çlirimit. Romani «Do të jetojmë ndryshe» tregon mirë gjendjen shpirtërore të Magan Rekës, partizanit të kthyer në qytet pas luftime, të familjes së tij, që shkëputet nga varlësia e tregtarëve në shtëpinë e të cilëve ka qenë strehuar e, në mënyrë të veçantë, botën e tregtarëve dhe armiqve që marrin fund me reagimet e tyre të fundit. Njerëzit e rinj, me botën e tyre, me humanizmin partizan e punëtor spikasin në vepër, ndonëse do të pritej më shumë në këtë anë.

Në kushte të tjera, në një fshat malor e shtjellon ngjarjen H. Petrela të «Luginat». Meritë e kësaj vepre, e cila do të kërkonte një punë më të madhe artistike dhe skalitje personazhesh, është pasuria e materialit jetësor që ndihet në kapjen e ngjarjeve, të paraqitjes së njerëzve të mirë si dhe të ndonjë tipi të gërryer nga ambicia, dëshira për t'u dalluar duke urreyer njerëzit e mirë, ëndrrat e tij për fatkeqësinë e imagjinuar të tjetrit, si edhe lufta kundër intrigave, thashethemeve e cila, në raste të veçanta, bëhet e mprehtë dhe e padurueshme. Prirja për t'i dhënë në ashpërsinë e tyre këto konflikte është e drejtë.

Luftës së klasave në një front ballë për ballë me armikun i kushtohet romani «Mërgata e qyqeve» i N. Jorgaqit me temën e «heronjve të heshtur» dhe të sigurimit të popullit. Ky roman me një analizë psikologjike dhe hetim në ndërgjegjje, përmes figurës së heroit Manush Kelmendi, na zbulon tipat e «qyqeve», e njerëzve të degjeneruar që braktisën atdheun dhe morën rrugën e turpit. Romane të kësaj teme janë shkruar disa si, «Juaji, Furtuna» dhe «Takim apo duel» të M. Dodanit, «Kurthi i gjelbër» i H. Petrelës, «Kërcënim në errësirë» i A. Nases, të cilët kanë zgjuar interes të lexuesi po duhet thënë se ndër to ndihen edhe mungesa dhe nivel i pamjaftueshëm artistik. Këtu do të theksojmë një çështje që ka dalë në praktikë. Kur bëhet fjalë për romanin me temën e ndjekjes së armikut, të vigjilencës etj., pohohet se zakonisht atij duhet të zotërojnë ngjarjet, veprimi ndërsa karakteret, kanë edhe ato vendin e tyre, por spikasin më shumë në rrjedhën

ë ngjarjes. Prandaj edhe e papritura, një kureshtje më të dukshme se në tipat e tjerë të romanit, ka vendin e vet dhe nuk është e tepërt. Po kuptohet se romani ynë me këtë temë nuk ka të bëjë me tipat e romanit policesk dhe me aventurat e pabesueshme dhe triviale.

Tema aktuale në romanin satirik vitet e fundit është trajtuar pak dhe nuk ka rënë në sy të lexuesit. Tradita të reja të romanit satirik botuar pas Plenumit të 4-t, me vepra si «Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo», kanë ndihmuar për të zbuluar dhe ironizuar anë negative të jetës dhe vanitetin, gjithmonë në emër të një ideali pozitiv.

Letërsia për fëmijët, për veçorinë e saj, duhet të studiohet veçanërisht. Po do të dëshironim të përmendim këtu romane me temë aktuale që kanë luajtur dhe lozin rol në edukimin e fëmijëve dhe në pasurimin e fantazisë së tyre si, «**Fëmijët e pallatit tim**» B. Dedes, «**Shqipëri, atdhe i dashur**» i I. Resos etj.

Kjo do të ishte një pasqyrë e shkurtër e veprave të arrira me temë aktuale, në të cilat, ku më shumë e ku më pak, vihen re edhe të meta, po ku ndihet jeta e sotme, zbulohen konflikte, ka realizëm dhe, në disa më të mirat, edhe një mjeshtëri të dukshme në thurjen e subjektit dhe në skalitjen e karaktereve të paharrueshme.

Siç u përmend edhe në krye, në trajtimin e temës aktuale janë dukur të meta të ndieshme dhe ka pasur mungesa. Realiteti ynë socialist ngre shumë më tepër probleme nga ato që trajtohen në roman dhe, veç asaj, nuk janë kapur si duhet disa probleme të ditës të aspekteve politike, shoqërore dhe morale. Njerëzit, nëpër romanet tona, ndodh që jepen në një ngjyrim të zbehtë, skematik, nuk janë vëprues dhe mendimtarë; lexuesi e merr vesh që në fillim se ku do të dalë autori dhe kjo ndodh nga njohja e cekët, në disa raste, dhe nga interpretimi i pamjaftueshëm i tipave dhe dukurive.

Problemet e njohjes me ato të botëkuptimit, të in-

terpretimit dhe të mjeshtërisë janë të lidhura me njëra-tjetrën dhe shpesh dalin të gërshetuara. Në këtë vështrim bien në sy dy dobësi lidhur me temën aktuale po edhe me tema të tjera:

Së pari, do të theksonim deskriptivizmin që ndihet në disa vepra (jo vetëm në romane), mungesa e përgjithësimeve më të dukshme, një cektësi hera-herës në pasqyrimin e jetës. Kjo dobësi lidhet më shumë me përvojën e pamjaftueshme të disa autorëve, me kulturën e paktë filozofike dhe me njohjen e cekët të jetës apo të dokumenteve historike, me mungesa në organizimin e materialit jetësor për t'i dhënë formën e duhur letrare. Ajo ka të bëjë gjithashtu me kërkimet e pamjaftueshme në fushën e artit romanesk, me vijimin e një rutine që nuk lejon t'i gjurmosh dhe t'i interpretosh në thellësi fenomenet po të kënaqesh me një rrëfim disi të sipërfaqshëm.

Së dyti, në vepra të veçanta me tema të ndryshme vëmë re trajtim skematik, thurje të subjektit sipas një skeme të njohur dhe kjo e bën veprën të mos jetë gjer në fund bindëse dhe personazhet të duken si sajime të autorit e jo njerëz të vërtetë. Kjo e metë lidhet edhe me zbulimin e cekët të konflikteve, me kapjen e disa lloj konfliktesh stereotipe, që dobësojnë veprimin dhe interesin e lexuesit. Lufta kundër skematizmit lidhet me njohjen më të thellë të jetës dhe me pasurimin e koncepteve të autorit, duke u nisur nga botëkuptimi marksist-leninist dhe nga një këndvështrim më i përcaktuar ideestetik.

Për të kapërcyer këto mungesa e dobësi është e nevojshme, në radhë të parë, të njihet më thellë njeriu i sotëm me interesat e tij të gjera politike, shoqërore dhe morale; njeriu ynë i socializmit, i cili jeton në situata ndërkombëtare të turbullta dhe të vështira, por i orientuar qartë nga vija e Partisë sonë. Me gjithë arritjet dhe përpjekjet e bëra mbetet mjaft për ta krijuar më mirë këtë hero në faqet e romaneve tona, hero me një frymëmarrje të gjerë, me botë të pasur e komplekse, me një dialektikë të brendshme po me idë-

ale të qarta. Ky njeri ka jetën shoqërore dhe vetjake, ka punën dhe familjen, shokët, njerëzit dhe, kuptohet, se jo çdo gjë shkon bukur dhe rrëshqet lehtë në jetën e përditshme të tij: në ndërgjegjen dhe në veprimtarinë e tij ka vështirësi dhe luftë për të ecur përpara. Rrethi i ngjarjeve tani është zgjeruar. Jeta nuk na paraqitet në forma të ngurta dhe të thjeshtëzuara. Romani nuk e fut kurdoherë në fokusin e vet këtë pasuri jetësore. Me gjithë sukseset, edhe nga romancierë ndër më të mirët e më prodhimtarët si, I. Kadare, S. Spasse, F. Gjata, D. Agolli, Sh. Musaraj, A. Abdihoxa, T. Laço, S. Godo, Dh. Xhuvani etj., kërkohet e pritët edhe më shumë në krijimin e heroit dhe të figurave artistike sidomos nga ditët tona, pa lënë mënjanë heronjtë historikë, që përbëjnë krenarinë e lashtë të kombit.

Problemi i heroit, i krijimit të karaktereve më të plota lidhet ngushtë me konceptimin tërësor të veprës, me tipizimin e fakteve dhe të tipave jetësorë. Prandaj procesi i krijimit është i lidhur me njohjen dhe përgjithësimin, me aftësinë interpretuese. P.sh. një roman si «Lugina» i H. Petrelës, me material jetësor të pasur dhe konflikt të qartë, vuan nga deskriptivizmi, nga mungesa e thellimit, në disa raste, në faktet dhe ngjarjet që përshkruhen. Kështu në këtë vepër një personazh i mbytur me të meta si Shaqir Arra nuk mund të hyjë në radhën e pozitivëve dhe as që ka mundësi të japë shenja këthese, sepse kemi të bëjmë me një logjikë tjetër, të degjenerimit shpirtëror të tij. Përveç kësaj, lidhjet me shokët e Partisë të «Luginat» mund të jepeshin më mirë dhe drejtuesit t'u hynin më thellë problemeve të fshatit dhe jo të mjaftoheshin me letrat që u dërgon ndonjë intrigant. Këto të meta, që duken edhe në vepra të tjera, kanë të bëjnë pikërisht me tipizimin dhe një harmoni midis faktit, njeriut dhe gjykimit mbi të. vlerësimit ideomocional të autorit.

Njohja dhe mjeshtëria janë dy probleme që lidhen me njëri-tjetrin. Ndodh që mosthëllimi në jetë, në karaktere, në mendimin themelor shpie në fragmentarizëm e në hallakatje ose materiali mund të ekzistojë, po nuk

gjen mishërimin e duhur artistik. Fragmentarizëm gjej-
 më edhe në romane që janë pritur mirë si, «Vëllezërit»
 i A. Cergës e ndonjë tjetër, kurse në romanin me vlerë
 të M. Qillerit «Jetë dhe dashuri» mendojmë se lind
 problemi i spostimit të vëmendjes nga tema qendrore
 dhe nga problemi kryesor që do të shtrojë autori, në
 paraqitjen e të cilit ka merita të dukshme. Kuptohet se
 puna, lufta, jeta dhe dashuria janë të lidhura dhe kë-
 shtu do të jepen edhe në roman, por problemi themelor
 që ngrihet në një vepër nuk duhet spostuar nga të tje-
 rët, sepse dëmton zgjidhjen e asaj që është thelbësore.
 E kemi fjalën të konflikti i gjatë dhe i pamotivuar midis
 Tomit dhe Kristinës, për pajtimin e të cilëve hyn në
 mes edhe Viktori gjersa më në fund i arrihet qëllimit.
 Problemi moral duhej t'i nënshtrohej atij të përgjith-
 shmit, se kështu largohet vëmendja nga rrjedha krye-
 sore dhe kjo linjë, e grindjes së zgjatur, nuk del bin-
 dëse, ndonëse ndjenjat e dashurisë përshkruhen me poe-
 zinë e tyre. Probleme të kësaj natyre nuk kanë të bëj-
 në vetëm me një vepër dhe meritojnë të diskutohen.

Veç këtyre problemeve në disa romane të kohëve të
 fundit dalin fenomene më të dukshme negative, që ka-
 në të bëjnë më ato të meta që u përmendën të ske-
 matizmit, të njohjes së cekët, të një lloj kurdisjeje të
 tipave dhe të zgjidhjeve të konflikteve. Në disa raste
 karakteri fiktiv i konfliktit, ecuria artificiale e tij,
 skematizmi i tipave dhe mungesa e tipikes në paraqi-
 tjen e personazheve dhe ngjarjeve e zbehin veprën
 dhe e dëmtojnë ose ia humbasin krejt vërtetësinë.

Pasqyrimi i mjediseve punëtore, i punës në uzinë,
 i karaktereve të klasës me botën dhe energjinë e tyre
 morale është problem i rëndësishëm dhe, më siguri,
 do të preokupojë në të ardhmen më shumë shkrimtar-
 rët tanë. Tani për tani kjo temë është rrahur pak dhe
 pa shumë rezultate. Problemin e edukimit të një inte-
 lektuali, aktori të njohur, në gjirin e klasës punëtore
 ka vënë në qendër të vëmendjes S. Këlliçi në romanin
 e tij «Nën harqet e zjarra». Ky autor ka një shkathtë-
 si në të shkruar, krijon subjekt të qartë dhe përshkru-

an mirë disa ambiente të punës, miqësinë e punëtorëve, çiltërsinë e tyre etj. Po kjo vepër vuan mjaft nga një ndërtim skematik, nga stereotipe të njohura kur një vajzë e përkëdhelur le të fejuarin, apo një armik, Qerim Aga gjën veglën e tij Hysenin, i cili punon në fonderi dhe çdo ditë mundohet të hedhë helm midis punëtorëve. Gjen edhe një përgjegjës sylesh, Banushin. Nuk është e besueshme lufta e këtyre armiqve: ku mbahehen, ç'kërkojnë të arrijnë, ku e gjejnë këtë kurajë në ditët tona kur armiku vëpron më i maskuar? Përveç kësaj, dërgimi i një aktori, apo i kujtdo qoftë, midis punëtorëve për t'u riedukuar për egoizmin e tij dhe për gabime nuk do të ishte një temë tipike dhe e domosdoshme kur ka shumë mënyra të tjera për të treguar punën dhe forcën edukuese të klasës punëto-re. Skema ka në disa vepra kur ngjarjet sajohen dhe zgjidhen sipas një «parafabrikati» të njohur dhe kur vërehet pak njohje ose konceptimi i fakteve është i dobët dhe mungon forca e duhur përgjithësuese.

Është e vështirë t'i përmendësh apo t'i vlerësosh gjithë romanet me këtë trimë. Romane si, «Ngarkesë e largët» e A. Kaninit, «Drizana» e A. Micit etj. janë krijime të para të këtyre autorëve në gjininë e romanit dhe i kushtohen punës, heroizmit të punonjësve, konflikteve me armiqtë e vështirësitë natyrore, formimit të personalitetit të njeriut. Po, duke u nisur nga kërkesat e sotme, vihet re në to nivel i pamjaftueshëm artistik dhe vështirë se mund të flasim për dimensione të gjinisë së romanit. Një roman tjetër si «Gjergji» i H. Sinanit, është shkruar me një stil realist e të përmbajtur dhe flet për rrugën në jetë të një punëtori, i cili është i ndërshtëm, fiton kulturë dhe ka prirje për të përkthyer, po vihen re në të mungesa. Kuptohet se çdo zgjidhje, kur motivohet mirë, mund të jetë e pranueshme, por këtu nuk ka një motiv aq të përshtatshëm për të treguar rritjen dhe pasurimin shpirtëror të punëtorit (që shkon përkthyes në një fushë ku ai të shprehë hovin dhe pasionet e tij).

Problemi i tipizimit dhe i vendosjes në kohë të ka-

raktereve ka qenë dhe mbetet një kërkesë e drejtë për romanin. Nuk mund të avancohen ngjarjet dhe të jepet një tablo e pasaktë lidhur me situatat politike, siç ndodh p.sh. në ndonjë vepër që, pa u bërë të qarta nga Partia situatat dhe pa dalë mirë kontradiktat me revizionizmin, njerëzit t'i dinë të gjitha dhe të flasin, si në ditët tona ose si pas zbulimit të konflikteve. Kjo vihet re në romanin «Tajfun në brigjet tona» të R. Likës, i cili është edhe mjaft i dobët artistikisht.

Veprat që përmendëm këtu më lart si edhe ndonjë që u zu në gojë më parë, si «Nën harqet e zjarrit» e S. Këlliçit, dhe të tjera, pa dashur t'i peshojmë të gjitha me një kandar, do të ishte mirë të punoheshin më shumë e të redaktoheshin më mirë para se të botoheshin.

Të meta e mungesa të natyrës artistike vihen re edhe në romane që u përmendën e që janë ndër më të mirët. Këto mangësi, lidhur me mjeshtërinë artistike, janë të përhapura edhe tek autorë të tjerë. Kështu p.sh., problemi i ndërtimit të romanit, i arkitekturës së tij del edhe te një vepër realiste si «Buka e një stino me borë» e K. Kostës, ku në faqet e fillimit ka zgjatje; fragmentarizëm apo një lirizëm i tepruar që dobëson ndonjëherë veprimin, vërehet në romane si i Z. Çelës, ndonjë roman si «Stinët e jetës» i N. Lakos, i cili ka përshtyje dhe analiza të mprehta nga jeta, po subjekti vjen i shkapërderdhur dhe vështirëson perceptimin e ngjarjeve dhe tërësinë e figurave.

Pasqyrimi më i mirë i realitetit socialist është një problem i rëndësishëm ideologjik dhe artistik e ka të bëjë edhe me trajtimin e temave të tjera nga lufta dhe historia jonë. Partia na mëson se kërkimet në të shtemen përcaktojnë novatorizmin e artit dhe hedhin dritë si në shpjegimin e së kaluarës, ashtu edhe në ndriçimin e së nesërme.

Shkaqet e dobësive në pasqyrimin e realitetit socialist duhen kërkuar, në radhë të parë, në njohjen e pamjaftueshmë të jetës dhe të tipave, në të jetuarit pa shqetësimet e duhura krijuese, si edhe, — ky moment

është gjithashtu shumë i rëndësishëm — në përpjekjet e pamjaftueshme për të njohur më në thellësi proceset e përditshme, ngjarjet, ekonominë, për t'u pasuruar më tej me filozofinë marksiste-leniniste. Shkrimtarët dhe artistët, romancierët tanë i njohin dhe i studiojnë materialet e rëndësishme dhe dokumentet e Partisë, por, të shohim rezultatet, në disa raste vemë re se këto nuk janë përvetësuar në thellësi dhe nuk gjejnë një zbatim harmonik në praktikë. Në disa romane që përmendëm e në të tjera botime të zbehta vihet re edhe thjesht një mungesë kulture letrare e gjuhësore, veç asaj që problemi i trajtuar njihet shkarazi.

PROBLEME TË TRAJTIMIT TË TEMËS SË LUFTËS DHE TË HISTORISË

Lufta Nacionalçlirimtare është pasqyruar në romanin tonë gjatë këtyre viteve dhe temat janë pasuruar me disa anë jo fort të trajtuara më parë si edhe me thellimin në botën e brendshme të njeriut të asaj kohe. Këto tema janë rrahur më shumë nga autorë me përvojë jetësore që i kanë jetuar edhe vetë ngjarjet e Luftës, megjithëse, kuptohet, kjo nuk është kurdoherë e mundur dhe e domosdoshme. Motivet që kanë zotëruar në këto romane janë të lidhura me karakterin popullor të Luftës të udhëhequr nga Partia, me rolin e këshillave nacionalçlirimtare, pra të pushtetit të ri që po lindte dhe të autoritetit të tij në popull, me formimin moral të njeriut në luftë, me emancipimin e përgjithshëm të tij gjatë kësaj kohe, kur revolucioni, krahas problemeve politike, sillte me vete edhe farën e ndryshimeve shoqërore.

Në periudhën pas Plenumit të 4-t të 1973 u botuan romane si, «Njeriu me top» i D. Agollit, «Zgjimi i Nebi Surelit» i Dh. Xhuvanit, «Shtigjeve të zëna» i M. Kallamatës etj., të cilët lartësonin momente të heroizmit

dhe të formimit të ndërgjegjes shoqërore në luftë. Në vitet e mëpastajme u botuan vepra të tjera që kanë tërhequr lexuesit e kritikën.

Aspekte nga epika dhe heroizmi i luftës kapin në veprat e tyre prozatorët Sh. Musaraj te «**Belxhiku që këndon vence**» dhe F. Gjata te «**Këshilltarët**». Problemi i formimit të ndërgjegjes së heroit të vet, Sino Borakut, të njëriut të dalë nga gjiri i popullit, patriotizmi i masave dhe roli i drejtuesve në luftë, i bijve të veçorisë dhe të tjera anë të jetës, në rrjedhën e saj të mëtejshme, kanë preokupuar shkrimtarin në veprën e tij. Në të ka figura të goditura, të dhëna ashtu vetvetiu, përmes kujtimeve dhe përshtypjeve që ka pasur autori dhe këto figura, në çastet më të bukura e më emocionuese, të nguliten në mendje dhe të prekin me thjeshtësinë e tyre.

Proza jonë është marrë edhe më parë me këto anë të jetës partizane, të karakterit popullor të kësaj lufte, po këtu janë pasuruar disa përmasa dhe bëhet një përpjekje për të dhënë me portrete e përmes episodesh të nxjerra nga ngjarjet reale, një varg tipash që japin fizionominë kolektive të popullit.

Në një plan tjetër, me stilin e tij plot patos dhe me një romantikë të brendshme e lirizëm e kap luftën F. Gjata te «**Këshilltarët**», e cila u botua më parë si novelë e më pas autori e zgjeroi dhe e bëri roman. Me këtë vepër, si edhe me të tjera në prozë e në gjini dhe lloje të ndryshme arti, pasurohet letërsia dhe arti ynë duke rikrijuar tipare të luftës mbi lindjen dhe forcimin e pushtetit të ri, një formë krejtësisht demokratike, që doli nga gjiri i masave dhe arriti të zhvillohet vazhdimisht. Gjetja e subjektit në këtë roman dhe zgjidhja e tij sjellin diçka të re dhe origjinale; anëtarët e këshillit nacionalçlirimtar, të kapur dhe të dënuar nga armiku, ruajnë gjakftohtësinë dhe dënojnë me vdekje disa nga tradhtarët, ndërkaq ngarkojnë një të ri Bejton, (të cilin e shpëtojnë para pushkatimit, duke mbuluar me trupin e tyre) që ta vejë në zbatim këtë urdhër të këshilltarëve të pushkatuar. Kjo thu-

rje i ka dhënë autorit mundësi të përfshijë një realitet të luftës, të japë çaste emocionuese dhe heroike nga lufta e fshatarëve tanë të udhëhequr nga komunistët.

Tablo të luftës, të betejave me armikun, problemeve të kapërcimit të kontradiktave të brendshme kanë rrokur në romanet e tyre autorë si, S. Godo me romanin «**Prova e zjarrit**» dhe L. Qafëzezi me «**Yje dhe helmeta**». «**Prova e zjarrit**» është një vepër e shkruar me vërtetësi, me stil konçiz mbi jetën dhe luftën e batalionëve partizane, të ndeshjes me xhandarë e ballistë, mbi karakterin, guximin dhe gjakftohtësinë e njerëzve të popullit në luftë. Heroi i veprës, Bejto Mërkuri, kalon nëpër një sërë provash. Kjo arrihet përmes një lufte shpirtërore që herë pas here vjen nga një sedër e tepruar. Në roman përshkruhen ndjenjat e tij delikate të dashurisë që jepen me kursim, duke ruajtur ngjyrat e kohës. Fundi i armikut, degjenerimi i tij, është dhënë me detaje bindëse dhe përbën një nga momentet e rëndësishme të veprës.

Kurse romani «**Yje dhe helmeta**» paraqet në një linjë të vet disa aspekte të patrajuara të një kontradikte të brendshme midis dy drejtuesve partizanë, shokë lufte, të cilët në punë të taktikës kanë qëndrime të ndryshme. Kjo linjë përfshihet në konfliktin themelor të luftës me armikun, përmes betejash të shumta, qëndrimesh heroikë, portrete njerëzish të popullit, të lidhur ngushtë me partizanët. Vepra ka vërtetësi, material të pasur jetësor dhe një përpjekje për t'u thelluar në anë të veçanta të luftës.

Me një stil tjetër në krahasim me veprat që u përmendën, me të njëjtin patos dhe duke u nisur nga po ai realitet i luftës, ka krijuar F. Arapi romanin e tij «**Shokët**», i cili ka marrë shkas nga një ide poetike dhe popullore, që shokët e rënë në luftë t'i kenë varret pranë njëri-tjetrit. Këtu ka zënë fill frymëzimi i këtij autori, i cili e ndërton subjektin, të thuash, mbi një shtat simbolik po ku spikat heroika dhe stoicizmi popullor.

Qëndrimi i klasave dhe shtresave të ndryshme në

Luftë ka qenë objekt pasqyrimi që në fillimet e romanit tonë të ri. Kjo prirje vjen duke u zhvilluar e thelluar në mjedise të tjera, pak të trajtuara deri tani. Kështu, romani i S. Drinit «Midis dy kohëve», në tablo të gjera dhe linja të gërshetuara, përshkruan pjesëmarrjen në luftë të njerëzve të popullit, të intelektualëve të dalë nga gjiri i tij, dhe të ndeshjes së tyre me klerin, i cili bënte përpjekje për të penguar luftën dhe për të hedhur helm në ndërgjegjen e njerëzve. Hipokrizia e reaksionit klerikal, çjerrja e maskës së tij jepet mirë në veprën ku zotëron një mënyrë e saktë, e studiuar e analizës dhe ku subjekti mbështetet mbi shumë fakte e të dhëna konkrete, të rikrijuara në imagjinatën e shkrimtarit.

Pasqyrimi i ngjarjeve të paraluftës, në prag të saj, dhe pastaj të luftës, në një plan politik e patriotik dhe social, me problemin e marrëdhënieve klasore dhe të ndeshjes së botëkuptimeve, të pikëpamjeve të kundërta, siç del edhe te romani «Midis dy kohëve», duket qartë te vepra e fundit e shkrimtarit J. Xoxa te romani «Lulja e kripës». Ky shkrimtar, që i dha mjaft letërsisë sonë me talentin, njohjen e jetës dhe punën e palodhur, edhe në këtë vepër, krijoi tipa të gdhendur, pasqyroi gjendjen e argatëve të kripores, pasurimin, në njërin anë, të arkondëve e çifligarëve dhe varfërimin, në anën tjetër, të fshatarësisë. Ai krijoi në këtë vepër tipa pozitivë si Petriti, apo Peri i Këputur, dha tablo të jetës, të luftës ideologjike dhe të veprimtarisë së masave në prag dhe pas formimit të Partisë. Përshkrimi i mjediseve, koloriti dhe atmosfera, jeta në shumanshmërinë e saj kanë gjetur shprehje në këtë vepër.

Me periudhën në prag të luftës, në një zonë të Myzeqesë, është marrë edhe V. Koreshi në romanin e tij «Mali mbi kënetë», ku gjejmë gjithashtu këtë prirje të pasqyrimin të marrëdhënieve shoqërore, të vuajtjeve dhe revoltës së fshatarësisë dhe të shpirtit patriotik të popullit.

Kësaj tëme i kanë kushtuar romanet e tyre edhe

shkrimtarët si. M. Zaloshnja («Kur malet kërkonin die-llin»), R. Bedo («Gjurmë të ndezura»), S. Jasa («Tokë e papushtueshme»), autorë më të rinj si N. Lera («Gjaku i prillit») etj.

U munduam të jepnim një pasqyrë të shkurtër të romaneve mbi luftën dhe arritjeve në këtë fushë. Disa të meta dhe mangësi, që vihen re përgjithësisht në romanin tonë, ndihen edhe këtu. P.sh., me gjithë meritat, vepra si, «Yje dhe helmeta» apo vende-vende edhe «Belxhiku që këndon vende» kanë një lloj deskriptivizmi, janë të ngarkuara me ngjarje dhe kjo dëmton dramaticitetin si edhe spikatjen më të mirë të karaktereve. Te «Këshilltarët» F. Gjata, bie, në ndonjë rast, në stil agjitativ, që mund të ishte shmangur. Kjo e më të vihet re në forma më të dukshme edhe në romane të tjera për luftën. Për një kompozim dhe dramacitet më të dukshëm, më të theksuar do të kishte nevojë «Prova e zjarrit», kurse te «Shokët» ideja poetike duhet të kishte gjetur një zgjidhje më të besueshme dhe më realiste. Kështu mund të bëheshin vërejtje edhe për vepra të tjera ku ka zgjatje apo dialog agjitativ në vend të gjuhës së thjeshtë, të natyrshme dhe të figurshme.

Romani me temën e luftës do të zhvillohet tek ne më tej. E rëndësishme është që të gjenden aspekte të reja, të patrajtuara të kapërcehet skema e dhënies së tipave, të zbulohen më mirë, më në thellësi, ato fije të brendshme që bashkojnë kohët, që nisnin nga e sotmja për të ndriçuar të kaluarën, historinë tonë të re.

Historia e popullit tonë ka tërhequr shkrimtarët për dy qëllime kryesore: për të njohur më mirë, me gjuhën e artit, të kaluarën, heroizmin e popullit, luftën kundër pushtuesve e tradhtarëve, jetën e tij të rikrijuar sipas faktëve dhe fantazisë si edhe për t'u bërë jehonë ngjarjeve të sotme, duke treguar vazhdimësinë e kombit, rrënjët e lashta të heroizmit dhe të luftërave shoqërore. Kur flasim për zotërimin dhe ngritjen e cilësisë në romanin me temë aktuale kuptohet vetiu se nuk lemë mënjanë edhe temën historike, të patriotiz-

mit, të unitetit të popullit dhe të ndeshjeve klasore në të kaluarën. Detyra e romancierit në këtë rast është edhe detyrë prej historiani, që të mbledhë me kujdes të dhënat dhe të dijë t'i interpretojë. Është e njohur se, sipas stilit dhe preferencës, ndodh që brenda letërsisë e artit shpikat më shumë apo më pak historiani, imagjinata zë një vend më shumë ose më pak të dukshëm, po shkrirja e këtyre dy elementeve është e domosdoshme për një vepër të vërtetë. Është e njohur gjithashtu se romancierit historik, si rregull, nuk merr me hulumtime ngjarjesh të reja, po merr ato ngjarje të mëdha të historisë së kombit që kanë lënë gjurmë në ndërgjegjen e popullit dhe i ndriçon emocionalisht e me një qëndrim të caktuar ideor.

Kështu janë nisur edhe romancierët tanë në trajtimin e temave historike që nga «Kështjella» e I. Kadarese, «Skënderbeu» e S. Godos e të veprave që janë krijuar në këtë periudhë.

Ngjarjet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, duke u nxitur edhe nga 100-vjetori i saj, kanë qenë objekt pasqyrimi i disa romanëve apo dhe veprave në gjini të tjera si drama. Kështu, romani i vëllimshëm «Mic Sokoli» i S. Krasniqit dhe romani «Zemërimi» i F. Cakajt u kushtojnë asaj kohe heroike që hyn në traditën luftarake të popullit tonë. Romani i S. Krasniqit ka një shtrirje të gjerë epike, një subjekt të atillë ku fillesa popullore është përcaktuese. Figurat e luftëtarëve të shquar si, Mic Sokoli, e udhëheqësve të lëvizjes popullore si, Abdyl Frashëri etj., janë të pleksura me shumë personazhe të popullit, disa të skalitura me mjeshhtëri e rrënjë të thella në tabanin kombëtar e popullor si Lokëmadhja etj. Rrjedha historike e ngjarjeve, jeta e njerëzve, skenat masive, luftimet si ajo e Kaçanikut etj., përbëjnë linjat e subjektit të pasur, ndonjë ndonjëherë të mbingarkuar e të zgjatur. Edhe romani «Zemërimi» ka zgjuar interes me qartësinë e përshkrimit, me disa skena emocionuese dhe personazhe historike e imagjinare, ndër të cilët Dem Delia (mishërim i Ramadan Zaskocit), nënë Rudana etj. Këto ve-

pra, si edhe të tjera, janë shtruar drejt historikisht, duke paraqitur të vërtetën historike në luftën kundër pushtuesve turq dhe manevrave e qëndrimeve armiqësore të shovinistëve fqinjë.

Një vend të dukshëm në romanin me temë historike të trilogjia e S. Spases për rilindësit, e cila vë në qendër të vëmendjes ngjarje të mëdha historike dhe përshkruan krahina të ndryshme të atdheut në atë periudhë. Epiciteti i dukshëm i kësaj vepre buron nga përshkrimi i ngjarjeve heroike dhe nga karakteri popullor i saj. Autori ka bërë një punë të madhe në grumbullimin dhe seleksionimin e fakteve, duke u dhënë atyre një formë artistikë si edhe në gërshetimin e linjës historike me atë shoqërore, të tipave historikë e të figurave që përfaqësojnë shtresa të ndryshme popullore. Meritë e kësaj vepre, ku përfshihet edhe pjesa e tretë që doli kohët e fundit, «**Ja vdekje ja liri**», mbi kryengritjen e Malësisë të 1911, është patosi patriotik, si dhe vërtetësia historike, e cila me përpunimin e veprës ka ardhur duke u saktësuar, është qëndrimi artistik krijues ndaj fakteve që kanë gjetur mishërim nëpër linja subjektesh e më personazhe që kalojnë nga një vepër në tjetrën. Në romanin «**Ja vdekje ja liri**» shkrimtari tregon luftën kundër pushtuesit turk, revoltën popullore, gdhend figura si Ded Gjo Luli si edhe mjaft personazhe të tjera, midis tyre dhe gra, si Dava, Nora e Tringa. Vepra tregon qartë edhe dredhitë dhe armiqësitë e Malit të Zi, që donte të mashtronte fshatarët e thjeshtë përmes dasisë fetare si edhe qëndrimin e paqpur dhe të mençur të malësorëve e të luftëtarëve që i udhëhiqnin.

Kësaj periudhe i ka kushtuar romanin e vet «**Vraje tradhtinë**» edhe Skënder Drini, i cili i përqendron ngjarjet në Shkodër, duke pasqyruar luftën kundër përfaqësuesve të Perandorisë Osmane, kundër dinakërisë dhe dhunës së tyre si edhe kundër qëndrimeve të shovinistëve fqinjë. Me një stil më të përmbajtur, ndonjëherë racional, ky autor në tërësi ia arrin qëllimit të vet të krijojë ngjarje dhe karaktere si Braho Shkreli

etj. dhe të stigmatizojë tradhtinë, të mishëruar këtu sidomos në figurën e Esad Toptanit, duke arritur në një përgjithësim të luftës kundër çdo tradhtije, e çdo kohe qoftë, duke treguar ç'neveri dhe urrejtje zgjon ajo në popull.

Edhe shkrimtarët tanë që shkruajnë për fëmijë i kanë kushtuar vëmendje temës historike. Kështu p.sh., ndër romanet që zgjojnë ndjenjën heroike dhe fantazinë e fëmijëve do të përmendim «Guna e zezë» e G. Bushakës.

Në vargun e veprave letrare historike zë vendin e vet romani «**Sos për mua as për ti**» i M. Kallamatës, shkruar me një narracion tërheqës, me material të pasur nga jeta e me vërtetësi, i cili i kushtohet qëndresës së fshatarëve me Rrapo Hekalin në krye, në periudhën e Kryengritjes së Tanzimatit, në luftë kundër bajlerëve shtypës dhe vegla të pushtuesve. Vepra nga historia më e afërme si, «**Tri të shtëna në Paris**» e S. Këllicit, kanë zgjuar interes.

Përveç këtyre romaneve historike është botuar edhe ndonjë veper me temë shoqërore nga e kaluara, siç është romani i T. Laços «**Lëndina e lotëve**» kushtuar plagës së kurbetit, jetës së rëndë ekonomike dhe marrëdhënieve shoqërore përmes tipash që nga njerëzit e thjeshtë të popullit, gjer te përfaqësues të borgjezisë së kohës, veglave të tyre dhe ndonjë intelektual pa personalitet. Stili i rrjedhshëm dhe emocionues i këtij shkrimtari ndihet edhe në këtë veper, e cila mund të kishte, sidoqoftë, një kompozicion më të zhdërvjell-të dhe të bëhej kështu më interesante.

Romanit tonë satirik më temë nga e kaluara si, «**Në hijen e dordolecëve**» i M. Kallamatës, apo «**Karriera e zotit Maksut**» i Q. Buxhelit i janë shtuar në këtë periudhë trilogjia «**Fshati midis ujërave**» i K. Jakovës që arrin deri në luftë e në çlirim si edhe «**Kiu Muzaka me hosten**» G. Kongolit. Romani ynë satirik ka ende zhvillim të pamjaftueshëm, po, duhet thënë ka arritur disa rezultate në krijimin e personazhit po-

zitiv përmes gjuhës së humorit si dhe të përvetësimit më të mirë të humorit popullor.

Romani ynë kushtuar luftës dhe historisë, siç del edhe nga kjo pasqyrë e shkurtër, ka pasur arritje, tablo të plota dhe larmi stilesh. Por është e nevojshme që të njihet edhe më thellë ky realitet i kaluar përmes dokumentesh dhe dëshmitarësh, kur është fjala për ngjarje të afërme në kohë, dhe të gjenden shumë vende të reja të pazbuluara, që i bëjnë jehonë kohës dhe kërkesave të njeriut të sotëm. Epoka e Skënderbeut, e luftërave popullore çlirimtare dhe klasore, koha e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe Rilindja përgjithësisht ashtu siç kanë qenë, janë kurdoherë të denja për vepra madhore. Edhe në këtë temë, siç u tha, duhet luftuar proliksiteti, deskriptivizmi historik, mungesa e emocioneve dhe e tensionit dramatik e të tjera dobësi. Krahas temave aktuale, ku duhet të bëhet një kapërcim i dallueshëm cilësor, temat e luftës dhe të historisë do të zenë në romanin tonë vendin e tyre të nderuar.

Kur flasim për romanin tonë dhe veçanërisht për trajtimin e temës kombëtare historike ne mendojmë edhe për tërë romanin shqiptar, për ato që krijohen këtu dhe në Kosovë, si edhe nga autorë shqiptarë në Maqedoni e Mal të Zi. Problemet e përbashkëta të romanit shqiptar aktual u rrahën në konsultën që u mbajt në nëntor të vitit të kaluar në Tiranë, ku morën pjesë edhe romancierë, e kritikë nga Kosova. Siç është thënë në atë konsultë, romani i krijuar në Kosovë ngre, në radhë të parë, problemet historiko-kombëtare, të dashurisë për truallin amtar, të plagës së mërgimit dhe të luftërave shoqërore e klasore për liri, tokë e drejtësi. Romani ka tema nga realiteti i pasluftës në Kosovë, i është kushtuar problemeve të emancipimit të femrës dhe të shoqërisë, të luftës kundër zakonisht të hakmarrjes, problemeve të së drejtës për kulturë e gjuhë, kundër elementëve regresive dhe hijeve të errëta që persekutojnë njerëzit e kulturës dhe popullin e thjeshtë. Në Kosovë është lëvruar si romani realist tradicional nga ana e formës, ashtu edhe një

mënyrë simbolike e alegorike apo që mbështetet në gërshetimin e narracionit me vështrimin metaforik, ku shpesh nënvizohet ideja e traditës së lashtë dhe e vazhdimësisë së kombit dhe të identitetit kombëtar. Shkrimtarët në Kosovë kanë krijuar vepra me brendi përparimtare e demokratike, për dashurinë ndaj vendlindjes dhe për miqësinë midis popujve. Romane të autorëve si, H. Sulejmani, N. Rrahmani, R. Kelmendi, M. Isaku etj., janë gjerësisht të njohura tek ne dhe gëzojnë simpatinë e lexuesit.

Pas ngjarjeve tragjike në Kosovë, të cilat, si gjithë populli ynë, edhe shkrimtarët e artistët tanë i kanë ndjekur e përjetuar me një vëmendje të madhe e me emocion, në mënyrë të gjallë e aktive, apologjetët e revizionizmit jugosllav në kulturë, serbomëdhenjtë antishqiptarë dhe veglat e tyre filluan të flasin për një lloj «romantizmi historik» në fushën e kulturës, të arsimit e të artit, duke dashur të largojnë vëmendjen nga historia shqiptare dhe madje të ndalojnë në Kosovë, me një arbitraritet policesk, trajtimin e temave nga historia jonë kombëtare, duke tentuar kështu të shuajnë kulturën dhe traditën shqiptare. Trajtimi i temave historike nga shkrimtarët shqiptarë, si këtu edhe në Kosovë, është bërë kurdoherë nga pozitat e një realizmi historik, e një të vërtete të pamohueshme dhe për të kanë qenë kurdoherë të huaja elementet shoviniste apo irredentiste, për të cilat ata akuzojnë. Përkundrazi, në artikujt tanë të «Zërit të popullit» në shtypin tjetër, ne kemi vërtetuar se shovinistë dhe antishqiptarë janë në veprat e tyre letrare disa autorë të tyre, të përkrahur dhe të nxitur nga propaganda e serbomëdhenjve. Tërë historia e popullit tonë dhe historia e shumë popujve në botë ka trëguar dhe tregon se përpjekjet e çdo reaksioni për të mohuar traditat e një kombi, kulturën, historinë e tij kanë dështuar dhe do të dështojnë me turp.

Domosdoshmëria e larmisë së formave të romanit

Për probleme të formës së romanit, të strukturës së tij, për anë të tjera të mjeshtërisë në thurjen e kësaj gjinie në dinamikë të vazhdueshme, është folur tek ne diçka më shumë kohët e fundit, megjithëse ndihen ende mungesa.

Nëpër simpoziume e diskutime janë rrahur disa probleme sidomos të strukturës në romanin tonë.

Është vërejtur se romani ynë për nga ndërtimi dallohet për tipin ekstensiv, me kompozicion të shtrirë në një rrjedhë të drejtpërdrejtë kohore si edhe një tip tjetër, intensiv, i përqendruar, ndonjëherë me alternime kohore, me zhvillimin paralel të kohës ose me kthime pas që ndihmojnë për të plotësuar fizionominë e tipave për të lidhur kohët me njëra-tjetrën.

Në romanet e periudhës që analizojmë janë përdorur, sipas materialit jetësor dhe synimeve të autorit, forma me kompozicion të shtrirë, me një ndërtim polifonik apo, në të tjera raste, duke e marrë historinë në rrjedhën e saj kronologjike, kurse ka pasur edhe forma më të përqendruara, ku veprimi zhvillohet midis pak personazheve po vështrimi hidhet në thellësi. Megjithatë larmi të dukshme formash nuk ka pasur dhe kërkimet në brendinë e jetës së sotme, si edhe në formë kanë qenë të pakta. Kjo gjendje shtron detyrën e kërkimeve më të shumta novatore në romanin tonë.

Në një vështrim tjetër strukturor është lëvruar më shumë tipi i romanit të karaktereve dhe më pak ai ku fabula, ngjarja zë vendin kryesor. Një ndarje e tillë, sigurisht, ka edhe konvencionin e vet, sepse ngjarja gërshetohet me karakteret, por sidoqoftë një dallim vihet re midis tyre.

Përsa i takon trajtimit kohor, do të thoshim se ka raste kur bëhet një prerje e kufizuar nga jeta brenda një mate apo brenda pak ditëve. Kjo do të kërkonte thellimin e karaktereve e do të pranonte edhe retrospektivën, po me masë, pa prishur zhvillimin inten-

siv të subjektit, sepse ndryshe nuk ka pse të mbyllet veprimi në një kornizë.

Janë shkruar tek ne romane shumëvöllimshe si trilogjia e S. Spasses, apo romani i ri i J. Xoxës, po edhe romane më të ngjeshura, ku dimensionet kohore apo ngjarjet janë më të përqendruara, siç kanë qënë më parë «Kronikë në gur», «Njeriu me top», «Përsëri në këmbë» etj. Po zhvillohet edhe një lloj romani ku ngjarjet janë të përqendruara në kohë po jeta merret në kompleks, në raporte të gjera klasore si p.sh., «Bu-ka e një stine me borë» etj.

Romani ynë po plotëson sot disa boshllëqe nga e kaluara, duke dhënë tablo me vlera të dukshme njohëse, natyrisht brenda natyrës së artit. Si kjo prirje, ashtu edhe pasurimi i mendimit, i reflektimit të shkrimtarit mbi ngjarjet dhe njerëzit do të vijjnë duke u theksuar e gjetur një gërshetim më të plotë në diversitetin e stileve.

Një anë tjetër e mjeshtërisë është prania e autorit në vepër, i cili, siç thoshte Floberi, duhet të jetë i gjithëpushtetshëm, por i padukshëm në vepër. Kuptohet se edhe në këtë vështrim ka stile e variante të ndryshme, disa mënyra ku lihet veprimi të flasë e të tjera ku interpretimi bëhet më i dukshëm përmes gjykimit, parantezave lirike e meditative, që mund të hyjnë midis kapitujve dhe të ndihmojnë veprimin. Mënjanimi i deskriptivizmit, skematizmit do të kërkonte më shumë praninë e autorit jo me ndërhyrje agjitative dhe moralizuese, po përmes veprimit, tipave si edhe në format lirike apo më të drejtpërdrejta poetike. Ne kemi nevojë për një larmi më të madhe formash edhe nga kjo pikëpamje.

Nga kjo analizë e romaneve sipas temave dhe problemeve dhe nga vlerësimi që bëme, duke u mbështetur edhe në mendimin kritik, në atë të lexuesve, në opinionin e krijuar për një varg veprash, dolën edhe problemet dhe detyrat më të përgjithshme që shtohen para romancierëve tanë, si edhe para studiuesve e kritikëve.

Një detyrë e rëndësishme dhe e mprehtë është zhvillimi i ndryshëm i romanit me temë aktuale, i pasqyrimin të realitetit socialist në fazat e tij të ndryshme, po duke u përqendruar më shumë në kohën tonë, në problemet politike, shoqërore dhe morale, me të cilat jetojmë. Këtu del qartë nevoja e njohjes së jetës, një njohje e përditshme, intensive, njohje me një konceptim të qartë ideor dhe jo spontan e të sipërfaqshëm. Kjo kërkon rritjen e ndërgjegjes komuniste të shkrimtarëve dhe organizim të punës nga ana e Lidhjes dhe e degëve të saj. Të jetuarit intensiv, të qenit më pranë njerëzve do t'i bëjë veprat më jetësore dhe me një karakter më të dukshëm problemor.

Kjo detyrë është e lidhur ngushtë me kulturën e gjerë që duhet të ketë romancierin, me njohjen më të thellë të materialëve të Partisë e të veprave të shokut Enver, të historisë së kaluar e të re, duke shfletuar e studiuar libra, dokumente, materiale arkivash, politike e sociologjike, histori e filozofi, gjë që ndihet në veprat më të mira. Historia jonë është një dhe e pandarë dhe temat e së kaluarës marrin një tingëllim aktual kur njihet mirë koha dhe kur interpretohen në dritën e shkencës marksiste-leniniste.

Një shembull i shkëlqyer i vërtetësisë jetësore, i pasqyrimin realist të fakteve, i përdorimit me vend dhe lakonik të fjalës dhe i skalitjes së tipave me pak penelata e me thjeshtësi është libri i shokut Enver Hoxha «**Kur lindi Partia**» (kujtime), i cili do t'u vlejë romancierëve tanë, si gjithë krijesve, për t'u njohur më mirë me faktet, për të luftuar frazat e tepërta e për të qenë sa më realistë.

Format e romanëve kanë qenë dhe duhet të jenë të ndryshme, të larmishme, po në to vendin kryesor e zë njeriu, jeta, me dramën, kulmet dhe poezinë e përditshme. Jashtë tyre nuk ka letërsi dhe as roman. Prandaj thellimi në karaktere, pasqyrimi i njeriut, i jetës në shumanëshmerinë e saj është një detyrë e mëtejshme që kërkon rritjen e shkallës së njohjes dhe të kulturës.

Zhvillimi i mëtejshëm i romanit kërkon edhe një njohje më të mirë të traditës sonë dhe të traditës së romanit përparimtar e revolucionar botëror. Kjo nuk i ka munguar letërsisë e krijuesve tanë dhe do të vijë duke u thelluar edhe më shumë. Lidhja është reciproke: ne marrim nga kultura botërore e përparuar dhe i japim asaj tonën. Kështu, është shtuar numri i romaneve të përkthyer në botën e jashtme dhe më shumë punë duhet bërë nga ne për t'u dhënë lexuesve të huaj romanet tona më të mira.

Një rol të rëndësishëm për rrahjen e mendimit mbi romanin mund të lozë kritika.

Kritikët dhe studiuesit tanë më të njohur e me përvojë si, J. Bulo, K. Bihiku, R. Brahimi, A. Uçi, J. Mato, A. Kallulli, e më të rinj si, B. Kuçuku, Ç. Gjo-kutaj, Xh. Abazi, F. Malo, L. Berati etj., i kanë kushtuar vëmendje problemeve të romanit. Edhe krijuesit vetë kanë kontribuar në fushën e mendimit kritik e estetik mbi romanin. Por duhet thënë se bëhet ende pak në krahasim me zhvillimin e kësaj gjinie dhe me problematikën që lind. Shpesh botohen artikuj globalë, me një njohje të pamjaftueshme të krijimtarisë, të teorisë së romanit dhe ka pak analiza të mirëfillta të veprave të shquara. Nganjëherë vihet re një nivelim i vlerave dhe nuk bëhet kritikë e argumentuar për romanet e dobta. Kritika për romanin duhet të mbajë një peshë më të madhe, të jetë më luftarake dhe me nivel më të thellë shkencor, ashtu siç porositi Plenumi i 8 i KQ të Partisë për shkencat tona dhe për shkencat sociologjike veçanërisht. Duhet synuar më shumë edhe për larmi stilesh në kritikë dhe për një gjuhë më të pasur të saj.

1981

PRIRJE TË POEZISË SË KOHËVE TË FUNDIT NË PËRMBAJTJE DHE NË FORMË

Në letërsinë e sotme shqiptare, poezia zë një vënd të dukshëm. Kjo lidhet, në radhë të parë, me shpirtin poetik të popullit, me kontrastet, dramat dhe konfliktet e historisë sonë si edhe, pa dyshim, me traditën e pasur poetike që kemi trashëguar. Zhvillimi i gjinive të veçanta në periudha të caktuara historike ka shkaqet e veta. Jo kudo sot në botë lëvrohet me sukses poezia. Ndër popuj që kanë një elan shpirtëror si populli shqiptar ose atje ku ka një protestë shoqërore apo ku shtrohen me mprehtësi probleme të lirive dhe të ruajtjes së pavarësisë nacionale, lindin më shumë ndjenja poetike, duke krijuar kushtet për një hov më të madh të poezisë. Pas zhvillimit të gjinive të tjera, si romani etj., poezia ka thelluar përmbajtjen e saj. Nxitje për lëvrimin e poezisë bëhet edhe vetë kërkesa e lexuesve që e duan poezinë dhe e kanë si kënaqësi të jetës. Në kohët më dramatike të historisë shqiptare, poezitë e Naimit, Pashko Vasës, Mjedës, Nolit e Migjennit janë mbajtur afër si një kërkesë shpirtërore dhe kanë luajtur rol në formimin kombëtar dhe shoqëror të ndërgjegjes. Sot poezitë e autorëve të njohur si D. Agolli, I. Kadare, Ll. Siliqi, F. Arapi dhe më të rinj si K. Petriti, N. Papeleka etj. gëzojnë simpatinë

e lexuesve. Poetë shqiptarë të Kosovës si E. Mekuli, A. Shkreli, D. Mehmeti, B. Bokshi, F. Gunga, E. Gjergjeu, R. Dede, A. Podrimja, Q. Ujkani etj. janë të njohur ndër ne, botohen e lexohen me kënaqësi.

Zhvillimi i poezisë së realizmit socialist në Shqipëri, si edhe gjinitë e tjera, ka shkuar nëpër disa etapa kryesore dhe sot është në një etapë pjekurie, kërkimesh artistike. Ajo priret drejt një mendimi më të thelluar e më të gjerë.

Para se të shohim disa dukuri konkrete të sotme, do të desha të ndalem shkurt për pikënisjen teorike në këtë fushë dhe për disa probleme që rrahim në diskutimet tona.

1. Premisa teorike për një konceptim të drejtë dhe evolutiv të poezisë

Dihet se poezia ka lindur për të shprehur veprimtarinë dhe përjetimet e brendshme të njeriut, ndjenjat dhe mendimet e tij, kurdoherë në forma konkrete emocionale. Është e njohur se dikur poezia ishte mëma e të gjitha gjinive dhe prej saj dolën e u zhvilluan gjinitë e tjera. Pas kësaj, poezia u përqëndrua më tepër në vetvete, u specializua, si të themi, lëroi më tepër arën e saj. Ajo ka qenë dhe mbetet një sintezë e jetës, e botës së brendshme të njeriut. Gjithë arti nuk mund të bëjë pa ndjenjë, po poezia në mënyrë të veçantë, shquhet për një densitet emocional. Duke qenë kështu, vetvetiu ajo shkon drejt ritmit, rimës, muzikalitetit. Sa më i thelluar, më i gjerë të jetë mendimi, aq më i larmishëm, më emocional është edhe ritmi i saj. Ndryshon ritmi dhe organizimi i brendshëm i poezisë së periudhës romantike e sentimentale nga ai i periudhës realiste, i brendisë revolucionare që kërkon udhë të reja dhe sjell me vete hera-herës shpërthime tronditëse.

Pra, nga kjo pikëpamje, si një art sintezë — megjithë format më analitike apo më të ngjeshura që ka njohur, poezia ka veçoritë e veta dhe nuk mund të ngatërrohet me prozën. Gjinitë evoluojnë dhe marrin nga njëra-tjetra, po mbeten përgjithësisht në hullinë e vet — sepse kanë lindur nga një nevojë estetike. Megjithatë, duhet marrë parasysh, se çdo kohë përpunon stilin e vet, dhe tani nuk mund të pëlqehen më — sado larmi formash të kenë — poezi emfatike, deklarative, sentimentale, me pasthirrma të shumta. Gjithashtu koha po tregon se mënyrat narrative në poezi nuk duhet të përjashtohen — poezia e gjatë sidomos e do një lloj fabule — porse tregimi poetik haset më rrallë dhe ndërthuret me ndërhyrjet e autorit, me parantezat lirike e meditative, me përgjithësimin e ndjenjës e të mendimit. Në poezinë tonë, edhe ato poema që mbështeten mbi një ngjarje konkrete si p.sh. «**Heronjtë e Vigut**» e K. Jakovës, «**Këngë e re për dashurinë e vjetër**» e D. Siliqit etj., e fusin ngjarjen aq sa i duhet poezisë dhe tregimi jepet në forma sintetike-lapidare të një stili tipik për poezinë epike ose lirike. Në poezitë që priren nga narracioni si «**Baladë e re për komisarin**» etj. D. Agolli krijon portrete lirike dhe fillat pastaj vetë si poet. Me këto nuk do të mohojmë gjinitë dhe llojet, vetëm duam t'i marrim ato në evolucion dhe në efektin estetik që mund të bëjnë ndër periudha të ndryshme historike.

Në praktikën tonë krijuese, në fushën e poezisë jemi ndëshur me dukuri të formës që kalonin në ekstreme. Në fillim ndodhte që narracioni bëhej empirik dhe pa nerv poetik, më pastaj, ndofta si reagim ndaj këtij ekstremi, u kalua ndonjëherë në ekstremin tjetër, të një ngjeshje të tepruar të materialit që ia humbiste poezisë atë freskinë e saj dhe aromën e papërsëritshme të jetës. Megjithëse ka ende të meta dhe poezi të dobëta, tani në dakadat e fundit kërkimet kanë gjetur shprehje më të dukshme nga kjo pikëpamje dhe vërejmë një shkërrje më harmonike midis mendimit e ndjenjës, midis monologut lirik të poetit dhe fabulës së nevojshme për poezinë.

Një problem tjetër teorik dhe praktik — problem që

është rrahur e rrihet në mendimin kritik botëror — ka të bëjë me karakterin shprehës dhe pasqyrues të poezisë. Kjo rrjedh nga natyra lirike apo epike e saj. Mendoj se duhet t'i pranojmë të dyja atributet e poezisë, ndryshe ose do të biem në deskriptivizëm ose në një abstraksion të shkëputur nga jeta. *Uni* poetik, term që përdoret gjerësisht, nuk mund të jetë një tip *asocial*, përkundrazi ai pasqyron një epokë, njeriun e kohës, poetin tek i cili përqendrohen tipa të tjerë që mishërohen tek ai. Në poezinë tonë janë hequr barrierat midis tij dhe shoqërisë, kohëve të fundit dëshmon për një përdorim të gjerë po kjo nuk do të thotë që në poezinë e re të zbehet *uni* dhe përjetimet e brendshme të poetit. Edhe poezia jonë e kohëve të fundit dëshmon për një përdorim të gjerë të *unit lirik* dhe për gjerësinë e jetës që hyn në të. Teoritë e ashtuquajtura të *vetëshprehjes*, e kufizojnë *unin* poetik dhe e mbyllin në vetvete, duke e shkëputur nga shoqëria. Këtu e kanë burimin edhe shfaqjet hermetike apo abstrakte që nuk e quajnë të domosdoshëm komunikimin dhe nisen, në fakt, nga një pozicion formalist artistokratik i poezisë për vete duke përjashtuar misionin e madh të artistit për t'i shërbyer popullit dhe shoqërisë.

Poezia jonë e re ka ecur në një rrugë zhvillimi. Nga këngët partizane të frymëzuara të F. Gjatës, A. Varfit, K. Jakovës etj. te përmasat më të gjera të paraqitjes së jetës — «Prishtina» e Ll. Siliqit, «Ashtu Myzeqe» e A. Çaçit, në poezinë realiste, po disi përkruese (poemat e gjata narrative), drejt një sintetizimi të botës së poetit me jetën. Prania e njeriut bëhet më e plotë dhe poezia arrin të të prekë më shumë, të jetë më e afërme dhe më bashkëkohore. Kjo u duk në lirikat dhe poemat e I. Kadaresë, D. Agollit etj., kjo prirje vazhdon edhe tani, duke luftuar retorikën, uniformitetin, largimin ndonjëherë nga tradita kombëtare e vargut, i cili merret kurdoherë në larminë dhe evolucionin e tij.

Problemet që preokupojnë sot poezinë lidhen me ato të shoqërisë sonë — me historinë dhe të sotmen, me njeriun, punën, dashurinë, harmoninë midis njeriut dhe na-

tyrës shqiptare, me temën e miqësisë dhe të internacionalizmit; po jo vetëm me harmoninë — edhe me kontradiktat — luftën kundër burokratizmit, meskinitetit, qëndrimeve mikroborgjeze, mblesërive, zakoneve të vjetra. Një poezi pa nerv, pa probleme nuk mund të jetë luf-tarake dhe të ndihmojë njeriun në formimin e tij shpirtëror, moral dhe estetik. Poezia duhet të hyjë thellë në problemet dhe në gëzimet e hidhërimet e njeriut, në dialektikën e brendshme të jetës.

2. Probleme të përmbajtjes së poezisë sonë të kohëve të fundit

Siç u përmend, poezia jeton me kohën, me botën dhe veprimtarinë e njeriut. Kemi rrahur mendime edhe kohët e fundit dhe kemi arritur në disa përfundime për prirjet kryesore.

Gjatë periudhës së fundit, 4-5 vjet e më shumë, vazhdon prirja për një përgjithësim të historisë dhe të së sotmes. Po shpesh nuk mund të flasim këtu për një ndarje të tillë tematike si në gjini të tjera, si proza apo drama. Ajo është më fluide, kalon nga njëra temë te tjetra, duke mbetur te një problem i madh, i atdheut, p.sh. i historisë dhe së sotmes, i dashurisë, i virtyteve njerëzore, i filozofisë së jetës e të vdekjes. Sidomos në poema të mëdha e gjejmë këtë gërshetim tematik më qartë.

Prirja e përgjithësimeve është e lidhur me një për-pjekje për ta konceptuar më shumë e më thellë jetën nga ana filozofike, për të pasur një pikënisje të tillë. Këtu nuk është fjala vetëm për lirikën filozofike që merret ngushtësisht me probleme të tilla, po për filozofinë e jetës që buron nga një ngjarje, nga një fakt, meditim, nga ëndrra dhe realiteti, nga kuptimi i gjërave të thjeshta. Nga kjo pikëpamje, në poezinë e sotme ndjenja është e lidhur më shumë me mendimin; ajo nuk mbetet sentimentale; po, kuptohet, se edhe një poezi e

mbështetur në mendimin e thatë bëhet racionale, nuk i flet ndërgjegjes estetike të njeriut.

Kështu, për të ilustruar më mirë këtë prirje — të përgjithësimeve të shkrirjes së kohës me poetin, të shtruarjes së problemeve më të mprehta të sotme, do të sjellim disa shembuj. Shohim poemën «Nënë Shqipëri» të D. Agollit.

Cilat janë disa merita të saj? Gjerësia e jetës, stili polemizues, romantika dhe ironia kundër armiqve, diapazoni i gjerë i motiveve dhe mishërimi artistik i mendimit dhe vrojtimeve. Nga vargjet e saj buron edhe mendimi filozofik edhe ndjenja e madhe dhe e sigurt e dashurisë për atdheun dhe për të ardhmen e tij:

*Njeriu ka nevojë të këndojë për
njeriun e lindur
në kohën kur emrin ia vë
për ta mbajtur në shekuj,
njeriu ka nevojë të qajë hidhur
për të dashurin, njeriun e vdekur,
njeriu ka nevojë të fshijë frikën,
skamjen, urinë,
njeriu ka nevojë të shembë
padronë,
njeriu ka nevojë të shohë
lirinë,
të ndezë revolucionë!*

☞ Kjo prirje e përgjithësimeve, e trajtimit të problemeve të mëdha historike dhe aktuale duket qartë te vëllimi «Koha» i I. Kadaresë, ndihet te poema si «Përpara historisë» të Ll. Siliqit, «Drejt qindra shekujsh shkojmë» e F. Arapit, «Firma e popullit tim» e K. Petritit, «Vdekje e perëndive» e Xh. Spahiu etj.

Lufta për të ruajtur progresin dhe lirinë, kombin kundër supershteteve, trajtohet në një varg poemash e poezish, si në poemën e Ll. Siliqit, ku spikat ndjenja e patriotizmit dhe e një krenarie të ligjshme nacionale:

*S'është Shqipëria
 kafshatë goje,
 monedhë këmbimi e letër lojë,
 kujdes, pra, zotërinj,
 se mos
 ju mbushet mendja për
 ndonjë shëtitje,
 ky vend, ta dini, s'njeh
 dremitje.
 I lirë ndër këto troje
 gjakvadtur
 për luftë e për fitore
 është kalitur.*

Disa poetë i kanë kushtuar vëmendje të veçantë
 problemit të historisë, me një konceptim të gjerë. P. sh.
 I. Kadareja në poemën «**Shqipëria dhe tri Romat**» ndalet
 në momente kryesore të historisë dhe me një varg të
 thjeshtë popullor, me një figuracion të natyrshëm — duke
 u thënë kështu tërthorazi edhe më të rinjve, që më
 shumë t'i kërkojmë në popull dhe në folklor figurat tona
 poetike — evokon heroizmin e popullit dhe fatin tragjik
 të kombit në të kaluarën:

*Ç'rrëzëllin ashtu
 mes shekujsh të nxirë
 shqiptari me plagë
 si me xhevahirë.*

*O ti shpend, ti shpend
 që m'u ule pranë
 mëmë e atë më pyet,
 mëmë e atë unë s'kam.*

*Mengadalë, o shpend,
 përmbi plagë m'u ul
 merr nga gjaku im
 shtoje mbi flamur...*

Në një varg poezisht janë trajtuar temat historike, duke marrë shkas edhe nga 100 vjetori i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe duke u nisur nga ideja patriotike e tërësisë së kombit për të pohuar të sotmen dhe të ardhmen e tij. Në trajtimin e figurave historike dhe të periudhave të shumta ka tani një konceptim më të thelluar marksist-leninist në marrëdhëniet e individit, të heroit me masën e njerëzve, një vlerësim të drejtë dhe emocional të rolit të tyre në histori. Kjo p.sh. ndihet në ciklin e F. Arapit botuar në «Nëntori» 1978 për Skënderbeun si në vjershën «Ata»:

*...Po ata të panumërit që emër nuk kanë...
që në thirrjen e Gjergjit për lirinë ranë...
që ishin dhe shpatë dhe
parzmore e lirisë,
ata ishin buka dhe gjaku
i Shqipërisë.
Ata ishin lindja, ata
ishin vdekja
dhe, në fund të fundit,
ata ishin jeta.*

ashtu edhe në «Vdekja e Skënderbeut» ku me një ritëm emocional, tregohet përjetësia e emrit të heroit:

*Supet e njerëzve...
ishin supet e betejave
të fitoreve,
të lavdive,
të dhimbjeve,
të tragjedive të popullit
të tij.
Dhe ishin supe të kërrusur
njerëzore...*

Përveç kësaj prirje social-historike më të dukshme dhe më të rëndësishme, do të thoshja se prirja tjetër është thellimi i unit poetik, lirizmi, depërtimi në pro-

blemet e ndryshimeve morale dhe shoqërore, të dialektikës dhe të nuancës së ndjenjave, të zbulimit poetik të ngjyrave të natyrës, të depërtimit në shpirtin e njeriut, pra lirika me motive sociale dhe intime, të lidhura edhe këto me shoqërinë jo në mënyrë vulgare dhe të thjeshtëzuar, po me disa fije të brendshme e organike. Ndihet një nevojë e depërtimit nga rasti konkret dhe detaji të mendimi më i madh, të kompleksi i ndjenjave, të zbulimi i poezisë në një sferë më të gjerë jetësore dhe shpirtërore.

Shembuj që dëshmojnë për këtë prirje ka mjaft. Vëllimi «**Fjala gdhend gurin**» i D. Agollit shquhet për kërkime edhe të kësaj natyre; duke marrë shkas p.sh. nga një fakt i thjeshtë si fluturimi i patave të egra ai shkruan:

*O viset prindërore
o malet në karvan,
në qiell lundrojnë patat
me vargun naimjan.*

*Dhe malli i poetit
troket në kraharor,
nga malet vijnë patat
me vargun naimjan.*

Në librin «**Koha**» të I. Kadaresë, në gjurmët e lirikës së tij të parë, ka vargje që shquhen për ndjenja delikate, njerëzore dhe që të prekin me thjeshtësinë e tyre.

Poetë si K. Petriti bëjnë përpjekje të hyjnë më thellë në ndjenja dhe të mos mbeten në sipërfaqe. Në një lirikë ai i thotë vjazës që do se nuk e nxjerr emrin e saj në poezi, sepse gjërat e rënda, me peshë, qëndrojnë në fund, ai i këndon natyrës me ngjyra të buta dhe të ëmbla.

Më thellë mundohet të hyjë në jetë, në *unin* e vet dhe në humanizmin aktiv të kohës sonë N. Papleka, me një gjuhë asociative, me metafora («Arkitectura e

dritës»). Nga një detaj, nga një fakt i thjeshtë në dukje ai nxjerr idenë e progresit, të lënies prapa të diçkaje, po duke ruajtur gjithmonë respektin ndaj asaj që është bërë më parë dhe duket e parë punën njerëzore në një vazhdimësi të pandërprerë (Mos u pikëllo, lundër e vogël»).

Po kështu edhe poezi të N. Gjetjes, Xh. Spahiut, etj., ku ndjenja shpesh gërshetohet në një mendim të thelluar etj. Të tilla vjersha të goditura kanë edhe poetë të tjerë si N. Lako, H. Aliaj, Ll. Ruci Zh. Jorganxhi etj.

Krahas zbulimit të unit lirik apo zbulimit të poezisë përmes detajit, mjediseve, vihet re edhe një prirje për të dhënë portrete lirike të njeriut të sotëm, ku, natyrisht, shkrihet edhe vetë poeti me heroin që përshkruan. Këto portrete dalin mirë edhe në poema e lirika dhe flasin për zgjerimin problemor e tematik të poezisë. Tani luftohet për një konceptim më filozofik, për cilësi e mjete figurative më të pasura, duke thelluar pohimin e idealit si edhe mohimin e së keqes, përmes një mënyre polemizuese, në formën e adresimit, të bashkëbisedimit, të komunikimit të drejtpërdrejtë me lexuesit.

3. Mbi tipat e vargut të sotëm dhe figuracionin poetik

Përmbajtja është primare dhe përcakton formën, po ky problem nuk mund të kuptohet në mënyrë mekanike. Novatorizmi i përmbajtjes shpie edhe në novatorizmin e formës, sidomos në periudhën e pjekurisë dhe të konsolidimit të përmbajtjes, por, kuptohet se forma e vjetër, disa elemente të saj shërbejnë për një kohë relativisht të gjatë. Forma nuk mund të jetë punë mode — kur na mërzitet një varg të kthehemi te tjetri! Edhe kthimi te vargu i rrëgjullt që vihet re sot në disa letërsi evropiane, ndonjëherë edhe te soneti, ka domethënie e vet: kjo vjen si një reagim ndaj eksperimenteve të shumta e shpesh pa sukses të vargut që mbetet amorf,

po edhe si përpjekje për të sqaruar dhe «disiplinuar» mendimin.

Zgjerimi tematik e problemor, nevoja për të shprehur ndjenja e mendime më komplekse, raportet e shumanshme të poetit me shoqërinë, shtimi i nuancave, ngjyrave, kontrasteve shpie edhe në larminë, pasurimin e vargut dhe të figuracionit, të imazheve poetike të figurave stilistike (metaforë, krahasime, simbole etj.), po edhe të epitetit e detajit, të vështrimit figurativ të jetës.

Pasurimi i mjeteve është tipik po fetishizimi i një mënyre dhe injorimi i një tjetre nuk do të ishte i drejtë dhe objektiv, sepse kemi shembuj mënyrash të ndryshme që japin rezultate estetike. Po të marrim vargun që përdoret në poezin e sotme, do të vëmë re se prirja kryesore, më e rëndësishme, është një varg ritmik me forma të larmishme, me një muzikë më të gjerë e individuale, por kurdoherë të pranueshme. Kështu janë shkruar «Përse mendohen këto male» apo «Nuk lindëm ne princa», «Devoll, Devoll» dhe «Nënë Shqipëri», «Alarme të përgjakura» etj. Poetë si F. Gjata, K. Jakova, A. Varfi, L. Qafëzezi ose si Ll. Siliqi, D. Agolli, I. Kadareja e më të rinj si K. Petriti, P. Jorgoni e mjaft të tjerë kanë përdorur e përdorin vargun me metër klasik. Shpesh brenda tyre do të vëmë re ndryshime në ritmet e brendshme, në pauzat, në thyerjen e monotonisë etj. Një varg më të lirë përdorin në një pjesë të mirë të krijimtarisë poetë si F. Arapi, R. Marku, N. Pappleka etj.

Pra, po të bëhej një kategorizim, do të shihnim se përdoren pak a shumë, tre tipa:

a) Vargu i ritullit; b) vargu i çliruar nga disa rregulla që ruan ritmin origjinal dhe c) vargu i lirë që nuk mund të jetë jashtë kërkesave të ritmit e rimës, po kur përdorimi i tyre është më individual.

Te vargu i lirë ka edhe raste prozaizmi. Kjo ka të bëjë me dobësitë që mund të ndeshen si në këtë lloj ashtu edhe në vargje të llojit tjetër. Po kur ky varg përdoret me kritere poetike atëherë zotëron një sintaks poetik, paralelizëm figurativ, përsëritje epitetesh me

një synim artistik, ndërtimesh inverse me qëllim emocional etj. Muzika dhe ritmi krijohen disa herë përmes vargut tonik (sasia e barabartë e thekseve ose përdorimi në vende të barabarta nëpër vargje).

Përdorimi i figurës stilistike, i kërkimeve në këtë fushë ka qenë dhe është një problem aktual për poezinë tonë. Ne kemi luftuar dhe luftojmë për një shprehje të figurshme, duke u mbështetur në traditën tonë, që nga Naimi të Migjani apo edhe në traditën botërore si Majakovski, Uitman, Neruda e mjaft të tjerë poetë të mëdhenj të shekullit tonë.

Duke luftuar kundër ndikimeve moderniste, ne kemi luftuar vazhdimisht edhe kundër çdo vulgarizmi dhe semplizmi, për një poezi të qartë, por të thellë, që nënkupton format e shumta, alegoritë dhe simbolin, por që nuk e humbet asnjëherë lidhjen me jetën dhe që vë kurdoherë në qendër të vëmendjes njeriun, atdheun, lirinë, luftën për dinjitetin dhe lumturinë njerëzore.

**PROCESI KRIJUES
I SHKRIMTARIT**

THE UNIVERSITY OF CHICAGO
LIBRARY

PËR KRIJIMTARINË E DRITËRO AGOLLIT

Krijimtaria e D. Agollit zë një vend të rëndësishëm në letërsinë tonë të realizmit socialist. Ky autor është ndër më të shquarit që ka lëvruar lloje të ndryshme letrare, sidomos në fushën e poezisë dhe të prozës. Krijimtaria e shumanshme e D. Agollit, së bashku me krijimtarinë e autorëve të tjerë më të mirë, qëndron në radhët e para të letërsisë e të artit tonë të ri, ku gjejnë pasqyrim dhe shprehje të gjallë realiteti socialist, e sotmja dhe historia shqiptare, idetë e partishmërisë më të lartë proletare dhe karakteri kombëtar. Në veprën letrare të D. Agollit ka harmoni midis përmbajtjes e formës dhe origjinalitet krijues; vërehet një përpjekje e vazhdueshme për të zbuluar anë të reja të jetës dhe për të përsosur mjetet shprehëse, një kërkim i pandërprerë në thesarin e madh të gjuhës popullore.

Sado të ndryshme të jenë krijimet e D. Agollit si gjini letrare, në tërë veprën e tij vihet re një koherencë ideore dhe artistike që spikat edhe në stilin e tij, në atë që shpreh personalitetin e një autori. Thënia e vjetër se «stili është vetë njeriu» i shkon për shtat këtë autori. Shkrimtar realist, me një prirje të dukshme lirike, me një zbulim poetik të të vërtetave të jetës, me ndërhyrje të këndshme të botës së tij poetike, me humor dhe me një sinqeritet e thjeshtësi të përhershme — këto

do të ishin disa tipare të portretit letrar të D. Agollit. Në krijimet e tij mendimet më të rëndësishme e më sublime thuhën thjesht, pa fraza dhe vijnë natyrshëm, pas një përshkrimi, një soditjeje, një detaji. Mjeshtëria e poetit është ndier gjithmonë në lirikën e shumta. Ku ka krijuar mënyrën e tij të dallueshme duke lëvruar llojet e ndryshme të tyre me tipare vetjake. Me kalimin e kohës, kjo mjeshtëri ka ardhur dukë u kristalizuar: këtë e dëshmojnë poemat e tij të gjata që kanë një ide tërësore dhe procedojnë sipas një ndërtimi të menduar, duke i lënë shteg gjithmonë frymëzimit të lirë e të natyrshëm. Kjo vihet re edhe në rrugën krijuese si romancier, ku kompozicioni sa vjen e zotërohet më mirë nga autori, në përdorimin e humorit dhe të satirës, ku narracioni i shtruar dhe i qetë gërshetohet me një ironi të mprehtë, me situata groteske, në kufirin e së pranueshmes së artit, dhe me një dialog të këndshëm.

D. Agolli, që ka lindur në Devoll, që ka kaluar atje fëmijërinë dhe ka marrë përshtypjet e para të fuqishme të jetës, gjatë gjithë veprimtarisë së tij si gazetar dhe si krijues ka mbetur kurdoherë pranë tokës, pranë Devollit, fshatarëve, punëtorëve e intelektualëve, në gjirin e «nënës» Shqipëri.

Ai filloi të shkruante duke qenë ende nxënës i shkollës së mesme, nga fundi i viteve 40 e fillimi i viteve 50. Botonte në organet letrare të asaj kohe: «Letrari i ri» e «Letërsia jonë». Këto ishin poezitë e para, ende të thjeshta, po me një freski prej fshatari që së shpejti do të kapte edhe motive nga qyteti, me një varg muzikor dhe gjuhë popullore. Vëllimin e tij të parë «Në rrugë dola». D. Agolli e botoi më 1958, pasi grumbulloi përvojë e kulturë. U duk kështu në fushën e poezisë sonë një poet i ri i ngrohtë, i drejtpërdrejtë, i natyrshëm dhe me një sens autokritik, si një veçori e shprehjes së botës së tij të brendshme.

Pastaj ai botoi me radhë vëllimet e tij poetike me vjersha e poema: «Hapat e mia në asfalt», «Shtigje malesh dhe trotuare», «Mesditë», përmbledhjen me poezi të zgjedhura, romanin «Komisari Memo», poemën «Nënë

Shqipëri», romanet «**Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo**» dhe «**Njeriu me top**», vëllimin poetik «**Fjala gdhend gurin**», si edhe krijime të tjera. D. Agolli ka dhënë kontribut edhe në fushën e tregimit, të dramës e komedisë, si p.sh. me komedinë «**Fytyra e dytë**» që është luajtur në skenat e teatrove tona. Veç këtyre ai ka shkruar një numër të madh reportazhesh e përshkrimesh, artikujsh, shënimesh kritike e mendime mbi letërsinë e artin tonë.

(D. Agolli bën pjesë në brezin e shkrimtarëve që hynë në letërsi nga fundi i viteve 50, pikërisht atëherë kur do të niste një fazë pjekurie më e madhe në letërsinë tonë, një realizëm më i ndjeshëm dhe një sintezë më e dukshme midis përmbajtjes dhe formës, e cila shprehej me një cilësi më të lartë. Ky ishte brezi i shkrimtarëve të rinj të asaj kohe ku bënë pjesë edhe I. Kadare, F. Arapi, D. Siliqi, A. Gjakova etj. Këta autorë do të pasonin krijimtarinë poetike të autorëve të brezit të Luftës Nacionalçlirimtare, si Sh. Musaraj, F. Gjata, Ll. Siliqi, A. Varfi, K. Jakova, A. Çaçi, L. Qafëzezi, e mjaft të tjerë, të cilët vazhdonin të kontribuonin në zhvillimin e pasurimin e letërsisë sonë. Brezi më i ri vinte, pasi kishte njohur mirë krijimtarinë e brezit të përparshëm.

Si e gjithë poezia jonë, edhe poezia e D. Agollit dhe e gjithë këtij brezi të më të rinjve (me individualitete të ndryshme) ngrihej mbi bazën e realitetit socialist, duke u mbështetur fort te mësimet e Partisë dhe të shokut Enver. Burimet letrare të saj kanë qenë ato të traditës sonë poetike të vjetër e më të re si edhe të traditës poetike përparimtare botërore.

Përvetësimi i këtyre traditave pozitive: tradita të poezisë sonë e të folklorit si edhe të poezisë revolucionare botërore, vërehet edhe në krijimtarinë e D. Agollit. tek i cili, që me vëllimet e para do të gjejmë tipare individuale që vijnë duke u theksuar e duke u bërë gjithmonë e më të qarta.

Krijimtaria e D. Agollit, ashtu si gjithë letërsia jonë, shquhet për militantizmin e vet, për pasqyrimin e revolucionit tonë, të etapave të ndryshme të zhvillimit të

tij. Veprat e këtij autori kanë pasur kurdoherë dhe kanë një prirje të dukshme drejt problemeve të mëdha dhe kyçe të historisë sonë kombëtare; ato vënë në qendër Luftën Nacionalçlirimtare, shndërrimet socialiste të jetës, formimin shoqëror dhe moral të njeriut, fshatin, qytetin, arat, malet. D. Agolli ndjek hap pas hapi në poezinë e tij ngjarjet e kohës; është një pasqyrues dhe këngëtar i apasionuar i realitetit tonë dhe i problemeve që ngre Partia nëpër dokumentet e saj. Angazhimi shoqëror dhe politik të ky autor, sikundër përgjithësisht në artin tonë socialist, vjen si diçka e natyrshme dhe e pandarë nga frymëzimi. Lidhja e vazhdueshme me jetën, me njerëzit, me punën dhe botën e tyre të brendshme, me ndodhitë kombëtare dhe ndërkombëtare — kjo është një bazë e domosdoshme që i jep gjallëri krijimtarisë së tij, e bën të afërme për lexuesit. Poezia e mbyllur në vetvete, e pakuptueshme, me figura të ngarkuara që bëhen qëllim në vetvete, poezia «aristokrate», e krijuar vetëm për një rreth të ngushtë njerëzish, është krejt e huaj për D. Agollin dhe përgjithësisht për arritjet më të mira në poezinë tonë. D. Agolli ka luajtur dhe luan rol të ndjeshëm për formimin e traditës sonë të re letrare, të shembullit prej nga kanë mësuar e do të mësojnë edhe autorët më të rinj. Qartësia e mendimit, prirja e dukshme shoqërore, puna këmbëngulëse mbi veprën e fjalën, të shikuarit e krijimtarisë si diçka shumë serioze dhe aspak e lehtë, e mbështetur mbi spontaneitetin janë tipare që karakterizojnë këtë autor.

*
* *
*

D. Agolli është një ndër poetët tanë që e ka vazhduar rrugën e poezisë. Edhe duke u marrë, herë pas here, me gjini të tjera, ai nuk ka hequr dorë prej saj, po ka ecur drejt poezisë, e ka kërkuar në jetë. Ai ka mbetur besnik i vetvetes në mënyrën e trajtimit të temave e njëkohësisht edhe është zhvilluar më tej, duke arritur në

përgjithësimet artistike më të mëdha. Në vitet 60, kur u afirmua si ndër poetët kryesorë dhe më pas, në vitet 70 e deri në ditët lona, ai ka bërë një udhë evoluimi në fushën e poezisë dhe ka mbajtur një peshë të rëndësishme me pasqyrimet e gjera dhe problemet kardinale që ka ngritur në poemat e në lirikat e tij. Çështja e atdheut, e së sotmes dhe e së kaluarës së tij, si një e tërë e pandarë, çështja e komunizmit, e figurës së komunistëve, e luftës kundër armiqve të djeshëm e të sotëm, kundër bllokadës imperialisto-revizioniste dhe e qëndresës së popullit, roli i masave dhe i udhëheqësit në revolucion — kanë qënë qendrore në krijimtarinë poetike të tij, sidomos në gjininë e poemës.

Objekti kryesor i poezive lirike, që ka shkruar D. Agolli qysh nga vëllimi «Në rrugë dola» e gjer te «Fjala gdhend gurin» është realiteti ynë i sotëm dhe Lufta Nacional-lirimtare. Nuk mungojnë edhe motive nga historia e afërme apo e largme e vendit tonë ose poezi të mbështetura në figura të njohura të kulturës botërore, prej të cilave autori nxjerr mësimet për të sotmen.

Le të shohim, së pari, disa vija karakteristike të lirikës së poetit, të motiveve kryesore që e kanë tërhequr atë dhe të mënyrës se si krijon, si i ndërton pamjet e figurat, si i ripërtërin poetikisht çastet nga jeta.

Në lirikën e tij D. Agolli, siç u përmend, e ka krijuar prej kohësh stilin e vet dhe ka disa tipare të dallueshme. Këto tipare janë veçori të tij dhe lidhen me vlerat e poezisë që ai krijon. Është e kuptueshme, siç ka thënë Majakovski, se na duhen sa më shumë poetë dhe të ndryshëm. Në dallimin e stileve qëndron edhe bukuria e një krijimtari. Poetët tanë të realizmit socialist i bashkojnë parimet e njëjta dhe nisen nga po ai realitet. Po ky është kaq i gjerë dhe këndshikimet origjinale janë kaq të shumta, sa ka mundësi për një pasuri të madhe motiveve dhe interpretimi.

Prirja e përgjithshme që ka shprehur e shpreh poezia e D. Agollit në krijimtarinë tonë poetike — prirje që është dukur në veprat më të mira të poetëve tanë qysh në fillim të letërsisë së re e që ka ardhur duke u

forcuar këto dy dekadat e fundit — ka të bëjë me interpretimin më realist të jetës, me një vëmendje më të madhe ndaj figurës së njeriut, i marrë ky jo vetëm në një drejtim dhe jo vetëm në anën sublime, po në tërësi dhe në një lidhje më të ngushtë të këndëve shoqërore e intime; ai ka të bëjë me një shkrirje më të plotë të unit lirik me realitetin, me pasurimin e mendimit, të konceptimit filozofik të jetës e të njeriut. Disa poetë e japin këtë mendim të përgjithësuar poetik në mënyra më konceptuale, metaforike, disa e japin përmes çastesh e figurash konkrete, si të thuash, në filozofinë e jetës.

Për të çarë këtë rrugë dhe për theksimin e kësaj prirjeje pozitive, D. Agolli ka bërë mjaft. Si pasojë, duke ecur në gjurmët më të mira të poezisë së krijuar që me luftën e këtej, u arrit që lirika të jetë më konkrete, të depërtojë më shumë në faktet dhe në shpirtin e njeriut, të zgjerojë më shumë sferën e temave, të subjekteve, të figurave njerëzore dhe të pasqyrimin poetik të realitetit.

◦ Afrimi me jetën, me njeriun, zbulimi i fakteve konkrete, i gjetjes së poezisë edhe në dukuri, e çaste që mund të ngjasin si të rëndomta, është një prirje e theksuar e poezisë së D. Agollit.

◦ Pasionin e tij drejt poezisë, të lindur ashtu vetvetiu në gjirin e jetës, përmes fushës, rrzëzë kodrës mbushur me dëllinja, ai e shfaq në vjershën e tij «Hyrja».

*Vargjet nëpër fusha i kam shkruar,
rrzëzë hije rrapesh apo shelgjesh,
shokëve të mi ua kam lexuar,
nën këmborë e blegërima delesh.*

Vjershat lirike të D. Agollit kanë tematikë e-kënde shikimi të ndryshme, por, nëse do të mundoheshim të gjenim disa fije lidhjeje në këtë mori vargjesh të të gjitha vëllimeve, mund të arrinim në disa përfundime. ◦ Së pari, janë vjershat me një përmbajtje politiko-shoqërore; të një natyre disi odike; ◦ së dyti, vjershat e shumta që kanë, pa dyshim, përmbajtje politiko-shoqërore po mendi-

min e japin përmes episodesh, çastesh, imazhesh dhe që do t'i quanim si një lirikë meditative mbi figurat njerëzore. Kur përfshihet edhe uni lirik i vetë poetit; së treti do të thoshim, vijnë një grup tjetër poezish me një prirje më të përgjithësuar morale-lirike të peizazhit dhe dashurisë, prej nga nxirren konkluzione për jetën, për marrëdhëniet midis njerëzve. Këtu mund të hynin edhe poezi të tipit që mbështeten mbi simbolin apo alegorinë. Edhe vargjet satirike-humoristike zënë një vend të ndjeshëm në poezinë e autorit.

‘Në tipin e parë hyjnë disa vjersha me një ndërtim më të përgjithshëm, me brendi politiko-shoqërore, ku mendimi është i drejtpërdrejtë. Këtë anë të patosit të tij poetik D. Agolli e ka shprehur dhe e shpreh më shumë në poemat e tij, ku tonet qytetare vijnë duke u shtuar e përforcuar dhe ku, krahas episodeve, zbulimit të vetvetes, të figurave konkrete, ka edhe parantezë meditimi poetik e shoqëror si edhe vrulle poetike në mbrojtje të idealeve, të njeriut punonjës, të tokës, të atdheut dhe lumturisë njerëzore. Vjersha të tilla si «Mendime para Shtëpisë së Partisë» etj., janë të arrira. Edhe në këto tipe vjershash, ku del qartë ideja e forcës së Partisë, e lidhjes së saj me njeriun e thjeshtë të popullit, ndihet mënyra vetjake e të shkruarit të D. Agollit, i cili i shmanget zakonisht në lirikë patetikës së drejtpërdrejtë dhe gjithçka e lidh me botën e tij (pra, me të njeriut të sotëm), me rrugën që ka bërë ai për të ardhur gjer këtu, para kësaj shtëpie të thjeshtë të popullit ku lindi Partia. Kjo ndihet edhe në motive të tjera politike.

Duke folur për rolin e shtypit të Partisë në Luftë, ai shkruan:

*Dhe hynte në oborre, hajate e oda të varfra,
dhe fliste menduar për tokën, bukën dhe hallet,
dhe larg fluturonin ëndrrat e kaltra,
dhe ngjiteshin sipër në malet.*

¶ Vjersha me përmbajtje shoqërore D. Agolli ka shkruar mjaft, duke qenë kurdoherë një luftëtar mili-

tantokundër ndikimeve të huaja borgjezo-revizioniste në jetë, në ndërgjegjen e njeriut si edhe në sjellje apo në dukjen e jashtme. Kjo temë rrihet te poema «Komunistët» si edhe në disa vjersha. Në anën tjetër, ai godet gjithçka mikroborgjeze, vanitoze, godet zakonet prapanikë, konservatore. Në vjersha të gjata si «Rebelimi i parë» bëhet fjalë për moralin e ulët të fesë dhe spekulimet e klerikëve në ndërgjegjen e njeriut të thjeshtë. Apo në një poemth si «Balada e ashpër» D. Agolli merr në mbrojtje dashurinë e vërtetë kundër shkesëve dhe paragjykimëve mbi dashurinë e familjen, duke zgjidhur drejt problemin e kontradiktave joantagoniste në gjirin e njerëzve tanë. Tema shoqërore trajtohen edhe në vjersha si «Mundja e Lekë Dukagjinit» e mjaft të tjera. Shpesh këto lloj poezish kanë edhe një notë humoristike apo satirike që i shkon për shtat kritikës me prirje shoqërore, ku përqeshet apo vihet në lojë fenomeni negativ. Në poezitë më të gjata, të tipit të poemës apo të tipit baladik, përdoret edhe narracioni, vizatohen figura njerëzish, duke i portretizuar me atë mundësi tipizimi që mund të japë poezia. Po në shumicën e rasteve, këto janë vjersha të llojit odik, pamfletist apo të përsiatjeve satirike.

Një vend më të madh, dhe pothuaj vendin kryesor, në lirikat e këtij poeti zënë vjershat e tipit të dytë, ku ndjenjat dhe mendimet e autorit zbulohen përmes figurave apo portreteve njerëzore. Kur rilexon lirikat e D. Agollit dhe, më një kënaqësi të veçantë, ndalesh e mendon për figurat e shumta të krijuara (përgjithësimet të njeriut të dalë nga gjiri i popullit) apo për persona të vërtetë të historisë së madhe dhe të thjeshtë të jetës sonë të sotme e të kaluar, të dalin përpara imazhe të shumta, një grup i madh portretesh poetike, me emër e pa emër që zënë vendet e tyre si në një kopsht të madh poetik.

• Jo më kot. D. Agolli një kapitull të vëllimit «Fjala gdhend gurin» e ka quajtur «Kënga e njeriut». Dhe ja se ç'është për kuptimin dhe vendin e njeriut në vjershën me këtë titull:

*E të gjitha i di: këngën, dhembjen, trishtimin,
e të gjitha përpiqem t'i di përherë e më shumë.
Plakemi, rinohe mi, luftë pa fund e mbarim,
një grimëz e tokës së madhe jam unë.*

* E kështu «Kënga e njeriut» mendoj se poetikisht mund të quhej tërë lirika e tij. Këngë për njeriun, të cilin ai e do aq shumë, është motivi kryesor i tërë krijimtarisë së tij poetike, që nga njeriu më i thjeshtë e deri tek figura e Enver Hoxhës.

Portretet e njerëzve të popullit që vizaton poeti në shumë vjersha të tij e në poema janë pasojë e mbresave të pashlyeshme nga jeta dhe i shërbejnë për të rrahur temën e heroizmit, të shndërrimeve shoqërore e morale, të vazhdimësisë së ideve të revolucionit, temën e punës dhe të dashurisë për tokën, lirinë, atdheun. Natyrisht, format poetike janë të shumta, po konkretësia poetike dhe figura e njeriut janë tipare thelbësore të poezisë realiste. Kështu, duke lexuar vëllimet poetike të D Agollit, që nga i pari e gjer te më i fundit, të mbeten të paharruara «Karmeni», vajza që donte të bëhej këngëtare dhe të lozte rolin e Karmenit në skenë; nëna «e bukura Hatixhe» më e bukura nga gjithë fshataret «E urta, e mira»), Leni («Leni, Leni»), vajza që u dogj nga armiqtë në Borovë dhe që, ndofta, po të jetonte, mund të «ishte bërë edhe gruaja e poetit» (shenjë afërsie emocionale kjo); xha Rexhepi («Elegji partizane») që u vra dhe la si kujtim çibukun; ai nuk duhej të vdiste, thotë poeti, se e prisnin arat, e priste puna.

*Ti s'duhej të vriteshe atje, xha Rexhep,
ti gjysmën e udhës s'e kishe bërë.
Ta gjetëm kutinë e çibukun në xhep,
t'i gjetëm opingat me gjak e me rërë.*

qTë mbeten në mend pesë kufitarët që ngrinë në kufi, roja për të mbrojtur atdheun, të gjithë si një e të pandarë me po ato ideale dhe secili me individualitetin e tij, me ëndrrat e tij: dikush me fletorkën e poezive e

tjetri me një instrument që priste dorën e tij për këngë të reja; të vijnë në mend «E paharruara» partizane që nëna e partizanit ëndërronte ta bënte nusen e djalit; gratë që gatuajnë bukë në dyzet shtëpi («Ai mot») për të pritur partizanët; pleqtë e Gjirokastrës që rrinë në hijen e rrapit dhe kujtojnë luftërat, Çerçizin apo Muço Matohitën me shokë; Maro Podgozhani me trimëritë e saj legjendare apo partizani Meke që fjeti në krevatin e perandorit, pasi fitoi luftën; babai i atij djali të ri («Babanë tënd e kisha shok») që i vdiq në duar shokut, të cilit i kujtohen gjithmonë «një gur, një zog, dy pisha» ku ai ra duke lënë pas të pashlyera gjurmët e revolucionit:

*Dhe kam kërkuar veç një gjë prej teje:
Mos shkelje kurrë nderin e babait;
gjersa të rrihte gjaku nëpër deje,
të mbaheshe si shoku im u mbajt!*

Këto dhe shumë portrete të tjera janë vizatuar bukur, me një frymëzim të natyrshëm ku spikasin marrëdhëniet e sinqerta të poetit me figurën që përshkruan, një dialektikë ndjenjash që lidh të sotmen me të kaluarën, njeriun me kujtimet e tij, me të afërmit, me gjurmët që ka lënë në ndërgjegjen e atyre që e njihnin dhe me patosin e humanizmin e vërtetë socialist që buron nga një çast, ndodhi apo detaj dhe që të mbetet përpara syve si i gdhendur. Ajo pak fabul, histori e formë baladike, gërshetuar me lirizmin me depërtimin psikologjik, me figurat stilistike, përbëjnë zakonisht mjetet kryesore shprehëse në këto lloj vjershash.

Lirika e D. Agollit është e pasur në fakte, vrojtime, në përtëritjen e çasteve dhe zbulimin e momenteve poetike që burojnë nga jeta. Siç është pohuar edhe herë të tjera, kur jemi ndalur në shikimin teorik të problemit, lirizmi i poezisë sonë, i poezisë së realizmit socialist në përgjithësi, i zgjeron caqet e unit poetik; heroi lirik ka një shtrirje më të madhe dhe lidhet me botën objektive. Por këtu mund të lindë pyetja se ç'e dallon pasqyri-

min lirik nga ai epik si dhe shqetësimi se mos fshihet kufiri midis tyre. Mënyrat e pasqyrimin, llojet dhe gjinitë evoluojnë, ndonjë formë shuhet duke ua lënë vendin të tjerave, po, në tërësi, gjersa mbeten shkaqet dhe rrethanat që i kanë përfutuar, ato jetojnë dhe ka një domosdoshmëri objektive që të lëvrohen. Kështu pra, lirizmi ka të bëjë me pasqyrimin dhe shprehjen e botës së brendshme të njeriut (natyrisht, të lidhur me mjedisin ku jeton), qoftë kjo e shfaqur subjektivisht, qoftë edhe duke hyrë në anët lirike të njeriut, gjë që jep shumë mundësi për komunikimin lirik të poetit me heroin që trajton (tipikë kjo për D. Agollin). Një shtrirje e tillë e lirizmit është mjaft e përhapur te ne, po megjithatë ka poetë lirikë, të cilët zbulojnë më shumë vetveten, si pjesëtarë të shoqërisë sonë, ose lëvrojnë një lirikë metaforike që ngrihet mbi idetë, mbi kontrastet dhe vegimet më të përgjithshme. Lirizmi i Dritëroit nuk është i njëtrajtshëm; zbulimin e botës së tij ai e përdor si një mjet të rëndësishëm e këtu qëndron edhe një nga meritat, se e bën lirikën vërtet lirikë dhe i shmanget ftohtësisë dhe shartimeve të panevojshme të formave; por është një lloj lirizmi, si të thuash, «objektiv», në të cilin, përmes filtrit të poetit, ndjenjave, mendimeve dhe përjetimeve të tij, kalon bota përreth me njerëzit, natyrën, shpendët, pemët, faktet, episodet ku zë fill frymëzimi. Subjekti herë bëhet objekt i zbulimit poetik, herë pasqyrë e botës materiale. Ky fenomen, natyrisht, nuk spikat vetëm te ky poet, ai buron nga jeta e parimet estetike të artit tonë. Por, duke marrë parasysh gjithmonë mënyrat individuale dhe parapëlqimet e njërit apo të tjetrit poet, në përgjithësi, do të thoshim se është pozitive prirja që vihet re e një objektivizmi të tillë më të madh të lirikës sonë në përgjithësi. Në anën tjetër, poezia e D. Agollit, si dhe ajo e disa poetëve të tjerë mund të vlejë si shembull edhe për depërtimin në ndjenjat, në përjetimet njerëzore, në gjetjen e poezisë edhe te gjërat e thjeshta, te faktet që mund të dukeshin të rëndomta, po që në të vërtetë formojnë jetën dhe poezinë e përditshme të njeriut.

Poezitë e një natyre meditative — filozofike — etike, poezitë e peizazhit (për aq sa mund të ndahen poezitë në grupime midis tyre, se mënyrat dhe problemet gërshetohen me njëra-tjetrën), zënë gjithashtu një vend të dukshëm në krijimtarinë poetike të D. Agollit. Nga vëllimet e para tek i fundit këto lloj vjershash janë zhvilluar më tej dhe mendimi i autorit bëhet më me peshë, duke mbetur gjithmonë i thjeshtë. Të tilla janë vjershat që flasin drejtpërdrejt për meditime lirike të poetit mbi jetën e tij («**Mund të mendojmë**»), mbi dashurinë, për gratë, shoqe të denja të jetës, për gëzimin që sjell lindja e fëmijës, ndërsa poeti ndodhej midis sharrëxhinjve në pyll («**Telegram**») apo për filozofinë e gjuetisë së detit që i bënte të buzëqeshnin poetët që nga kohët më të lashta, kur kalonin këndeje me një torbë lëkurë dhie në krah («**Duke udhëtuar anës detit**») e mbi motive të tjera.

Poezi të kësaj natyre janë edhe ato që marrin shkas nga një pamje në natyrë dhe shpie në meditime për vendin, për ndryshimet dhe përjetësinë e atdheut («**Patat e egra**»); ose për vazhdimësinë e gjeneratave («**Lejleku**»), vjershë ku flitet për lirinë që rritet dhe mban mbi vete brezat e lejlejkëve apo për bardhësinë e ëndrrave të njeriut që punon dhe, duke pushuar në arë, i duket sikur mbështillet nga një re e bardhë («**Peizazh me një re të bardhë**») dhe se do të zgjohet përsëri në gjirin e saj:

*Punova tërë ditën shumë,
Ja një re e bardhë mbi kodrinë,
të mbulohem me të e të bie në gjumë
këtu në bar në lëndinë....*

*E prapë të hap sytë ngadalë,
e prapë në punë...
Një re si jorgan i bardhë,
një ëndërr e bardhë mbi lumë...*

¶ Tema e luftës kundër vanitetit, madhështisë së rreme dhe bujës trajtohet edhe në vjershën «**Firdusi**», poet i

madh persian që pinte çaj veresie në një qoshe të çajhanesë, ndërsa të tjerë, zulmëmëdhenj, nuk e përfillnin fare dhe mburrëshin për veprat e tyre.

Parimet e veta estetike mbi të bukurën, mbi rëndësinë e artitj («Zgjimi i baladave» etj.), mbi vargjet që mund të jenë të rregullta, të lira, të shkurtra, të gjata mjafton që të sjellin përzënë e jetës, të vërtetën e saj etj.. ai i shpreh në disa vjersha si edhe në poemat e tij si «Komunistët» etj.

Poema është një gjini shumë e lëvruar nga D. Agolli. Motivët dhe problematika e poemave ka të bëjë me tërë krijimtarinë poetike të autorit. Ka tema që rimerren nga një vjershë, zgjerohen e thellohen. Është e natyrshme se brenda «botës poetike» të një autori, sikundër përgjithësisht brenda «botës artistike» të një krijuesi, do të gjenden tipare e profile të caktuara, të pëlqyera prej tij, që i japin edhe fizionominë edhe përmbajtjen krijimtarisë. Këto tipare janë të dallueshme në veprën e D. Agollit dhe lexuesi njihet, «miqësohet» me njerëzit, lidhet me episodet dhe meditimet që gjenden në të.

Në poema janë zhvilluar momente kryesore të kësaj krijimtarie poetike dhe autori në to shfaqet në mënyrë të plotë e të shumanshme, duke i trajtuar gjerësisht motivet e preferuara dhe duke arritur në rezultate të dukshme. Poemat më të rëndësishme të krijuara nga D. Agolli si «Devoll, Devoll», «Baballarët», «Komunistët», «Toka ime, kënga ime», «Nënë Shqipëri» dhe të tjera zënë një vend të dalluar në vargun e poemave të poezisë sonë të sotme. Ato zgjojnë emocione a mendime të shumta të lexuesit e janë ndër shembujt më të mirë në këtë gjini të rëndësishme poetike, për origjinalitetin e tyre, për gërshetimin e pamjeve konkrete të jetës me botën e brendshme të heroit lirik, për larminë e dukurive estetike që pasqyrohen në to dhe për gjuhën popullore e komunikuese.

Temat dhe problemet kryesore që kanë tërhequr vëmendjen e autorit lidhen me Luftën Nacionalçlirimtare, me ndryshimet në realitetin socialist, me dashurinë për

tokën dhe për nënën Shqipëri, me luftën kundër moralit të huaj patriarkal e mikroborgjez dhe me pohimin e idealeve të komunizmit. Siç u tha edhe në krye, poeti ndodhet kudo i pranishëm, si qytetar, si komunist, si njeri me ndjenjë. Ky hero lirik, duke pasur shumë gjëra të përbashkëta me të tjerët, me esencën e shqiptarit të sotëm komunist, të lidhur me tokën, me baltën, të edukuar nga Partia, gati për t'u ngritur në këmbë po të dojë interesi i atdheut ka edhe veçoritë e tij, shprehjen konkrete që e bën të papërsëritshëm. Kështu p.sh. ky është një fshatar që e ka pasur shtëpinë midis lajthishtave, që ka lëruar në arë, që ka bredhur midis fushave, ka ndier bukurinë e grunjërave, të mollëve e të pjeshkëve, ka jetuar me fshatarët e punëtorët, me sharrëxhinjtë me minatorët, ka dëgjuar gurgullimën e ujërave dhe ka ndier freskinë e pyjeve me ahe e me pisha; ka ndier frymëmarrjen e nënës Shqipëri.

Te poemat e D. Agollit, që nga më të hershmet e më të thjeshtat, si «**Këngë për babanë dhe për vete**» apo «**Poema e udhës**» gjer te më e zhvilluara e më kompleksja «**Nënë Shqipëri**» ndihet rritja, si në pasurimin e motiveve e të përmbajtjes, ashtu edhe të mjeteve artistike. Heroi i tyre është një njeri që do të udhëtojë nëpër vendin e tij, të shohë vise të reja, të njihet me njerëz, të marrë pjesë në gëzimet e hidhërimet e tyre, të kthehet prapë te njerëzit e dashur. Jeta në lëvizje, në larminë e saj, është ajo që e tërheq më shumë. Mendimi ka ardhur duke u thelluar në këto krijime dhe patosi duke gjetur shprehje më të plotë e më militante. Poemat e para kanë qenë më shumë të mbështetura mbi disa epizode, mbi përshlypje (gjithmonë konkrete) e Lirizmi shkrihej përmes një fabule, një ndodhie si te «**Baladë e re për komisarin**» etj. Dhe kjo është një mënyrë e këndshme poetike, që kurdoherë ruan vlerën e saj. Pastaj poema ka ecur në rrugën e përgjithësimeve lirike, të thellimit në botën e njeriut, me një monolog lirik të fuqishëm, me një spontaneitet të qartë si te «**Devoll, Devoll**», përmes personifikimeve dhe bashkëbisedimeve të ngrohta me tokën, si te «**Toka ime, kënga ime**», te

portretet kolektive që japin një tablo të plotë të tipareve të një gjenerate, si të «**Baballarët**» apo «**Komunistët**» ku ndihen edhe notat polemizuese që do të vazhdojnë edhe më vonë — e gjer te thellimi i këtyre veçorive dhe i një sinteze të dukshme të motiveve dhe mundësive poetike të autorit, te një patos qytetar i fuqishëm dhe përgjithësim i kohës sonë, i rrugës së Shqipërisë së sotme, me luftën që bën kundër armiqve e me gjithë historinë e saj.

Tipat e poemave, nga pikëpamja e ndërtimit, e llojit, brenda një uniteti stilistikor, kanë edhe disa dallime, të cilat varen nga materiali jetësor dhe nga qëllimi i autorit. Këta tipa mund të përmblihen, përgjithësisht, në llojin e poemës sintetike, me një prirje të theksuar drejt lirizmit e me kalimin drejt përmasave më të gjera epiko-lirike. «Poema tregimtare, brenda kërkesave të poezisë, janë «**Baladë e re për komisarin**», «**Rebelimi i parë**» dhe «**Baladë e ashpër**», njëra me themel nga lufta dhe dy të tjerat që rrahin probleme shoqërore e morale të luftës kundër zakoneve prapanike, për emancipimin e gruas, si edhe kundër mashtrimeve fetare të klerit që jetonte në kurriz të popullit, duke spekuluar mbi ndjenjat e njeriut të thjeshtë. Edhe në këto poema të tipit tregimtar, ndonëse rrëfimi përcakton strukturën e këtij krijimi, përsëri ai poetizohet. Rrëfimi, ndodhia u nënshtrohen mënyrës poetike, parantezave dhe kalimeve lirike apo satirike («**Rebelimi i parë**»). Qëndrimi emocional i autorit ndaj asaj që tregon bëhet i dukshëm dhe komunikues; pjesëmarrja shpirtërore në dhimbjen, urrejtjen apo dashurinë është shumë e qartë. Duke iu drejtuar komisarit të vrarë («**Baladë e re për komisarin**») autori thotë:

*Unë poeti në vargjet e mia,
sikur të të ngjaja një grimëz,
edhe i vdekur vargje me mija
të hidhja në luftë për komunizëm.
...Unë poeti do të doja të vdisja
si ti,*

*i madh,
i nderuar.*

Një tip tjetër poeme më sintetike se këto, është ai i poemave që ndërtohen mbi bazën e meditimeve, përshlypjeve të udhëtimit, apo kontrasteve, antitezave që mbështeten te mendimi përgjithësues si dhe në fakte të gjalla e detaje të gjetura. Të tilla janë «Poema e udhës», «Poema malore», «Dashuri dhe ferobeton» e ndonjë tjetër. Duke vënë «kamerën» në jetën plot dinamizëm, në ndryshimet e natyrës, të peizazhit, autori flet për zhvillimin e jetës sonë, për pjesëmarrjen e njeriut aktiv në këtë jetë, për vazhdimësinë e udhës që nis nga fëmijëria e pastaj hidhet në luftë; në ndërtimin e hekurudhës së rinisë e kudo ku e thërret atdheu.

Një vend të dukshëm nga pikëpamja tipologjike në krijimin e poemës së D. Agollit, zë poema që niset nga një portret i zgjeruar lirik («Devoll, Devoll»), ose që, siç u përmend, jep përfytyrimin poetik të një gjenerate, të prindërve që bënë luftën, mendimi i të cilëve zgjatet «nga kokrra e grurit, gjer te qeveria... nga lëmi i fshatit, gjer te gjithësia...» («Baballarët») apo të atyne që dolën nga gjiri i popullit, e udhëhoqën në luftë e në punë dhe qëndrojnë në krye të revolucionit kundër armiqve të çdo ngjyre («Komunistët»).

Poema si «Devoll, Devoll» apo «Komunistët» zënë një vend të dukshëm në krijimet poetike të D. Agollit dhe janë, bashkë me poemën «Nënë Shqipëri», që zë një vend të veçantë, ndër më të mirat në poemën tonë të realizmit socialist.

Portreti lirik, bota e brendshme e heroit të lidhur me tokën, me popullin, me gëzimet, me alarmet, të ashpër me armiqtë, po të dhimbshëm edhe për një zog, del qartë në poemën «Devoll, Devoll», e cila shquhet për frymëzimin e saj, për hovet e vetvetishme poetike që e dallojnë. Bukuria e kësaj poeme qëndron tek idetë që e përshkojnë, tek ai gëzim dhe ajo ngrohtësi që sjell me vete revolucionin, njeriu i dalë prej tij dhe te pasqyrimi i natyrës komplekse të ndjenjave, të njeriut të shoqërisë sonë, bota shpirtërore e të cilit vjen duke u pasuruar.

*Unë i dua zogjtë edhe drutë,
barin që burimi e spërkat,
unë e dua grurin,
kur ul kryet;
kur në duar i «thërrmoj kallinjtë»,
si të kem thërrmuar tërë yjet,
sikur të kem tokur perënditë...*

Poema «**Komunistët**» është një himn drejtuar figurës së komunistëve, po një himn pa emfazë e retorikë. Autori e shpie mendimin në disa shtigje të caktuara dhe mundohet të gjejë burimin se nga dalin komunistët, ç'i pruri në jetë dhe si u gatuan, ç'ideal kanë në gjë dhe përse luftojnë. Për të ndërtuar poemën autori, siç bën shpesh, merr si strumbullar kompozicional heroin lirik, i cili hyn midis këtyre njerëzve kërkon kuptimin e jetës dhe të luftës. Poeti kthehet gjithmonë tek ata dhe kërkon të zbulojë botën e tyre dhe të pasqyrojë veprimin. Ai nuk është i kënaqur me vetveten, sepse sheh që vepra e tyre është shumë më e madhe nga ç'e ka paraqitur ai. Kjo është një dëshirë e natyrshme, një ndjenjë fisnike që të shpie kurdoherë drejt njohjes dhe që lidhet me të vërtetën se jeta, njeriu përbëjnë një fushë të gjerë e të shumanshme së cilës gjithmonë arti duhet të përpiqet t'i afrohet.

Autori në këtë poemë pohon mendimin se jeta jonë, varfëria, lufta i nxori revolucionarët nga gjiri i popullit. Nuk ishin filozofë me mjekër, po në luftë e sipër, në përpjekje, e mësuan marksizmin. Në poemë polemizohet me ata që rrinin kafeneve ose bridhnin nëpër Evropë duke u hequr si të ditur, ndërsa populli vuante.

Poema shtron edhe një problem tjetër të rëndësishëm, të cilin e zgjidh me mjetet e poezisë: si lindën te ne udhëheqësit e revolucionit dhe si u krijua raporti i tyre i drejtë me masat. Në poemë, përmes antitezash në plan polemizues dhe afirmues, spikat figura e udhëheqësit të revolucionit tonë, shokut Enver Hoxha, e cila jepet me tiparet e veta esenciale, ashtu siç e njeh populli, siç janë drejtuesit e vërtetë që nxjerr revolucionin.

Për Enver Hoxhën
 këngë
 thur
 tërë
 jetën,
 Se nëna ime
 bukë i dha me dhallë;
 Me të
 në dhomën pa tavan
 ne fjetëm,
 Na puthi ne
 fëmijët
 mu në ballë.

Ashtu si edhe në disa poema të tjera, ku ka një shikim të gjerë të kohës së sotme, të gërshetuar me historinë, me klasat dhe brezin e ri, edhe te «Komunistët» rrihet problemi i të rinjve, të cilët «komunizmi i lindi nëpër zjarri» dhe ecin përpara duke çarë malet me stafetën e revolucionit në dorë. Autori këtu shtron edhe problemin etik të edukimit të rinisë, të formimit të saj me idealet e revolucionit, kundër shkarjave moderniste, duke theksuar se puna është ajo që e mban jetën dhe jo pozat dhe modat. Në këtë poemë, sikundër edhe në plot raste të tjera, autori shtron drejt probleme estetike të larmisë së formave, të vargjeve në poezi, mjafton që këto të kenë «gazin e brengën e popullit të madh e zemërmirë».

«Nënë Shqipëri», siç është thënë disa herë, përbën një nga shfaqjet e shquara të poezisë sonë të realizmit socialist, ku ndihet edhe tradita naimiane e ku motivet lindin e pasurohen nga koha jonë, nga historia, lufta dhe puna e Shqipërisë socialiste në periudhat e ndeshjeve klasore, të luftës kundër bllokadës borgjezo-revizioniste, për të mbrojtur çdo gjë të shtrenjtë që krijoi populli nën udhëheqjen e Partisë.

Kjo poemë u mendua në fillim si një poezi odike, thotë autori, pastaj mori përpjesëtime më të gjera. Ajo përfshin brenda shumë aspekte të jetës, historinë e zhvi-

llimit të Shqipërisë socialiste me të kaluarën e vet. me luftën, njerëzit e shquar, dhe imazhin kolektiv të njerëzve të thjeshtë që krijojnë çdo ditë historinë. Poema është një sintezë e rrugës që ka bërë vendi ynë në etapat e ndryshme të jetës së vet. Në qendër është realiteti i sotëm, po ky lidhet me fije të shumta me të shkuarën. «Nënë Shqipëri» ka një ndërtim polifonik; është ngritur mbi disa planë; bashkëbisedime të përfytyruara me nënën Shqipëri, pamje të jetës, mendime mbi klasën punëtore e fshatarësinë, mbi rininë, polemikë me armiqtë, meditime lirike, episode dhe figura të njohura të historisë sonë. Dhe përsëri motivi i atdheut, i nënës Shqipëri, i birit, i bijve të saj që ulen e vënë kokën në prehër për t'u çlodhur pak nga punët e rënda.

Kjo poemë ngrihet mbi një arkitekturë të menduar. Ajo fillon me dëshirat e poetit për ta «nënshtruar» fjalën, poezinë, vijon me vizatimin e portretit të nënës Shqipëri, me bukurinë e saj mahnitëse, me livadhe e male, me mëngjese e muzgje të magjishme, me poetizimin e njeriut tonë krijues të jetës dhe të lumturisë; kalon më tej me përshkrimin e maleve duke evokuar historinë që nga Skënderbeu te Avni Rustemi dhe pastaj hidhet në Luftën Nacionalçlirimtare, trajton temën e Partisë, të lindjes dhe të zhvillimit të saj gjithmonë me rrënjët në popull, në strehëzën nga e cila nuk duhet larguar kurrë; jep një pasqyrë të ndryshimeve të pamjes së atdheut dhe herë pas here satirizon armikun, i cili, si në përrallë, bëri tak-tak në derë dhe fshehu këmbën e ujkut për të na mashtruar: kalon në një himnizim të «nënës» dhe tregon lidhjet e thella të brendshme të birit të saj me të duke dhënë jetën tonë në një dinamikë të përhershme.

E gjithë kjo është derdhur në një varg të zgjedhur, me një mënyrë të natyrshme të shprehjes së patosit. Ndërtimi i poemës nënkupton lirinë e motiveve dhe të kalimeve poetike; hovet e vëtvetishme të frymëzimit ndihen në gjithë poemën. Fjala është zgjedhur me kujdes dhe vërehet puna e madhe mbi vargun, mbi imazhet që autori do të krijojë:

*Përpjekin krahët pëllumbat e turtujt
dhe nisen nga strehët drejt reve.
Kur çel yll i mbrëmjes, kur zbresin muzgjet,
sërishmi kthehen nga qielli foleve.
E prapë ajo këngë e dashur, e mirë,
zefir, fërfërimë, shtrëngatë, puhi,
vjen erë limoni, borige, rrëshirë,
nënë Shqipëri, nënë Shqipëri!*

Përfytyrimet, siç shihet edhe në këto vargje, janë të pasura, konkrete; detajet në vetvete, pa qenë metaforike (kjo ka të bëjë me stilin e tij) kthehen në imazhe që të zgjojnë ndjenjën dhe ta bëjnë më të afërm objektin që përshkruhet.

Vargjet qytetare, të përshkuara nga një patos i dukshëm, hyjnë midis pamjeve e përshkrimeve dhe e gjallërojnë poezinë me mendim, pa u larguar nga vrojtimet konkrete:

Na shihni?

*Ne u lidhëm me Partinë e komunistëve përjetë,
ne që bënim potkonj, drapinj, e plorë.
ne që mbështillnim bukën e misrit në gazetë.*

Nga tablotë dhe meditimet më të përgjithshme poeti kalon në përfytyrime konkrete si mbi figurën e fshatarit në gjirin e natyrës, te mendimet mbi përjetësinë e tokës dhe të poezisë, trajton temën aktuale poetike e kthehet te heroi lirik i vënë përballë Shqipërisë nënë. Jeta ecën, udha zgjatet dhe frymëzimi nuk mbaron:

*Dhe rruga thërret në male e lugje,
dhe të psherëtin: «Njatjeta, vëllezër!
Vëllezër, që çani lëndinat me plugje,
vëllezër që shpini fëmijët në çerdhe!»
Trokasin rrokjet, trokasin vargjet:
trokasin hapat në Jug e Veri,
trokasin pikat në strehët e pragjet:
Nënë Shqipëri! Nënë Shqipëri!*

E një mënyre të tillë sintetike, me momente politike të përgjithësuara, me parantezë lirike dhe ton polemizues është edhe poema «Nëntoriada» (ku autori zbulon prirjen e tij të patosit qytetar lidhur me ngjarjet e ditës.

Rruga poetikë e D. Agollit shënon një ngjitje dhe shpreh përparimin e përgjithshëm të poezisë sonë. Kjo rrugë ka qenë plot kërkime dhe, gjatë saj, autori ka pasuruar tematikën, fushën e problemeve dhe mjetet e artit. Në udhën e tij të përparimit, autori është larguar nga ndonjë element thjeshtësimi apo prozaizmi dhe ka ardhur duke formuar mendimin e duke u thelluar në mënyrën e vet liriko-filozofike, ka kaluar nga më e thjeshta te më kompleksja. Në poetikën e tij të vargut një vend të dukshëm zë epiteti, si një element artistik sa i lashtë, aq edhe i ri, krahasimi e, hera-herës, edhe metafora apo simboli etj. Duke u zhvilluar, ai i qëndron besnik mënyrës së vet. Ai pasuron këtë lloj poetike pa pasur ndonjë prirje të veçantë drejt tropeve, duke përforcuar kështu edhe mendimin e njohur se poezia mund të krijohet fare bukur me mënyrat më të ndryshme, se as rendja pas figurave, po as edhe një poezi jashtë konceptimit të figurshëm, nuk e ndihmojnë poezinë e vërtetë, për krijimin e së cilës D. Agolli, si edhe poetët tanë të tjerë më të mirë, ka dhënë e po jep kontribut të shquar.

*
* * *

Proza artistike dhe publicistika letrare zë gjithashtu një vend të rëndësishëm në krijimtarinë e D. Agollit. Duke shprehur prirjet realiste të prozës sonë në vitet 60 e 70, në gjurmët e arritjeve më të mira të mëparshme, proza e D. Agollit, së bashku me atë të J. Xoxes, I. Kadaresë, Sh. Musarajt, S. Spasses, F. Gjatës, Dh. Xhuvanit, T. Laços, S. Godos, e të tjerëve pasuroi gjininë e romanit, kontribuoi në pasqyrimin më të plotë e

me vërtetësi të jetës, sidomos të Luftës Nacionalçlirimtare, në skalitjen e karaktereve dhe në pasurimin e stileve dhe të gjuhës artistike.

Duke mbetur konsekuent në stilin dhe fushën e vet të frymëzimit, D. Agolli në prozë, zakonisht, nuk shpie mekanikisht mjetet shprehëse të poezisë, por mërr prej tyre çfarë i duket më e përshtatshme dhe u nënshtrohet kërkesave dhe poetikës së prozës, natyrisht brenda stilit dhe individualitetit të tij krijues. Konceptimi poetik ndihet hera-herës në thurjen e romanit «**Komisari Memo**» apo në ndonjë tregim, si edhe në përshkrime, por këtu ai zhvillohet si prozator duke trajtuar gjerësisht subjektin dhe fabulën, karakteret, të cilat, më tepër sesa me parahistorinë e tyre, dalin në marrëdhëniet e krijuara në vepër me anë të dialogut, të çasteve liriko-psikologjike dhe sidomos të veprimit, situatave dramatike, skenave me humor e, ndonjëherë edhe të monologut të brendshëm.

Pasi e mprehu penën në poezi e në shkrime publicistike të shumta, si grumbulloi mjaft përvojë jetësore, D. Agolli shkroi romanin «**Komisari Memo**» (1970), i cili në fillim qe menduar si një novelë, por më vonë mori përpjesëtime më të gjera. Ky roman përfshin periudhën e luftës me armiqtë fashistë e ballistë. Përmes skenave të qytetit, ku strehohet Memoja, përmes episodesh, gjatë të cilave bëhet ndeshja me armiqtë, edukohen politikisht e moralisht njerëzit dhe arrihet në zgjimin dhe formimin e ndëngjegjes revolucionare të tyre. Në një shtrat të gjerë të luftës politike, romani ka shtruar si detyrë problemin e edukimit politik e moral të shtresave të ndryshme, luftën kundër lëkundjeve mikroborgjeze si edhe mbeturinave të vjetra patriarkale apo të bajraktarizmit, të shfaqjeve të anarkizmit që vjen si pasojë e ndjenjës individualiste dhe e shfaqjeve mikroborgjeze të fshatarësisë. Romani ka, si të thuash, dy pjesë të mëdha: njëra në qytet dhe tjetra në mal. E dyta është më e rëndësishme, më dinamike dhe më përcaktuese për formimin e karaktereve, por edhe në luftën ilegale të qytetit shtrohej po e njëjta detyrë — vazhdi-

mi i luftës kundër armikut dhe edukimi i njeriut që nuk e përqafton dot menjëherë revolucionin (si Kristo Borova) apo i fëmijëve të tij, Andresë dhe Almës, të cilët marrin më shpejt anën e luftës dhe do t'i përkasin me gjithë shpirt asaj. Autori tregon, përmes disa rastesh dhe figurash, se si nuk ka qenë e lehtë të formohet shpirtërisht njeriu, se përveç problemit të madh politik — me popullin apo me armikun — dilnin edhe probleme të tjera shoqërore e morale, të cilat revolucionin do të fillonte t'i zgjidhte, duke i hapur udhën luftës së mëvonshme për edukimin e gjithanshëm komunist të njeriut.

Lufta për të futur në shpirtin e njerëzve, të fshatarëve si komandanti Rrapo Tabani e të tjerë, normat morale të revolucionit, të qëndrimit proletar, të një disiplinë të re, të vërtetë në radhët partizane, për të ngritur frymën e kolektivitetit kundër shfaqjeve të individualizmit — kjo luftë zë një vend të rëndësishëm në romanin «Komisari Memo». Personazhet janë dhënë me thellësi dhe krijojnë para lexuesit një linjë të plotë e të qartë. Memo Kovaçi është disi i njëtrajtshëm si figurë, por në tërësi i realizuar mirë, me botën e tij, me një vendosmëri revolucionare në çastet përcaktuese të ndeshjeve me armikun. Ai bën punë të madhe për edukimin e njerëzve, e shokëve të batalionit; është këmbëngulës për të vendosur normat e emancipimit që sjell me vete revolucionin, për futjen e vajzave në batalion (në kundërshtim me Rrapon që nuk donte) dhe për luftën kundër analfabetizmit. Prova më e madhe ishte përpjekja me armikun dhe kjo i bashkon më shumë se çdo gjë tjetër Memon me Rrapon. Figura e Memos jepet në evoluim, po më shumë zbulohet në situatat më delikate dhe më të mprehta si edhe në anën e tij intime, me ndjenjat e para të druajtura të dashurisë për Almën.

Figura e Rrapo Tabanit është ndër më të gjallat dhe më të realizuarat e prozës sonë: trim, i thjeshtë në shpirt, po me huqe, me mbeturina të botës së vjetër. Ai jepet në zhvillim e sipër dhe kjo gjë duket e natyr-

shme dhe e besueshme; gjuha e individualizuar dhe plot ngjyra i jep gjallëri figurës, e cila del e plotë para lexuesit. Personazhet e tjera të partizanëve, të fshatarëve dhe qytetarëve skaliten mirë nga autori, i cili tregon me këtë roman aftësi të paraqitjes lakonike të tipave dhe të një narracioni të rrjedhshëm e të natyreshëm. Figurat antagoniste si Sali Protopapa jepen disi me ngjyra të forta, groteske, me qëllim që të dalë më qartë natyra barbare e armikut dhe egërsia e tij në momentet e humbjes.

Me romanin «**Komisari Memo**» autori hodhi një hap të mëtejshëm në krijimtarinë e tij dhe pati zhvillim në pasqyrimin e gjerë epik të realitetit dhe në krijimin e tipave me ngjyrë kombëtare, duke ecur në rrugën e atyre portretizimeve poetike, të përdorura prej tij në përmasat e poezisë. Narracioni epik është i gërshtuar me nota lirike dhe me humor popullor, që del më shumë përmes dialogut, gjuhës plot ngjyra fshatare. Thurja e romanit, me motivin e bustit që shpien në fshatin e Memo Kovaçit, është poetike dhe origjinale në prozën tonë. Ajo ndihmon për të poetizuar figurën e Memos dhe për të treguar se e djeshmja dhe e sotmja janë të lidhura në shpirtin e njerëzve dhe se populli ynë ruan për të rënët ndjenjat më të thella.

Romani i dytë për Luftën i D. Agollit «**Njeriu me top**» (1975) dëshmon për vazhdimësinë e mënyrës së krijimit dhe të stilit të autorit, për realizmin e tij, për rikrijimin e ambienteve plot ngjyrë dhe të tipave me individualitet të theksuar. Freskia e materialit jetësor, e thurjes së veprës, e problemit që do të zgjidhë dhe, së bashku me këto, mënyra origjinale e kapjes së subjektit, e bëjnë romanin më vlera ideoartistike dhe tërheqës në të lexuar. Kjo vepër, nga përmasat dhe problematika, nuk është më e rëndësishme se «**Komisari Memo**», ku përballohet një periudhë dhe probleme më të gjera, por është e arrirë për qëllimin që ka; ngjarjet vijnë të ngjashura, romani ka ritëm; episodet, ngjarjet, detajet i nënshtrohen një qëllimi kryesor. Në këtë

vepër ndihet përparimi i autorit në punë të mjeshtërisë, të ndërtimit kompozicional.

Problemi që shtron për zgjidhje D. Agolli në këtë vepër nuk është i ri dhe as i patrajtuar. Lufta Nacionalçlirimtare, së bashku me detyrën themelore të çlirimit nga pushtuesit dhe tradhtarët, vuri përpara edhe probleme të shndërrimeve morale, të luftës kundër zakonit të egër prapanik të hakmarrjes, që e përçante dhe e pengonte popullin të ngrihej në luftë. Ky zakon i vjetër feudal nuk mund të jetonte më normat e reja të marrëdhënieve shoqërore dhe me idenë e vëllazërimit të popullit në luftë kundër fashizmit. Problemi është i rrahur në letërsi, poema e drama, por, kur trajtohet mirë dhe arrihet në përgjithësim, çdo autor ka mundësi të japë kontributin e vet dhe tema të mos duket e konsumuar. Autori ka ditur të lidhë problemin e madh të luftës me brengën e një fshatari, i cili ka shumë «arsye» shoqërore dhe vetjake të mos dalë dot aq lehtë nga qorrsokaku i zakonit të gjakmarrjes. Vërtetësia, dialogu, natyrshmëria e të treguarit, kompozicioni i harmonishëm i veprës e bëjnë atë të përçojë më mirë idenë. Romani ka një gjë tjetër të veçantë: Mato Gruda zbulon një top gjerman, të mbetur pas kapitullimit të Italisë; e merr atë dhe e fsheh për të goditur hasmin e tij, plakun Mere, shtëpinë e Fizëve. Politikisht Mato Gruda është i tëri me luftën, me Partinë, po në qëndrimet e tij shoqërore-morale ka mbeturina të ndjeshme. Procesi i luftës, ngjarjet që rjedhin në sy të tij, vrasja nga armiqtë e shokut të ngushtë, komunistit Murat Shtaga, ngjarjet pas shtënies me top në shtëpinë e Fizëve (një goditje e pasuksesshme), ku del qartë se çdo zhvendosje e vëmendjes nga Lufta sillte dëm — këto përcaktojnë edhe kthesën e Mato Grudës, i cili, më në fund, e drejton grykën e topit kundër nazistëve gjermanë dhe krisma e topit të tij bashkohet me breshërinë partizane.

Tërë marrëdhëniet e Mato Grudës me familjen, me të shoqen, një grua e mençur dhe me ndjenja delikate, me hallën, që e shtyn në gjakmarrje dhe nuk del dot nga këto paragjykime, me të birin, i cili i zë vendin

pranë topit, me ushtarin italian që punon në shtëpi të tij pas kapitullimit dhe më pas del partizan etj., janë dhënë me realizëm e me ngrohtësi. Invencionit i autorit në këtë vepër (topi i fshehur dhe peripecitë me të) është një kyç artistik për ta dhënë idenë dhe këtë përmbajtje në një mënyrë të re dhe të këndshme, përmes një fakti real që kthehet edhe në një simbol jetësor. Në vepër del ndikimi i luftës edhe në një ambient të tilla si në familjen e Fizëve, ku fillojnë të kthjellohen e të kërkojnë shpëtim nga kthetrat e plakut Mere, një nga një më të rinjtë e pastaj edhe më të rriturit. Nëpërmjet situatave dramatike, duke vënë nderin mbi gjithçka, ata vendosin në çastet më përcaktuese të marrin anën e revolucionit.

Përveç temës së luftës, të trajtuar në këto dy romane dhe në disa tregime. D. Agolli ka treguar vëmendje edhe për probleme morale dhe shoqërore të ditëve tona. Edhe në satirën e tij, në poezi, prozë apo në komedinë «Fytyra e dytë» ai i trajton këto probleme duke zbuluar rrënjët e burokratizmit, të vanitetit, duke atakuar servilët apo hipokritët. Satira e tij është e goditur, e pangarkuar me figura; ai përdor shpesh ironinë dhe i vendos ngjarjet apo tipat në situata komike të jetës së përditshme, që marrin shkas nga një ndodhi e thjeshtë, nga një gjest, p.sh. nga mania për t'u dukur, për të qenë i pari në çdo gjë, edhe kur nuk e meriton, për të sjellë «progres» me mënyra naive dhe qesharake. duke humbur taktin dhe ndjenjën realiste të gjërave.

Vepra më e bukur satirike e D. Agollit dhe një ndër romanet më të goditura të këtij lloji është «Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo» (1973).

Ky është një roman që ngrihet kundër madhështisë së rreme e vanitetit dhe tregon, përmes shumë situatash, qëndrimesh të «heroit», sentencash e monologësh se sa qesharakë dhe të dëmshëm janë njerëz si Zyloja, që jetojnë të mbështjellë në një burokraci të përditshme dhe nuk shohin gjendjen reale, nuk kuptojnë ç'mendon në të vërtetë shoqëria për ta. Të dy personazhet që rrinë krah për krah, Zyloja dhe ndihmësi i tij, Demka, ka-

lojnë nëpër një varg episodesh dhe, si tipa letrarë, vlejné për të zbuluar njëri-tjetrin. Demka, njeri i zgjuar dhe me aftësi, e kupton gjithçka dhe e njeh «të zotin» (binom i njohur dhe i preferuar në prozën satirike ky i të zotit dhe i një pasuesi!), por mbetet në hijen e tij dhe i nënshtrohet. Ai thotë fjalë të mençura, kupton thelbin komik të Zylos si edhe ndonjë anë të mirë që ka ai.

Zyloja si tip, është një dukuri negative që është pëjll burokratizmi, i cili të ne luftohet në çdo shfaqje të tij. Brenda stilit të veprës del qartë përqeshja e shoqërisë me këtë tip, si edhe ana tjetër, elementët e veçantë që i mbajnë iso e i venë pas avazit, tipa servilësh e lajkatarësh.

«**Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo**» me tërë episodet dhe situatat ka në qendër kurdoherë figurën qëndrore të Zylos, që demaskohet para syve tanë hap pas hapi. Zbulimi i tij nëpër situata, qëndrimi i Demkës, i Aranitit të ngrysur e të vrazhdë, po të drejtë dhe sidomos, i kolektivit të fshatarëve etj., që qash e tallet me marrëzitë e Zylos — këto hedhin dritë në karakterin e tij dhe japin të qartë mendimin e autorit, sipas të cilit për shoqërinë tonë Zyloja është një fenomen, në thelb i huaj e negativ, që satirizohet. Ndjenja e shëndoshë e humorit popullor, e optimizmit, e gazit të çiltër është përshtojnë këtë roman.

Më 1978 D. Agolli botoi në revistën «Nëntori» romanin «**Trëndafili në gotë**». Ky është një roman shoqëror me një prirje të dukshme nga lirizmi, i cili është i gërshetuar dhe me elementë dramatikë. Autori shtron problemin e rolit aktiv të shkrimtarit në gjirin e shoqërisë, të karakterit luftarak, që duhet të ketë ai në çdo rrethanë.

Ndonëse vihen re disa mungesa në skalitjen e personazhit kryesor, Minait, e të ndonjë personazhi tjetër, bota e tij del qartë e me mjaft forcë shprehëse. Mospajtimi me të keqen, zbulimi i së vërtetës shoqërore, thjeshtësia dhe pastërtia shpirtërore — janë tipare të rrugës së tij. Romani i kushton vëmendje psikologjise

së heroit e botës së pasur të ndjenjave. Bukur dhe me vërtetësi ai jep pasionin e një dashurie të pastër dhe të vetvetishme që i shkon për shtat natyrës dhe karakterit të Minait.

Romani shquhet përthurje të bukur, për stil tërheqës dhe poetik.

Romanet e D. Agollit në ndërtimin e tyre ndjekin zakonisht rrugën e subjektit me një hero qendror, me një protagonist dhe ngjarjet vijnë e thuren rreth tij. Kjo është një mënyrë mjaft e përdorur në romanin tradicional si edhe në romanin realist bashkëkohor. Por novatorizmi i përmbajtjes, i idesë dhe i jetës që pasqyrohet, sjell edhe një novatorizëm të formës. Ky shprehet, së pari, në gërshetimin e skenave të veçanta me skena nga jeta popullore, në patosin lirik të vepërës, në romantikën revolucionare që përshkon realizmin dhe në largimin nga mënyra (ndonjëherë edhe tani e shfrytëzuar) e ndërtimit të romanit mbi një hero qendror.

Ideja qendrore se masat, të drejtuara nga Partia, bëjnë historinë dhe revolucionin transformon shpirtërisht njerëzit, hedhin dritë në vepër e lozin rol edhe në stil e në ndërtimin e saj.

D. Agolli ka lëvruar herë pas here edhe gjininë e tregimit. Në më të mirat prej tyre, ashtu si edhe në romane, ndihet vërtetësia e fakteve, realizmi, ndonjëherë i vrazhdë, lirizmi e humori dhe një mënyrë e natyrshme dhe e rrjedhshme në të treguar. Tema e aktualitetit dhe e Luftës janë ato që trajton shkrimtari në këtë gjini. Tregime të gjata si «Njeriu i mirë», «Apasionata» etj., rrahin probleme shoqërore, etikomorale të kohës sonë. Te «Njeriu i mirë» bëhet fjalë për një intelektual të ri, Telon, që do të shkojë në bazë për të punuar. Ai ka interesat e tij në jetë, i pëlqen Tirana, dashuron një vajzë, po këto nuk e pengojnë që të kryejë detyrën, të cilën ai e bën me bindje e pasion. Tregimi nuk ka emfazë apo eufori, nuk ka asnjë notë artificiale. Po të jesh i ndershëm, duhet të bësh punën atje ku je i nevojshëm, ku e kërkon edhe zanati. Përballë tij vihet një nëpunës, Kiço Pela, karrierist, nje-

ri që jeton në një botë të vogël mikroborgjeze. Vajza që e do Telon, pakëz naive dhe e papërvojë, afrohet me të shpirtërisht dhe e gjen rrugën e drejtë në jetë.

Tregimi tjetër «**Apasionata**» ngrihet kundër vanitetit dhe mendjelehtësisë së ndonjë prindi që mundohet ta bëjë me pahir artist, muzikant të birin, vetëm për të ushqyer disa iluzione të rreme. Por i riu, student në konservator, ndonëse i pëlqen muzika, e kupton që nuk ka talent dhe kërkon të gjejë vendin e tij në jetë. Sinqeriteti i tij dhe ndjenja realiste të bëjnë për vete. Pengesa që lind në dashuri (për shkallë të babait të djalit) kapërcehet si pasojë e faktorëve moralë që vepron në ndërgjegjen e prindërve. I ati i djalit dhe i vajzës takohen pas shumë kohësh: ata kishin qenë shoqëruar. Një koincidençë disi e papritur, por letërsia mund të pranojë edhe të tilla «truke» (në thelb të mundshme) për të theksuar një mendim, për të mbrojtur një moral.

Tregime të tjera mjaft të mira të këtij autori, janë edhe: «**Lamtumirë, kapedani im**», «**Një i tretë**», tregimet humoristike e satirike si «**Shuarja e humorit**», «**Portreti i njeriut të madh**» etj.

Një vend të dukshëm në krijimtarinë letrare dhe gazetareske të D. Agollit zë edhe publicistika e tij, reportazhet, përshkrimet e mbresat, shënimet e udhëtimit si edhe fejtonet e pamfletet, artikujt kritikë mbi probleme të letërsisë e artit. Për një tyre shpesh kanë lindur edhe motivet e vjershave, poemave, apo edhe romaneve. Si gazetar D. Agolli është një vrojtues i mirë i fakteve, ai ka pohuar anët pozitive të jetës, ka krijuar figura të gjalla njerëzish të thjeshtë dhe ka kritikuar fenomenet negative. Ai ka ngritur probleme të mprehta për jetën kulturore e shoqërore. Në shkrimet e tij publicistike njeriu ka qenë kurdoherë në qendër të vëmendjes. Edhe natyra zë vend në të duke hedhur ngjyrimë lirike mbi heronjtë dhe episodet. Faktet janë në boshtin e shkrimeve dhe ato u japin përmbajtje e gjallëri përshkrimeve, përmes një mendimi të qartë.

Shndërrimet në jetën e sotme, rendja pas gjurmëve të Luftës, pasqyrimi i njerëzve të popullit, të dësh-

morëve, të bujqve e punëtorëve, përshkrimi i peizazhit, i ngjyrave të shënuara etj., kanë qenë objekt vëzhgimesh në publicistikën e gjerë të D. Agollit. Shkrime të kësaj natyre si «**Buka dhe drita**», «**Poema e një lumi dhe e një lugine**», «**Djemtë e xha Jahos**», «**Nënë Pashakoja**», «**Anës kurorës së Lurës**», e shumë të tjera lexohen me ëndje dhe lënë gjurmë në ndërgjegjen e lexuesit.

Lufta dhe puna, edukimi revolucionar i brezit të ri, mbrojtja e atdheut dhe të tjera tema të rëndësishme janë trajtuar në publicistikën e D. Agollit. Fakti dhe njeriu gërshetohen në brendinë e shkrimeve të kësaj natyre; motivi i udhës, i përshtypjeve, i meditimeve mbi ngjarjet e mbi njerëzit hasen shpesh, ashtu si edhe në krijimtarinë e mirëfilltë artistike të tij. Të duket nganjëherë se ke të bësh me tregime; tipat janë realë, autentikë, ashtu siç e kërkon edhe gjinia, po ndodh që një hap i ndan nga figurat artistike, në kuptimin e vlerës përgjithësuese që menç përshkrimi i një njeriu konkret. Fakti në këtë gjini, siç dihet, është përcaktues, po edhe momenti i trillimit artistik është i pranishëm në shkrimet publicistike të D. Agollit. Pa imagjinatë, doemos, nuk bëhet asgjë; puna është te ndjenja e masës dhe te koherenca stilistike brenda gjinisë që të mos dalë një përzierje stilesh, po të ketë tërësi organike.

Publicistika e D. Agollit u është përgjigjur kërkesave të kohës, ngjarjeve të rëndësishme. Ai ka ditur të gjurmojë si gazetar dhe si letrar në të sotmen dhe në ngjarjet e figurat e Luftës.

Në publicistikën përfshihen edhe artikuj që ngrenë probleme të kulturës, të gjuhës letrare si p.sh. «**Intelektuali dhe shtëpia e kulturës**», «**Ka ardhur koha të flasim për gjuhën artistike**», «**Kultura e ambientit**» e mjaft të tjerë. Këto probleme ngrihen me një mprehtësi publicistike herë-herë me ngjyra satirike, duke kritikuar fenomenin negativ me një ironi të mprehtë, përmes detajesh dhe faktorësh që nuk kanë nevojë për shumë komente.

Publicistika e D. Agollit është tipike për frymën

e saj militante, për pasqyrimin me kohë të problemeve që kanë preokupuar vendin dhe Partinë. Së bashku me gazetarë e publicistë të tipit letrar, D. Agolli ka dhënë një kontribut të çmuar edhe në zhvillimin e publicistikës sonë letrare, në krijimin e një lloji të ri publicistike, ku narracioni i natyrshëm gërshetohet me faktin e fortë, me dialogun: humori me lirizmin, apo kritika (në llojet e artikullit e të fejtimit) me çaste konkrete që zbulojnë thelbin e problemit. Gjuha ka shumë thekse popullore dhe është e çliruar nga emfaza dhe toni deklarativ.

Puna si gazetar, si poet e prozator që ndien nevojën të shprehë mendimet e veta për letërsinë dhe artin e, më vonë, puna drejtuese në Lidhjen e Shkrimtarëve e të Artistëve (si kryetar i saj që nga 1973) kanë përcaktuar edhe një intensitet të veçantë të këtij autori ndaj problemeve ideoartistike dhe estetike të krijimtarisë sonë.

Artikujt kritikë e me karakter studimor të D. Agollit mbrojnë parimet e realizmit socialist, shquhen për një shpirt polemizues e luftarak, ngrihen kundër mediokritetit dhe ngrenë zërin për novatorizmin në art. Stili i publicistit dhe i poetit ndihet në disa prej tyre. Me kalimin e kohës D. Agolli ka kontribuar në zhvillimin e mendimit kritik dhe estetik të ne.

D. Agolli ka shkruar artikuj kritikë, recensione për vepra letrare, shfaqje e ekspozita, ka mbajtur referate e ka shkruar disa studime mbi probleme që kanë lindur nga praktika jonë krijuese dhe në kushtet e ashpërsimit të luftës ideoestetike. Në këto shkrime ai ka qenë kurdoherë një luftëtar i zjarrtë i ideve të Partisë në fushën e artit dhe ka ndihmuar për zbërthimin e këtyre ideve. Veçanërisht pas Plenumit të 4-t të 1973-së ai ka shkruar mbi probleme të partishmërisë, të karakterit kombëtar, të mjeshhtërisë artistike etj. Duke zbatuar orientimet e Partisë, duke qenë në krye të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, së bashku me shokët e tij shkrimtarë dhe artistë, ai ka mbrojtur parimet e realizmit socialist, ka luftuar kundër pikëpamjeve liberale e moderniste të F. Paçramit, e T. Lubonjës, kundër

shtrembërimit dhe konfuzionit ideologjik që traditën e quante konservatorizëm dhe modernizmin e paraqiste si novatorizëm. Ai kontribuon vazhdimisht në luftën që bën Partia si kundër pikëpamjeve moderniste në letërsi e art, ashtu edhe kundër pikëpamjeve konservatore e kundër skematizmit.

* * *

Krijimtaria e D. Agollit është një dëshmi e lidhjes së ngushtë me jetën, me idealet e Partisë e të revolucionit, një pasqyrë besnikë e aspekteve të rëndësishme të realitetit tonë socialist, të jetës e luftës së popullit. Ajo gëzon simpatinë e gjerë të lexuesit tonë. Disa nga veprat e tij janë botuar në gjuhë të huaja dhe kanë pasur jehonë tek lexuesi.

Vetëm kur zemra mëh për popullin dhe kur pena është kurdoherë kërkuese, dalin vepra të mira dhe të frymëzuara. Për poezitë e D. Agollit shoku Enver ka thënë: «...ato shprehin ndjenjat e pastra të popullit, janë të lidhura me realitetin, me njerëzit e punës, me balatën, me prodhimet e lulet e kësaj toke, me oxhaqet e mëdha të kombinateve dhe me hallet e gëzimet e njerëzve në vatrat e tyre familjare». ¹⁾

Krijimet e D. Agollit si dhe të shkrimtarëve të tjerë më të mirë të vendit tonë, flasin për forcën përtëritëse të artit të realizmit socialist. Rruga krijuese e D. Agollit dëshmon për talentin e shquar dhe flet për vazhdimësinë krijuese të tij në të ardhmen.

1) Enver Hoxha, Mbi letërsinë dhe artin, f. 479.

POETI DHE KRITIKU MILITANT

Në 50-vjetorin e lindjes së Drago Siliqit

Si krijues, si aktivist shoqëror e letrar, si njeri militant i edukuar nga Partia, që dha gjithë aftësitë e tij në fushën e krijimit dhe të mendimit letrar, Drago Siliqi zë një vend të nderuar në historinë e zhvillimit të letërsisë sonë. Në 50-vjetorin e lindjes së tij, ne e kujtojmë me ndjenjë të vërtetë respekti, rilexojmë shkri-met e tij, kujtojmë punën që ka bërë dhe e sjellim në mend si njeri, si shok të dashur, të palodhur e gojë-ëmbël, gjithmonë optimist dhe të gjallë.

Që në moshën 14-vjeçare, i dalë nga gjiri i një familjeje të varfër, ai u hodh në radhët partizane, punoi si korrier partizan në rrethin e Tiranës dhe në radhët e Batalionit partizan Krujë-Ishëm; në luftë u gatua me ato ideale të reja revolucionare që do ta shoqëronin gjatë jetës së tij të shkurtër. Atje, midis popullit, midis fshatarëve të thjeshtë, mes shokëve partizanë, në shembullin e komisarëve e të komandantëve, të heronjve që nxirrte lufta e, më vonë, në vitet e para pas Çlirimit, midis të rinjve, në hekurudhë e gjetkë, si edhe shumë të tjerë, ai gjeti frymëzimin e poezive të tij, në fillim të thjeshta e më pas më të thelluara e me një depërtim në psikologjinë dhe botën e njeriut, po gjithmonë të çiltra dhe optimiste.

Në vitet pas Çlirimit Dragua punoi nga 1946-1951 në organet e rinisë e të pionierëve. Ka qenë anëtar i redaksisë së gazetës «Letrari i ri», që nxirrte për të rinjtë Lidhja e Shkrimtarëve në atë kohë. Unë e kisha njohur Dragon që në gjimnaz, po në redaksinë e «Letrarit të ri» patëm rast të njihemi edhe më mirë. Mua dhe shokëve të tjerë, që punonim aso kohe atje, si Luan Qafëzezi etj., na kujtohet mirë si hynte Dragua në zyrën e «Letrarit të ri» gjithmonë i qeshur, nxirrte nga xhepi vjershat që vinin nga bashkëpunëtorët dhe, kur i pëlqente ndonjë, na e lexonte me zë të lartë. Krijimet e bukura, zbulimi i talenteve të reja, gjatë gjithë jetës së tij, pastaj si përgjegjës i redaksisë së letërsisë shqipe në Shtëpinë Botuese «Naim Frashëri» e më vonë si drejtor i saj, kanë qenë për të një kënaqësi e madhe. Në këto çaste atij i ndrimsnin sytë me gëzim dhe bënte çmos për t'i afruar më të rinjtë, kudo që ishin, në skajet më të largëta të atdheut.

D. Siliqi ishte aktivist shoqëror, mirrte pjesë gjallërisht në jetën politike dhe artistike të vendit, sidomos të rinisë; mbante referate nëpër plenumet të Lidhjes, vazhdimisht diskutonte. Si komunist, si qytetar, ai e thoshte haptas dhe me çiltërsi shoqërore mendimin e tij mbi veprat e problemet letrare, hynte në polemikë; kur diskutoheshin veprat letrare ose fenomene të veçanta, ai mbante qëndrim dhe e mbronte pikëpamjen e vet sinqerisht.

Si drejtor i Shtëpisë Botuese, sipas mësimëve të Partisë dhe të shokut Enver, ai ka bërë një punë të mirë dhe të frytshme, në krye të kolektivit, duke nxitur botimin e veprave të shëndosha, duke zgjedhur krijimet më të mira, të cilat së bashku me shokët e tjerë të punës, i shikonte me objektivitet e vigjilencë revolucionare. Edhe në fushën e botimeve nga letërsia e huaj, ka ndihmuar për t'i dhënë lexuesit kryevepra të letërsisë klasike, të realizmit e të autorëve revolucionarë.

Drago Siliqi ka dhënë kontributin e tij si poet, kritik e publicist. Duke qenë për një kohë korrespondent

i «Zërit të Popullit», në Shkodër, ai hyri më shumë në jetë, shkroi artikuj për probleme shoqërore e kulturore.

Poezia e Dragos është një pasqyrë dhe shprehje e ndërgjegjes së të rinjve që kaluan luftën dhe morën pjesë në dhjetëvjeçarët e parë të ndërtimit të shoqërisë socialiste. Ajo ka atë frymë, ato tipare dhe shpreh kërkesat estetike të kohës. Shumë vjersha të tij, që u përmblodhën pas vdekjes në vëllimin «Kur zemra flet» si edhe ato për fëmijë janë të ndjera, flasin për një thellim në ndërgjegje, për një lirizëm meditativ dhe koncept të qartë filozofik. Në disa raste ndihet fare mirë si përkon mendimi i tij si kritik me atë që shprehet në poezi, lufta për të vënë në qendër të poezisë më mirë njeriun tonë, për të gërshetuar anën shoqërore me atë intime, duke mos e marrë asnjëherë të shkëputur. Shumë vjersha janë pasojë e përjetimeve personale; nisën nga një njeri i njohur, nga një çast i jetës partizane, nga jeta familjare dhe arrijnë në një mendim të përgjithësuar. Vjershat e D. Siliqit janë vjersha të një poeti militant, i cili gjithçka, atdheun, familjen, natyrën, dashurinë, marrëdhëniet midis njerëzve i sheh me syrin e komunistit dhe mundohet kurdoherë të gjejë midis tyre një dialektikë të brendshme. Gjithashtu, lufta kundër skematizmit, që theksohet në mendimin e tij kritik, vihet re edhe në krijimet poetike. Ai mundohet të tregojë se ndjenja nuk është e thjeshtë, se ajo ka rrugën e saj shpesh komplekse, se bukuria në jetë dhe në dashuri nuk është e njëtrajtshme dhe nuk duhet kërkuar vetëm në format e jashtme, po më thellë, në atë që shpesh nuk duket dhe nuk bën bujë. Këto vështrime estetike të së bukurës janë dukur edhe te poetë të tjerë dhe pasqyrojnë kërkime të një kohe të caktuar.

Në poezinë e vet D. Siliqi ka ardhur duke u thelluar drejt gjurmimeve shoqërore e psikologjike dhe duke krijuar portrete njerëzore me gjuhën e poezisë në vjersha si edhe në poemën «Këngë e re për dashurinë e vjetër». Poezia e tij është konkrete dhe mendimi me ndjenjën gjejnë një koherencë, e cila arrin të komunikojë emocionin e autorit. Ka vjersha që janë të një

natyre përgjithësuëse, po të shkruara pa deklarata të jashtme si p.sh. «**Revolucioni**», «**Atdheu**», «**Një ulli në breg të Jonit**» etj. Vjersha si «**Kur pyesja nënën**» ose «**Motrës**» janë të një natyre më konkrete dhe shumë emocionuese. Për autorin e këtyre vargjeve nuk ka gjë më të shtrenjtë se atdheu dhe revolucioni; të afërmit, nëna, motra, vajza e dashur, shokët dhe miqtë, — gjithçka është pjesë e jetës shqiptare, e kësaj jete të re për të cilën edhe ai kishte luftuar e luftonte. Poema «**Këngë e re për dashurinë e vjetër**» është një përpjekje serioze e autorit për të dhënë në vargje historinë tragjike të mërgimtarëve që venin në vande të largëta për të kërkuar bukën e gojës. Realiteti ynë e shëroi këtë plagë të hidhur. Pas një endjeje të gjatë burri kthehet në shtëpi, në Shqipërinë e çliruar dhe, nga fundi i jetës, gjen disa çaste të lumtura; në shpirtin e tij kthehet gëzimi i humbur prej vitash. Synimi i poetit për të krijuar karaktere në poezi, parantezat lirike, gërshetimi i ngjarjes me momentet e gjykimeve të autorit, e meditimeve të tij mbi jetën — kanë shpurrë në rezultate dhe në vlera ideoestetike të poemës.

D. Siliqi është mbështetur në traditën kombëtare; ai ka njohur mirë dhe ka dashur Naimin, Mjedën, Migjenin. Ka njohur e çmuar poezinë e poetëve bashkëkohorë duke pritur me entuziazëm çdo arritje të tyre. Po gjithmonë ishte kërkues ndaj poezisë së vet dhe nuk vendoste për ta botuar vëllimin me poezi lirike.

Sidomos kur punonte në shtypin e rinisë, Dragua botoi mjaft poezi kushtuar jetës së fëmijëve. Ka botuar vëllimin «**Zgjimi pranveror**», poemën «**Brigadierja**» dhe poezi të tjera nëpër organet e shtypit. Në këto vjersha, të ribotuara edhe kohët e fundit, ndihet një freski ndjenje, lehtësi në thurjen e vargut dhe gjuhë e rrjedhshme. Figurat e fëmijëve, të vizatuara poetikisht, spikasin në mjaft vjersha që kapin pamje të jetës nga bota e gjithë fëmijëve të Shqipërisë. Vjershat për atdheun, natyrën e bukur shqiptare, për punën vullnetare në

hekurudha etj, janë të thjeshta dhe të kapshme nga të vegjlit.

Poezia jonë ka ecur përpara. Ajo është pasuruar me shumë zëra e vepra tashmë të njohura. Në këtë bukuri ngjyrash poetike ka vendin e vet edhe poezia e çiltër dhe e pasur në mendim e D. Siliqit, të cilën lexuesit e kujtojnë me një ndjenjë simpatie.

Një kontribut të çmuar ka dhënë D. Siliqi në fushën e kritikës me artikujt dhe studimet e tij, pjesa më e madhe e të cilave janë përmbledhur në vëllimin «Në kërkim të së nesër». Ky është një vëllim relativisht jo i madh, po me shumë vlerë, dëshmi e mendimit të përparuar, të partishëm të fundit të viteve '50 dhe të fillimit të viteve '60. Këtij vëllimi mendoj se do t'i kthehen gjithmonë studiuesit e krijuesit për të gjetur mendime të drejta e për të kuptuar zhvillimin historik të kritikës sonë. Duke u mbështetur në parimet e estetikës marksiste-leniniste, sidomos mbi raportin e përmbajtjes me formën, në mësimet e Partisë dhe të shokut Enver se e reja duhet të kërkohet, në radhë të parë, në përmbajtje, pastaj në formë, — ai ka bërë studime me vlerë mbi traditën e novatorizmin në letërsinë tonë e sidomos në poezi, ka vlerësuar drejt disa autorë që po spikatnin atëherë e janë zhvilluar edhe më tepër më vonë, ka ditur të kuptojë dhe të çmojë vlerat e stileve të ndryshme, duke mënjeluar subjektivizmin apo qëndrimet e njëanshme.

Artikulli «Në kërkim të së nesër» u shkrua në përiudhën kur në shtypin tonë letrar dhe në diskutime krijuese flitej mjaft për kërkimet në poezi, kur, krahas poetëve që shkruanin prej një kohe më të gjatë si Ll. Siliqi, L. Qafëzezi, A. Varfi, M. Gurakuqi, V. Bala etj., po shquheshin autorë si I. Kadare, D. Agolli etj. Ai dalloi ku qëndronte e reja që kishin sjellë e po sillnin autorë stilesh të ndryshme dhe tregoi se kjo nuk qëndronte te vargu, te ritmi i matur ose jo i matur dhe te përdorimi i rimës, po, në radhë të parë, te materiali jetësor që përvetësonin poetët dhe te mendimi që i përshkonte krijimet poetike. Merita e D.

Siliqit është se e konkretizoi këtë problem përmes shembujsh dhe argumentoi me kompetencë se çdo qëndrim ekstremist në të kuptuarit e formës do të ishte i njëanshëm dhe i gabuar. Kështu ai, me të drejtë, shkruante se ta quash novatore një poezi vetëm sepse në të përdoren vargu i lirë dhe figura të reja, ky është qëndrim formalist. Por a priori ta hedhësh poshtë sepse nuk ndiqet forma tradicionale e vargut të matur, e poezisë strofike, gjithashtu është formaliste. Si ata që fetishizonjë vargun e lirë, si ata që fetishizojnë vargun e matur bien në formalizëm.

Ky është një qëndrim dialektik që e vlerëson poezinë, në radhë të parë, nga përmbajtja, po që nuk mohon edhe kërkimet në formë, kur këto janë në përshtatje me brendinë. Kuptohet se në vërejtjet e autorit, jo çdo konstatim është plotësisht i saktë dhe jo çdo gjë mund të parashikohej atëherë, po në prirjen dhe vrojtimet e përgjithshme ai është treguar objektiv dhe i mprehtë. D. Siliqi ka luftuar uniformitetin në poezi, ka argumentuar se përdorimi pa vend i figurave e dobëson poezinë, dhe e kundërta, e forcon kur këto vijnë si një domosdoshmëri; ai ka dhënë gjykime të plota mbi individualitetin e artistit, se si duhet kuptuar forma, jo vetëm me rimën e me ritmin, po në tërë komponentet e saj, me sistemin figurativ, si shprehje dhe materializim i një brendie të caktuar. «Individualitetin artistik të poetit, — shkruan ai, — e përcakton, në radhë të parë, materiali i ri veçantë jetësor që ai heton në caqet e natimit, prizmi i ri i përgjithësimit të tij në kuadrin e luftës së të kundërtave si dhe sistemi figurativ që ai përdor për të pasqyruar momentet e veçanta të realitetit objektiv.»

Në studimin e tij «**Mbi konfliktin në art**», ai mbështetet në estetikën marksiste-leniniste dhe në filozofinë materialiste e dialektike mbi zhvillimin e shoqërisë përmes luftës së të kundërtave. Ky do të ishte një pohim i njohur dhe i përgjithshëm, po D. Siliqi, pasi e shtron drejt teorikisht problemin e konfliktit, nda-

let në disa vepra konkrete dhe lufton «teorinë» e mungesës së konfliktit, të përhapur asi kohe nga disa kritikë sovjetikë, dhe të hedhur poshtë nga Stalini në qëndrimet e tij kundër lustrës dhe zbulurimit të jashtëm. Duke polemizuar edhe me ndonjë mendim të shprehur tek ne se mund të shkruhej poema pa konflikt, ai mbronte mendimin se konflikti duhet të jetë i pranishëm në të gjitha gjinitë, po do mbajtur parasysh veçoria e tij në raste të ndryshme. Ky mendim është i drejtë, sepse në zanafillën e çdo krijimi artistik, brenda subjektit ose në idenë themelore të çdo autori, diçka mbrohet dhe diçka mohohet; vetë mbrojtja e zjarhtë e një fillese është mohim i tërthortë i fillesës së kundërt.

Duke folur edhe për elemente të tjera të formës, siç është fabula, D. Siliqi thoshte me të drejtë se fabula e një kënge popullore nuk mund të jetë e njëjtë me fabulën e një drame (për shembull në dramën «Halili e Hajria» të K. Jakovës). Lidhur me konfliktin ai mbronte idenë se duhet treguar më shumë vëmendje për aktualitetin e tij, për të gjetur momente të atilla që hedhin dritë në problemet bashkëkohore, të cilat shoqëria i shtron për t'i zgjidhur.

Ai bëri edhe analiza konkrete e të thelluara për vepra të veçanta, si për «Kënetën» e F. Gjatës etj.

Me kontributin e tij, D. Siliqi mbetet një ndër kritikët më seriozë, me mendime të sakta dhe objektive, një kritik që shtronte dhe zgjidhte probleme të ndërlikuara të letërsisë. Ishte një ndër të paktët që përmbajtjen e merrte të lidhur ngushtë dhe organikisht me formën, duke bërë një analizë organike të veprave. Ai është një shembull i mirë sidomos për kritikët tanë të rinj.

Në 50-vjetorin e lindjes së Drago Siliqit, i cili u nda prej nesh shumë i ri, ne e përkujtojmë me nderim e dashuri shokun, poetin e kritikun e partishëm, që mbetet në përfytyrimin tonë kurdoherë i ri dhe i frymëzuar.



KRITIKË DHE PËRSHTYPJE



ARTI I MADH I POPULLIT

Në sheshin e kalasë së Gjirokastrës, rrethuar me mure të vjetra, karshi malit të Lunxhërisë, grykave e faqeve që krijojnë një dekor të madhërisëm, për shtatë ditë rresht zjeu kënga dhe vallja popullore në festivalin folklorik kombëtar. Ishin ditë të gëzueshme, të gjalla, që i ndoqi me vëmendje gjithë Shqipëria, sepse në atë podium të kalasë vërshoi frymëzimi popullor, u zbulua shpirti i popullit përmes artit të tij të pavdekshëm, doli qartë dhe me ngjyra të habitshme vitaliteti shpirtëror estetik i popullit, krijuesit më të madh, që nga ka zënë fill dhe merr gjithmonë frymëzim arti i kultivuar.

Vlera tradicionale dhe aktuale e folklorit tonë, ruajtja dhe lëvrimi i tij në kushtet e zhvillimit të socializmit në vendin tonë, lulëzimi bashkëkohor i folklorit në kohët moderne, të përparimit të gjithanshëm të jetës, siç thaksoi edhe Plenumi i 4-t i KQ të Partisë, jo vetëm që kanë kuptim praktik, por argumentojnë edhe tezën e drejtë teorike se folklori është një thesar i madh i historisë së popullit, i botës së tij shpirtërore dhe se ai ecën përpara, zhvillohet me një masivitet të pashoq, kur kultura, në një shoqëri si jona, udhëhiqet nga parime të drejta marksiste-leniniste dhe përshkohet nga karakteri popullor. Natyrisht, gjinitë dhe

llojet folklorike ruhen dhe evoluojnë në raporte të caktuara; disa lloje të folklorit gojor (p.sh. fantastiko-përrallore) nuk mund të kenë zhvillim në kohën e botëkuptimit shkencor mbi jetën, por në tërësi, siç dëshmon edhe praktika, kënga, vallja, evoluojnë, duke i qëndruar me besnikëri traditës, gjuhës së folklorit, mënyrave të përpunuara më parë. Siç është thënë në mendimin tonë estetik, folklori ka një prirje shumë të theksuar ndaj traditës dhe evoluimi mund të bëhet vetëm në këtë rrugë. Fryma kolektive, emancipimi i gruas, dinamika e sotme janë dukur e do të duken gjithmonë më tepër në krijimtarinë me temë nga Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe nga e sotmja, botëkuptimi ynë shtrihet gjithashtu edhe në interpretimin e motiveve të kaluara, sepse është njeriu i sotëm, me një botëkuptim të ri, që i pasqyron dhe i interpreton. Këtu gjithë puna është te ndjenja e masës dhe te evoluimi i natyrshëm, sipas kërkesave të brendshme, dhe jo te ndryshimi i sipërfaqshëm dhe i rastit.

Duke parë këngët dhe vallet e popullit në këtë festival, nga të gjitha krahinat e Shqipërisë, ne ndjejmë artin që buron nga shekujt dhe vjen gjer në ditët tona. Në brendinë e tij, me konceptimin filozofik dhe artistik, ai është i përkryer, kur interpretimi i përgjigjet nivelit të krijimtarisë. Spektatori i shikon dhe pushtohet nga ndjenja të vërteta dhe mendime për jetën dhe luftën e popullit tonë gjatë historisë së tij, për botën e brendshme, dertet dhe gëzimet, patosin heroik që përshkon shumë nga krijimet. Të sotmen revolucionare, emrin e Partisë, të shokut Enver, tërë ngjarjet politike, qëndruesën ndaj armiqve, populli i merr dhe i fut organikisht në artin e tij të madh, i cili ka ecur nëpër një shtrat të gjerë të temave të mëdha, të ngjarjeve me rëndësi kombëtare, duke përfshirë Skënderbeun, luftërat kundër pushtuesve, Lidhjen e Prizrenit, Naimin, Ismail Qemalin dhe pastaj dëshmorët dhe episodet e mëdha të Luftës Antifashiste Na-

cionalçlirimtare; si Mezhgoranin e Drashovicën, rrugët e Tiranës, Shkodrën, Dibrën etj.

Epika popullore i këndon Partisë dhe shokut Enver me thekse dhe ngjyra heroike, që kanë krenarinë dhe lartësinë e maleve, gjerësinë e fushave, larminë e ndjenjave dhe të relievit shqiptar. Të paharrueshëm ishin, p.sh., ata këngëtarët e Dukatit që u ulën në gjunjë para mikrofomit dhe, me një zë të thellë, me një harmoni të lashtë dhe të re, i këndonin Ismail Qemalit për punët e mira që ka bërë ndaj këtij vendi.

Ky festival u shqua për masivitetin e tij, për larminë e temave dhe të gjinive, për zbulimin e gjërave të reja si nga tradita, ashtu edhe nga krijimi i sotëm. U shqua për ruajtjen, në vijat më kryesore, të autenticitetit të folklorit, duke e dalluar atë nga lëvizja amatore dhe nga arti i kultivuar. Festivali ishte i larmishëm, sepse në artin popullor ishte kapur jeta në shumanshmërinë e saj. Anët politike, shoqërore dhe poetike të realitetit ishin marrë në aspektet e shumta estetike. Krahas epikës, që zinte vendin kryesor dhe të natyrshëm, dilte edhe lirika apo satira e popullit, elementet dramatike dhe tragjike, të cilat kanë një zgjidhje drejt heroikes. Kështu, p.sh., krahas valles burrërore të Vranishtit, vinte kënga poetike e vajzave të Rehovës, që i këndonin manushaqes me një lirisim të bukur. Edhe motivet satirike në këngë e valle zunë një vend të dukshëm në festival. Kënga e Zagories «**Katër llafe për tetë pikat**» është një satirë e mprehtë popullore.

Gëzimi i jetës së re dilte i qartë në shumë këngë e valle, si në ato të vajzave të Tropojës, në këngë të Tiranës, në valle të Dropullit, në orkestrën popullore të Pukës apo në vallen e Rrajoës. Elegancë dhe shkathtësi dallohej në vallen gorarçe, me një ekzekutim të përkryer. Që nga thëllësitë e shekujve vinin tingujt e lahutarëve, si të atij nga Lezha e krahina të tjera. Bukuria dhe harmonia e shumë melodive popullore ndihej në orkestrat, në këngët me fyej, çifteli, që zgjojnë kënaqësi të vërtetë.

Gjithçka që krijohet me shpirt, që lind natyrshëm,

që vjen si një kërkesë e brendshme, dël e bukur. Arti latohet, lëvrohet, me kalimin e kohës dhe mbetet i gjallë.

Këto ndjenja të singërta dhe të thella ndihen në shumë këngë të lashta dhe të reja. Tragjizmi popullor spikat në disa këngë që kanë lindur pikërisht kur humbja ka qenë e madhe, kur ngjarja ka bërë përshtypje në popull dhe ai e ka përjetësuar në këngë. Kështu, p.sh., përshtypje të thellë bëri kënga e grupit të Rrogozhinës (këngë çame) për Çelo Mezanin, sepse ishte e ndjerë dhe e kënduar në mënyrë origjinale. Ngjarja tregohet me një dhemshuri, po edhe me ton të përmbajtur për rrëfenjësit epik që ka parë shumë dhe e di si ndodhin këto gjëra. Ai që ia mban, me një zë të ngrohtë dhe depërtues, vajton të vvarin, duket sikur dëshmon ato që thotë rrëfenjësi dhe hyn më thellë në kuptimin e ngjarjes. Fjalët janë të derdhura, të gdhendura me daltë dhe ndjenja për të rënin vjen e thellohet gradualisht gjersa kënga mbyllet me një mendim optimist.

Karakterit epik, heroik zotëroi në festival, duke i bërë jehonë jetës sonë, së sotmes, luftës heroike të Partisë dhe të popullit për të ecur përpara në rrugën e revolucionit dhe të socializmit. Ndjenjat e trimërisë, të forcës shpirtërore, madhësisë dhe bukurisë, të lidhura me nuancat më të holla të shpirtit, të dashurisë dhe të marrëdhënieve njerëzore, dilnin të qarta në këtë festival. Prandaj, duke ndjekur krijimtarinë, duke parë kostumet me një bukuri të rrallë, të dukej se ecje në një livadh të bukur, se kaloje midis historisë, ku shihje trima me martina e maliherë, ku dëgjoje krisma lufte, apo sikur bridhje midis pyjeve e lëndinave ku dëgjoje bilbilë, gurgullimë ujërash, merrje erën e manushaqeve e të trëndafilave, kaloje midis barit me vesë. Një jetë e tërë, me ngjyrat më të larmishme, e mishëruar në folklor, e riprodhuar me besnikëri e bukuri të vërtetë! Kënga e grupeve arbëreshe sillte një mall të vetin, që depërtonte nëpër shekuj dhe përhapej që nga kalaja e Gjirokastrës nëpër Shqipërinë e sotme. Është nderimi që i bëjnë bijtë e

shpërndarë nënës së tyre të munduar dikur, po të lumtur sot.

Duke ndjekur festivalin folklorik, me një pjesëmarrje të gjerë dhe me program shumë të pasur, vetvetiu lindin edhe mendime e probleme që kanë nevojë të rrihen e të marrin një shpjegim më të saktë në të ardhmen, gjë që me siguri do ta bëjnë specialistët në këtë fushë.

Së pari, të lind mendimi për atë të vërtetë të pamohueshme se sa më krijues të jetë njeriu në punë dhe në jetë, aq më tepër ka nevojë për veprimtari estetike, aq më shumë kërkon të gjejë një fushë veprimi ku të shfaqë ndenjat e tij, dashurinë apo urrejtjen. Kjo kërkesë e ka shoqëruar popullin nëpër shekuj e është bërë edhe më e madhe sot, kur njeriu gëzon liri dhe ka ndërtuar jetën e tij, kur krijon në të gjitha fushat e jetës. Zhvillimi i madh i kulturës socialiste ndikon edhe për krijimin e folklorit, po është krijimtaria popullore, në tërë rrjedhën e saj shekullore, që shërben si burimi i parë artistik kombëtar i artit. Ndonëse arti i kultivuar plotëson sot shumë më tepër nevoja shpirtërore se më përpara, rëndësia e folklorit nuk zbehet, po përkundrazi, ai merr përpjesëtime më masive, duke luajtur rol edhe në edukimin e njerëzve, në ushqimin e tyre shpirtëror. Kuptohet se gjinitë nuk zhvillohen të gjitha njësoj, po në tërësi folklori bëhet një kërkesë e theksuar e masave dhe një burim i vazhdueshëm për krijuesit, të cilët kanë për detyrë që motivet e tij t'i njohin thellë dhe t'i përvetësojnë në mënyrë krijuese për të forcuar edhe më tepër karakterin kombëtar të letërsisë e arteve tonë, frymën e tyre popullore.

Së dyti, pasi kuptohen rëndësia estetike dhe kërkesat e sotme të folklorit, nuk mund të mos lindë edhe një problem tjetër, që lidhet me veçoritë e tij të sotme, në kushtet e zhvillimit të dukshëm të kulturës popullore.

Krijimtaria e popullit është e vetvetishme, ajo lind nga persona me dhunti të veçanta artistike, që kri-

jojnë shpesh ose në raste të rralla, kur pëken tepër nga një ndodhi e jashtëzakonshme. Krijimet përpunohen, skaliten nga krijuesi i madh anonim-populli. Duke u ndodhur në një gëzim, njeriu do të marrë pjesë edhe vetë në këngë apo në valle, sado që gjithmonë ka edhe admirues që rrethojnë interpretuesit. Kur folklori lëvrohet kaq gjerë si tek ne dhe ngjitet në skenë, vetvetiu lind problemi i elementeve të skenës, të artit të mirëfilltë dhe këtu folklori do të ndikohet nga arti i kultivuar, i cili edhe jep ndihmën e tij. Ky fenomen do të ndodhë si diçka e natyrshme, puna është vetëm të mos kalohet masa dhe folklori të ruajë vulën e tij të krijimit popullor, pa futur në të elemente të jashtme. Kriteri kryesor i vlerësimit, për mendimin tonë, duhet të jetë ky: sa është në thelb popullor krijimi i interpretuar, sa e jep shpirtin e popullit dhe sa pasqyron kohën kur ka dalë.

Së *treti*, duke ruajtur autenticitetin e folklorit, mos e ngatërrojmë këtë me të drejtën e tij për të evoluar, për t'iu përgjigjur kërkesave dhe kushteve të sotme social-estetike. Zhvillimi, që i bën vetë populli mënyrës së vet të të krijuarit, flet për një mençuri të veçantë dhe për ndjenjën e masës, gjë që është e domosdoshme kurdoherë në art. Botëkuptimi revolucionar, mënyra e të jetuarit, kultura e fituar — të gjitha ndikojnë në krijim dhe në interpretim. Drejtimi dhe orientimi i krijimtarisë popullore qëndron në ruajtjen e traditës më të shëndoshë dhe në zhvillimin e shtigjeve të reja që ajo të ecë në këto gjurmë dhe të shprehë botën e sotme të njerëzve.

Së *katërti*, është e qartë se festivali edhe një herë ngre problemin e përvetësimit më të madh e më të dobishëm të folklorit nga artistët tanë, me angazhimin në ngjarjet e mëdha historike, me lakonizmin e tij të habitshëm, me bukurinë e figurës, me elegancën dhe ndjenjën e masës, me dramaturgjinë, e cila fshihet edhe brenda polifonisë apo valles. Krijimtaria jonë e kultivuar artistike është ushqim shumë i madh estetik për

masat dhe ajo ka përfituar shumë prej folklorit. Por problemi i stilizimit, i përpunimit, i shfrytëzimit të folklorit të krahinave të ndryshme mbetet gjithmonë i mprehtë. Përveç arritjeve, dihet se kemi pasur edhe raste stilizimesh apo përpunimesh të papranueshme, me lëvizje të tepruara, të niveluara, ku hiqet origjinaliteti dhe ngjyra e papërsëritshme popullore. Nga populli do të mësojmë thjeshtësinë e tij, artin pa artificialitet dhe manierizma, do të mësojmë pastërtinë e gjuhës, të ritmeve dhe të tingujve.

Këto dhe probleme të tjera lindin nga festivali i Gjirokastrës 1978, i cili ishte një manifestim i bukur, i larmishëm i mendimit dhe ndjenjës së thellë të popullit, që çan kohët e zhvillohet edhe në ditët tona.

1978

ARTI I RECITIMIT DHE POEZIA E NJË SHFAQJEJE

Vepra e Migjenit në «Teatrin e poezisë» të Shkodrës

Recitimi i poezisë e i prozës tërheq gjithmonë e më shumë aktorë e amatorë. Ai fillon që në bankat e shkollës dhe është një mënyrë tërheqëse e dobishme për formimin e kulturës së fjalës, për depërtimin në bukurinë e poezisë, të mendimit dhe të ndjenjës. Recitimi të ne është bërë masiv dhe ndiqet me interes nga shumë dëgjues e sidomos nga të rinjtë. Ka mjaft recitues të mirë, të pasionuar, me zë të ngrohtë, të kumbueshëm, të cilët hyjnë thellë në fjalën artistike dhe ndodh që e zbulojnë veprën poetike, si të thuash, në një mënyrë të re, duket nxjerrë më në pah vlerat e vërteta të saj. Në këto raste dëgjuesi e ndjek me interes recitimin, ndjenjat që i përftohen janë më të shumta se kur i lexon vetë vargjet dhe ato i lënë gjurmë në ndër-gjegje për një kohë të gjatë.

Teatrot tona, dega dramatike në Institutin e Lartë të Arteve, kanë përpunuar një shije realiste në recitimin e fjalës poetike. Janë mënjanuar, në përgjithësi, manierat e recitimit retorik, me gjeste të shumta e të panevojshme apo të deklamimit sentimental. Ka një ngritje të fjalës artistike në skenë. Po, megjithatë, dalin ende disa probleme të përmirësimit të mëtejshëm të recitimit, të ngritjes së nivelit të tij. Mendoj se du-

het të mbahen parasysh më shumë kërkesat e këtij arti, pikënisja nga fjala artistike, nga poezia, qëllimi për të komunikuar sa më bukur, në mënyrë ekspresive, fjalën, ritmin, muzikalitetin e vargut dhe për të dhënë sa më mirë mendimin. Por ndodh që, përveç rasteve kur recitohet dobët, poezia «interpretohet» më tapër se ç'duhet, aktori ose recituesi del para fjalës e poezisë dhe, vetvetiu, ajo mbetet si mënjane. Elemente si kadenca, ritmi, rima, duhet të ndihen, natyrisht, me mjeshtëri, por kjo nuk do të thotë që recitimi të bëhet monoton dhe anemik.

Koncertet e fjalës artistike, konkurset, mbrëmjet poetike-muzikore janë forma të njohura dhe të përhapura. Përveç këtyre ka lindur nevoja edhe për forma të tjera të interpretimit të poezisë apo të prozës, të një teatri të poezisë, apo të inskenimeve të prozës ku nuk kemi të bëjmë me dramë, po ku aktorët mbeten te baza e recitimit, duke e dhënë veprën në mënyrë të figurshme dhe poetike.

Me mendime të kësaj natyre dhe me kureshtje, siç ndodh gjithmonë kur pret diçka të re, shkruam për të parë shfaqjen kushtuar veprës së Migjenit në «Teatrin e poezisë», organizuar nga teatri profesionist i Shkodrës. Kolektivi i këtij teatri ka menduar që kjo formë e paraqitjes artistike figurative të poezisë të përfshijë një varg autorësh shqiptarë, duke ndihmuar kështu për ta bërë më të afërt, më të kuptueshme dhe të dashur veprën e tyre. Kjo, iniciativë, që mbështetet edhe në praktikën teatrale botërore, ka shumë origjinalitet dhe veçori tonat, që burojnë nga brendia poetike, nga qëllimi për ta bërë teatrin edhe më shumë një mjet të fuqishëm edukativ e njohës dhe një tribunë të mendimit revolucionar.

Para se të flasim për shfaqjen mbi veprën e Migjenit, le të shënojmë shkurtimisht se ç'përfaqëson kjo lloj shfaqjeje. «Teatri i poezisë» nuk jepet vetëm në skenën e zakonshme, po edhe në një sallë më të vogël, ku spektatorët vendosen përreth si në një amfiteatër dhe trupa e jep shfaqjen në një podium në mes

tyre, fare pranë. Aktorët janë të veshur si në një koncert, sepse këtu mbetet themelore fjala e autorit dhe recitimi i saj e jo loja e aktorit, sado që janë përdorur edhe inskenime, dialogë e monologë. Në pikëpamje të zhanrit, pra, ky teatër gërsheton formën e koncertit recitativ të shoqëruar me muzikë e drita (këta dy elemente lozin një rol të ndjeshëm, sepse ndihmojnë për të zbuluar më mirë poezinë), me inskenimet dramatike, me teatrin e pantomimës (vendosje të personazheve në forma përmendoresh, sfonde që shoqërojnë mendimin e dialogun) si edhe me recitime kolektive, në kor, që sjellin, në njëfarë mënyre, jehonën e koreve antike, duke shtuar forcën e fjalës gjer në një kulm emocionues. Kështu, edhe në Shkodër shfaqja vende-vende arrinte në një triumf të mendimit të poezisë migjeniane, me recitimin nga fundi të vargjeve optimiste «dhe pranvera erdhi... nëpër fytyrat tona rëshqiti një gëzim...».

Kjo shfaqje, vënë në skenë me fantazi dhe mendim të qartë nga regjisori Serafin Fanku, i cili ka bërë edhe zgjedhjen dhe lidhjen e materialit nga vepra e Migjenit, zbërthen mirë dhe me dinamikë të brendshme një pjesë të veprës së tij dhe momentet e saj të rëndësishme. Disa aktorë dalin si ndërlidhës të mendimeve e vihen në rolin e autorit që paraqet jetën e njerëzit dhe kuptimin e atyre që ndodhin. Kjo bëhet p.sh. për novelëzat e tij të njohura «Një refren i qytetit tëm», «Moll' e ndalueme», «A don qymyr, zotni», «Luli i vocërr» etj.

Një meritë e kësaj shfaqjeje qëndron edhe në kalimin, përgjithësisht logjik, nga njëra poezi te tjetra, nga njëri motiv në tjetrin pa krijuar shkëputje, duke na dhënë një fizionomi të plotë të botës së pasqyruar e të shprehur nga Migjeni. Kështu, fillohet me «Kangët e mjerimit» («Poema e mjerimit», në një pjesë të mirë të shfaqjes përdoret si lajtmotiv për të lidhur pamjet dhe poezitë që pasqyrojnë jetën e rëndë të Shqipërisë së periudhës kur jetoi Migjeni), merren poezi nga «Kangët e rinisë», fragmente nga novelëzat dhe kalohet

në «Kangët e ringjalljes», të cilat jepen me tone optimiste, ku tingëllojnë bukur motivet e «Kangës së rinisë», «Të birtë e shekullit të ri» dhe «Zgjimi». Shfaqja ka një ndërtim që niset nga konceptimi i drejtë regjisorial me një mendim të përcaktuar; pamje të rënda të jetës së Shqipërisë së mjeruar të dikurshme, silueta e një qyteti në vuajtje, plot plagë shoqërore, po edhe grushte të shtrënguara e zemërim; drama e njeriut të asaj kohe, ironia politike e shoqërore dhe pastaj zgjimi, thirrja e poetit për të ngritur grushtin në luftëra të reja dhe gëzimi romantik i pranverës që erdhi. Kështu, shfaqja ndjek një dinamikë të parë me syrin e njeriut të sotëm, gjithmonë brenda veprës dhe mendimit migjenian. Dhe duke shikuar këtë shfaqje, duke dëgjuar recitimet e frymëzuara dhe ekspresive (të ndjera dhe pa pozë, përgjithësisht të arrira) spektatori mendon përsëri se ç'forcë ka vepra e Migjenit, ç'ide të thella përmban ajo në vetvete, sa e donte poeti njeriun, sa i dhimbsej ai, dhe si ëndërronte, përmes mundimesh shpirtërore e fizike, për të ardhmen e vendit të vet, për fatin e të varfërve dhe të mjeruarve.

Shfaqja është një zbrëthim i veprës së Migjenit, një vështrim i sotëm, që vë në pah ngarkesën sociale dhe dramën e jetës së asaj periudhe përmes mendimit të autorit dhe notave të besimit e të dritës për të ardhmen.

Gjetja regjisoriale, disa këndshikime të goditura, në tërësinë e tyre ruajnë unitet stilistikor estetik në një shfaqje ku nuk bëhet teatër i dramës, por i poezisë. Fjala, mendimi i autorit mbetën në qendër të vëmendjes. Mizanskenat e thjeshta, plastika e gjetur, zgjidhjet simbolike që shoqërojnë mendimin apo ngjarjen janë në funksion të së tërës dhe krijojnë atmosferë.

Recitimi dhe interpretimi i aktorëve shpreh bukur mendimin e autorit dhe idenë regjisoriale. Aktorët më me përvojë, apo ata të rinj, recituan me ngrohësi, sipas kërkesave të poezisë dhe të fjalës artistike, me dashuri për veprën e autorit dhe me një qëndrim ideoemocional të përcaktuar. Natyrisht, niveli

i recitimit nuk është i njëjtë te të gjithë, po gjithçka në këtë shfaqje tingëllon në ansambël, përshtypja krijohet në tërësi. Edhe veças, po t'i shohësh aktorët ka mjaft prej tyre që recitojnë bukur, thjesht, disa me një forcë të dukshme shprehëse, me dramaticitet dhe me nerv, pa kaluar në britma apo në një stil pompoz. Kështu do të përmendim aktorët P. Gruda, B. Shiroka, V. Bruçeti, E. Hyseni, M. Bruçeti, R. Rama. A. Gjini etj. Na bënë përshtypje në mënyrë të veçantë për zërin e ngrohtë dhe interpretimin emocional, për nuancën në zërbërthimin e poezisë dhe të novelëzave të Migjenit dy aktorë të rinj, P. Gruda dhe E. Hyseni. Binte në sy gjithashtu se aktorë të njohur e me përvojë në teatër si B. Shiroka, që nuk janë marrë me recitime përpara, krijonin përshtypje të mirë, sepse e thanë fjalën qartë e thjesht, me dramaticitet, brenda natyrës së poezisë.

Spektatori emocionohet duke parë «inskenimin poetik» të novelëzës «**Bukuria që vret**», patosi dhe ironia e së cilës godasin fort; apo interpretimin e mprehtë satirik të «**Programit të një reviste**», etj.

«**Teatri i poezisë**» që po ripërtrihet me krijimtarinë e Migjenit në teatrin e Shkodrës, ndiqet nga punëtorë, studentë e nxënës, nga publiku artdashës. Urojmë që kjo shfaqje të pasohet edhe nga të tjera, duke zbuluar gjithmonë e më mirë dhe në forma të larmishme bukurinë e poezisë shqiptare.

1981

FRËMËMARRJE E GJERË POPULLORE

(Mbi romanin «*Belxhiku që këndon vençe*»
të Sh. Musarajt)

Krahas temës së ndërtimit të socializmit, të dukurive dhe problemeve të mëdha të ditëve tona, tema e Luftës Nacionalçlirimtare ka tërhequr e tërheq vëmendjen e shkrimtarëve tanë, sidomos të atyre që e kanë jetuar këtë kohë dhe kanë marrë pjesë në të. Ndihet nevojë gjithmonë e më shumë për vëpra nga koha jonë, nga dukuritë dhe problemet e mëdha të ditëve tona (çdo art realist e përparimtar afirmohet, në radhë të parë, me pasqyrimin e kohës kur lind), po ne, me të drejtë, e marrim dhe kohën e Luftës si një pjesë të këtij realiteti të ri, kur nisën, u realizuan dhe po zhvillohen e thellohen ndryshime të mëdha në të gjitha fushat e jetës. Kjo nuk do të thotë se krijuesit lënë mënjanë temat e së kaluarës, të cilat kanë vendin e tyre të merituar dhe po trajtohen nga shkrimtarët e gjithë krijuesit tanë me pjekuri dhe nga një këndvështrim i ditëve tona.

Shkrimtari Shevqet Musaraj, i cili ka botuar para ca kohe romanin «*Belxhiku që këndon vençe*», me temën e Luftës Nacionalçlirimtare, gëzon simpatinë e lezuesve dhe pëlqehet prej tyre për vërtetësinë e jetës

që sjell në krijimet e tij, për tipat dhe mjediset shqiptare, të dhëna me realizëm e ngjyrimë të dukshme. Lexuesi çmon tek ky shkrimtar mënyrën e thjeshtë dhe të natyrshme të të treguarit, gjuhën shumë të shkathtë dhe të bukur shqipe, një gjuhë plot frazeologji popullore, po edhe të zhvilluar, me nuancat dhe përpjesëtimet që i ka dhënë koha jonë.

Lexuesi, që ka ndjekur krijimtarinë e Sh. Musarajt, që ka marrë në dorë të gjashtë vëllimet e veprës së tij (një punë shumë e dobishme që po vazhdon e do të vazhdojë me autorë të tjerë të njohur) priti me kurreshtje dhe me kënaqësi romanin «**Belxhiku që këndon vende**». Ç'pjesë të realitetit të Luftës, ç'tipa, ç'probleme të asaj kohe, që i bëjnë jehonë edhe kohës sonë, sjell ky shkrimtar i njohur në veprën e tij të re? Këto do të ishin disa nga pyetjet që të vijnë në mend kur nis leximin e këtij libri të autorit që ka shkruar «Epopenë e Ballit Kombëtar», romanin «Para agimit» apo tregimin «Isha unë Çobo Rrapushi».

Ngjarja e kësaj vepre zhvillohet në kohën e luftës kundër pushtuesit fashist italian e pjesërisht pas kapitullimit të Italisë dhe ardhjes së nazistëve gjermanë në Shqipëri. Subjekti rrjedh në një shtrat të gjerë të luftës së popullit nën udhëheqjen e Partisë, kundër pushtuesve dhe tradhtarëve. Ky subjekt ndërtohet me një varg ngjarjesh dhe episodesh që vijnë njëri pas tjetrit, që japin pamje dhe tipa të asaj periudhe, duke na krijuar një përfytyrim të plotë dhe të shumanshëm të karakterit thellësisht popullor të Luftës Nacional-lirimtare. Romani nuk mbështetet mbi një kronikë ngjarjesh, po realitetin historik të asaj kohe, faktet dhe përshtypjet e shumta, i riprodhon përmes një subjekti konkret të përcaktuar në tipa dhe në fabulën që lidhet kryesisht me odisenë e një djali të varfër fshatar, të Sino Borakës, që mbeti jetim, u lidh me familjen e një punëtori, të Pandit, njeri i Luftës, (i cili pastaj del në mal), ndihmoi Lëvizjen, hyri në burg, u arratis që andej së bashku me shokë të tjerë dhe u bë luftëtar në radhët partizane. Subjekti i romanit mërr

shkas edhe nga disa ngjarje reale të luftës së Partisë kundër deviatorit dhe tradhtarit Xhepi dhe, bashkë me debatin midis përfaqësuesve të Partisë e të popullit si Belxhiku (pseudonimi i Besos) etj. dhe njerëzve të Ballit si zoti Kamberaj, Siri beu etj., përfshin në vepër luftën politike dhe ideologjike të asaj kohe. Romani pra zhvillohet me një linjë kryesore që përmban idenë, boshtin themelor të veprës: Lufta Nacionalçlirimtare, si një lëvizje e madhe popullore, i përfshiu masat e popullit, njerëzit e thjeshtë, të cilët u rritën, u edukuan dalngadalë, u bënë të ndërgjegjshëm përmes ndeshjeve dhe peripecive të shumta, nën ndikimin e drejtpërdrejtë të komunistëve, të komisarëve e komandantëve si Belxhiku, Pandi, Bardhyli, të partizanëve si Leveni, xha Qerimi dhe shumë të tjerë. Linja epike, e veprimit të gjallë, e burgut, e endjeve partizane shteg më shteg, në një pyll, në një lëndinë ndanë fshatrave, qafës së malit apo pranë shpellave, në llogoret e luftës apo në shoqërinë partizane e në vatrat e ngrohta fshatare — kjo linjë, mjaft e përcaktuar dhe konkrete në këtë vepër — bëri që materiali jetësor të organizohet në tërësi mirë, romani të lexohet me një interes të veçantë dhe të spikasin, përmes ngjarjesh, mjaft personazhe, çaste të paharrueshme dhe prekëse që do të lenë gjurmë në ndërgjegje. Problemet e mjeshtërisë, që dalin gjithmonë e më shumë, sa më tepër zhvillohet romani, para romancierëve tanë lidhen veçanërisht me ndërtimin kompozicional të një vepre, me vazhdimësinë e karaktereve, me hastimin që bën shkrimtari në ndërgjegjen e tyre dhe në marrëdhëniet që kanë me njëri-tjetrin. Sa më të ngjeshura të jenë ngjarjet dhe sa më të lidhur personazhet, aq më kompakte është vepra dhe aq më shumë shkrimtari arrin të përçojë idetë dhe të gdhendë tipat që nxjerr nga jeta. Ky roman, me gjithë ndonjë ngarkesë të tepërt diku, është i kompozuar mirë, lirisht, pa shabllone të përsëritura, vjen si një rrëfim epik që e dikton vetë materiali dhe përvoja e shkrimtarit, i cili i vendos za-

konisht ngjarjet në një shtrat të gjerë epik duke ruajtur linjën kryesore të subjektit.

Tregimi i ngjarjes bëhet në vetë të parë, në gojën e personazhit qëndror, të Sinos. Kjo i jep veprës një natyrshmëri, autenticitet dhe lidhet me një nga synimet më të rëndësishme të romanit, të tregojë se si, përmes mundimesh, ditësh të vështira, po edhe plot miqësi të re shokësh, përmes luftës, duke dëgjuar biseda udhëheqësish partizanë, duke marrë pjesë në debate, në ndeshje ideologjike e politike rritet dhe forcohet karakteri, formohet botëkuptimi i ri, fitohet ndërgjegjja revolucionare. Dhe kësaj detyre të rëndësishme, si edhe pasqyrimin të skenave të luftës, të karaktereve të ndryshme nga fronti i popullit si edhe nga ai i armikut autori ia del mbanë me gjuhën e një narracioni të rrjedhshëm dhe, në shumicën e rastëve, të këndshëm.

Me personazhin qëndror të veprës, Mersinin e vogël që rritet bashkë me Luftën, autori lidh gjithë personazhet e tjerë, të cilët marrin një vlerë të pavarur, zenë një vend të rëndësishëm apo episodik. Kjo mënyrë kompozimi, me një figurë që lidh e gërsheton ngjarjet është e njohur në romanin klasik të realizmit si dhe të realizmit socialist. Romani i Sh. Musarajt është tipik për personazhet e shumtë, për skalitjen, skicimin e vizatimin e tyre. Në këtë vepër nuk kanë vlera të barabarta artistike të gjitha figurat, por ka mjaft që të mbeten në mend dhe vizatohen bukur me jetën, me botën e tyre të brendshme, me preokupimet dhe ndjenjat që kanë, duke dalë përpara nesh ashtu fare natyrshëm, pa asnjë shtrëngim apo «këmbëngulje» nga ana e shkrimtarit.

Në romanin e ri të Sh. Musarajt krijohen figura komunistësh, udhëheqësish partizanë si Belxhiku. Krahas tij përmenden edhe të tjerë si Shqiponja (autori përdor pseudonimet e tyre, gjë tipike për kohën e luftës), po këta zenë më pak vend. Me figurën e Belxhikut shkrimtari na jep një drejtues komunist dhe partizan të dashur me njerëzit, shumë të vëmendshëm

ndaj Sinos, djalit të vogël që e nxorën në luftë hallet e popullit, ndaj xha Qerimit dhe gjithë të tjerëve. Figura e tij vizatohet nga disa anë dhe na jepet në çaste të ndërlikuara të luftës ideologjike e politikë me armikun, me njerëzit e Ballit dhe me pikëpamjet e Xhepit, në beteja kur ai udhëheq me gjakftohtësi, me përvojën që ka fituar. Besua (Belxhiku) bëhet një personazh i rëndësishëm dhe i dashur për lexuesin, ai mbart peshën kryesore ideologjike të veprës. Megjithatë, për një figurë me përmasa të tilla, do të ishte nevoja për një trajtim edhe më kompleks, duke na dhënë më tepër botën e tij dhe udhëheqjen në veprim, përmas disa çasteve dramatike, tipike për luftën, ku të spikaste edhe më mirë karakteri i tij. Megjithëse të nevojshme në shumë raste, bisedat dhe debatet në këtë roman mund të zinin më pak vend, sepse nganjëherë dalin disi agjitative dhe e ulin interesin e leximit. Janë të njohura fjalët e Manksit për rëndësinë që kanë figurat e udhëheqësve revolucionarë në një vepër, për të hedhur tek ata një dritë rembrandiane, e për t'i bërë kështu sa më realiste. Këto janë vetëm vërejtje të pjesshme për figurën e Belxhikut, autori duhet përgëzuar për iniciativën e mirë që të ndriçojë këto ngjarje dhe figura të Luftës Nacionalçlirimtare.

Ka mjaft çaste emocionuese, të bukura në vepër që lidhen me figurat e Mersinit, të xha Qerimit, teto Kallisë, Trëndelinës dhe shumë të tjera, si skenat e burgut, ku përshkruhen e portretizohen me mjeshtëri katër shokë me përpjekjet e tyre për të hapur një kanal e për të ikur nga burgu si edhe çasti kur dalin në ajër të pastër, në jetën e lirë partizane etj. Mbyll librin dhe të mbeten të paharruara shumë pamje e çaste, të duket sikur dëgjon zërin e xha Qerimit, atij plaku simpatik që lufton bashkë me të rinjtë, gjithmonë i palodhur dhe me humor të mirë. Autori e vizaton disa herë bukur: kur ndahet nga partizanët, duke nderuar me grusht ndanë pyllit, kur gjen nusen e djalit, Hatikën me fëmijën në duar, kur mallëngjehet

për partizanin italian Salvatore Xhonkarlon dhe thotë se duhet të varroset siç i ka hije partizanit «ky Salvatore-ziu», duke e bërë kështu me epitetin «ziu» krejt të vetin, si djemtë e popullit tonë, — dhe në shumë raste të tjera. Vdekja e tij është prekëse, ajo vjen në faqet e fundit të romanit, që kurorëzohet me fjalët e Belxhikut për të: «Ç'vdekje e bukur».

Bukuria e ndjenjës, e marrëdhënieve etike, e heroizmit të konceptuar me realizëm dhe pa bujë, të bëjnë përshtypje në këtë roman. E mbyll librin dhe përpara syve të dalin pyjet dhe livadhet ku mblidheshin e këndonin partizanët, lëvizja e përhershme e tyre në kërkim të lirisë dhe të debimit të armikut, takimet mallëngjyese të shokëve, të partizanëve me popullin dhe ajo dashuri fare e thjeshtë dhe shumë e pastër e Sinos me Trëndelinën, vajzën e xha Pandit. që spikat disi me druajtje po e sigurt në shpellë ndërsa Sinua përmendet pas plagës që kishte marrë në luftë dhe sheh Trëndelinën që i rri te koka. Kështu të kujtohen edhe xha Koli me tregimet e tij në burg për vajzën e vdekur, Serafinën, teto Kalia, Leveni me të fejuarën dhe historia e ndërlikuar e lidhjes së tyre etj.

Autori ka mundur të japë mirë në këtë vepër mjaft skena luftimesh sidomos atë kur Sinua hyn për herë të parë në luftë dhe dallohet pa qenë edhe vetë shumë i ndërgjegjshëm për vlerën e veprimit të tij kur tremb fashistët etj. Këto skena përshkruhen me realizëm, pa bujë dhe hyjnë natyrshëm në konceptimin e përgjithshëm epik dhe popullor të luftës.

Siç u përmend, një vend të dukshëm zë në roman edhe lufta ideologjike, formimi i njeriut në luftë e sipër përmes qëndrimeve në situata të caktuara. Këto çaste dhe skena janë të nevojshme në këtë vepër, po duhej ruajtur ndjenja e masës që autori të mos binte në ndonjë përsëritje me romanin e vet të mëparshëm «Para agimit» dhe këto të mos ulnin sado pak ritmin e subjektit. Kështu, duhej shmangur, në ndonjë rast, agjitacioni i hapur, ndërsa ndeshjet botëkuptim-

ore, debati mund të përshkohej hora-herës nga më shumë pasion, gjë që do të buronte nga dramaticiteti i situatave. Në këtë plan e shohim edhe figurën e Milit, shokut të afërm të Sinos, njeri i vendosur e parimor në thelb, luftëtar trim, po që bie përkohësisht nën ndikimin ideologjik të Xhëpit dhe bëhet shkak për mënjanimin nga shokët gjatë një luftimi. Është mirë që në prozën tonë trajtohen edhe figura të tilla komplekse dhe këtu autori ka merita, po një depërtim më i thelluar në ndërgjegjen e tij dhe një motivim më i brendshëm, në këtë rast (pa dalë nga stili i autorit) do të ndihmonin për ta konceptuar më qartë personazhin dhe për të treguar më mirë se ç'luftë politike, ideologjike dhe morale bëri Partia për t'i formuar njerëzit dhe për të rrënjësuar tek ata ideologjinë proletare.

Këto vërejtje si edhe ndonjë çështje tjetër që lidhet me një mbingarkesë materiali vende-vende, apo me personazhe, të cilët nuk marrin atë jetë që do të pritej dhe duket ndonjëherë sikur dublojnë njëri-tjetrin, janë të pjesshme, jo thelbësore dhe nuk çënojnë të tërën realiste, të mishëruar bukur artistikisht. Vepëra të mban gjallë, ajo ka vlera si njohëse edukative, ashtu edhe të mirëfillta estetike.

Shkrimtari në këtë roman forcon ngjyrat realiste dhe kombëtare, thellohet kurdoherë në natyrën klasore të luftës, me atë veçori që kjo kishte atëherë, ai nuk pajtohet me skematizmin. Po ai demaskim i mprehtë dhe ironik për armiqtë, i «Epopesë së Ballit», apo ai thellim të «Para agimit» gjendet edhe në romanin e ri të Sh. Musarajt. Ai ka forcuar këtu në mënyrë të ndjeshme frymëmarrjen popullore të veprës, ka ditur të japë thjesht dhe larg çdo letrarizmi tipa dhe episode të paharrueshme. Kështu, të mbetet në mend pritja që u bën populli partizanëve, se si mundohen gratë të gatujnë diçka të mirë për ta, si u qëndrojnë mbi kokë kur janë të sëmurë a të plagosur, si ëndërrojnë partizanët për të ardhmen duke e përlytyruar në mënyrat më të ndryshme. Në roman bie një dritë

që sjell me vete epoka e re e Partisë, kur luftohej për Shqipërinë dhe për «botën e re» që do të lindte.

Arti na tërheq me të vërtetën që zbulon, me atë kënaqësi estetike që na jep. Rrugët stilistike të arritjes së vlerave janë të shumta, po platforma jonë estetike është e përbashkët. Dhe ky unitet parimesh ndihmon diversitetin e stileve e nuk pengon, siç duan të thonë estetët dhe propaganda borgjezo-rëvizioniste. Përvoja jonë këtë po e dëshmon vazhdimisht.

Sh. Musaraj edhe në këtë roman ka mënyrën e stilit të tij të krijimit, që qëndron përkrah stileve të tjera. Ai i jep rëndësi narracionit, i krijon karakteret më shumë përmes dialogut të mprehtë me ngjyrë popullore. Në këtë vepër ka një prirje më të dukshme nga veprimi, nga ngjarja dhe tregon më shumë vëmendje se më përpara për të gërshetuar anën politike e shoqërore, me atë etike dhe intime, duke zgjedhur detaje të thjeshta dhe të bukura. Nuk merret pothuaj ky shkrimtar me monologun e brendshëm dhe me analiza të hollësishme psikologjike. Kjo mënyrë, që krijon natyrshmëri, përcaktohet edhe nga materiali jetësor dhe synimet e autorit, po është më tepër një veçori. Të tjerë autorë ndjekin me sukses mënyra të tjera me më shumë meditime, monologje të brendshëm etj. Bukuria qëndron, midis të tjerash, edhe te larmia e stileve. Në romanin e Sh. Musarajt ka mjaft poezi, gjuhë të këndshme e të rrjedhshme, ku nuk gjen ndërtime të huaja, të sforcuara apo artificiale. Shkrimtarët e rinj, veç të tjerave, kanë shumë për të mësuar nga gjuha e Sh. Musarajt.

Megjithëse nuk është quajtur ky libër si pjesë e parë e romanit, vepra do të vazhdojë sepse edhe shtigjet janë lënë të hapura. Është përpara një etapë e rëndësishme e Luftës me pushtuesit gjermanë gjer në çlirimin e atdheut. Dhe besoj se do të ndjekim me kënaqësi fatin e Mersinit, rrugën e shokëve të tij, të Belxhikut, të Bardhyllit, të teto Kalisë, apo Trëndelinës dhe të tjerëve. Duke shfletuar faqet

e pjesës së dytë të romanit, kur të dalë, do të kujtojmë herë pas here dhe figurën simpatike të xha Qerimit, që pati një «vdekje të bukur», ashtu me grushtin e ngritur ndanë pyllit, me pushkë në krahë dhe gëzimin që ndien kur sheh nusen e djalit me nipin në duar...

1980

VLERAT SHOQËRORE DHE SHTRATI POPULLOR I NJË VEPRE

(Për romanin «Lulja e kripës» të Jakov Xoxës)

Me romanin «Lulja e kripës», të shkrimtarit Jakov Xoxa, letërsia dhe proza jonë pasurohen me një vepër të re serioze, e cila jep një pasqyrë të gjerë e të vërtetë të jetës së argatëve dhe të shtresave të tjera në një periudhë historike të rëndësishme për vendin tonë. Jakov Xoxa, autori i «Lumit të vdekur», i «Jugës së Bardhë», i novelave të para, Jakovi pedagog dhe aktivist shoqëror, që nuk është më midis nesh, na flet përsëri përmes faqeve të romanit të ri me një gjuhë të bukur e të larmishme, me realizëm e fantazi, me një dashuri të madhe për popullin e tij, për komunizmin dhe bukurinë e idealit.

«Lulja e kripës» është një vepër e gjerë me botë të pasur, me një arkitekturë origjinale që, në këtë vështrim, ndryshon disi nga veprat e tjera të autorit, duke ruajtur gjithmonë tiparet më thelbësore të krijimtarisë dhe të talentit të tij. Ky roman do të studiohet e do të analizohet më gjerë, siç e meriton. Në këto shënime unë do të dëshiroja të hidhja disa mendime dhe përshtypje të miat nga leximi e rileximi i kësaj vepre, sepse kam pasur rastin ta lexoj që në dorëshkrim e

pastaj të përpunuar nga autori me durim e këmbëngulje.

Shkrimtarin Jakov Xoxa e patën tërhequr gjithmonë tablotë e gjera të jetës, me shumë personazhe, me situata të dhëna qartë e të ndërlikuara në fatet e njerëzve, e pat tërhequr njeriu dhe natyra, gjuha e pasur popullore dhe psikologjia e popullit. Ai ishte një vrojtues i hollë i jetës e i tipave, mbledhte fakte të shumta, studionte, njihte kulturën e teorinë, mbështetej kurdoherë në mësimet e Partisë, dhe ndërtonte pastaj ngrehinën e veprës së vet ku, si ke hyrë brenda e ke soditur pastaj nga larg, fiton admirimin për këtë punë të madhe, sa të frymëzuar aq edhe të mirë.

Romani «Lulja e kripës» është një vepër që përkshkruan jetën e kripores, të fshatit Naforë, duke nisur që nga legjenda për të, te historia reale që fillon prej 1940-ës e gjer në veprimtarinë antifashiste revolucionare pas formimit të Partisë, me demonstrata, shpërndarje traktesh e ndjekje me italianët fashistë e me milicët. Në këto përpjekje morën pjesë të mëdhenj e të vegjël, burra e gra.

Me pak fjalë, mund të thoshim se ky roman i vëllimshëm është një pasqyrim artistik i jetës shoqërore, i shpërbërjes ekonomike të një familjeje ku ka sunduar arkondi i madh (Grigor Dosari, shfrytëzues dhe amoral, grabitës i pasurive të fshatarëve dhe i nipërve të tij), i marrëdhënieve të ndërlikuara klasore, i pasurimit të një pakice, në njërin anë, dhe i varfërimit të shumicës së madhe të njerëzve, në anën tjetër. Ky proces i borgjezimit dhe proletarizimit, i shpjeguar nga pozita marksiste, kapet me thellësi nga autori dhe analizohet përmes një analize sociale, me detaje artistike të shumta, me fate individësh si Llambro Dosari, i cili, për shkak të qëndrimit dhe sjelljes së të ungjit pasanik, arkondit, është hedhur në varfëri të plotë dhe në një mjerim familjar, sepse e shoqja nuk bëri fëmijë dhe kjo e shpie familjen në një traumë, në qëndrime patologjike në kushtet e thasethemëve dhe të paragjyqimeve në fshat. Prej kësaj

gjendjeje tragjike ata lehtësohen disi kur hyjnë në mes ngjarjet e luftës dhe kur Petriti, komunist, ndihmon për të kuptuar pse gruaja e Llambros Dosarit u shndërrua në një Grua të Mallkimit, që rri e mbyllur dhe nëm tërë njerëzinë. Mundet që romani disi largohet nga vija themelore dhe merret shumë me këtë patologjizëm, por, në thelb, ngjarja është tronditëse dhe, sado e përçunduar dhe «përrallore», duket në pamjen e parë (edhe mbyllja e Llambros në kasolle dhe «filozofimet» e tij shkojnë në po këtë linjë), në të vërtetë kuptimi dhe shpjegimi i kësaj që ndodh është i qartë dhe i thjeshtë: lakmia për pasurim dhe imoraliteti i klasave të pasura, i arkondit të madh, në këtë rast, egoizmi i tij dhe injoranca shkaktojnë tragjedi të rënda dhe u sjellin njerëzve aq shumë dëshpërim dhe helmim, sa mund t'i gjymtojnë edhe psikikisht. Në bisedën me Petritin, në demonstratë kur ajo ngre kufomën e një fëmije të vdekur në duar, si protestë kundër urisë dhe pushtesve, zbulohet përpara nesh bota shpirtërore e Gruas së Mallkimit, e Patrës, në ndiejmë zemëbardhësinë e saj dhe fatin e mjeruar të gruas shqiptare në të kaluarën, përmes elementeve realiste, po edhe zmadhimit e nënvizimit të dukshëm të një ideje nga ana e shkrimtarit për qëllime të caktuara ideoemocionale.

Ky shtrat kryesor i veprës, shtrat social, i analizave të marrëdhënieve klasore, ndërthuret me shtratin patriotik, të Luftës Nacionalçlirimtare, që hyn në subjekt sidomos pas formimit të Partisë me përfaqësues si, Petriti, Peri i Këputur. Ylviu etj., që mbajnë peshën e kësaj lëvizjeje dhe bëhen përkrahje e mbështetje morale e argatëve dhe e fshatarëve. «Lulja e kripës» nuk mund të quhet aq një roman i mirëfilltë për luftën, se sa një gërshetim i anëve të rëndësishme sociale, i degëzimeve klasore, i fateve të personazheve në jetën e përditshme me ngjarjet e luftës, me veprimtarinë dhe meditimet mbi luftën dhe komunizmin. Nga kjo pikëpamje J. Xoxa sjell diçka të re, të parrahur prej tij më parë në këto përmasa; elementin polemist, të debatit ideologjik që mbush skena të tëra

dhe, në disa raste, ndërton subjektin e veprës. Ky debat bëhet edhe më shpesh midis dy vëllezërve, Petritit, si mbrojtës i zjarrtë i luftës dhe i komunizmit, në njërën anë, dhe Miltos, i cili pat shëtitur në Evropë e pat simpatizuar diçka edhe marksizmin, po tani është bërë një renegat dhe një tip i sëmurë sensual. Ky njeri mbi gjithçka vë dashurinë për Ermionin, një «bukuroshe» e përdalë dhe vjell vrer kundër ideve të komunizmit. Fëmijët e tij, Pacin dhe Majin, i bëri me vete Petriti si dhe vetë ngjarjet e luftës, kështu ata nuk hyjnë në batakun e mikroborgjesisë. Autori kap këtë anë të luftës; kanë ndodhur raste kur fëmijët janë shkëputur nga prindërit.

Kjo besohet aq më tepër se ata janë fëmijë dhe nuk bien doemos nën ndikimin e të atit, kanë një nënë shpirtmirë, Mellaninë, që vuan e torturohet nga i shoqi, rreth tyre ngjarjet veprojnë për mirë dhe i ungji, Petriti, ka një ndikim shpirtëror tek ata. Zgjidhja të tilla të ndarjeve brenda një familjeje janë të besueshme dhe realiste në një vepër letrare kur shpjegohen mirë, motivohen. Pikërisht, me një rast të tillë kemi të bëjmë edhe në këtë roman. Petriti, si mekanik, përqafon lëvizjen dhe hidhet në luftë me të vëllanë. (Linja e Miltos me Ermionin mund të zinte më pak vend në roman dhe mund të kishte më pak përshkrime të jashtme.)

Në roman nuk ka aq shumë personazhe në krahasim me vëllimin e faqeve. Autori ka punuar me ata kryesorët, i ka skalitur dhe mbahen mend mirë. Kështu ndodh me Perin e Këputur dhe të shoqen, Sotirën, të cilët janë të lidhur nga një dashuri e singertë dhe e thjeshtë; me Petritin e Fanullën, që duhen dhe kanë për njëri-tjetrin ndjenjë të pastër, me Llambron dhe Patrën. Të mbetet në mend Pavlo Dosari e sidomos fundi i tij kuptimplotë kur hedh në erë mauzoleun, ku ka dashur të varroset me nderime arkondi i madh, duke zhvarrosur të vëllanë, si për t'i dhënë fund pushtetit të arkonëve dhe agallarëve; Pavloja vritet duke gjuajtur mbi milicët etj. J. Xoxa ishte një shkrimtar me aftësi të

madhe përshkruese, narrative, me një plastikë të rrallë në gdhendjen e personazheve, të cilët kanë anët e tyre të shumta dhe të larmishme dhe nuk janë aspak skematikë. Ata jetojnë, hyjnë në marrëdhënie të caktuara, punojnë, kanë jetën vetjake, diskutojnë e filozofojnë në mënyrën e tyre, duan natyrën në gjirin e së cilës rrojnë, vozitin me barkë, shkojnë për peshkim, punojnë me teknikën, ndajnë trakte etj.

Sfondi realist i veprës së J. Xoxës mbështetet në një dialektikë marrëdhëniesh, ndjenjash e rrahje pikëpamjesh. Personazhet kryesore janë njerëz të thjeshtë; elementi i ri punëtor, argatët e fshatarët, gratë punëtore dhe të ndërshe. Këta hyjnë në marrëdhënie e në luftë me përfaqësuesit e shtresave të pasura, me armiq, me fashistë e renegatë, tregtarë e spekulatorë që i pille ajo kohë. Dhe kurdoherë del e kthjellët forca morale e popullit, drejtësia e tij, hallet dhe mjerimi në të kaluarën. Revolucioni erdhi si një dritë e re, si një frymë optimiste, që nuk ishte ndier më parë, për t'u hapur njerëzve horizonte të reja, për t'u dhënë shpresë e lumturi. Shkrimtari ishte një realist i thellë dhe nuk binte asnjëherë në deklarata e ilustrime, as nuk kalonte në nxirje të realitetit. Në këtë vepër të tij mund të ketë vende të zgjatura, personazhe anësore që nuk lënë gjurmë, ndonjë teprim me arsyetime, po frymëmarrja e përgjithshme është realiste, e vërtetë dhe me brendi të thellë. «Lulja e kripës» është ndofta një vepër që kërkon vëmendje në të lexuar dhe nuk shquhet kurdoherë për linja «tërheqëse». Po kam bindjen se kur hyn në të, njihesh me personazhet dhe fatet e tyre, e sheh jetën në shumëllojshmërinë e saj, futesh në bukurinë e peizazhit të preferuar prej autorit, atëherë kupton më mirë vlerat e romanit dhe thellohesh në domethënieën e tij.

Së fundi, duke mbyllur këto shënime të shkurtra, desha të shtoj disa radhë për konceptimin e figurshëm, poetik hera-herës të veprës, të zhvilluar kryesisht në plan narrativ tradicional (në kuptimin e formës). Ka

qenë karakteristike për autorin edhe në romanet e tjera të kërkonte një figurë qendrore, një simbol që lidhej me përfytyrimin e ngjarjeve dhe kuptimin e veprës: «lumi i vdekur», «juga e bardhë» dhe «lulja e kripës». Kjo lule e kristaltë spërkatet me gjakun e fëmijëve, që nuk durojnë sëpatën fashiste. Kriporja duket si një varrezë e argatëve me shkretinë dhe shterpësinë e saj. Legjenda e krijimit të Naforës bën fjalë për stërkungujt e egër dhe për shterpësinë, së cilës gjatë veprës i kundërvihet ideja e dashurisë dhe e pjellorisë. Proza e një stili realist vende-vende përzihet me legjendën, me përrallën ose konceptimin konvencional, hiperbolik, duke u mbështetur në mendimin dhe fantazinë popullore. Ky gërshetim i jep veprës larmi stilistikore dhe pasuron imagjinatën e lexuesit.

Duke lexuar romanin «Lulja e kripës» ne bindemi për vlerat e tij, për frymën popullore e partishmërinë e veprës, për punën kolosale, të frymëzuar e të imtë të autorit dhe kujtojmë me nderim njeriun dhe shkrimtarin, vepra dhe emri i të cilit janë të paharruara për të gjithë lexuesit dhe shokët e tij.

TRIUMF SHPIRTËROR I POPULLIT

(Mbi filmin «Gjeneral gramafoni»)

Përparimi i kinematografisë sonë, vështrimi realist i jetës që zotëron në të, idetë revolucionare që e përshkojnë, flasin për forcën e të ardhmen e artit tonë të realizmit socialist; ato dëshmojnë edhe për një të vërtetë të madhe estetike, të pohuar gjithmonë te ne, se zhvillimi, ecja përpara bëhen me sukses brenda parimeve të shëndosha të një arti që nisët nga partishmëria, nga interesat e popullit dhe nga shikimi marksist-leninist i proceseve historike të shoqërisë. Filma artistikë e televizivë që kanë dalë vetëm dy vitet e fundit, si «Udha e shkronjave», «Njeriu me top», «Nga mesi i errësirës», filma dokumentarë, si «Lumja ti, moj Shqipëri», si edhe të tjerë që kanë dalë e do të dalin së shpejti, flasin për këtë përparim, për nivelin e ngritur të këtij arti masiv kaq shumë të pëlqyer te ne e që është pritur mirë edhe nga spektatorë të huaj.

Filmi «Gjeneral gramafoni» është një arritje e re e kinematografisë sonë. Ky film mendoj se radhitet ndër më të mirët që janë krijuar në vendin tonë. Bukuria dhe forca e një vepre të mirë artistike qëndrojnë në rikrijimin e gjallë e me partishmëri të realitetit, në mpleksjen e natyrshme e të harmonishme të fakteve jetësore me idetë, me emocionet, me përjetimet e

brendshme të heronjve që kalojnë në ndërgjegjen e shikuesve me kontrastet dramatike. Filmi «Gjeneral gramafoni», me mendimin e rëndësishëm dhe emocionues që bart, me origjinalitetin e tij në konceptim si skenar e regji, me lojën e bukur të aktorëve etj., të fut në botën e vet artistike, e cila është krijim përtëritës i një cope të realitetit të dikurshëm, realitet i hidhur plot drama e dhembje, por edhe me bukurinë e shpirtit të popullit e me ndjenjën e protestës kundër çdo agresioni ideologjik e kuturor, që përgatit terrenin për agresion ushtarak e politik.

Subjekti i filmit është orgjinal dhe i parratur, krejt i besueshëm e i qartë, i përshtatshëm për të konkretizuar idetë, për të skalitur tipa e mjedise, për të dhënë disa kulme kontrastuese si dhe dramën e brendshme e shpirtin kryengritës të njeriut të thjeshtë, disa vjet para pushtimit fashist, kur shoqëria vajguore italiane AIPA që vendosur në Shqipëri dhe kur fashistët bënin përgatitje për të fituar nga brenda shpirtin dhe ndjenjat e popullit, gjë që nuk mundën ta arrinin kurrë, me gjithë dyert e hapura nga qeveria e Zogut dhe klasat sunduese.

Vija zotëruese në subjektin e këtij filmi është ajo e muzikantëve të popullit, që u bien me frymëzim motiveve popullore, të bukura e të thella, emocionuese gjer në çaste tronditëse, motive që tingëllojnë si një simfoni e pavdekshme, duke shprehur dertet e hallet e njerëzve të thjeshtë, tragjizmin e jetës së asaj kohe, si dhe notat lirike dhe heroike, të shpresës e të besimit në të ardhmen, ndjenja që nuk i kanë munguar kurrë shpirtit të popullit edhe në kushtet e mjerimit e të jetës më të rëndë. Këta njerëz, kjo muzikë e pastër dhe e vërtetë, në kuptimin më të thellë estetik, hyjnë në konflikt me përfaqësuesit fashistë, me të dërguarin e fashizmit që vjen për të përhapur muzikën e sheqerosur e pa shije, prodhim i dekadencës e i pseudo-sentimenteve të asaj kohe, si dhe me qëllimin e fshehtë për të njohur gjendjen e për të luajtur një rol së

bashku me përfaqësuesit e AIPA-s e të tjerë në pushimin e mëvonshëm të Shqipërisë. Kjo vijë subjekti lidhet me punën e punëtorëve në pusët e vajgurit, me jetën e popullit, me përgatitjen e lëvizjes punëtore, që del në sfond e ngrihet në mënyrë të dukshme në mbylljen e filmit.

Lufta kundër çdo agresioni, kundër pilulave të sheqerosura nga jashtë por me helm brenda, për ruajtjen e pavarësisë, të traditës së shëndoshë, të personalitetit të njeriut dhe të të drejtave kombëtare, përbuzja e dredhive të huaja dhe triumfi i shpirtit të popullit — këto do të përbënin idetë më të rëndësishme që përçon filmi te masat e spektatorëve. Këto ide kanë vlerë sa historike aq edhe aktuale. A nuk janë të ngjashme me skenat e këtij filmi përpjekjet e sotme të superfuqive, të vendeve borgjeze e revizioniste, që mundohen të shpien «kulturën» në emër të «madhështisë» të vendeve të tyre te popujt më të vegjël? A nuk të kujtojnë këto skena vërshimin e sotëm të muzikës formaliste, të filmave të degjeneruar, të veprave komerciale, si dhe rezistencën e popujve, kundërshtimin e tyre me luftë të armatosur, por edhe përmes kulturës popullore e kombëtare?

Filmi të tërheq me vërtetësinë e ambienteve, me atmosferën, dialogun e goditur e lojën e natyrshme dhe realiste të aktorëve. Shtëpitë, rrugicat, ura me harqe të bukura, feneri që ndizet në mbrëmje, kalldrëmet me shtëpi të futura, një gërnëtë që dëgjohet në muzg, vajza e kafexhiut që ujit saksitë me lule në dritare dhe shumë detaje të tjera të futin në një atmosferë të veçantë dhe të bëjnë të jetosh me ngjarjet e filmit. Ideja mbrohet pa bujë, pa fjalë të shumta, përmes veprimit të matur, përmes kontrasteve muzikore e çasteve dramatike. Të tilla janë, p.sh. prishja e dasmës me varjen e dy patriotëve dhe kabaja e dhembjes që lind vetvetiu për kujtimin e tyre, arrestimi i plakut me bastun, që luftonte me mënyrën e tij, çasti kur muzikantët popullore ia marrin këngës së Çerçiz Topullit në mbrëmjen

e organizuar nga të huajt, përlëshja në Ditën e Flamurit e të tjera skena.

Për të gjitha këto kanë meritë të veçantë skenaristi Vath Koreshi, i cili, veç konceptimit letrar, ka përdorur gjuhë të bukur dhe dialog të natyrshëm e poetik, regjisori V. Gjika, që e ka ndërtuar me mjeshtëri materialin dhe ka mundur të krijojë një vizion të plotë e të larmishëm në unitetin e vet. Por një vend të veçantë në këtë film ka muzika, për vetë subjektin që trajtohet. Këtu ka një meritë të dukshme kompozitori A. Peçi, i cili ka ditur të zgjedhë dhe të përpunojë muzikë popullore të përshtatshme, depërtuese. Kjo është arritur me interpretimin e muzikantëve popullorë të talentuar e plot frymëzim, si Laver Bariu etj., të cilët të prekin me kabatë dhe meloditë e tyre. Muzika nuk është thjesht një komponent i filmit, ajo hyn në dramaturgjinë e tij dhe shërben për të dhënë mendimin kryesor politik e shoqëror. Por këtu kemi të bëjmë edhe me një problem të mirëfilltë estetik të një rëndësie më të gjerë: muzika e popullit, që lind nga ndjenja të vërteta as që mund të krahasohet me këngët mikroborgjeze me të cilat dëfrenjë shtresat e larta dhe vetë fashistët. Edhe folklori i shpëlarë, i neveritshëm e banal i shtresave të degjeneruara, që donin të na servirin të huajt, bëhet qesharak dhe nuk i qëndron dot përballë folklorit të vërtetë popullor. Kompozitori ka ditur të krijojë edhe muzikën e tij të kultivuar, që shoqëron e interpreton ngjarjet. Muzika e tij merr ngjyra dramatike e satirizuese në skenën e fundit të përlëshjes, kur përqeshen këngët fashiste e mikroborgjeze dhe i këndohet heroizmit të popullit.

Një punë shumë të mirë kanë bërë aktorët, të cilët, me lojën e tyre, të lënë mbresa të paharrueshme; Bujar Lakoja, në rolin e Halit Beratit, mjeshtrit të gërnetës, interpreton me thellësi, me një lojë të brendshme, ai flet me vështrimin e tij, e ndien këngën nën ndikimin e ngjarjeve që rrjedhin dhe të fjalëve që i thotë shoku i tij, Nasi, anëtar i grupit komunist. Aktori Guljem Radoja, në rolin e italianit, «gjeneralit — gra-

mafon», krijon në mënyrë bindëse tipin e një fashisti mjaft dinak e të zgjuar, me një vështrim herë tinzar e të shtirë, herë të egër e prepotent. Një rol tjetër original shtoi në vargun e tipave të krijuara prej tij aktori Kadri Roshi, si muzikant plak, i varfër, me fat-keqësinë e djalit të gjymtuar në punë dhe të braktisur nga AIPA, por jo nga shokët. Ai është i ndryshëm sipas momenteve, njerëzor, i besueshëm në halle dhe i singertë në protestën e tij. Tipa të gjallë krijojnë edhe Sulejman Pitarka, Tinka Kurti, Stavri Shkurti, Reshat Arbana, Sheri Mita, aktorja amatore Mimoza Topulli etj.

Filmi «Gjeneral gramafoni» është një realizim i ri i bukur i kinostudios «Shqipëria e re», i kolektivit të saj krijues, dhe një premtim për filma të tjerë të frymëzuar.

1979

ATA KISHIN NJË NËNË TË MADHE

(Shënime për filmin «Lulëkuqet mbi mure»)

Arti i kinemasë, me natyrshmërinë dhe dinamikën e vet, me mundësitë e shumta të kapjes së jetës, është bërë shumë i dashur për të gjithë dhe një mjet i drejtpërdrejtë e i shpejtë i përcimit të ideve dhe emocioneve pozitive që ndihmojnë në edukimin e njeriut.

Filmi i ri «Lulëkuqet mbi mure», sipas skenarit të P. Qafëzezit e Dh. Anagnostit, me regjisor Dh. Anagnostin, është një tregim dhe dramë kinematografike prekëse që lë gjurmë të thella në zemrën e spektatorit, i cili mëson nga ajo kohë e luftës, në atë mjedis që pasqyrohet, i zgjohen mendime dhe del nga kinemaja, pasi ka përjetuar çaste të vërteta të një botë dhe kohe të përcaktuar.

Subjekti i filmit zë fill nga motive të romanit për fëmijë «Bonjakët» të shkrimtarit P. Qafëzezi, i cili ka qenë dëshmitar i atyre ngjarjeve (ja edhe një provë tjetër për të treguar se jeta e njohur apo çastet e përjetuara thellësisht mund të dalin mirë e të besueshme në një vepër arti, për të mos bërë as truke artificiale e për të mos rënë në nota libeske). Filmi ka gjetur gjuhën e vet sipas një skenari të përshtat-

shëm, që nuk vuan nga tepëri e fjalëve apo nga mbingarkesa e situatave. Dhe, pa dyshim, merita është e të gjithëve, e autorëve kryesorë të filmit dhe e aktorëve, e fëmijëve aq të dashur e simpatikë. por duhet thënë se këtu bie në sy qartë puna e madhe krijuese, me logjikë të fortë e ndjenjë që buron së brendshmi, e regjisorit Dh. Anagnosti. Merita e filmit, e gjithë kolektivit krijues duket në rikrijimin e kohës dhe të mjedisit, në zbulimin e ideve plot patos antifashist dhe humanizëm të ri revolucionar; kjo del e qartë në zgjimin e ndjenjës së protestës tek fëmijët jetimë, dy herë të goditur: nga fatkëqësia shoqërore dhe nga fashizmi që donte t'i bënte skllëvër të vet, që e quante veten «shpëtimtar» i këtyre të mjeruarve. Afrimi me Lëvizjen Nacionalçlirimtare, idetë e Partisë që hynin edhe prapa murave të larta të jetimores, njerëzit që i shpinin këto, si djaloshi punëtor Aliu (luajtur natyrshëm e thjesht nga gjimnazisti A. Kote) apo mësuesi patriot e komunist, — bënë që fëmijët të njohin veten e tyre, të fitojnë dalngadalë ndërgjegjen patriotike e revolucionare. Ky zgjim i ndërgjegjes është një kapërcim shumë i rëndësishëm në botën e fëmijëve; njeriu i mjeruar dhe i përbuzur në shoqërinë me klasa antagoniste, fëmija që ende s'ka fituar personalitetin e vet, i ndritur nga agimet e një jete të re që niste, e cila do ta shpëtonte nga shtypja shoqërore dhe morale, u nis të marrë frymë lirisht, në fillim me druajtje, pastaj më me guxim dhe të hyjë në jetë me të drejtat më të plota. Pjekuria e thjeshtë e, vende-vende, tronditëse e filmit qëndron pikërisht te realizmi i tij, tek ajo vërtetësi që ndihet në sytë e fëmijëve me kokat e qethura, në palltot bojëhiri; ajo ndihet në cinizmin apo demagogjinë e armikut, në kalimet nga një gjendje shpirtërore e rëndë dhe tragjike në një shpërthim heroik, nga dramaticiteti në çaste komike, përmes antitezash të gjetura, duke ruajtur kurdoherë një atmosferë dhe ton të përgjithshëm, të përshtatshëm për temën dhe pro-

blemin që trajtohet. Bukuria e artit qëndron te harmonia e jetës, te shmangia e çfarëdolloj monotonie apo uniformiteti, te pasqyrimi i karaktereve dhe situatave me ngjyrat dhe plasticitetin e vet. Pa asnjë teprim, do të thoshim me bindje se filmi «Lulëkuqet mbi mure» është ndër krijimet më të mira të kinematografisë sonë, një vepër e bukur artistike e viteve të fundit ku, në thjeshtësinë dhe natyrshmërinë e tyre, pleksen këto elemente estetike që japin kënaqësi të vërtetë, në një film që mbron idenë e luftës kundër fytyrës çnjerëzore të fashizmit; kundër meskinitetit, idenë e protestës dhe të revoltës kundër padrejtësive shoqërore, idenë e lirisë së vërtetë të fëmijës.

Që në fillim kur kamera (e përdorur me mjeshhtëri në këtë film nga operatori P. Kallfa) afron muret e shtëpisë së jetimëve dhe ndalon tek tabela «Streha vorfnore», ndihet një vështrim realist dhe funksional. Ndërsa muzika e K. Laros, me nota depërtuese, paralajmëron se diçka prekëse njerëzore do të ndodhë në këtë Strehë, spektatori hyn në atmosferën e filmit. Dihet se atmosfera në një vepër arti sidomos në film, prozë e dramë lot rol të madh e lidhet me brendinë e me formën, me raportin midis karakterit dhe mjedisit, me ato hollësi që përgatisin gjendjen shpirtërore, ku do të zhvillohet episodi, drama, zbulimi i ndjenjave të brendshme apo veprimi. Në këtë film i jepet rëndësi atmosferës; momentet kyçe përgatiten bukur me një shtrirje të qetë e të ngadalshme në dukje, por me ritëm të brendshëm që pastaj del në sipërfaqe dhe arrin të prekë thellë.

Në film janë krijuar karaktere të vërteta sipas materialit të skenarit, me punën e regjisurës dhe, natyrisht me punën e madhe dhe krijuese të aktorëve. Filmat mund e duhet të jenë të ndryshëm, me një thurje më të ngjeshur apo më të shtrirë, po kryesore është që veprimi të ruajë unitetin e vet dhe t'i nënshtrohet idesë themelore që zotëron. «Lulëkuqet mbi mure» është një film me kompozicion të përqendruar: kamera ngulet në atë strehë vorfnore, del disi edhe

në rrugë e diku gjetkë po aty brenda lëvizin dritat dhe hijet e saj. E kjo është një mënyrë e përshtatshme për këtë subjekt që lejon të thellohesh, të hysh në karaktere dhe episode, të cilat nuk shkapërderdhen po përmbliidhen rreth disa momenteve. Që nga rrëzimi prej fëmijëve, në shenjë hakmarrjeje, i kujdestarit shpirtkazëm dhe servil (interpretuar me mjeshtëri nga aktori i njohur Kadri Roshi, i cili fliste me çdo detaj, me çdo shikim), gjer te vrasja e Sulos, fëmijës që nuk pranoi të spiunojë shokët dhe doli nga «streha», ndër- sa patrulla fashiste e qëlloi, te shpërndarja e trakteve nga fëmijët dhe pjesëmarrja e disave në veprime më të rëndësishme antifashiste, — filmi vjen duke u ngritur. Në kuadrot e fundit të filmit ne nuk kemi përpara fëmijë të braktisur nga fati, po fëmijë që janë radhitur ose do të radhiten së bashku me popullin e me fëmijët e tjerë në rreshtat e luftës e të njerëzve me personalitet e botëkuptim të qartë, që do të formonte revolucionin.

Filmi nuk përpiqet të thërrasë e të «derdhë» emocion në çdo çast. Kjo nuk do të ishte jetësore dhe as artistike. Ai, siç u përmend, duket i shtruar, po ka disa kyçe dramatike dhe momente shpërthimi që vij- në të përgatitura dhe prandaj ia arrijnë qëllimit. Mo- menti i parë është qëndrimi i mësuesit të shqipës, nje- ri i partisë që zbulohet dalngadalë para fëmijëve, pa- si i kanë përdorur këta për të shuar parullat antifa- shiste natën. Ky fakt është i dhimbshëm dhe shqetë- sues. Në klasë ka heshtje. Mësuesi lexon një vjershë të Naimit për tradhtarët. Qortimi është i menduar, i ma- tur dhe kjo i trondit fëmijët: ata nuk do të pranojnë më t'i shërbejnë fashizmit. Momenti i dytë emocio- nant është ai kur Suloja ngashërehet natën, ndërsa shokët flenë, sepse nuk do të bëhet spiun dhe kujdes- tari e torturon vazhdimisht si edhe vdekja e tij, vra- sja nga fashistët. Momenti i tretë, ku filmi arrin një kulm të rrallë tronditës, që lidh traditën me atë kohë, dhembjen me ndjenjën heroike, ku shprehet haptazi ideja qendrore e filmit se ata nuk janë jetimë, se ta-

ni ka një nënë që i do dhe i mbro, Partia — është ai kur lulet vendosen në vendin bosh të bankës kurrinte Suloja dhe një nxënës fillon të lexojë vargje të Nolit, të cilat i pason mësuesi, duke shprehur me ndjenjë shumë të fuqishme, një indinjatë të thellë njerëzore kundër vrasjes e duke bërë thirrje për t'u ngritur në luftë kundër fashizmit dhe tiranëve. Fëmijët në klasë, e dëgjojnë mësuesin me sy të mençur, me shikim të mprehtë e të revoltuar. Ata nuk janë jetimë kokulur, po fëmijë të guximshëm, që po kuptojnë të vërtetën. Në gjithë lojën e tij të thelluar, të përmbajtur e plot pasion, aktori T. Flloko, duke interpretuar mësuesin e shqipes (figurë shpeshherë tipike e patriotit revolucionar gjatë luftës) krijon një hero pozitiv për t'u admiruar, me një potencial ndjenjash të vërteta. Mendja të shkon te forca e madhe edukative dhe emocionuese e heroit pozitiv, kur vihet në situata të goditura dhe kur përjeton dramën, mendimin, revoltën e vërtetë ndaj së keqes apo gëzimin e çiltër ndaj çdo gjëje të mirë.

Të gjithë aktorët luajnë mirë në rolet e tyre. Veç atyre që u përmendën, kanë vërtetësi, ngjyrë dhe të folur të goditur e shprehës aktorët A. Qirjaqi (i qartë, me logjikë e nuanca që japin karakterin e një drejtori fashist), A. Kristofori, L. Qerimi, P. Mani. Edhe E. Dauti e L. Laska, në rolin e njerëzve të thjeshtë të popullit që përkrahin fëmijët dhe urrejnë fashizmin, lenë mbresa te spektatori. Siç thamë, i paharruar është roli i kujdestarit cinik e hakmarrës që interpreton K. Roshi.

Puna e piktorit N. Prizreni i shkon fare mirë stilit të filmit, thekson me realizëm mjedisin dhe ndihmon në krijimin e asaj kohe dhe të atmosferës që përshkon veprën kinematografike.

Fëmijët me lojën e tyre të natyrshme dhe ekspresive, janë shumë simpatikë. Veçanërisht S. Zaimi (Jaci), E. Zhaku (Lelua) dhe K. Arifi (Sulua) mbajnë një peshë të rëndësishme në film dhe kanë një shpirt të

vërtetë prej artisti. Puna regjisoriale me gjithë masën e fëmijëve, prirja e tyre natyrale që flet për një botë të brendshme të pasur (bij të një populli të talentuar) kanë dhënë rezultate të bukura.

Me filma të tillë kinostudioja «Shqipëria e re» ecën në rrugën e filmave të saj më të mirë, duke sjellë edhe ngjyra të freskëta e të reja.

1977

DISA MENDIME PËR KRITIKËN

Zhvillimi i gjinive letrare dhe raportet që janë krijuar midis tyre, problemi i konfrontimit të letërsisë me jetën, me shoqërinë si edhe problemet e ndryshimeve në strukturën e veprave, kanë shtruar detyrën e një përparimi më të dukshëm edhe në fushën e kritikës letrare e të kritikës përgjithësisht.

Nëse letërsia dhe artet janë quajtur ndërgjegje e drejtpërdrejtë estetike e shoqërisë, kritika dhe mendimi teorik artistik janë quajtur ndërgjegje filozofike mbi artin, opinion i shoqërisë mbi fenomenet artistike. Prandaj, njëra pa tjetrën do të na jepnin një pamje të mangët dhe do të dëshmonin për një zhvillim të njëanshëm të kulturës. Kritika nuk ka qenë dhe nuk është «në shërbim» të letërsisë, po merr shkas prej saj. Tek ne ajo mbështetet në estetikën marksiste-leniniste, në mësimet e Partisë në të shokut Enver dhe lot e mund të lozë një rol më të madh për mbarëvajtjen e krijimtarisë.

Zhvillimi i drejtë e mbi baza shkencore i luftës ideologjike, estetike, sidomos pas Plenumit të 4-t e Kongresit të 7 të Partisë ka krijuar mundësi më të mëdha për një kritikë më të pjekur në përmbajtje dhe me cilësi më të mirë. U është bërë një luftë më konsekuente pikëpamjeve të huaja dhe teorizimeve formaliste e

moderniste, që dukeshin te ne në raste të veçanta. Është zgjeruar, ndonëse jo në masën e mjaftueshme, numri i kritikëve dhe janë shtuar interesat e studiuesve për problemë teorike dhe estetike.

Besoj se nuk gaboj po të them se arritjet më të dukshme në këtë periudhë janë vënë re në fushën e mendimit teoriko-estetik ose letrar, në fushën historiko-letrare e më pak në analizën shkencore të veprave të veçanta. Natyrisht, ka pasur dhe artikuj të mirë për vepra, po këtu ndihen mungesa. Recensionet janë edhe ato të nevojshme, po — me gjithë arritjet — shpesh dalin të zbehta, uniformë dhe nuk zbulohen sa duhet vlerat dhe të metat objektivisht. Duhet thënë se ka dhe lëvdata standarde dhe nuk kapen probleme konkrete e tek ato të përqendrohet vëmendja.

Duke folur për arritjet do të përmendim shkurtimisht librat e A. Uçit «**Labirintet e modernizmit**» apo «**Probleme të estetikës**», ku u bëhet një analizë e qartë dhe bindëse disa problemeve aktuale, si rrënjëve filozofike dhe kuptimit estetik të rrymave moderniste, fenomeneve të zhvillimit të folklorit, të filozofisë dhe artit etj.

Kështu, një arritje ka qenë në këtë periudhë dhe dalja e maketit «**Historia e letërsisë shqiptare të realizmit socialist**», ku bëhet përpjekja e parë për të dhënë procesin historik të letërsisë dhe analizohen mirë disa nga veprat më të rëndësishme prej studiuesve si K. Bihi-ku, J. Bulo, D. Siliqi etj. Natyrisht, maketi do të përpunohet edhe më tej e do të dalë si tekst, po me të hidhet një bazë që ndihmon edhe kritikën e studimit e ardhshme historiko-letrare.

Ndër kritikët që janë marrë me analizën e veprave të veçanta ose me studime dhe kanë arritur sukses do të përmendim R. Brahimin, A. Kallullin, N. Z. Tomën, D. Dilaverin, Xh. Lloshin, P. Jorgonin si dhe më të rinj si Ç. Gjokutaj, F. Malo, B. Kuçuku etj., që shkruajnë prej disa vitesh.

Në analizën e veprave ka një përpjekje për të qenë më dialektikë në lidhjen e përmbajtjes me for-

mën, po këtu mbetet shumë për të bërë që edhe kritika të jetë më shkencore, më e lexueshme dhe më tërheqëse.

Këto janë të shumta dhe ndihet nevoja për një aktivizim më të madh të të gjitha forcave, edhe të atyre që bëjnë tekste e disertacione, edhe të pedagogëve, redaktorëve e më të rinjve. Ndjekja e letërsisë korrente është një detyrë për të gjithë.

Mendoj se këto do të ishin disa detyra imediate të kritikës:

Së pari, pa hequr dorë nga artikujt problemorë e teorikë (të mbështetur më shumë mbi materiale konkrete dhe jo globale) ndihet nevoja të forcohet kritika dhe analiza e veprave konkrete, natyrisht, duke u ndalur në ato më të rëndësishmet. Shpesh vihet re këndi i ngushtë i shikimit të veprës, brenda «kopertinës» së librit, pa dalë në probleme shoqërore dhe pa e lidhur me të tërën. Kështu që bëhen vlerësime të përgjithshme për veprën dhe nuk theksohen gjërat kryesore.

Së dyti, procesi i zhvillimit letrar (dhe artistik) duhet parë më shumë si një proces lufte për progres, për të përvetësuar më mirë parimet e realizmit socialist, dukuritë e reja të jetës. Partia na mëson që kritika të jetë objektive e qartë dhe konstruktive. Ajo do të pohojë më me shumë argumente arritjet, po të mos mbyllë sytë para të metave, para dobësive ideore dhe artistike. Çdo ndikim i huaj, çdo shtrembërim estetik duhet kritikuar në kohën e vet që të mos zmadhohet. Kur kritika është e hapur, e thotë të mirën e të keqen në sy (pa përjashtuar taktin e duhur), fiton më shumë autoritet, sepse është më e partishme. Ende kritika nuk e ka bërë sa duhet metodë pune analizën objektive dhe këtu na bie barra të gjithëve që të japim kontributin tonë. Një kritikë më militante, dashamirëse po luftarake, larg indiferentizmit u takon si organeve letrare, ashtu edhe institucioneve kërkimore-pedagogjike e kritikëve ta organizojnë e ta lëvrojnë.

Së treti, duhet luftuar për një kritikë më me kul-

turë, me një gjuhë më të bukur, me logjikë e stil. Ne kemi tani një nivel të atillë arsimor e kulturor për të mos u pajtuar me mediokritetin dhe artikuj ku ndodh që edhe frazat e termat janë si të stisura.

Natyrisht, kritika ka nevojë për një bazë teorike të shëndoshë dhe të saktë. Një kritik që nuk njeh mirë estetikën, teorinë letrare apo artistike, nuk mund të bëjë analiza bindëse. Sepse një kritik nuk mjafton të thotë «më pëlqen» apo «s'më pëlqen», po të argumentojë, të shpjegojë shkaqet dhe t'i përlligjë teorikisht. Një vështrim më estetik ndihmon për të zbuluar të bukurën, unitetin e përmbajtjes dhe formës, për të pasur shije më të gjera brenda konceptit tonë, për të pranuar mënyra e stile të ndryshme dhe për të mos parapëlqyer vetëm një mënyrë të shkruari. Një kritik, estetikisht i formuar, e krahason më mirë artin dhe fenomenet estetike të jetës, zbulon thelbin estetik të veprës dhe shpjegon pse e prek gjykimin apo ndjenjën një vepër ose nuk të jep kënaqësi një tjetër etj.

Po kështu edhe njohja konkrete e materialit letrar i jep mundësi estetit të materializojë më mirë mendimet e tij.

1979

TEATËR — 1981

Vitet e fundit është ndjerë në vendin tonë një gjallërim i mëtejshëm i lëvizjes teatrale. Kërkesat e publikut janë rritur dhe niveli i vetë artit është i tillë që kërkohet një përpunim edhe më i madh. Kjo do të arrihet duke pasuruar më tej repertorin, mënyrat origjinale, si edhe me një interpretim më të mirë.

Java e teatrit profesionist u prit me interes; pati shfaqje me nivel të mirë që zgjuan emocione te spektatorët dhe krijuan një atmosferë të ngrohtë në këtë vit jubilar; tematika ishte e larmishme; trupat teatrale kishin punuar seriozisht, po, në disa raste, pati edhe dobësi.

Të gjitha shfaqjet u përshkuan nga ide revolucionare e patriotike, nga qëllimi për të dhënë karaktere e konflikte dramatike, nga dëshira e mirë për të kërkuar tema të parrahura. Duke parë shfaqjet, njeriu mendon për rrugën realiste të teatrit tonë, për frymëzimet e artit që i merr burimet nga jeta dhe për forcën komunikuese të tij.

Atmosferës së këtij viti, në prag të festave, si edhe kërkesave të artit tonë për të nxjerrë më në pah figurën e komunistit i përgjigjej shfaqja «Komunistët». Një vend të rëndësishëm, si për sasinë ashtu edhe për cilësinë e tyre, zinin shfaqjet kushtuar ngjarjeve nga his-

toria e popullit tonë, ose me subjekte të marra nga e kaluara: «Dy krisma në Paris», «Gjaku i Arbrit», «Tokë e ndezur», «Lidhur si fishekë gjerdani». U bënë gjithashtu përpjekje për të pasqyruar pamje dhe tipa nga koha jonë si komedia «Mirë se vjen, Elona», dramat «Në ditët tona» dhe «Shqetësimet e Anës».

Shfaqja «Komunistët» e Teatrit Popullor të Tiranës (dramë e R. Pulahës, regjia e P. Manit) krijoi emociione të vërteta te spektatorët edhe evokoi në skenë çaste heroike të kohës kur u formua Partia, të kalitjes revolucionare të njerëzve të popullit dhe të qëndrimit të komunistëve përballë armikut në fushën politike dhe ideologjike. Është e kuptueshme, nga shtjellimi i ngjarjeve, ne kemi të bëjmë me prototipë si Qemal Stafa e Vasil Shanto, të cilët vihen në qendër të subjektit me një trajtim të lirë e përgjithësues, përmes figurave artistike si Besimi, luajtur me pasion e energji, me diksion të qartë dhe zë dëpërtues nga Viktor Zhusti, si edhe të Aleksit (i cili zë më pak vend), interpretuar me realizëm e ngrohtësi nga Ahmet Pasha. Meritat e dramës dolën mirë në pah në shfaqje, ku regjia e Piro Manit u ndie, si edhe hërë të tjera, në krijimin e një shfaqjeje të lidhur, me ritëm të dukshëm, me ndërthurje të çasteve heroike, dramatike e komike, ashtu siç janë në jetë, duke krijuar kështu një pamje të gjallë, bindës e tërheqëse. Meritë e shfaqjes është sidomos krijimi i disa pikave kulmore, emociounese, ndonjëherë tronditëse. Këto ndihen edhe në lidhjet e ngushta shoqërore dhe intime të komunistëve me njerëzit e popullit, me familjen e thjeshtë tiranase të Ramadanit, luajtur me vërtetësi e kolorit nga Robert Ndrenika dhe të Sabrijes, po kështu të dhënë në një mishërim të qartë e të thjeshtë popullor nga Margarita Xhepa. Mbeten të paharruara çastet e Besimit dhe të Aleksit në gjyq, fundi heroik i Besimit, takimi i tij me Ramadanin, ku duken lidhjet e thella të komunistit me popullin etj. Drama zhvillohet në dy plane të lidhura me njëra-tjetrën: në planin e Luftës Antifashiste, të ndëshjeve me pushtuesin e reaksionin,

si edhe në plan ideologjik, të luftës me deviatorë. Drama është mbështetur në librin e shokut Enver «**Kur lindi Partia**», burim i madh frymëzimi për shkrimtarët dhe artistët tanë me pasurinë e fakteve dhe vërtetësinë e forcën realiste përshkruese.

Në planin e dytë, për të cilin u fol, shprehet loja e aktorit Agim Qirjaqi, që dha një tip të qartë të intelektualit pseudomarksist, mikroborgjez, njeri që mundohet të ruajë sedrën dhe që hiqet si «i urtë» po që në thelb është i kalbur dhe ruan rehatin e tij, gjersa arrin në tradhti.

U ndalëm te kjo shfaqje, që u nderua me çmimin e javës së teatrit, për problemet që ngre dhe vendin që zuri në këto takime teatrale kushtuar festave të mëdha. Po të hysh në hollësi dhe në analizë më të imtë, vërehen edhe mangësi, që kanë të bëjnë me ndonjë tablo apo skenë të paarritur, të dhënë në mënyrë agjitative, me momente të zgjatura dhe jo gjer në fund funksionale. Po, në tërësi, përshtypja ishte shumë e mirë dhe njerëzve që ndiqnin nga salla ngjarjet e shtjelluara në skenë, u përçoheshin ndjenjat dhe u shkaktohesh një emocion i vërtetë.

Me interes të veçantë u ndoqën shfaqjet e Fierit «**Dy krisma në Paris**» (dramë e Sh. Mitës, P. Kullës, regjia P. Kulla) dhe «**Gjaku i Arbrit**» (dramë e F. Krajes, regjia e S. Fankut), si edhe dramat e tjera me temë historike e teatrit të Vlorës dhe të Elbasanit. Autorët e dramave dhe teatrot u janë drejtuar figurave dhe ngjarjeve të njohura dhe të rëndësishme nga e kaluara jonë historike. Është bërë përpjekje për një interpretim bashkëkohor, ndonëse simbolik të baladave që mbështeten mbi besnikërinë e vëllait të vdekur, i cili dha fjalën dhe e solli të motrën (Garantinën apo Dhoqinën etj.) martuar tre male larg, gërshetuar edhe në balada të tjera.

Spektatorët ndoqën me vëmendje shfaqjen e Fierit, mbështetur mbi ngjarjen reale të atentatit që patrioti Avni Rustemi i bëri në Paris tradhtarit të urreyer të popullit Esat Toptanit dhe, sidomos të gjyqit që

u zhvillua në Paris pas këtij atentati. Kjo është një dramë e mbështetur në dokumentacion dhe e zhvilluar mbi një logjikë të fortë, me një debat politik të mprehtë, me çaste kur fjala e Avniut në shfaqje shkaktoi emocione dhe u shoqërua me duartrokitje të spektatorëve. Pati edhe dobësi, si hyrja e pamotivuar sa duhet, konceptimi disi grotesk i Esat Toptanit etj., po në tërësi shfaqja la mbresa të thella. Tensioni dramatik i gjyqit, dinamika e mendimit, përgjigjet e mençura të të akuzuarit, që u shndërrua në akuzues si edhe të avokatit francez e bëjnë shfaqjen interesante dhe pasurojnë repertorin e teatrit tonë si edhe mënyrat regjisoriale ku spikat një zbërthim intensiv, i përqendruar në procesin e gjyqit, me një mizanskenë të pastër dhe të studiuar mirë. Aktorë si Fatos Sela, në rolin e A. Rustemit, Vladimir Musha në rolin e avokatit, Muhamet Sherri të Xhafos apo Dervish Biba në të prokurorit etj. u shquan për lojën e tyre realiste, tension dramatik dhe me patos, ironi e qesëndi, sipas karakterit dhe rastit.

Temën patriotike e trajtuan edhe teatri i Vlorës me «**Lidhur si fishek gjerdani**» (drama e B. Kozelit, regjia P. Gjoka, L. Filipi) si edhe i Elbasanit me «**Tokë e ndezur**» (dramatizim nga F. Balliu i romanit të shkrimtarit kosovar N. Rrahmani, regjia T. Shishmani).

Në shfaqjen e Vlorës u dalluan aktorët K. Roshi, L. Laska, A. Shuke etj. Në disa raste në këtë shfaqje vihej re një lloj emfaze e papërligjur për stilin e veprës, loja e aktorëve mbetej e jashtme, sepse edhe teksti binte në deklaratat. Gërshetimi i linjës kryesore, i luftës kundër pushtuesit me atë të mbeturinave të hakmarrjes mund të mos ishte i nevojshëm për këtë dramë, aq më tepër se kjo e dyta është mjaft e përdorur dhe, në këtë rast, e panevojshme.

Dashuria për vëllezërit e motrat kosovare, indinjata kundër qëndrimeve të serbomëdhenjve në ngjarjet e tanishme si dhe gjatë historisë, problemi i truallit amtari kanë frymëzuar trupën e Elbasanit në shfaqjen

e vjet që shquan për regji të mirë, lojë të aktorëve si D. Hyskja, E. Behili, Sh. Shmilli etj.

Siç u përmend, një subjekt baladash e legjendash kishte marrë trupa e Shkodrës në shfaqjen e saj. Dhe kjo flet për kërkime si nga dramaturgët ashtu edhe nga teatri, flet për mënyra origjinale. Mbështetja në legjenda apo mite të një populli që shprehin virtyte, përmbajtje filozofike të përparuar, kuptohet se është e pranueshme dhe pasuron zërat në fushën e krijimit. Por është e qartë, gjithashtu, se kalohet në këto mjete për të bërë një përgjithësim të gjerë filozofik apo poetik, për të arritur në një simbol të madh dhe jo për të zbuluar diçka shumë konkrete dhe të dukshme, sqarimi dhe dënoncimi i së cilës nuk do të kishte nevojë për legjendën. Këtë e themi jo se duhet abstraguar pa baza reale, po për të kuptuar më mirë veçorinë e gjinisë. Drama e F. Krajës, me gjithë meritat e saj, frymën poetike, bukurinë e fjalës dhe të figurës, kishte një kontradiktë të tillë, sepse mendohej të pajtonte simbolikën me një çmimizim të papërligjur plotësisht dhe që nuk e thellon, por e zbeh disi idenë fillestare të mendimit popullor. Veç asaj, skena si dashuria e vajzës së mbretit blu (ç'nevojë ka për një mbret të tillë!) me djaloshin shqipëtar të lidhur në pranga është krejt e papërligjur dhe melodramatike. Shpëtimi i tij dhe ardhja me të motrën, Rinën, sfidon në një mënyrë skematike legjendën, e cila, sidoqoftë, në idenë e saj mbetet më e thellë: edhe i vdekur ai e mbajti fjalën! Le të kujtojmë me këtë rast novelën e Ismail Kadaresë «Kush e s'lli Doruntinën» (i njëjti subjekt në linjën kryesore), ku bëhen supozime (ç'është e vërteta edhe aventurioze e të tepëruar për ardhjen e Doruntinës), po ku më në fund, autori arrin në përfundimin se rëndësi ka që u mbajt fjala dhe se në këtë legjendë gjejmë dëshirën e madhe, ëndrrën e tij për të pasur të afërmit pranë, për të bërë edhe të pamundurën të mundur. Por, kuptohet, se kërkimet kanë të drejtën e tyre kur ideja themelore është e drejtë, drama dhe shfa-

qja përshkohen nga patriotizmi dhe nga një romanti-
kë me të cilën duhet të pasurohet teatri ynë, naty-
risht, në rrugë më bindëse. Desha të shtoj me këtë
rast se regjia ka bërë një punë të mirë e me fantazi,
ka skena mallëngjyese, me dekor të bukur e plot de-
taje konkrete e simbolike; muzika është zgjedhur me
mjeshtëri dhe është vendosur në çaste të përshtatshme.
Aktorë si T. Kurti, L. Bushati, S. Bala etj. u shquan
në këtë shfaqje për tonet e tyre poetike. Stili i vë-
prës dhe mënyra e përdorur nga regjisori kërkonin.
natyrisht, një poezi të brendshme ekspressive, gjë që
nuk do të thotë emfazë apo deklarativizëm. Shfaqje
teatrale më forcë shprehëse, ku fjala të kumbojë bu-
kur dhe t'i afrojë poezisë, janë të nevojshme dhe
shtojnë larminë e stileve. Aktorja e re P. Gruda u
dallua nga kjo pikëpamje në rolin e Rinës.

Jeta, e sotme, problemet me të cilat jeton shoqë-
ria jonë kanë tërhequr vëmendjen e dramaturgëve
dhe të teatrove. Drama apo komedi të mira me temë
aktuale kemi pasur, po më shumë duhet të shtoh-
hen përpjekjet dhe të rriten kërkesat artistike. Ko-
media e teatrit të Durrësit «Mirë se erdhe, Flona»
(vepra dhe regjia nga H. Rama), nuk thellohej në
problemin që shtronte. ndonëse krijonte një interes
te spektatori me disa situata komike dhe me lojën e
këndshme të aktorit të njohur Mirush Kabashi, që
mbante peshën kryesore të shfaqjes. Edhe aktorët F.
Ujkaj, K. Koti etj. u shquan për lojë të mirë.

Të dy shfaqjet me temë të ditës, e Gjirokastrës
dhe e Korçës, niseshin nga probleme të mprehta të
kohës: edukimi i njeriut në punë dhe lufta kundër
psikologjisë mikroborgjeze. Qëllimi dhe pikënisja ishin
të mira, por rezultatet nuk ishin të dëshiruara.

Shfaqja e Gjirokastrës (drama M. Qillari, regjia
B. Kokalari) trajtoi një problem të punës së përdit-
shme të punonjësve në një laborator, përpjekjet e
kimistes Ana për të pasuruar një mineral të rëndësi-
shëm, që të mos importohet nga jashtë. Ajo bëri një
gabim dhe del pastaj përballë Halili, një koleg in-

trigant që kurdis plane për t'ia hedhur dhe rënduar fajin Anës. Drama nis mirë, po në vend që të thellohet në konflikt dhe në karakteret kthehet më shumë në një analizë teknikiste dhe humbet interesi letrar e skenik. E para, konflikti nuk është gjetur mirë, nuk është real dhe i besueshëm, e dyta, marrëdhëniet midis personazheve kryesorë nuk zgjidhen me realizëm. Halili, ai intrigant aq smirëzi, papritur kthehet e bëhet i mirë. Këtë ne nuk e shohim, veçse na thuhet se paska bërë autokritikë. Trupa e Gjirokastrës, siç dihet, ka forca të mira, po duhet të kërkohej më shumë materiali letrar. Aktorë si B. Kokalari, D. Hila, K. Konomi etj., luajtën mirë dhe u munduan ta mbanin lojën në një nivel realist.

Po kështu edhe shfaqja e Korçës, siç është pohuar edhe në diskutime e në artikuj kritikë, doli e zbehtë, me një trajtim skematik e me një thurje të panatyrshme të subjektit. Edhe këtu dobësitë bien mbi dramën, e cila mbetet e sipërfaqshme dhe nuk arrin të krijojë emocione. Trupa e Korçës, e njohur për rezultatet e saj, me regjisor Dh. Orgockën, aktorë të njohur si P. Raidhi, S. Shkurti, Th. Filipi, etj. ka mundësi të mëdha.

Me gjithë anët e dobëta dhe problemet që dalin, java e teatrit kombëtar ishte një veprimtari e gjallë, që u ndoq me interes, pati arritje dhe ndihmoi për t'u hapur udhën më tej shfaqjeve të tjera edhe më të mira. Detyrat që shtron Kongresi i 8 i Partisë, porosinë e shokut Enver për kulturën, letërsinë e artin, janë një frymëzim i madh edhe për teatrin tonë, për cilësi më të lartë dhe për trajtimin më të mirë të aktualitetit socialist, ku ndihen nevoja më të mëdha.

The following information was obtained from a review of the records of the Department of the Interior, Bureau of Land Management, concerning the acquisition of land for the establishment of the National Park System. The records indicate that the following lands were acquired for the National Park System:

1. The first acquisition was the purchase of the Aniakchak National Monument in Alaska, established in 1925.

2. The second acquisition was the purchase of the Denali National Monument in Alaska, established in 1925.

3. The third acquisition was the purchase of the Katmai National Monument in Alaska, established in 1924.

4. The fourth acquisition was the purchase of the Mount St. Helens National Monument in Washington, established in 1902.

5. The fifth acquisition was the purchase of the Mount Rainier National Monument in Washington, established in 1899.

6. The sixth acquisition was the purchase of the Mount Hood National Monument in Oregon, established in 1902.

7. The seventh acquisition was the purchase of the Mount Hood National Monument in Oregon, established in 1902.

8. The eighth acquisition was the purchase of the Mount Hood National Monument in Oregon, established in 1902.

9. The ninth acquisition was the purchase of the Mount Hood National Monument in Oregon, established in 1902.

10. The tenth acquisition was the purchase of the Mount Hood National Monument in Oregon, established in 1902.

PASQYRA E LËNDËS

Në mbrojtje të parimeve të realizmit socialist

Analizë marksiste-leniniste dhe frymëzim për zhvillimin e gjithanshëm të artit	5
Kuptimi i drejtë i realizmit socialist dhe lufta për mbrojtjen e tij	12
Frymë socialiste dhe origjinalitet kombëtar	22
Njohje e thellë e jetës, formim më i plotë botëkuptimor	27
Vepra më të shumta dhe më të mira kushtuar realitetit tonë socialist	33
Aspekte të sotme të revizionizmit sovjetik në teorinë dhe praktikën artistike	43
Përparimi i kulturës sonë dhe zhvillimi i shijeve estetike	50

Drama, proza dhe poezia

Vështrim mbi dramën tonë — brendia dhe arti i saj (1974-1978)	61
Historia dhe e sotmja në romanin shqiptar	89
Pasqyrimi i kohës sonë dhe historisë në romanin e viteve të fundit	99
Prirje të poezisë së kohëve të fundit në përmbajtje dhe në formë	131

Procesi krijues i shkrimtarit

Për krijimtarinë e Dritëro Agollit	145
Poeti dhe kritiku militant	177

Kritikë dhe përshtypje

Arti i madh i popullit	187
Arti i recitimit dhe poezia e një shfaqjeje	194
Frymëmarrje e gjerë popullore	199
Vlerat shoqërore dhe shtrati popullor i një vepre	208
Triumf shpirtëror i popullit	214
Ata kishin një nënë të madhe	219
Disa mendime për kritikën	225
Teatër-1981	229

NDREQJE GABIMESH

Faqe	Kreshti	Si është	Si duhet
24	34	vizatuar	vizituar
134	11	është përsëritur gabimisht, të kapërcehet	

Lokë 10

**VEPRA
DHE
PROBLEME
TË
REALIZMIT
SOCIALIST**